

POZITA JURIDIKE E MINORITETEVE NË SHQIPËRI GJATË VITEVE 1920-1930

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Juridike, me profil e Drejtë Publike, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Punoi: doktorant Marenglen Çobo

Udhëheqës shkencor: prof. as. dr. Erjona Canaj

Numri i fjalëve: 52. 500

Tiranë, shtator 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar ndonjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban materiale të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

© Copyright:

Marenglen Çobo 2017. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.

ABSTRAKT

Minoritetet në Shqipëri kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kulturës dhe formimin e një shteti me administratë të strukturuar sipas modelit të shteteve të Evropës Perëndimore. Rëndësia e tyre do të përforcohej akoma më shumë në momentin e pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, kur anëtarësimi i vendit në këtë organizatë do të kushtëzohej me garantimin nga shteti shqiptar i një regjimi të minoriteteve. Impenjimi që do të merrte vendi rreth kësaj çështjeje do të siguronte mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar, jo vetëm në miratimin dhe aprovimin e një legjislacioni sipas modelit evropian por, sidomos, në dërgimin e Komisionit Ndërkombëtar që do të hetonte gjendjen e popullsisë dhe do të ofronte ndihmë në zhvillimin ekonomik. Me stabilizimin ekonomiko-politik të vendit, shteti ndërmernte një sërë reformash të cilat kishin si qëllim promovimin e parimit të barazisë përpara ligjit të gjithë nënshtetasve pa dallim race, gjuhe apo besimi fetar. Forcimi i shtetit shqiptar bënte të mundur përqëndrimin e vëmendjes së tij edhe mbi problemet dhe vështirësitë me të cilat përballej popullsia minoritare. Të rëndësishme në këtë drejtim ishin ligjet e aprovuara, që kishin të bënin me përmirësimin e sistemit arsimor dhe me përforcimin e lirisë së ndërgjegjjes fetare. Të dyja këto tematika shteti mendohej t'i trajtonte sipas standardeve të kohës të vendosura nga komuniteti ndërkombëtar.

Masat apo reformat që ndërmernte shteti shqiptar, siç ishin shtetëzimi i shkollave apo mbështetja e madhe që i jepej krijimit të Kishës Autoqefale Shqiptare, do të ngjallnin kundërshtime të popullsisë minoritare dhe kishës greke. Shpesh herë këto kundërshtime do të ishin në një farë mase të drejta pasi me ndërhyrjet e tij, shteti në disa raste, do të cënonte në mënyrë të kufizuar të drejtat e kësaj pjese të popullsisë. Pavarësisht miratimit të këtyre reformave, të drejtat e minoriteteve në Shqipëri gjatë viteve 1920-1930, do të garantoheshin nga legjislacioni i brendshëm në përputhje me standardet e vendosura nga komuniteti ndërkombëtar.

Fjalë kyçe: Minoritetet, legjislacion, shteti shqiptar, parimi i barazisë, Lidhja e Kombeve.

ABSTRACT

Minorities in Albania have played a crucial role in the country's culture and in the structuration of the state's administration according to western models. Before joining the league of Nations in 1921, Albania would have had first to guarantee the respect of the national minorities living in its territory. It is in this occasion that minorities become more and more important to the new state. The acceptance and the respect of these minorities would gain Albania the approbation of the international community. This would lead to the formation of European style legislation and the presence of an International Committee. The Committee was to investigate the situation of the population and would also help in the economic development of the country.

As a result of the economic and the political stabilization of the country, the state would start a series of reforms to promote the equality of all the Albanian citizens without distinctions of race, language or religion. The consolidation of the state allowed Albania to give more attention and concentrate more than ever before on the problems faced by minorities. Very important in this direction was the approbation of laws that aimed the improvement of the teaching system and the enforcement of the religious freedom. Both these were handled according to modern international standards.

The measures and the reforms undertaken by the state in the nationalisation of the teaching system or in the creation of the Albanian Orthodox church faced the opposition of both the minorities and the Greek Orthodox Church. This aversion was justified because, in some points, the Albanian state restricted the freedom of these minorities. However, despite these reforms, in 1920-1930 the rights of the Albanian minorities were fully guaranteed by a legislation that was in accordance with international standards.

Keywords: Minorities, legislation, Albanian state, equality, League of Nations.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE DHE BAZIMI TEORIK

1.1. HYRJE.....	1
1.2. RËNDËSIA E STUDIMIT.....	3
1.3. OBJEKTI I STUDIMIT.....	3
1.4. HIPOTEZAT DHE PYETJET KËRKIMORE.....	5
1.4.1. Hipotezat kërkimore.....	5
1.4.2. Pyetjet kërkimore.....	5
1.5. METODOLOGJIA DHE METODAT E KËRKIMIT.....	6
1.6. KUFIZIMET E STUDIMIT.....	7
1.7. PËRMBLEDHJA DHE STRUKTURIMI I STUDIMIT.....	8

KAPITULLI II: SISTEMI NDËRKOMBËTAR DHE PËRPJEKJET PËR AFIRMIMIN E TË DREJTAVE TË MINORITETEVE

2.1. FORMIMI I SHTETIT-KOMB DHE MINORITETET.....	12
--	----

2.2. LIDHJA E KOMBEVE DHE SISTEMI I GARANCIVE TË MINORITETEVE NË ARENËN NDËRKOMBËTARE.....	18
2.3. PËRKUFIZIMI I PAKICAVE KOMBËTARE	24
2.3.1. Pakicat etnokulturore.....	25
2.3.2. Minoritetet fetare.....	26
2.4. MINORITETI KOMB.....	27
2.5. MINORITETI I FUQISHËM.....	28
2.6. MINORITETI I PAFORMUAR.....	29

KAPITULLI III: ÇËSHTJA E MINORITETEVE NË KONFERENCËN E PAQES

3.1. FORMIMI I IDENTITETIT KOMBËTAR DHE KONFERENCA E PAQES.....	30
3.2. MINORITETI GREKOFON DHE RIVENDIKIMET TERRITORIALE TË SHTETIT GREK.....	33
3.3. NJOHJA E MINORITETEVE NGA QEVERIA SHQIPTARE NË KONFERENCËN E PAQES.....	41
3.4. ÇËSHTJA “VORIO-EPIRIOTE” NË KONFERENCËN E PAQES.....	47

3.5. FUQITË E MËDHA DHE PËRCAKTIMI I KUFIRIT TË SHQIPËRISË SË JUGUT.....	51
--	----

KAPITULLI IV: MINORITETET NË SHQIPËRI GJATË VITEVE 1920-1930

4.1. MINORITETI KOMBËTAR GREK.....	59
4.2. MINORITETI KOMBËTAR MAQEDONAS.....	64
4.3. MINORITETI KOMBËTAR SERBO-MALAZES.....	66
4.4. MINORITETI ETNOKULTUROR ARUMUN.....	67
4.5. MINORITETI ETNOKULTUROR ROM.....	70

KAPITULLI V: ANËTARËSIMI NË LIDHJEN E KOMBEVE DHE HETIMET E KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR NË SHQIPËRI

5.1. PËRPJEKJET PËR KONSOLIDIMIN E INSTITUCIONEVE KOMBËTARE DHE KONGRESI I LUSHNJËS.....	72
5.2. STATUTI I ZGJERUAR I LUSHNJËS DHE SANKSIONIMI I PARIMIT TË BARAZISË TË QYTETARVE PËRPARA LIGJIT.....	75
5.3. ANËTARËSIMI I SHQIPËRISË NË LIDHJEN E KOMBEVE.....	78

5.4. DEKLARATA MBI MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË MINORITETEVE NË SHQIPËRI.....	80
5.5. KOMISIONI NDËRKOMBËTAR DHE HETIMET MBI POPULLSINË NË SHQIPËRI.....	88
5.5.1. Kryengritja e fiseve katolike të Mirditës kundër monopolit të pushtetit mysliman të Tiranës.....	93
5.5.2. Lëvizja patriotike dhe mungesa e minoritetit grek në Korçë.....	96
5.6. SITUATA POLITIKE NË SHQIPËRINË E JUGUT.....	102
5.7. PROTESTAT E POPULLSISË HIMARIOTE KUNDËR REFORMAVE TË SHETIT SHQIPTAR.....	105
5.8. TË DHËNAT KONTRADITORE MBI POPULLSINË DHË VËSHTIRËSIA NË PËRCAKTIMIN E PAKICAVE.....	111
5.9. PËRFAQËSIMI I POPULLSISË NË POLITIKË DHE PUNËSIMI I SAJ NË ADMINISTRATËN LOKALE SIPAS BESIMIT FETAR.....	114
5.10. REKOMANDIMET E KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR MBI ÇËSHTJEN E MINORITETEVE.....	119

KAPITULLI VI: REFORMA ARSIMORE DHE BESIMET FETARE NË SHQIPËRI

6.1. GJENDJA E ARSIMIT NË SHQIPËRI.....	124
6.2. UNIFIKIMI I SISTEMIT ARSIMOR DHE SHTETËZIMI I SHKOLLAVE.....	127
6.3. SHKOLLAT E MINORITETIT GREK NË SHQIPËRINË E JUGUT.....	133
6.4. PROTESTAT E GREQISË KUNDËR REFORMËS ARSIMORE.....	141
6.5. SHKOLLAT E MINORITETIT MALAZEZ NË SHQIPËRINË E VERIUT.....	147
6.6. SITUATA E SHKOLLAVE TË MINORITETIT ETNOKULTUROR ARUMUN NË SHQIPËRI.....	150
6.7. BESIMET FETARE NË SHQIPËRI.....	155
6.8. LAICITETI I SHTETIT SHQIPTAR SI GARANCI E TË DREJTAVE TË MINORITETEVE FETARE.....	160
6.9. STATUTI LEGAL I KOMUNITETEVE FETARE.....	163
6.10. KRIJIMI I KISHËS AUTOQEFALE SHQIPTARE NËN FRYMËN E RESPEKTIMIT TË MINORITETEVE.....	166

PËRFUNDIME.....	175
------------------------	------------

BIBLIOGRAFIA.....	186
--------------------------	------------

LISTA E TABELAVE

Tabela nr. 1. Numri i deputetve të ndarë sipas përkatësisës fetare të llogaritur me popullsinë e çdo prefekturë në viti 1920.	116
Tabela nr. 2. Numri i përgjithshëm i shkollave në Shqipëri gjatë vitit 1921.	124
Tabela nr. 3. Popullsia në krahinën e Korçës e ndarë sipas qeverisë greke në shqiptarë dhe grekë.	142
Tabela nr. 4. Popullsia në krahinën e Gjirokastrës e ndarë sipas qeverisë greke në shqiptarë dhe grekë.	142
Tabela nr. 5. Popullsia në një pjesë të krahinës së Janinës e ndarë sipas qeverisë greke në shqiptarë dhe grekë.	142
Tabela nr. 6. Shkollat arumune në Shqipëri përpara 1912 të paraqitura në bazë të numrit të nxënësve dhe personelit për çdo lokalitet.	152
Tabela nr. 7. Shkollat arumune në Shqipëri pas 1927 të paraqitura në bazë të numrit të nxënësve dhe personelit për çdo lokalitet.	154
Tabela nr. 8. Popullsia e ndarë në prefaktura sipas përkatësisës fetare në Shqipëri në vitin 1923.	155
Tabela nr. 9. Popullsia shqiptare e ndarë në tre krahina sipas përkatësisës fetare dhe përqindja që zë çdo besim fetar në secilën nga këto krahina.	156

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

FM - FUQITË E MËDHA

GJPDN - GJYKATA E PËRHERSHME E DREJTËSISË NDËRKOMBËTARË

KASH - KISHA AUTOQEFALE SHQIPTARE

KH - KOMISIONI HETIMOR

KLK - KËSHILLI I LIDHJES SË KOMBEVE

KNK - KOMISIONI NDËRKOMBËTAR I KONTROLLIT

KQ - KONFERENCA E PAQES

LK - LIDHJA E KOMBEVE

MA - MINISTRIA E ARSIMIT

MPB - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

MPJ - MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

KAPITULLI I: HYRJE DHE BAZIMI TEORIK

1.1. Hyrje

Minoritet kanë zënë një vend të rëndësishëm gjatë shek. të XX, në formimin e shteteve kombëtare, sidomos, në Gadishullin e Ballkanit. Prezenca e kësaj pjese të popullsisë brenda territoreve të shteteve ballkanike, shpesh herë është përdorur për të justifikuar shpërthimin e konflikteve të armatosura, të cilat kishin si qëllim të vetëm zgjerimin territorial të këtyre shteteve në kurriz të shteteve fqinje. Shqipëria është shteti i fundit në Ballkan që fitonte pavarësinë nga Perandoria Osmane. Pushtimi pothuajse pesë shekullor i vendit linte shumë pasoja që do të ndikonin negativisht në krijimin e një ndjenje kombëtare shqiptare. Por, dobësimi i kësaj ndjenje bënte të mundur krijimin e një shoqërie ku diversiteti etnik, gjuhësor dhe fetar ishin të pranuar nga popullsia shqiptare. Mungesa e zhvillimit të nacionalizmit, ndryshe nga shtetet e tjera ballkanike, nuk arrinte të garantonte krijimin e një shteti të fortë e të pavarur, të mbrojtur nga ndërhyrjet e jashtme, të cilat kishin si qëllim kryesor shpërbërjen e Shqipërisë.¹ Prezenca e popullsisë minoritare në territoret e shtetit të ri shqiptar, kufijtë e të cilit do të vendoseshin padrejtësisht nga Fuqitë e Mëdha, do të vërtetohej nga të dhënat statistikore që ofronin fillimisht Perandoria Osmane e më vonë Austro-Hungaria dhe Italia. Kjo ndodhte pasi administrata e shteti shqiptar që do të formohej nuk ishte në gjendje të bënte regjistrimin e popullsisë sipas përkatësisë kombëtare. Por pavarësisht gjendjes të brishtë në të cilën ndodhej shteti dhe rreziqet e një

¹ Albert Mousset, *Shqipëria përball ë Europës (1912-1929)*, "Dituria", Tiranë, f. 32.

coptimi të territoreve që i vinin nga vendet fqinje, Shqipëria nuk do të ndërmernte asnjë vendim diskriminues kundër minoriteteve që jetonin brenda kufijve të saj.² Këtë qëndrim miqësor e vërtetonte prezenca e shkollave që i përkisnin pakicave, ku fëmijët mund të mësonin lirisht gjuhën e tyre amtare dhe të trashgonin identitetin e tyre kombëtar.³ Shteti shqiptar do të mbante gjithmonë një qëndrim tolerues në drejtim të këtyre popullsive dhe do t'u jepte mundësinë të zhvillonin lirisht kulturën e tyre. Gjithashtu, shteti do të ndiqte një politikë të mosndërhyrës edhe në lidhje me besimin fetar. Në Shqipëri liria e ndërgjegjjes fetare dhe predikimi ishin të garantuara⁴ dhe çdo besimtari i njihej e drejta të ndërronte fenë sipas rregullave të vendosura nga komunitetet fetare.

Shteti shqiptar, ndoshta duke u ndikuar edhe nga kushtetutat e vendeve evropiane, lidhur me të drejtat e nënshtetasve do të vinte në themelet e veta parimin e barazimit përpara ligjit. Ky parim do të ishte një e drejtë kushtetuese që do t'u garantohej të gjithë nënshtetasve që jetonin në territorin e vendit.

Pavarësisht faktit që termi “minoritet” nuk përmendej në Kushtetutë (ose siç quhej ndryshe Statuti Themeltar) parimi i barazisë vlente edhe për këtë pjesë të popullsisë. Një shtytje vendimtare në fushën e të drejtave të minoriteteve Shqipëria do ta merrte në momentin e pranimit në Lidhjen e Kombeve. Ky është një nga momentet më domethënëse në historinë e shtetit, pasi siguronte pavarësinë dhe njohjen e tij në arenën ndërkombëtare.⁵ Anëtarësimi në këtë organizatë detyronte qeverinë të firmoste Deklaratën mbi të Drejtat e

² Luan Omari, *Çështja e pakicave kombëtare*, “Guttenberg”, Tiranë, 2014, f. 48.

³ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, Tiranë, 2013, f.319

⁴ Aleks Luarasi, *Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri*, Luarasi, Tiranë, 1999, f. 109.

⁵ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2003, f. 348

Minoriteteve. Ky akt me karakter ndërkombëtar do të përbënte bazën mbi të cilin do të zhvillohej regjimi i minoriteteve. Duke u nisur dhe marrë parasysh këto konsiderime, ne do të zhvillojmë dhe të trajtojmë çështjen e pozitës juridike të minoriteteve.

1.2. Rëndësia e studimit

Në fokusin e këtij studimi qëndron afirmimi i pozitave juridike të të drejtave të minoriteteve gjatë viteve 1920-1930, nëpërmjet dokumenteve zyrtare të kohës dhe studimit të autorëve të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj. Studimi i jep përparësi të drejtave të minoriteteve në një periudhë shumë të rëndësishme për krijimin e shtetit shqiptar, i cili po luftonte për pavarësinë dhe mbijetesën e vet. Vështirësitë e arritjes së pavarësisë së Shqipërisë bënin që për këtë periudhë thelbësore për të ardhmen e vendit, studiuesit e ndryshëm të anashkalonin disi çështjen e minoriteteve, duke e lënë atë në plan të dytë. Punimi risjell në qendër të vëmendjes të drejtat e minoriteteve dhe ndikimin që kishin jo vetëm në afirmimin e të drejtave të qytetarëve në vend gjatë kësaj periudhe por, edhe rëndësinë që patën ato në njohjen e Shqipërisë si shtet i pavarur nga Lidhja e Kombeve.

1.3. Objekti i studimit

Ky punim ka si objekt studimi pozitën juridike në të cilën ndodheshin minoritetet në Shqipëri gjatë viteve 1920-1930. Në këtë periudhë, falë reformave dhe aprovimit të një sërë ligjesh, vërehej një përmirësim i ndjeshëm i kushteve socio-politike të minoriteteve që

jetonin në territorin e shtetit shqiptar. Ky përmirësim bëhej i mundur duke u garantuar të gjithë nënshtetasve shqiptarë një mbrojtje të plotë të jetës dhe lirisë së tyre, pa dallim lindjeje, kombësie, gjuhe, race dhe feje. Kjo mbrojtje sigurohej nëpërmjet statuteve themeltarë të miratuara gjatë këtyre viteve, ku në plan të parë do të vihej parimi i barazisë përpara ligjit dhe gëzimi i të gjitha atyre të drejtave civile e politike për çdo nënshtetas.

Synimi kryesor i punimit është që nëpërmjet dokumenteve zyrtare të arkivave të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe studimeve të bëra mbi minoritetet gjatë këtyre viteve, të analizojë evolucionin e ligjit të të drejtave të minoriteteve që jetonin brenda territorit të Shqipërisë. Gjithashtu, synim tjetër i punimit është të hedhë dritë mbi rëndësinë që ka patur impenjimi i Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, jo vetëm për evolucionin e këtyre të drejtave por, mbi të gjitha për garantimin dhe zhvillimin e një regjimi të minoriteteve.

Një tjetër synim i këtij punimi është të paraqesë në mënyrë të detajuar masat që do të marrë shteti shqiptar në aprovimin e një sërë ligjesh që kishin si qëllim ruajtjen dhe trashëgimin e identitetit kombëtar të minoriteteve. Kjo paraqitje do të bëhet nëpërmjet analizimit të ligjeve mbi arsimin dhe ligjeve që konfirmonin pavarësinë e komuniteteve fetare nga shteti. Si përfundim, synimi i këtij punimi është që me anë të të dhënave dhe dokumenteve zyrtare, të paraqes në mënyrë të detajuar minoritetet prezente në Shqipëri gjatë viteve 1920-1930. Kjo paraqitje do të bëhet, jo vetëm me anë të analizimit të të dhënave të mbledhura nga dokumentat historike por, duke paraqitur edhe të dhëna statistikore mbi numrin e secilës prej komuniteteve minoritare që jetonte në territorin e Shqipërisë.

1.4. Hipotezat dhe pyetjet kërkimore

1.4.1. Hipotezat kërkimore

Duke u bazuar në studimet e autorëve të cilët kanë trajtuar të njëjtën temë dhe premisat teorike, hipotezat që ngremë për këtë punim janë si më poshtë:

Hipoteza 1. Të drejtat e minoriteteve në Shqipëri gjatë viteve 1920-1930 janë respektuar në përputhje me ligjet ekzistuese në vend.

Hipoteza 2. Parimi i barazisë përpara ligjit është zbatuar edhe për atë pjesë të popullsisë, e cila për nga etnia, gjuha, feja dhe kultura përbënte minorancën.

Hipoteza 3. Lidhja e Kombeve kishte një rëndësi të madhe në imponimin e Shqipërisë për respektimin dhe garantimin e të drejtat e minoriteteve që jetonin brenda kufijve të saj.

Hipoteza 4. Komuniteteve minoritare u është lejuar pjesërisht zhvillimi dhe trashëgimi i identitetit, pasi shteti, nëpërmjet reformave arsimore, do të kufizonte çeljen e shkollave të minoriteteve.

1.4.2. Pyetjet kërkimore

Duke hedhur një vështrim historiko-juridik sistemit ligjor të vendit tonë, që rregullonte regjimin e minoriteteve gjatë viteve 1920-1930 dhe duke analizuar rëndësinë që këto ligje kishin, jo vetëm për mbrojtjen e kësaj pjese të popullsisë, por edhe për

trashëgimin e vlerave, të kulturës e identitetin kombëtar të tyre linden disa pyetje kërkimore:

- A janë respektuar plotësisht të drejtat e minoriteteve në Shqipëri gjatë viteve 1920-1930 sipas atyre pak ligjeve që ekzistonin në vend?
- A është respektuar edhe për popullsinë minoritare parimi i barazisë përpara ligjit që garantohej nga statutet e ndryshme të aprovuara gjatë atyre viteve?
- A janë respektuar detyrimet ligjore të marra nga Shqipëria për minoritetet gjatë momentit të firmosjes së “Deklaratës mbi mbrojtjen e minoriteteve”, akt juridik ndërkombëtar ky që vendoste krijimin e një regjimi të pakicave?
- Deri në çfarë mase u është lejuar komuniteteve minoritare zhvillimi dhe trashëgimi i identitetit të tyre, duke patur si synim të drejtën e çeljes së shkollave dhe lirinë e predikimit të besimeve fetare nga shteti shqiptar?

1.5. Metodologjia dhe metodat e kërkimit

Metodologjitë kryesore të zgjedhura për të kryer këtë kërkim janë historike, analitike dhe përshkrimore. Është zgjedhur metoda përshkrimore duke qenë se “qëllimi kryesor i kësaj metode është të përshkruaj faktet, ngjarjet, statusin e të dhënave ashtu siç kanë qenë gjatë kohës që fokusohet studimi. Duke qenë se në thelb të këtij hulumtimi është raportimi i ngjarjeve historiko-juridike, i afirmimit të të drejtave të minoriteteve, i grumbullimit të të dhënave, i efekteve që projektimi ka në procesin e zhvillimit të identitetit minoritar si dhe i faktorëve që ndikojnë kryesisht duke u bazuar edhe në rishikimin e

literaturës kombëtare dhe të huaj , por pa influencuar në këta variabla, e bëjnë këtë kërkim të tipit përshkrimor. Në kapitullin e katërt, të pestë dhe të gjashtë, në të kundërt është përdorur metoda analitike, ku të dhënat e grumbulluara, ligjet, faktet, informacionet e mbledhura, analizohen duke bërë një vlerësim kritik të tyre.

Për përgatitjen e kapitullit e dytë dhe të tretë metoda e kërkimit është bazuar kryesisht në literaturën dhe studimin e të dhënave të kryera më herët, kështu që burimi i të dhënave kanë qënë të llojit parësor, sekondar, por edhe terciar, duke qënë se këta kapituj bazohen kryesisht në shpjegimin e termit “minoritet” dhe zhvillimeve historike në Shqipëri. Gjithashtu, nëpërmjet këtyre të dhënave shpjegohen faktorët kryesor që kanë ndikuar në afirmimin e të drejtave të pakicave.

Për realizimin e kapitujve të tretë e të pestë kërkimi është bazuar kryesisht në të dhënat primare ku janë marrë në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe në koleksionet e Bibliotekës Kombëtare.

1.6. Kufizimet e studimit

Pavarësisht se punimi është i përcaktur mirë në një kontekst kohor dhjetëvjeçar, fakti që analizohet një periudhë ku shteti shqiptar sapo kishte filluar të konsolidonte strukturat e veta, nuk të jep mundësinë të kesh një kuadër të plotë mbi legjislacionin e brendshëm që trajtonte të drejtat e minoriteteve. Gjatë kësaj periudhe pushteti ekzekutiv dhe ai ligjvënës ishin të përqëndruar në hartimin e një sërë ligjesh, që kishin si qëllim konsolidimin dhe ndarjen e pushteteve. Kjo bënte që garantimi i të drejtave të minoriteteve

të dilte në plan të dytë. Ato do afirmoheshin në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë në parimet e të drejtave të përgjithëshme politike dhe sociale të nënshtetasve që garantoheshin në Statutet Themeltare.

Gjithashtu, mungesa e një institucioni kombëtar, të krijuar posaçërisht për mbledhjen e të dhënave statistikore mbi popullsinë me kombësi shqiptare në përgjithësi dhe asaj minoritare në veçanti, që jetonte brenda kufijve të shtetit shqiptar, e bën të vështirë paraqitjen e një punimi me të dhëna statistikore të sakta dhe të larmishme mbi nënshtetasit që përbënin komunitetet minoritare. Një tjetër kufizim është fakti që ky punim paraqet pozitën juridike jo vetëm të popullsisë së një minorance në veçanti por, të popullsisë të të gjitha minoriteteve që jetonin në Shqipëri gjatë viteve 1920-1930. Kjo lloj paraqitje vështirëson zhvillimin e një studimi më të detajuar të secilës pakicë, duke bërë që here pas here disa aspekte ose karakteristika të minoriteteve të mos vihen në dukje në detaje.

1.7. Përmbledhja dhe strukturimi i studimit

Ky kërkim është konceptuar në gjashtë kapituj kryesor, të ndjekur nga përfundimet, ku kombinohen gjatë gjithë punimit kriteri historik me atë juridik. Disertacioni është menduar në pjesë të cilat trajtojnë një çështje të rëndësishme, siç ishin të drejtat e minoriteteve, gjatë një hapësire kohore themeltare për formimin e shtetit të pavarur shqiptar. Hulumtimi i grupuar në gjashtë kapituj kryesorë lidhet me gjashtë tema thelbësore:

Kapitulli I: Hyrje dhe bazimi teorik. Ky kapitull përbën pjesën e paraqitjes së punimit, të punës së bërë për realizimin e tij, të rëndësisë së studimit dhe objektivit të

studimit, hipotezat dhe pyetjet kërkimore të parashtruara, metodologjia dhe metodat e përdorura për realizimin e këtij punimi dhe si përfundim ndalet në kufizimet që punimi nuk ka arritur të shprehë.

Kapitulli II: Sistemi Ndërkombëtar dhe përpjekjet për afirmimin e të drejtave të minoriteteve. Ky kapitull bën një analizë të mënyrës se si lindte çështja e minoriteteve dhe si trajtohej në arenën ndërkombëtare. Gjithashtu, me zhvillimin e punimit në këtë kapitull trajtohet përkufizimi juridik i këtij termi nga Gjykata e Përhershme Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe përcaktimi i sistemit të garancive të minoriteteve nga Lidhja e Kombeve. Së fundimi vijohet me klasifikimin e minoriteteve, ku renditen minoriteti komb, minoriteti i fuqishëm, minoriteti i paformuar dhe pakicat etno-kulturore.

Kapitulli III: Çështja e minoriteteve në Konferencën e Paqes. Në këtë kapitull bëhet një përshkrim i zhvillimeve historike që karakterizoheshin nga vështirësitë e afirmimit të gjuhës shqipe, e cila do të ndihmonte në formimin e identitetit kombëtar shqiptar. Më pas punimi trajton ballafaqimet që Shqipëria do të kishte me Greqinë në Konferencën e Paqes, ku në qendër të diskutimit do të ishte minoriteti grek në jug të vendit dhe njohja për herë të parë, në një konferencë ndërkombëtare, nga shteti shqiptar i popullsisë minoritare.

Kapitulli IV: Minoritetet në Shqipëri gjatë viteve 1920-1930. Kapitulli i katërt bën një analizë të detajuar të të gjitha minoriteteve prezente në territorin e shtetit shqiptar, duke i paraqitur ato një nga një të veçuara nga njëra-tjetra. Fillimisht analizohet minoriteti kombëtar grek, i cili ishte edhe më rëndësishmi, duke vazhduar me

minoritetin kombëtar maqedonas dhe atë serbo-malazes. Së fundmi, kapitulli mbyllet me analizimin e minoritetet etnokulturor arumun dhe atë rom gjatë viteve 1920-1930.

Kapitulli V: Anëtarësimi në Lidhjen e Kombeve dhe Komisioni

Hetimor në Shqipëri. Ky kapitull i dedikohet përforsimit të strukturave të brendshme të shtetit pas Kongresit të Lushnjës dhe anëtarësimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Ky hap që merrte shteti i ri në planin ndërkombëtar lidhej ngushtë me firmosjen e Deklaratës mbi të Drejtat e Minoriteteve, e cila ishte baza për krijimin e një regjimi të pakicave në vend. Gjithashtu, kapitulli bën dhe një analizë të operimit të Komisionit Hetimor në Shqipëri, i cili kishte si detyrë përcaktimin e vijës kufitare të shtetit, duke u bazuar në një hetim të detajuar të popullsisë që jetonte në territorin e vendit.

Kapitulli VI: Reforma arsimore dhe besimet fetare në Shqipëri.

Kapitulli i gjashtë bën një analizë të gjendjes së sistemit arsimor në Shqipëri, duke paraqitur një kuadër të hollësishëm me të dhëna statistikore të shkollave shqiptare dhe shkollave që i përkisnin minoriteteve. Kjo paraqitje e shkollave shoqërohet edhe me analizimin e ligjeve të ndërmarra nga shteti shqiptar për reformimin e sistemit arsimor, të cilat do të kundërshtoheshin përpara Lidhjes së Kombeve nga Greqia. Pjesa e dytë e kapitullit i dedikohet besimeve fetare në Shqipëri dhe parimit të laicitetit të shtetit si garanci e minoriteteve fetare. Ky parim afirmohej në Statutet Themeltare që aprovoreshin në Shqipëri gjatë vite 1920-1930 dhe shërbente për të përcaktuar ndarjen e pushtetit shpirtëror ndaj atij shtetëror. Si përfundim, kapitulli i dedikon një hapësirë krijimit të Kishës

Autoqefale Shqiptare, e cila në statutin e saj nuk nguronte të garantonte të drejtat e pakicave ortodokse (greke, malazeze dhe maqedonase), ku parashikonte që për këtë pjesë të popullsisë shërbimet fetare të kryheshin në gjuhën e tyre amtare.

Përfundimet: Jepet një sintezë e të gjitha fakteve dhe dukurive që zbulohen gjatë trajtimit të tyre në kapitujt dhe nënçështjet e veçanta. Gjithashtu, paraqiten edhe problemet dhe çështjet e hapura e të shtruara për shtjellime dhe interpretime të mëtejshme.

KAPITULLI II: SISTEMI NDËRKOMBËTAR DHE PËRPPJEKJET

PËR AFIRMIMIN E TË DREJTAVE TË MINORITETEVE

2.1. Formimi i shtetit-komb dhe minoritet

Koncepti i minoriteteve nuk është aspak i ri. Ai prej kohësh ka shqetësuar paqen botërore dhe ka qenë një motiv përplasjesh në marrëdhëniet ndërmjet shteteve të ndryshme. Koncepti i minoriteteve ka përcaktuar gjithashtu konflikte të shumta, të justifikuara apo jo, të cilat kanë shkaktuar luftra në një pjesë të madhe të komunitetit ndërkombëtar. Çështja e minoriteteve ka lindur si pasojë e afirmimit të shtetit komb,⁶ pasi gjatë kësaj periudhe përforcohej bindja, që një shtet të ishte legjitim dhe solid duhej të formohej nga një popullsi me histori, gjuhë dhe tradita të përbashkëta. Mbi bazën e këtij soliditeti historik dhe kultural populli duhej të ndihej pjesë e një kombi.⁷ Formimi i shtetit-komb presupozonte ndërthurjen e disa elementeve, siç ishin, territori i mirëpërcaktuar dhe mbi të prezencën e një popullsie që zgjidhte t'i përkiste të njëjtit shtet. Kuptohet që formimi i shtetit-komb varej nga vullneti i popullsisë që ekzistonte dhe jetonte në atë territor. Problemi lindte kur një pjesë e popullsisë nuk ndihej e përfaqësuar në këtë komb. Kjo pjesë e popullsisë që për nga ana numerike ishte më e pakët në numër në krahasim me popullsinë që jetonte në territorin e shtetit-komb do të përbënte minoritetin. Historia e mbrojtjes së minoriteteve do të niste me përpjekjet e ndërmarra për të siguruar mbrojtjen e pakicave fetare nga konfliktet

⁶ Émile Chanoux, *Mémoire de licence, delle minoranze etniche nel diritto internazionale*, l'Universita di Torino, 1927-1928, f.2.

⁷ Claudio Cerreti, *Minoranze etnico-linguistiche*, Enciclopedia dei ragazzi, 2006, f. 2, [http://www.treccani.it/enciclopedia/minoranze-etnico-linguistiche_\(Enciclopedia_dei_ragazzi\)/](http://www.treccani.it/enciclopedia/minoranze-etnico-linguistiche_(Enciclopedia_dei_ragazzi)/)

që kishin si baze diskriminim fetar. Por, me lindjen shtetit-komb, i cili përmblihte në vetvete individë që kishin të njëjtën racë, flisnin të njëjtën gjuhë dhe tentonin të formonin një entitet të përbashkët politik, shfaqej koncepti i minoritetit etnik. Ky koncept përmblihte një kompleks individësh që ishin subjekte politike të një shteti me kombësi të ndryshme nga ata. Ndryshe nga shumica që kishte një projekt politik dhe mund ta realizonte nëpërmjet parimit të vetvendosjes, falë edhe sigurimit të territorit, minoritetet kishin si objektiv aktivizimin e një qëndrese kolektive kundër asimilimit gjuhësor, kulturor dhe social të grupit. Me këto premisa, problematika e minoriteteve do të zinte një vend të rëndësishëm në debatet ndërkombëtare me firmosjen e Traktatit të Versajës, akt ky që dekretonte mbarimin e Luftës së Parë Botërore. Mbarimi i luftës evidentonte shpërbërjen e perandorive të mëdha dhe formimin e shteteve kombëtare të cilat përfshinin brenda kufijve të tyre politikë popullsi që konsideroheshin të ndryshme nga shumica për nga raca, nga gjuha dhe feja.⁸

Duke marrë parasysh aspektet politike, ekonomike dhe strategjike, shtetet trashëgimtare të perandorive të mëdha përfshinin brenda kufijve, krahina të banuara nga popuj me kombësi ose fe të ndryshme⁹. Për të lehtësuar disi regjimin e këtyre popullsive të shkëputura nga trungu kombëtar, sidomos për të shmangur tendencat separatiste, Fuqitë Aleate përcaktonin disa detyrime për trajtimin e këtyre popullsive. Këto detyrime binin mbi ato shtete të cilat kishin popullsi minoritare brenda kufijve të tyre. Mënyra si zbatoheshin përcaktimi i kufive dhe parimi i kombësisë linte jashtë kufijve etnike pothuajse 40 milionë

⁸ Dhimitër Berati, *Shënime historike mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Lidhjen e Kombeve, "Husi Borshi"*, Tiranë, 2007, f. 32.

⁹ Emile Chanoux, *Memorie de licence delle minoranze etniche nel diritto internazionale*, l'Universita di Torino, f. 2.

persona.¹⁰ Homogjeniteti i popullsisë që synohej të arrihej në shtetet evropiane mbetej relativ, sidomos në gadishullin Ballkanik, për shkak të numrit të madh të përzierjeve së popullsisë, gjë që e bënte të pamundur ekzistencën e shteteve tërësisht “të pastra” nga pikëpamja etnike. Pavarësisht vështirësive, disa nga shtetet ballkanike siç ishin: Greqia, Jugosllavia dhe Turqia, përpiqeshin vashdimisht për të arritur një farë homogjenizimi të popullsisë së tyre. Mbretëria serbo-kroate-slllovene, e cila falë marrëveshjeve që Fuqitë e Mëdha do të arrinin mbi Ballkanin, do të zgjerohej në dëm të popujve të tjerë dhe në 1927 do të quhej Jugosllavi.¹¹

Një nga rrugët e ndjekura për realizimin e synimeve të tyre ishte shkëmbimi i popullsisë ose thjesht dëbimi me dhunë i minoriteteve nga territori i tyre. Relativisht problemi i minoriteteve lindte kur këta popuj bëheshin të vetëdijshëm për kombëtarësinë dhe personalitetin e tyre dhe ngriheshin përpara shtetit ku bënë pjesë, duke kërkuar të drejtat e tyre për të jetuar. Që kjo popullsi të përkufizohej si “minoritet”, sipas vendimeve ndërkombëtare apo marrëveshjeve të formulara pas Luftës së Parë Botërore, në Konferencën e Paqes në Versajë, duhej të identifikohet si një komunitet njerëzor, pjesëtarët e të cilit, ishin vendosur kryesisht në mënyre kompakte në një hapësirë gjeografike, zakonisht e lokalizuar në periferinë kufitare të shtetit mëmë, gëzonin nënshtetësinë e shtetit ku jetonin dhe shfaqnin karakteristika etnike, kulturore, fetare ose linguistike të veçanta. “Sistemi i Versajës” më 1919, parashikonte që shtetet fituese të nënshkruanin traktate me shtete, të cilët kishin qënë aleatët e tyre gjatë luftës ose me ato shtete të sapo formuar me

¹⁰ Dhimitër Berati, *Shënime historike mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Lidhjen e Kombeve*, “HUSI BOROSHI”, Tiranë, 2007, f. 32.

¹¹ Koço Danaj, *Shqipëria natyrale*, “ERIK”, Tiranë, 2006, f. 25.

mbarimin e luftës. Të tillë ishin traktatet e St-Germain, Trianon, Neuilly-sur-Seine dhe Sevres, të cilëve përveç pjesëve që përcaktonin firmosjen e paqes, do t'u shtohet edhe një kapitull që trajtonte mbrojtjen e minoriteteve.¹²

Këta lloj traktate që firmoseshin nga Polonia, Çekosllovakia, Jugosllavia dhe Rumania, përmbanin pothuajse të njëjtat dispozita. Gjithashtu, edhe traktatet e paqes të nënshkruara me shtetet humbëse parashikonin kapituj për mbrojtjen e minoriteteve të mbetura brenda kufijve të tyre. Të tilla traktate do të firmoseshin me Austrinë, Bullgarinë, Hungarinë dhe Turqinë.¹³ Po ashtu në vazhdimësi, do të firmoseshin edhe disa deklarata të njëanshme që kishin si subjekt mbrojtjen e minoriteteve. Kështu mund të përmenden deklaratat unilaterale të firmosura nga Shqipëria më 2 tetor 1921, Lituania më 12 maj 1922, Letonia më 7 korrik 1923 dhe Estonia më 17 shtator 1923, në momentin e pranimit në Lidhjen e Kombeve.¹⁴ Këto deklarata ishin të rëndësishme jo vetëm për faktin se përbënin një nga kushtet për pranimin e shteteve në LK, por sepse do të jenë baza e regjimit të mbrojtjes së minoriteteve, i parashikuar nga sistemi i Versajës që synonte t'u garantonte personave që u përkisnin pakicave, të gëzonin de jure dhe de facto, të drejtat elementare që shtetet u njihnin të gjithë shtetasve të vet. Traktatet e lartpërmendura mund të klasifikohen në tre kategori:

- Kategoria e parë përfshinte ato traktate që u imponoheshin shteteve humbëse të Luftës së Parë Botërore, siç ishin: Austria, Hungaria, Bullgaria dhe Turqia.

¹² Emile Chanoux, *Memorie de licence delle minoranze etniche nel diritto internazionale*, l'Universita di Torino, f. 4.

¹³ Berati Dhimitër, *Shënime historike mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Lidhjen e Kombeve*, "Husi Borshi", Tiranë, 2007, f. 32.

¹⁴ Po aty, f. 15.

- Kategoria e dytë kishte të bënte me shtetet e reja, të krijuara nga territoret e mbetura pas tërheqjes së Perandorisë Osmane si dhe me shtetet, kufijtë e të cilave kishin ndryshuar sipas parimeve të paraqitura nga presidenti amerikan Wilson (Çekosllovakia, Greqia, Polonia, Rumania dhe Jugosllavia).¹⁵
- Në kategorinë e tretë përfshiheshin ato traktate të përbëra nga një numër klauzolah të veçanta dhe disa deklarata të njëanshme të nënshkruara pas anëtarësimit të shteteve të lartpërmenduar në LK.

Dy kategoritë e para të traktateve përfshinin të drejtën e barabartë në trajtimin e mosdiskriminimit, të drejtat për qytetarët, të drejtat e pakicave për të krijuar dhe për të kontrolluar institucionet e tyre, detyrimin shtetëror për të ofruar mbështetje financiare të arsyeshme në mirëmbajtjen e shkollave minoritare, ku mësimdhënia në klasat e para duhej të zhvillohej në gjuhën e pakicave dhe shkollat duhej të ishin të mjaftueshme në numër.¹⁶ Në disa raste për pakicat parashikohej edhe një farë shkalle autonomie territoriale. Këto traktate ishin dokumenta komplekse, që ndonjëherë brenda artikujve të tyre përfshinin njohjen e të drejtave të barabarta dhe mosdiskriminimin e çdo personi, pavarësisht se ai mund t'i përkiste një grupi pakicash ose jo.¹⁷

Në çdo traktat përfshiheshin edhe klauzola të përgjithshme që siguronin mbrojtjen e jetës, të lirisë dhe ushtrimin e lirë të besimit fetar për të gjithë banorët e një shteti, pa dallim kombësie, race, besimi fetar ose gjuhe. Qytetarët duhej të gëzonin të drejta politike e civile dhe të ishin të barabartë përpara ligjit, pa dallim race, gjuhe apo besimi fetar. Këto të drejta

¹⁵ Adrian Papajani, *Të drejtat e pakicave*, Elbasan, Sejko, 2005, f.48.

¹⁶ Po aty, f.48.

¹⁷ Po aty, f.48.

dhe liri ishin në mënyrë të dukshme individuale, pavarësisht nga statusi i pakicës. Traktatet e nënshkruara përfshinin dy lloje kryesore masash që shtetet fitimtarë duheshin të ndërmerinin. Së pari, individët që u përkisnin pakicave gjuhësore, ndërmjet të tjerave, duhej të vendoseshin në barazpeshë me shtetasit e tjerë që përbënin shumicën e një shteti. Së dyti, duhej të siguroheshin mjetet për të ruajtur veçoritë raciale dhe karakteristikat kombëtare të pakicave, përfshirë këtu dhe mësimin e gjuhës.¹⁸ Do të ishte Gjykata e Përhershme Ndërkombëtare e Drejtësisë ajo që do të kishte të drejtën e interpretimit të klauzolave të këtyre traktateve. Gjykata deklaronte se këto dy masa ishin të lidhura ngushtë, sepse nuk mund të kishte barazi të vërtetë ndërmjet shumicës dhe pakicës nëse kjo e fundit do të privohej nga institucionet e saj dhe për pasojë, do të detyrohej të braktiste atë të cilën krijonte thelbin e vërtetë të qenurit pakicë. Kjo nënkuptonte se, qytetarët që i përkisnin pakicave, duhej të gëzonin të njëjtin trajtim ligjor edhe në praktikë si e gjithë mazhoranca.¹⁹

Barazia ligjore fokusohet në veçanti, në të drejtën që kishin pakicat për të krijuar shkolla dhe institucione me shpenzimet e tyre. Sa për qytetet dhe rajonet ku pakicat përbënin një numër të konsiderueshëm në raport me pjesën tjetër të popullsisë, duhej që ato të siguronin e të gëzonin një ndarje të arsyeshme me pjesën tjetër të popullsisë, të fondeve publike, të cilat ishin të destinuara për arsimin dhe qëllime të tjera fetare apo bamirësie. Këto të drejta që traktatet duhet të garantonin nuk arrinin të zbatoheshin dhe sistemi i minoriteteve në një farë mënyre dështonte.

¹⁸ Adrian Papajani, *Të drejtat e pakicave*, Elbasan, Sejko, 2005, f.49.

¹⁹ Po aty, f. 49.

2.2. Lidhja e Kombeve dhe sistemi i garancive të minoriteteve në arenën ndërkombëtare

LK u krijua nga Fuqitë e Mëdha fituese më 28 prill 1919 dhe hyn në fuqi në janarin e vitit tjetër. Presidenti Amerikan Woodrow Wilson, arrinte të fuste në traktatin themelues një paragraf, në bazë të të cilit, shtetet e reja si kusht për njohjen e pavarësisë së tyre, duhej të impenjoheshin të garantonin një trajtim të barabart të minoriteteve kombëtare ose racore që jetonin brenda kufijve të tyre. Vetë presidenti i SHBA do t'ua impononte më vonë këtë paragraf edhe vendeve që do të anëtarësoheshin në të ardhmen në LK. Këto detyrime shiheshin me pakënaqësi nga shtetet e vogla, që nga momenti kur u kërkohej të firmosnin traktaktet për mbrojtjen e minoriteteve. Ata protestonin kundër asaj që quajtnë një kufizim të pavarësisë, e cila lindte si pasojë e një trajtimi të ndryshëm që u bëhej në krahasim me shtetet e mëdha.²⁰ Kundërshtimet e ngritura nga të ashtuquajtura “shtete të vogla”, rreth mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve, kaloheshin duke detyruar shtetet anëtare të mbanin një qëndrim standard kundrejt ndalimit të çfarëdolloj diskriminimi racor, gjuhësor ose fetar.²¹

Adoptoheshin gjithashtu, edhe disa masa që kishin si qëllim ruajtjen e identitetit kombëtar dhe vlerave të grupeve të veçanta kundër çdo rreziku asimilimi që mund të vinte si pasojë e ndryshimeve kufitare. Vështirësia e adoptimit të këtyre masave qëndronte në

²⁰ Adrian Papajani, *Të drejtat e pakicave*, Elbasan, Sejko, 2005, f.50.

²¹ Catello Avenia, *Tutela internazionale delle minoranze*, f.12, <http://www.altalex.com/documents/neës/2012/07/12/tutela-internazionale-delle-minoranze>

faktin se disa nga këto shtete ishin të lidhura midis tyre me traktakte të veçanta bilaterale dhe e kishin të vështirë zbatimin e tyre. Pothuajse të gjitha shtetet evropiane kishin përfshir në territoret e tyre grupe pakicash. Rëndësi të veçantë kishte rezoluta e LK e 21 shtatorit 1922, në të cilën theksohej, jo vetëm e drejta e mbrojtjes e minoriteteve nga çfarëdolloj forme shtypjesh, por dhe detyra e pjesëtarëve të këtyre grupeve që të bashkëpunonin si nënshtetas besnikë të shtetit ku bënë pjesë. Rezoluta duhej të garantonte edhe ndryshimin e ri territorial të vendosur nga Konferenca e Paqes më 1919, e cila parashikonte një zgjerim të territoreve të Serbisë, Rumanisë dhe Greqisë, dhe përcaktonte kufijtë e Polonisë dhe Çekosllovakisë. Këto marrëveshje kishin krijuar një numër të madh grupesh që për nga tradita kulturore, gjuhësore dhe fetare, gjendeshin në një pozitë minoriteti, të cilët duhet të mbroheshin me firmosjen e traktate të minoriteteve mes Fuqive të Mëdha Aleate dhe shteteve humbës të luftës.²² Në vija të përgjithshme, regjimi i ri parashikonte që mbrojtja e të drejtave të minoriteteve nga këto traktate të përqëndrohej në: barazinë përpara ligjit në lidhje me të drejtat civile dhe politike, lirinë e besimit, të drejtën e anëtarëve të minoriteteve të përdornin gjuhën e tyre, të drejtën për të pasur institucionet e tyre fetare dhe arsimore. Gjithashtu, përfshihej edhe e drejta për të zhvilluar mësimin në gjuhën minoritare në zonat, ku pakicat përbënin një numër të konsiderueshëm në krahasim me popullsinë mazhoritare.²³

Mbrojtja ndërkombëtare e minoriteteve vinte në dukje parimin e mosdiskriminit, i cili në thelb u garantonte anëtarëve të një minoriteti të gëzonin njëlloj të drejtat civile dhe politike me antarët e shumicës së popullsisë. Mbi parimin e mosdiskriminimit shprehej edhe GJPND. Ajo argumentonte se qëllimi i këtij parimi ishte parandalimi eventual i

²² Mimoza Agalliu, *Mbrojtja ndërkombëtare e minoriteteve*, "Marin Barleti", Tiranë, 2013, f. 11.

²³ Po aty, f. 11,

trajtimit jo të barabartë dhe garantimi i një regjimi që të ndalonte burimin e një trajtim të privilegjuar. Sipas qëndrimit që mbante gjykata, kuptohet që dispozitat mbi të drejtat e personave, të cilët u përkisnin minoriteteve kishin karakter negativ, sepse ato kufizoheshin në ndalimin e çdo lloj forme të diskriminimit. Parandalimi i diskriminimeve të minoriteteve, ishte një detyrë që i përkiste shteteve anëtare të LK, të cilët nëpërmjet legjislacionit të brendshëm duhet të ndërhyjnë që të garantojnë të drejtat e barabarta. Një rast i tillë mund të vihet në dukje kur, në ato pjesë të territorit, ku minoritetet përbënin shumicën e popullsisë, shteti duhet të ndërhynte jo vetëm për sigurimin e zhvillimit të mësimin në gjuhën e minoritetit por, edhe në ndarjen e drejtë të fondeve publike.²⁴

Dispozitat e traktateve të përfunduara në atë periudhë, kishin si objekt anëtarët e minoriteteve dhe jo minoritetet si komunitet. Nga ky këndvështrim dukej qartë qëndrimi i Fuqive Aleate, të cilat kërkonin të garantojnë një autonomi politike të minoriteteve, duke shmangur kështu me çdo kusht ngritjen e një shteti brenda shtetit. Sistemi ndërkombëtar i krijuar nga LK kishte si qëllim të shkonte përtej këtyre traktateve, pasi parashikonte ekzistencën e një “regjimi të pakicave” edhe në rastet kur, pa pasur traktate konkrete, të zbatoheshin të drejtat e pakicave. Me fjale të tjera, do të ishte ky organizëm ndërkombëtar që për herë të parë do të përpiqej t’u siguronte minoriteteve një status të vërtetë të njohur ndërkombëtarisht.²⁵ LK do ta ushtronte funksionin e garantimit nëpërmjet një praktike të shqyrtimit të peticioneve.²⁶ Këto peticione mund të paraqiteshin në emër të minoriteteve, kur këto pretendonin se po u shkeleshin të drejtat e tyre. Ankesat i drejtoheshin Sekretarit të

²⁴ Adrian Papajani, *Të drejtat e pakicave*, Elbasan, Sejko, 2005, f. 49.

²⁵ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, Tiranë, 2013, f.14.

²⁶ Po aty, f. 49.

Përgjithshëm të LK dhe në rast se ato konsideroheshin të pranueshme, Këshilli ngrinte një Komitet ad hoc të Minoriteteve, i cili synonte një zgjidhje paqësore të çështjes.²⁷ Në ato raste kur përpjekjet për një zgjidhje paqësore të çështjes midis LK dhe shtetit kundrejt të cilit pretendohesh se kishte dhunuar të drejtat e parashikuara në traktat dështonin, Këshillit i njihej e drejta për ta referuar çështjen për shqyrtim përpara GJPND. Një rast i tillë ka qënë dhe shqyrtimi nga ana e Gjykatës të çështjes së shkollave minoritare në Shqipëri, e ngritur nga shteti grek.²⁸ Bëhej fjalë për një vendim të marrë nga qeveria shqiptare për shtetëzimin e shkollave private që ndodheshin në territorin e saj.

Gjykata synonte të jepte një zgjidhje këtyre mosmarrëveshjeve, duke u përpjekur nga njëra anë, t'u siguronte pakicave të drejtat e caktuara në traktat, në mënyrë që të ruanin personalitetin dhe, nga ana tjetër, për arritjen e këtyre të drejtave, pakicat nuk duhej t'i kundërviheshin shtetit ku bënin pjesë. Në kuadrin e LK mendohej të krijohesh një sistem garancish. E rëndësishme është të nënvizohet se, traktaktet e përfunduar gjatë kësaj periudhe përbënin një hap drejt mbrojtjes së minoritetetve dhe njohjen e të drejtave të njëriut. Rëndësia themelore e tyre qëndronte në faktin se, e drejta ndërkombëtare publike nuk kishte objekt të saj vetëm marrëdhëniet ndërmjet shteteve, por edhe ruajtjen e garantimin e të drejtave të individit, ndonëse në një mënyrë të kufizuar.²⁹ Për herë të parë komuniteti ndërkombëtar ndërgjegjësohej për individët që i përkisnin pakicave, të cilët jetonin pa një mbrojtje ligjore në kuadrin e së drejtës së brendshme të shteteve. Nevojitej që këta individë të kishin një garanci shtesë për gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave të tyre

²⁷ Mimoza Agalliu, *Mbrojtja ndërkombëtare ...* vep. e cit., f. 12.

²⁸ Po aty, f. 13.

²⁹ Po aty, f. 14.

themelore nga një organizatë ndërkombëtare. Ky sistem garancish, që në vështrim të parë dukej koherent dhe mjaft liberal, do të dështonte për arsye më shumë politike se juridike. Kjo sepse, traktatet e ndryshme u kërkonin angazhime kryesisht shteteve të mundura në Luftën e Parë Botërore dhe këto përpiqeshin të çliroheshin nga angazhimet e marra përpara LK. Ishte e domosdoshme universalizimi i rregullave të miratuara nga sistemi i traktakteve. Detyrimet në fushën e minoriteteve nuk përfshiheshin në Statusin e LK, por u ngarkoheshin vetëm shteteve të lidhur me këto detyrime në traktatet e paqes. Pavarësisht këtyre arritjeve, e drejta ndërkombëtare nuk ofronte një mbrojtje efikase për minoriteteve. Në radhë të parë nuk ofrohej një mbrojtje juridike kolektive, por vetëm një mbrojtje individuale e atyre personve që gëzonin statusin e minoritetit. Një aspekt tjetër negativ ishte fakti se sistemi mbrojtës ndërkombëtar i formuar për minoritetet, parashikonte vetëm masa që garantonin liritë e tipit negativ. Këto ishin ato liri që njiheshin dhe garantoheshin nga Kushtetuta e çdo shteti anëtar si të padhunueshme, të cilat kishin si kërkesë të brendshme një sjellje mosndërhyrëse nga ana e shtetit. Ato shfaqeshin si një interes i mbrojtur drejtpërdrejt nga rendi juridik shtetëror.³⁰

Për garantimin e lirive negative, mund të merreshin disa masa të tilla si: adoptimi i parimit të mosdiskriminimit dhe detyrimi i shteteve firmues të zbatonin parimin e barazisë. Duhet kujtuar gjithashtu se LK ishte një iniciativë e presidentit amerikan Wilson por, fatkeqësisht SHBA nuk do të bëhej shtet anëtar e kësaj organizate ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i LK ishte ruajtja e paqes dhe sigurimi ndërkombëtar dhe shtetet anëtare ishin të detyruara t'i zgjidhnin konfliktet ndërshtetërore nëpërmjet një arbitrimi, ose duke ju drejtuar

³⁰ Luan Omari, Aurela Anastasi, *E Drejta Kushtetuese, "ABC"*, Tiranë, 2010, f. 93.

Këshillit të Asamblesë.³¹ Sistemi i normave të mbrojtjes së interesave të pakicave kombëtare, i përpunuar nga LK, dëshmonte për një varg pasaktësish, paqartësish dhe boshllëqesh serioze që iu linin shteg shteteve të ndryshme të abuzonin në kurriz të pakicave kombëtare, duke vënë në pikëpyetje vetë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.³² Pra dalja në planë të dytë në arenën ndërkombëtare dhe sistemi jo i saktë i normave që mbronin interesat e pakicave, ishin motivet që çështja e të drejtave të minoriteteve nuk arrinte të përmbushej me sukses. Edhe pse, pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore dhe krijimit të një regjimi të vërtetë ndërkombëtar nën kudesin e LK, nuk ekzistonte një definicion juridik detyrues dhe universalisht i pranuar rreth konceptit të minoritetit, do të ishte GJPND e LK, që, nëpërmjet në vendimi këshillues më 31 korrik 1930, në lidhje me çështjen e ngritur nga komuniteti bullgaro-grek, jepte një përkufizim. Ajo e përcaktonte si:

*një bashkësi individësh që jetojnë në një vend ose lokalitet të caktuar, që kanë të njëjtën racë, të njëjtin besim, të njëjtën gjuhë e tradita dhe janë të bashkuar nga identiteti i kësaj race, i këtij besimi, i kësaj gjuhe dhe i këtyre traditave në një ndjenjë solidarizimi, me qëllim që të ruajnë traditat e veta, të mbajnë besimin e vet, të sigurojnë mësimin dhe edukimin e fëmijve të tyre në përputhje me shpirtin dhe traditat e racës së vet dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin në mënyrë të ndërsjellte.*³³

Me fjalë të tjera që një grup personash të konsiderohej dhe të gëzonte statusin e minoritetit duhej të zotëronte disa karakteristika të përbashkta kombëtare, etnike dhe gjuhësore. Gjithashtu, termat si minoritet etnik, gjuhësor dhe fetar duheshin trajtuar si një nënkategori e minoritetit kombëtar, ku elementi komb përfshinte në vetvete karakteristikat

³¹ Catello Avenia, *Tutela internazionale delle minoranze*, f. 11,
<http://www.altalex.com/documents/neës/2012/07/12/tutela-internazionale-delle-minoranze>.

³² Elona Rizo, *Vështrim historik mbi përpjekjet për përcaktimin e përkufizimit të minoriteteve*, Jus & Justicia 1, Nr. 1, Tiranë, 2008, f. 112.

³³ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f.16.

e lartpërmendura. Ruajtja e këtyre karakteristikave kërkonte një formë qëndrimi kolektiv, i cili krijonte një identitet dhe në njëfarë mënyre tregonte një ndjenjë solidariteti ndërmjet pjesëtarve të grupit kundër aksioneve që mund të çonin drejt asimilimit gjuhësor, fetar ose kulturor. Vetë e drejta për identitet presupozonte, nga njëra anë aksionin e pjesëtarve të grupit minoritar e finalizuar për njohjen e të drejtave të veta dhe ruajtjen e identitetit, nga ana tjetër ndalimin e atyre aksioneve të shteteve që çonin drejt genocidit dhe spastrimit etnik. Nga konsiderimet e mësipërme mund të quajmë minoritet: një komunitet personash, numerikisht inferior në numër nga pjesa tjetër e popullsisë në shtetin në të cilin banojnë, e lidhur me këtë të fundit nga një raport shtetësie dhe zotëron disa karakteristika kombëtare të përbashkëta si, etnike, gjuhësore dhe fetare, e vendosur në një pozicion jo dominant, pjesëtarët e të cilit, vendosin disa forma qëndrese që kanë për qëllim të ruajnë të drejtën e vet të identitetit. Nisur nga këto përkufizime vihen në dukje tre lloje minoritete: minoritet etnik, minoritet etno-kulturor dhe së fundmi minoritet fetar.

2.3. Përkufizimi i pakicave kombëtare

Një popullatë gëzon statusin e pakicave kombëtare kur pjesëtarët e saj shfaqin karakteristika etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore të veçanta nga pjesa tjetër e popullsisë.³⁴ Jurisprudenca ndërkombëtare në përcaktimin e pakicave kombëtare bazohej në kriterin subjektiv dhe atë objektiv. Kriteri subjektiv nënkupton të drejtën e çdo individi për të shprehur lirisht identitetin e tij kombëtar apo etnik. Kriteri objektiv i referohet atyre të drejtave të proklamuar, jo vetëm nga dispozitat ligjore të një shteti por edhe nga

³⁴ Arqile Bërxfholi, *Minoritetet në Shqipëri (Studim Demografik)*, Tiranë, 2005, f.30.

dokumentet ndërkombëtare që rregullojnë çështjet e pakicave. Është e qartë që të dyja këto kritere janë të lidhura ngusht ndërmjet tyre në të kundërt do të kishim një paqartësi të madhe, e cila do të çonte drejt një instrumentalizmi të rrezikshëm politik të pakicave. Pakicat kombëtare janë pjesë të një kombi të caktuar brenda territorit shtetëror të një vendi tjetër, ku shumica e popullsisë përbëhet nga kombi autokton. Këto pakica të njohura janë të vendosura në territorin e tyre, flasin gjuhën e vet, pjestarët e tyre kanë të njëjtën fe dhe kulturisht janë të ndryshëm nga shumica. Por kjo nuk do të thotë që ata domosdoshmërisht ndihen një komb dhe duan të formojnë një shtet të vetin.

Megjithatë, prezenca e kësaj pakice mund të ndihet si një kërcënim nga ana e shumicës, në kuptimin që shumica nuk ka besim tek minoriteti, ndërkohë që, në anën tjetër, pakicat mund të ndihen të marxhinalizuara dhe të diskriminuara. Kontrasti ndërmjet këtyre dy grupeve bëhet më i fortë kur pakicat kanë si projekt formin e një kombi, ose më saktë kur pretendojnë të formojnë një shtet-komb të vetin në territorin ku jetojnë, duke u shkëputur nga shteti ku bëjnë pjesë, i cili është i dominuar nga një shumicë e ndryshme.³⁵ Formimi i situatave të tilla në Evropë dhe jashtë saj, kanë qënë shkak i shumë konflikteve të cilat shpeshherë kanë përfunduar në luftëra të dhunshme. Shumë herë etnia është përdorur si pretekst, ndërkohë që arsyet e vërteta që kanë çuar në shpërthimin e konflikteve kanë qënë kontrolli i territorit ose shfrytëzimi i pasurive nëntokësore. Por nuk duhet harruar që konfliktet e shpërthyera kanë pasur rrënjë të thella historiko-politike, fetare ose etno-kulturore.

³⁵ Claudio Cerreti, *Minoranze etnico-linguistiche*, Enciclopedia dei ragazzi 2006, f. 3.
[http://www.treccani.it/enciclopedia/minoranze-etnico-linguistiche_\(Enciclopedia_dei_ragazzi\)/](http://www.treccani.it/enciclopedia/minoranze-etnico-linguistiche_(Enciclopedia_dei_ragazzi)/)

2.3.1. Pakicat etnokulturore

Në këtë rast bëhet fjalë për një popullsi që është në minoritet në krahasim me shumicën, e cila përdor gjuhën e vet në të gjitha dimensionet dhe nivelet, po ashtu ka një kulturë të vetën dhe jetojnë zakonisht në zona kufitare. Pakicat etnokulturore janë pakica, të cilat nuk përbëjnë një pjesë të një kombi që është shkëputur mekanikisht nga shkaqe historike për të mbetur në një vend fqinj, sepse këto pakica i janë nënshtruar një metamorfoze ndryshimi historik, si pasojë e kohës së gjatë dhe largësisë nga vendi i origjinës.

2.3.2. Minoritetet fetare

Përkatësia e një minoriteti fetar nënkupton të drejtën e çdo individi të besojë ose jo apo të ndryshojë përkatësinë e tij fetare. Për përcaktimin e këtyre pakicave merret si bazë karakteri subjektiv, i cili është i lidhur me të drejtën e çdo individi që të shpreh lirisht orientimin e tij fetar. Gjithashtu, këto pakica nuk janë shumë të lidhura me territorin ato kanë si bazë botën shpirtërore, pra të mirat jo materiale.³⁶ Shumë studiues janë përballur me vështirësi të shumta në përcaktimin e atyre grupimeve që mund të gëzonin statusin e minoriteti. Por, duke vlerësuar strukturën e tyre sociale, natyrën e raporteve me shtetin dhe shumicën e popullsisë, prezencën dhe prirjet e potencialit të tyre në politik, ata përpiqen të ofrojnë një tipologji që të lehtësojë këtë klasifikim. Mbështetur në kriteret e ofruara nga disa burime, studiuesit arrijnë të përcaktojnë tre kategori, të cilat ishin të diferencuara si për nga struktura e tyre sociale, nga raportet e tyre me shtetin si dhe nga prirjet e potencialit të tyre

³⁶ Arqile Bërxfholi, *Minoritetet në Shqipëri*, vep. e cit. , f.23.

socio-politik.³⁷ Këto tre kategori janë: minoriteti komb, minoriteti i fuqishëm dhe minoriteti i pa formuar.

2.4. Minoriteti komb

Disa studiues e quajnë “minoritet etnik vendas” dhe është i lidhur me rastet kur atdheu i banorëve autoktonë është i shkëputur dhe këta banorë janë shtetas të një shteti tjetër, ndarë me kufij shtetërorë nga shteti i tyre mëmë.³⁸ Kështu mund të quheshin shqiptarët e Kosovës në raport me Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene ose si do të quhej më vonë Jugosllavia.

Kjo kategori përfaqëson një popullsi të konsiderueshme, që mund të llogaritet deri në disa milionë, e cila në trojet e veta dallohet për popullim numerikisht dominues të hapësirës. Sociologjikisht ata përmbajnë elemente dhe ruajnë funksione si të një shoqërie kompakte, por brenda një shoqërie tjetër kulturalisht të ndryshme. Qeverisja e tyre zakonisht realizohet mbi bazën e pavarësisë territoriale në raport me shtetin ku bëjnë pjesë. Njëherësh tërësia e elementeve sociologjike të saj janë të ngjashëm me ato të shtetit mëmë. Karakteristikë e veçantë e minoritetit komb është se ai kurrësi nuk mund të asimilohet, përkundrazi ka rritje të vazhdueshme të kontigjentit dhe mund të jetë në gjendje të asimilojë elementë të shumicës që ndërfiten në përbërje të tij.³⁹

³⁷ Arqile Bërxfholi, *Minoritetet në Shqipëri*, vep. e cit. , f.23.

³⁸ Po aty, f.23.

³⁹ Po aty, f. 23.

2.5. Minoriteti i fuqishëm

Ky grup përbëhet nga dy nëngrupe: minoriteti i fuqishëm dhe minoriteti i ngushtë, të ndarë sipas origjinës, raportit me shtetin mëmë dhe numrit të banorëve. Minoriteti i fuqishëm formohet atëhere kur e njëjta popullsi ndahet nga trangu mëmë me kufij zyrtarë shtetërorë, ose kur popullsia e një shteti është larguar gjatë historisë e vendoset brenda kufijve zyrtarë të një shteti tjetër.⁴⁰ Vendosja e tyre hapësinore zakonisht është periferike përgjatë kufirit me shtetin mëmë. Kur ky minoritet formohet si pasojë e copëzimit të hapësirës siç ishte rasti i çamëve në Greqi, apo të trevave shqiptare në Mal të Zi e Maqedoni, popullata e tij shtrihet kompakte në mjedise të caktuara dhe formojnë një shoqëri të dalluar qartë nga shumica, madje, krijojnë edhe një shtresëzim social lehëtësisht të dallueshëm. Ndaj kësaj popullsie vrehet më së shumti integrimi se asimilimi. Normalisht, minoriteti i fuqishëm gëzon të drejtën e ushtrimit të forcës së administrimit lokal dhe atij rajonal, dhe shpesh herë mund të ndodh që të formojnë edhe partitë e tyre.⁴¹ Minoriteti i ngushtë është i përbërë nga një pjesë të popullsisë së një shteti tjetër, larguar historikisht dhe të vendosur në shtetin ku konsiderohet si minoritet. Vendoset kryesisht në pjesët periferike dhe popullon zakonisht mjediset fshatare ose ndonjë qendër urbane lokale. Si rregull ky lloj minoriteti gëzon të drejtën e forcës së administrimit lokal në hapësirat kompakte, shpesh mund të ndodh që të formojnë edhe parti politike. Brenda grupit themelor minoriteti i ngushtë nuk njeh asimilim. Ky proces mund të ndodh kur individë apo

⁴⁰ Arqile Bërxfholi, *Minoritetet në Shqipëri*, vep. e cit. ,f. 23.

⁴¹ Po aty, f. 23.

grupe të vegjël largohen nga këto mjedise.⁴² Lidhur me realitetin shqiptar me një përkufizim të till mund të njehësojmë minoritetin grek.

2.6. Minoriteti i paformuar

Ky lloj minoriteti në disa raste mund të quhet edhe “minoritet etnik” ose “grup etnik”. Etiketimi i kësaj natyre, megjithëse ndonjëherë merrë kuptim përgjithësues, lidhet me popullsi të vendosura në përbërje të shteteve të ndryshëm, të cilët në evoluimin e tyre etnologjik arrin deri tek formimi i etnosit, në vendin e tyre të origjinës dhe fazat e tjera të kombësisë dhe kombit i kanë kaluar në kuadër të një mjedisi tjetër social. Këto etni siç mund të kuptohet nuk kanë një “komb mëmë” ose “shtet mëmë”.⁴³ Diferencimi kulturor i kësaj popullsie në raport me shumicën është i larmishëm. Mund të vrehen grupime të cilat janë plotësisht të diferencuara, grupime të tjera që këtë diferencim e kanë të pjesshëm, vetëm në kuadrin familjar, por evidentohen edhe grupime të integruara deri në asimilim.⁴⁴ Grupimet e diferencuara formojnë kryesisht komunitete rurale dhe thellësisht tradicionale, kurse grupimet e integruara lokalizohen në zonat urbane. Për vetë tendencës dhe përpjekjeve të tyre drejt integritit me shumicën, këto pakica shfaqin indiferentizëm kundrejt përpjekjeve për të fituar statusin përkatës të minoritetit. Minoritete të tilla gjithnjë e më shumë janë të ekspozuara drejt asimilimit, duke bartur më vete edhe rrezikun e shuarjes. Për sa i përket realitetit shqiptar, mund t’i referohemi minoriteteve arumune dhe rome, të cilat përmbushin karakteristikat e kësaj kategorie.

⁴²Arqile Bërxfholi, *Minoritetet në Shqipëri*, vep. e cit. ,f. 24.

⁴³Po aty, f. 24.

⁴⁴Po aty, f. 25.

KAPITULLI III: ÇËSHTJA E MINORITETEVE NË KONFERENCËN E PAQES

3.1. Formimi i identitetit kombëtar dhe Konferenca e Paqes

Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore në 11 nëntor 1918, Shqipëria gjendej në një pozicion shumë delikat pasi territori i saj ishte bërë fushë beteje për fqinjët dhe objekt këmbimi për Fuqitë e Medha. Kështu, pjesa më e madhe e Shqipërisë ishte e pushtuar nga trupat italiane: në qarkun e Korçës gjendeshin francezët dhe Shkodra ishte e uzurpuar nga një fuqi ndërkombëtare e përbërë nga ushtarë francezë, anglezë dhe italianë, nën komandën e gjeneralit francez de Furtu. Komandanti i ushtrisë franceze në Ballkan, gjenerali Franchet d'Esperay, kishte lejuar ndërkohë trupat serbe të zinin një vijë strategjike në veri të Liqenit të Pogradecit, e cila ndodhej brenda kufirit shqiptar të vendosur në vitin 1913. Në këtë gjendje kaq delikate, në fund të dhejtorit 1918,⁴⁵ mbledhej në Durrësin e pushtuar nga italianët një kongres prej 53 delegatësh, i cili krijonte një qeveri të përkohshme, nën kryesinë e Turhan Pashë Përmetit.⁴⁶ Kryediplomati do të ngarkohej të mbronte kauzën shqiptare në Konferencën e Parisit. Kongresi vendoste krijimin e një qeverie të përkohshme me karakter mbarëkombëtar, çka shënonte pa dyshim një hap përpara në rrugën drejt rimëkëmbjes së Shqipërisë së pavarur.⁴⁷ Gjithashtu, vendosej krijimi i një Pleqësie, kompetencat e së cilës ishin të përcaktuara në mënyrë të përgjithshme. Ato ishin vetëm shqyrtimi i veprimtarisë së qeverisë dhe dhënia e orientimeve për ta ndihmuar atë, si për

⁴⁵ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes Shqiptare 1878-1926*, Akademia e Shkencave, Tiranë 2003, f.275.

⁴⁶ Georges Castellani, *Historia e Ballkanit*, "Çabej", Tiranë, f. 450.

⁴⁷ Luan Omari, *Sistemi parlamentar, Lindja dhe evolucioni i parlamentarizmit*, Bot. 4, "Elena Gjika", f. 160.

çështjet e politikës së jashtme ashtu dhe asaj të brendshme. Me fjalë të tjera, Pleqësia ishte një organ këshillues i qeverisë dhe, për më tepër, i varur nga kjo e fundit. Ndërsa Qeveria e Durrësit kishte një detyrë sa të vështirë dhe aq delikate, të mbronte interesat e kombit shqiptar, në Konferencën e Paqes që do të zhvillohej në Paris.

Konferenca e Paqes do të bëhej skenë e përplasejes së orekseve kontradiktore të Italisë, Jugosllavisë e Greqisë për territoret e veriut dhe të jugut.⁴⁸ Hapi i parë që ndërmernte Qeveria e Durrësit ishte përgatitja dhe paraqitja i një memorandum i mbrojtjen e kërkesave shqiptare në Konferencë. Për këtë qëllim, në Paris delegacioni ishte i kryesuar nga vetë kryetari i Qeverisë Turhan Pasha, i cili kishte shërbyer si ambasador i Turqisë pranë Carit të Rusisë.⁴⁹ Në përbërje të tij kishte personalitete të shquara si Mihal Turtulli, Mehmet Konica, Mid'hat Frashëri e Luigj Bumci, të cilët së bashku mbulonin përfaqësinë e katër besimeve shqiptare.⁵⁰ Në Memorandum renditeshin pak a shumë kërkesat dhe rivendikimet e qeverisë shqiptare. Në këtë dokument, Qeveria e Durrësit mbështeste tezën se Shqipëria nuk ishte ndër shtetet humbës, përkundrazi ajo ishte gjendur e përfshirë në luftë si rezultat i shkeljes së neutralitetit të saj të garantuar nga Fuqitë e Mëdha.⁵¹

Ajo çka përmbante Memorandum i përfaqësonte variantin maksimal të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Rivendikimet që i parashtroheshin Konferencës së Paqes kishin si objekt jo vetëm rikthimin e tokave shqiptare sipas vendimeve të 1913-ës, por edhe ndreqjen e padrejtësive që ishin bërë në dëm të kombit shqiptar me vendimet e Kongresit të Berlinit

⁴⁸ Georges Castellani, *Historia e Ballkanit (shekulli XIV-XX)*, "Çabej", Tiranë, 1996, f. 450.

⁴⁹ Tajar Zavalani, *Historia e Shqipërisë*, "PHOENIX", Londër, 1996, f. 254.

⁵⁰ Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*, Botime Pegi, Tiranë, 2012, f. 197.

⁵¹ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes Shqiptare 1878-1926*, Akademia e Shkencave, Tiranë 2003, f.276.

të vitit 1878 dhe të Konferencës së Londrës.⁵² Vendime këto, që kishin lënë jashtë trojeve shqiptare një popullsi më të madhe se sa ajo që ndodhej brenda kufijve të saj. Popullsia shqiptare që ishte përfshirë në shtetet fqinjë ishte, si numër, pakrahasimisht më e madhe se sa popullsia e etnive të tjera që mbetej në territorin shqiptar. Në mbështetje të kësaj teze mund të përmendet edhe vepra me titullin “*Antologji mbi gjeografinë e Shqipërisë*”, shkruar nga Anton Xanoni, në vitet 1902-1906. Në këtë vepër autori ofronte konsiderata mbi numrin e popullsisë, vendosjen gjeografike e strukturën sociale në aspektin etnik e fetar, në një sipërfaqe prej 75000 km².

*Në “Antologji” argumentohet se popullsia e Shqipërisë ishte: rreth 2 milion banorë, prej të cilëve 1.3 milion banorë (ose 65%) ishte popullsi me etni shqiptare dhe rreth 700 mij banorë (ose 35%) ishte popullsi me etni joshqiptare. Nga kjo popullsi me etni joshqiptare 140 mij banorë ishin vllah, 150 mij banorë ishin greke dhe 400 mijë banorë sllave. Duke i qëndruar besnik grupimit bashëkohor etnik të popullatave humane në Shqipëri, sipas këtij burimi, vërtetohej se në popullsinë e trojeve shqiptare, pakicat kombëtare zinin 28% të popullsisë tërësore dhe grupi etno-kulturor vllah zinte vetëm 7% të numrit të popullsisë. Duke u bazur përsëri te ky volum, mund të vështrohet dislokimi hapësinor i etnive joshqiptare. Sipas saj, “Grekët gjenden në jug të Shqipërisë, në mes të liqenit të Prevezës e Janinës, në anën lindore të Shqipërisë, prej Kosturit deri në Mitrovicë banojnë sllavët. Vllahët më e shumta janë vendosur midis vargut të madh malor prej Manastirit deri në kufi të Greqisë, prej këndeje janë shpërndarë deri në Durrës e Shkodër e në qytete të tjera Berat, Elbasan, Kavajë”.*⁵³

Duke parë këto të dhëna, ishte e natyrshme që në Memorandum nuk ngurohej të bëhej fjalë për territoret që përbënin Shqipërinë etnike dhe historike. Në Konferencën Paqes kërkohej të ndreqeshin padrejtësitë e së kaluarës dhe të hidheshin në këtë mënyrë themelet e një paqeje të qëndrueshme në Gadishullin e Ballkanit.⁵⁴ Arritja e paqes ishte futur në një rrugë shumë të vështirë, pasi me mbarimin e Luftës së Parë Botërore popujt e Ballkanit

⁵² Arben Puto, *Shqipëria politike 1912 – 1939*, Botimet Toena, Tiranë, 2009, f. 226.

⁵³ Arqile Bërxfholi, *Minoritet në Shqipëri* (studim demografik), vep. e cit., f. 63.

⁵⁴ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 276.

kishin dalë të rraskapitur, ekonomit e tyre ishin të rrënuara dhe varfëria mbizotëronte kudo. Konfliktet e vjetra etnike ishin transformuar në urrejtje dhe afirmimi i identitetit kombëtar kishte marrë trajta agresive. Si kudo në Evropë, kishte ardhur koha e nacionalizmit, i cili në këto vende dukej tepër larg nga pranimi i idesë wilsoniane të vetëvendosjes së lirë të popujve dhe të demokracisë së tipit anglo-sakson. Kudo i referoheshin modelit francez të “shtetit komb”, por pas tij fshiheshin kundërvëniet ndëretnike të rënduara edhe më tepër nga tensionet sociale dhe fetare. Përsa i përkiste Shqipërisë, edhe pse kishte shpallur neutralitetin e saj gjatë luftës, ajo gjendej e pushtuar nga ushtritë e huaja dhe përpiquej në betejën e vështirë e rraskapitëse të mbijetesës dhe të ndërtimit të shtetit kombëtar.

3.2. Minoriteti grekofon dhe rivendikimet territoriale të shtetit grek

Ndërkohë që Shqipëria po luftonte për formimin dhe ndërtimin e një shteti sovran, qeveria greke në Konferencë e Paqes shpaloste rivendikime të saj mbi Shqipërinë e Jugut. Këto rivendikime për Greqinë ishin të legjitimuara pasi në jug të vendit, sipas saj, jetonte një popullsi greke, e cila përbënte shumicën e kësaj zone. Me këto argumenta, pala greke e kryesuar nga kryeministri Elefteros Venizellos, parashtronte kërkesat e saj territoriale mbi Shqipërinë e Jugut, ose siç e quante ajo “Vorio Epir”. Kjo zonë sipas historianëve grekë, shtrihej nga gjiri Ambraquis në jug e deri në malet Llogarasë në veri, ndërsa nga lindja kufizohej me Thesalinë dhe nga perëndimi me detin Jon.⁵⁵ Kërkesat e palës greke të hartuara në një dokument, i cili i shpërndahej delegacioneve që ishin të pranishëm, ishte një

⁵⁵ Filip Liço, *Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare*, Neraida, Tiranë, 2009, f. 207.

pasqyrë e popullsisë greke brenda dhe jashtë kufive të Greqisë.⁵⁶ Ajo që tërhiqte vëmendjen ishte fakti, se në Shqipërinë e Jugut, pala greke pretendonte se jetonin rreth 151.000 grekë. Lidhur me “Vorio Epirin”, delegatët grekë përpara Këshillit të Lartë, pohonin se: Greqia nuk mund t’i kërkonte këto territore në bazë të parimeve gjuhësore dhe raciale, por në bazë të përkatësisë fetare. Grekët në këtë mënyrë hidhnin poshtë parimet e lartpërmendura, duke ngulur këmbë se faktori vendimtar ishte ndërgjegjja kombëtare.⁵⁷ Por, sipas ideve mbizotëruese në ato kohë në Greqi, ndërgjegjja kombëtare e çdo populli identifikohet me fenë.⁵⁸ Këtë tezë e parashtronte më mirë kryeministri Venizellos, i cili theksonte se as raca, as gjuha nuk mund të merreshin si bazë për përcaktimin e kombësisë dhe se faktori kryesor të ishte vetëdija kombëtare. Një gjë e tillë përcaktohet nga feja dhe ndjenja kombëtare, jo nga gjuha.⁵⁹ Identifikimi i kombësisë me fenë nuk ishte e mjaftueshme për të përcaktuar që popullsia, e cila banonte në Shqipërinë e Jugut kishte kombësi greke. Ky qëndrim vërtetohet edhe nga e Drejta Ndërkombëtare, e cila përkufizonte kombin dhe kombësinë si: një shoqëri natyrore që ka zanafillë, gjuhë, kulturë, qytetërim, doke, histori, tradita e shpeshherë edhe vendbanime e besim të përbashkët, e vetëdijshme për këto të përbashkëta, dëshiron të jetojë bashkarisht për të ruajtur, të mbrojtur e të zhvilluar elementet kulturore të saj për një trajtim më të plotë të vetëdijes njerëzore.⁶⁰

Por, edhe pse teza greke nuk ishte bindëse, këto pretendime gjenim platformën e plotë të shtrirjes territoriale të Greqisë në drejtim të Shqipërisë së Jugut, që sipas palës greke, nuk

⁵⁶ Aben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, vep. e cit., f. 227.

⁵⁷ Tajar Zavalani, *Historia e Shqipërisë*, vep. e cit., f. 254.

⁵⁸ Émile Chanoux, *Mémoire de licence, delle minoranze etniche nel diritto internazionale*, l’Università di Torino, 1927-1928, f.17.

⁵⁹ Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi Etnik Fuqitë e mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*. Vep. e cit., f. 203.

⁶⁰ *Të drejtat e Shqipërisë Ethnike*, “Zoja e Paperlyeme”, Shkodër, 1944, f. 6.

ishte tjetër veçse thjesht një zgjatim i natyrshëm i Epirit. Përkundrazi, kryeministri Venizellos kundërshtonte vetë shprehjen “Shqipëri Jugore”. “Epiri i Veriut” ishte, sipas tij, e vetmja shprehje gjeografike e kësaj zone.⁶¹ Menjëherë pas fjalës së Venizellos përfaqësuesi i Britanisë së Madhe, Lloyd-George, i propozonte Këshillit të Lartë krijimin e një Komisioni të posaçëm për të analizuar kërkesat e palës greke.⁶² Komisioni ad hoc do të caktohej më 4 shkurt 1919 me vendim të Konferencës dhe do të formohej nga 4 antarë, të cilët ishin: W.L. Westermann për SHBA, Robert Borden, Eyre Crowe për Britaninë e Madhe, Jules Cambon për Francën, A. de Martino, i asistuar nga kolonel Castoldi për Italinë. Kishte edhe një byro që kryesohej nga J. Cambon dhe disa funksionarë të tjerë të lartë të Fuqive.⁶³

Komisioni do të zhvillonte punimet prej 12 shkurtit deri më 21 mars 1919.⁶⁴ Seanca e Komisionit hapej me leximin e përkujtesës së Venizellos me pretendimet greke. Në parashtesën e tij ai vinte në dispozicion me një mori tezash: historike, strategjike e gjuhësore, të kompletuar me të dhëna statistikore të cilat i paraqiste si autentike. Por siç e nënvizonte ai vetë, të gjitha argumentet zbeheshin përballë kriterit fetar. Në vijim kryeministri grek shpjegonte zhvillimin historik të Shqipërisë së Jugut, si një ndarje fetare dhe konflikti midis myslimaneve dhe të krishterëve. Sipas tij, kur sundimi turk ishte shtrirë në këto zona shumë shqiptarë konvertoheshin në fenë islame. Për këtë arsye, paraardhësit e tyre kishin harruar se të parët e tyre ishin shqiptarë nga raca dhe mund të thuhej se ata e ndjenin veten turq si pasojë e pushtimit të gjatë pesë shekullor. Ai vazhdonte arsyetimin i

⁶¹ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 286.

⁶² Po aty, f. 286.

⁶³ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, vep. e cit., f. 230.

⁶⁴ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 277.

tij duke pohuar se shqiptarët ortodoksë gjatë kësaj kohe e konsideronin veten gjithmonë si grekë. Ky ishte edhe shpjegimi i antagonizmit të përhershëm midis myslimanëve dhe të krishterëve që karakterizonte shoqërinë shqiptare. Si pasojë, rivaliteti i këtyre dy elementëve përfundonte në një luftë civile, siç kishte qënë lëvizja vorioepirote e qeverisë së krishterë të Zografos. Në të vërtetë, këto përplasje fetare shtyheshin nga grekët, pasi ata arrinin të ngjallnin frikën se qeveria shqiptare e mbizotëruar nga myslimanët do të vazhdonte ta konsideronte elementin ortodoks si inferior ndaj atij mysliman, sikurse kishte ndodhur nën sundimin osman.⁶⁵ Por, kriter vendimtar në përcaktimin e kufirit të Shqipërisë së Jugut, e cila ishte dhe pengesa kryesore në rrugën e realizimit të kërkesave greke, ishte gjuha shqipe e folur në familje. Disa nga argumentet që pala greke mendohej t'i përdorte në favor të saj, ishin: Së pari, sipas tyre një shumicë e banorëve të zonave nga Delvina deri në kufirin e atëherëshëm të Greqisë dhe në drejtim të Gjirokastrës flisnin greqisht. Argumenti i dytë përforcohej nga numri i madh i shkollave greke që funksiononin jo vetëm për shqiptarët ortodoksë, por edhe për ata myslimanë.⁶⁶ Ndryshe qëndronte çështia e lëvizjes për shkollat e para të gjuhës shqipe, pasi ato shfaqeshin vetëm në gjysmën e dytë të shekullit XIX.⁶⁷

Deri atëherë autoritet turke kishin lejuar vetëm shkollat greke. Një situatë e tillë rridhte nga pasojat e sistemit “milet” që kishte qënë në fuqi në Perandorinë Osmane. Për autoritetet osmane tipari dallues i një populli ishte feja dhe jo kombësia. Shteti ishte i organizuar mbi bazën e ndarjes fetare dhe bashkësitë jomyslimane quheshin millet. Mileti më i madh ishte ai grek dhe vetëm ai kishte të drejtën e shkollave në gjuhën greke. Shqiptarët, pushteti i

⁶⁵ Valentina Duka, *Historia e Shqipërisë 1912-2000*, “Kristalina-KH”, Tiranë, 2007, f. 63.

⁶⁶ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f.289.

⁶⁷ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, vep. e cit., f. 234.

njihte si turq (turko-shqiptar) dhe atyre u ishte mohuar e drejta e shkollave në gjuhën shqipe. Kuptohet që mileti grek kishte si udhëheqës shpirtëror patriarkun e Stambollit, klerikët e të cilit, me kalimin e kohës zinin pozitën më të lartë.⁶⁸ Mileti në vetvete lidhej me organizimin e bashkësive të veçanta fetare jo myslimane. Me miletet, entitetet e ndryshme kombëtare që ekzistonin në gjirin e perandorisë mohoheshin: diferencimi i vetëm që njihej brenda tyre kishte karakter fetar dhe jo etnik apo gjuhësor.⁶⁹ Falë këtij organizimi, Patriakana e Stambollit do ta rriste juridiksionin e saj mbi të gjithë ortodoksët si në çështjet fetare ashtu edhe mbi ato civile. Orientimi i saj privilegjonte vazhdimisht elementin grek dhe për këtë qëllim në të gjitha rajonet e perandorisë osmane të banuara nga ortodoks kleri i lartë ishte grek, sikurse gjuha liturgjike zyrtare ishte greqishtja.

Gjithashtu, edhe aktet administrative që u përkisnin çështjeve civile me të cilat merrej kisha ishin hartuar në greqisht.⁷⁰ Me kalimin e kohës, Patriarku pasi forconte pozitën e veta, paisej njëkohësisht me pushtet gjyqësor, fiskal dhe administrativ. Ky lloj pushteti, ushtrohej nga kleri i lartë dhe përfaqësuesit e tij në provincë, të cilët ndërhyjnë në zgjidhjet e problemeve të përgjithshme. Në pjesën jugore të Shqipërisë liturgjia zhvillohej në gjuhën greke, kjo si rrjedhojë e faktit që shqiptarëve nuk u ishte lejuar të krijojnë shtetin e tyre dhe një kishë të pavarur, e cila rrjedhimisht do të përdorte shqipen si gjuhë kishtare. Për më shumë, Patriakana e Stambollit kërkonte që besimtarët të mësonin greqishten si gjuhë kishtare dhe shkollore.⁷¹ Si rezultat e kësaj politike pothuajse asimiluese, kleri dhe kisha ortodokse bëheshin themeluesit e kulturës greke në Shqipëri. Ata do të themelonin shkolla

⁶⁸ Roberto Moroco dela Roka, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, "ELENA GJIKA", Tiranë, f. 43.

⁶⁹ Po aty, f. 44.

⁷⁰ Po aty, f. 43.

⁷¹ Po aty, f. 44.

fillore greke gjatë shek. XVII dhe XVIII në rajonin e Zagorisë dhe në provincën e Himarës. Më vonë, të tjera shkolla do të krijoreshin në Vlorë dhe në Korçë. Kështu, për më shumë se dy shekuj me radhë, kultura greke do të ushtronte një influencë të fortë mbi shqiptarët ortodoksë.⁷² Një impuls të ri kësaj politike i jepte krijimi i shtetit grek, i cili në bashkëpunim me kishën, do të punonte intensivisht për helenizimin e popullsisë shqiptare ortodokse. Shkollimi i popullsisë në këtë territor kryhej me tekste mësimore që vinin nga Athina. Vet kisha, me mbështetjen e vazhdueshme të shtetit grek, tentonte me çdo mënyrë që të ndalonte përdorimin e gjuhës dhe kulturën folklorike shqiptare.⁷³ Kuptohet që objektivi i kësaj politike ishte eliminimi i identitetit kombëtar të ortodoksve shqiptar.

Politikën helenizuese e kishin kuptuar rilindasit shqiptarë, të cilët theksonin se krijimi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare ishte një nga objektivat kryesore. Sami Frashëri e radhiste atë të dytën pas gjuhës shqipe për nga rëndësia.⁷⁴ Diplomacia greke e kishte të qartë se elementi i gjuhës ishte pika më e dobët në platformën politike të hartuara nga Greqia, prandaj ajo nuk konsiderohej si element thelbësor në përcaktimin e ndërgjegjjes kombëtare. Përsa i përkiste argumenteve statistikore, pala greke paraqiste disa të dhëna të pavërteta, ku pretendohesh se “Epiri i Veriut” banohej nga 230.000 veta, nga të cilët rreth 150.000 ishin grekë; dhe se, po të përjashtoheshin ato pjesë të kazave të Tepelenës dhe Përmetit që gjendeshin në veri të Vjosës dhe kazaja e Starovës, mbetej një rajon i banuar nga 120.000 grekë dhe 80.000 shqiptarë të mpleksur në mënyrë të pandashme.⁷⁵ Territoret e banuara nga shqiptarë sipas Greqisë duhej t’i lireshin shtetit të ri shqiptar që ishte

⁷² Roberto Moroco dela Roka, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, vep. e cit., f. 44.

⁷³ Po aty, f. 44.

⁷⁴ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 40.

⁷⁵ Joseph Swire, *Shqipëria: ngritja e një Mbretërie*, Williams&Norgate Ltd, Londer, 1929, f. 141.

parashikuar që të krijohej nga Konferenca e Paqes. Për të përforcuar pretendimet e delegacionit helen, në vitin 1919, Shtabi Madhor i Përgjithshëm Grek do të publikonte Hartën Etnografike të Epirit të Veriut, në vitin 1913. Statistikat e dhëna ishin tërësisht tendecioze dhe të ndërtuara sipas parimit se çdo ortodoks ishte grek. Sipas kësaj harte, Korça me tre kazatë e saj (kazaja e Korçës, Starovës dhe e Kolonjës) kishte 44.468 grekë dhe 53.684 shqiptarë.⁷⁶ Ndërsa për sa i përkiste Gjirokastrës, ajo ishte e përbërë prej gjashtë kazash (Kazaja e Gjirokastrës, Himarës, Delvinës, Leskovikut, Tepelenës dhe ajo e Përmetit) dhe paraqiteshin këto të dhëna: 66.870 grekë dhe 53.500 shqiptarë. Pak a shumë, këto ishin të dhënat që qeveria greke i kishte paraqitur vite më parë Konferencës së Ambasadorëve të Londrës në një memorandum për kufijtë e Epirit, të cilin e kishte pajisur me një tabelë statistikore, të hartuar sipas të dhënave otomane të vitit 1908.⁷⁷

Por në të vërtetë, sipas të dhënave statistikore të pakontestueshme, të përpiluara nga Byroja e Komisionit Francez në Korçë dhe në Starovë, në këto dy kaza banonin 122.315 persona, nga të cilët 82.245 ishin myslimanë dhe 40.070 ortodoksë. Sipas regjistrimit të popullsisë në pjesën tjetër të “Epirit të Veriut” (Gjirokastra, Tepelena, Përmeti, Delvina, Kurveleshi, Kolonja, Leskoviku), të bërë nga qeveria turke dhe Komisionit Ndërkombëtar, rezultonin 76.651 kristianë dhe 91.846 myslimanë. Popullsia totale ishte 168.497.⁷⁸ Duke shtuar edhe popullsinë e Korçës dhe të Pogradecit dilte që popullsia totale ishte 290.812 banorë.⁷⁹ Nga këta, 117.721 banorë i përkisnin fesë ortodokse, një shifër e përafërt me atë që paraqiste qeveria greke në memorandumun e saj. Këto shifra binin në kundërshtim me

⁷⁶ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 242.

⁷⁷ Po aty, f. 242.

⁷⁸ Po aty, f. 242.

⁷⁹ Po aty, f. 242.

numrin e popullsisë të paraqitur nga pala greke në Konferencë, që siç u ilustrua më lart ishte 230.000. Ishte e qartë që këto dhëna reduktonin me qëllim numrin e popullsisë myslimane, për të cilën pretendohesh se ishte 80.000 banorë. Por në të vërtetë po të zbriteshin prej shumës totale popullsia e krishterë që ishte 120.000, atëherë mbetej që popullsia myslimane të ishte 170.812 banorë.⁸⁰ Me qëllim që të sigurohej një shumicë ortodokse, pala greke mendonte të ndante në mënyrë arbitrare rajonin e Epirit. Nga “Epiri i Veriut” sipas saj, mund të shkëputeshin, rajonet e Kurveleshit, një pjesë e kazasë së Tepelenës dhe të Përmetit, të vendosura deri në veri të lumit Vjosë dhe të kazasë së Starovës, që gjendet në veri të Devollit, popullsia e të cilave ishte pothuajse shqiptare.⁸¹ Mirëpo duke vepruar në këtë mënyrë, injorohej fakti se shkëputja e këtyre territoreve nga rajonet me të cilat formonin një të tërë të pandashme nga pikëpamja ekonomike, etnike dhe gjeografike ishte e pamundur dhe do të kishte pasoja të rënda.

Pretendimet e palës greke, të cilat ngriheshin duke marrë për bazë vetëm kriterin e besimit fetar binin ndesh me të dhënat që zotëronte Franca. Edhe pse Franca kishte parapëlqyer gjithmonë të përkrahte aspiratat greke ndaj atyre shqiptare, një hartë e nxjerrë më 1915 nga Ministria Franceze e Luftës, që shënonte shpërndarjen e racave dhe të feve në Shqipëri, tregonte që “Epiri i Veriut” konsiderohej shqiptar në një shumicë dërrmuese dhe kryesisht mysliman.⁸² Kryeministri Venizellos me cilësinë e kryetarit të delegacionit grek në Konferencën e Paqes, e pranonte se e gjithë kjo popullsi ishte me origjinë shqiptare dhe gjuha e saj e folur ishte shqipja. Ai e injoronte vlerën që kishte ky fakt për të provuar

⁸⁰ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 242.

⁸¹ Po aty, f. 244.

⁸² Joseph Swire, *Shqipëria: Ngritja e një Mbretërie*, vep. e cit., f. 144.

kombësinë shqiptare të këtyre banorëve, duke supozuar se Fuqitë Aleate nuk mund të pranonin ndonjë kriter tjetër, përveçse atë të ndërgjegjjes kombëtare.⁸³ Ky qëndrim largohej shumë nga koncepti gjerman në përcaktimin e kombësisë së asaj kohe, i cili i referohej mbi të gjitha, idesë së kombit, në kuptimin e një përkatësie gjuhësore dhe kulturore, gjë që nënkuptonte se minoriteti për të qenë i mbrojtur, duhet të ishte i lidhur pas një kombi më të madh të shndërruar tashmë në shtet ose në një pjesë federative të një shteti federal. Delegacioni grek mbyllte ndërhyrjen e tij pranë Komisionit duke nënvizuar se çështja e shifrave rreth numrit të popullsisë nuk ishte kryesorja, rëndësi kishte të dihej se çfarë përfaqëson një grek dhe çfarë është një shqiptar.⁸⁴ Ajo që tërhoqte vëmendjen në Konferencën e Paqes, ishte fakti se delegatët helenë për përcaktimin e kombësisë së popullsisë në Shqipërinë e Jugut bazoheshin në kriterin fetar duke anashkaluar në këtë mënyrë elementë të rëndësishëm siç ishin etnia, gjuha dhe kultura.

3.3. Njohja e minoriteteve nga qeveria shqiptare në Konferencën e Paqes

Përballë një komisioni të krijuar posaçërisht për të mbështetur rivendikimet territoriale të Greqisë, të bazuara në prezencën e një popullsie minoritare, të krijohej përshtypja se çështja shqiptare ishte e pashpresë.⁸⁵ Aq më tepër që vetë çështja e pjesëmarrjes dhe e dëgjimit të delegacionit shqiptar në debat vihej në dyshim, pasi delegati francez dhe ai britanik gjykonin se nuk ekzistonte një qeveri shqiptare e njohur.⁸⁶ Qëndrim

⁸³ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 245.

⁸⁴ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 291.

⁸⁵ Po aty, f. 292.

⁸⁶ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, vep. e cit., f. 236.

komplet të kundërt mbante delegati amerikan, i cili kundërshtonte qëndrimet e delegatëve anglezë dhe francezë, dhe kërkonte që delegacioni zyrtar i Shqipërisë të dëgjohej. Si kundërpërgjigje të qëndrimit amerikan, delegati francez kërkonte që përpara komisionit të dëgjoheshin edhe përfaqësuesit e “qeverisë vorio-epiriotë”. Seanca e 27 shkurtit 1919 i kushtohej e gjitha dëgjimit të palëve dhe koha e mbledhjes ndahej midis delegacionit shqiptar dhe atij “vorio-epiriot”.⁸⁷ Kërkesat shqiptare mbroheshin nga Turhan Pasha, si kryetar i qeverisë së Durrësit, Mihal Turtulli dhe Mehmet Konica.⁸⁸

Rëndësia e ndërhyrjes së delegacionit qëndronte në faktin se ky ishte një ndër hapat e parë në angazhimin diplomatik të faktorit shqiptar për rimëkëmbjen e shtetit pas Luftës së Parë Botërore. Turhan Pasha, në fjalimin hyrës të tij, hidhte poshtë statistikën greke lidhur me Shqipërinë e Jugut, sipas të cilave, banorët që jetonin atje në shumicë ishin grekë, ku pjesa më e madhe e të cilëve ishin bujq migrues që punonin tokat e zotëruara nga shqiptarët.⁸⁹ Ai vashdonte me ndërhyrjen e tij duke argumentuar se në një tërësi prej 240.000 banorë që kishte Shqipëria e Jugut, vetëm 16.500 ishin grekë.⁹⁰ Lidhur me qytetet e kontestuara nga Greqia, Korça dhe Gjirokastra, Turhan Pasha deklaronte se aty nuk kishte as edhe një grek të vetëm. Më pas, fjalën e merr Mihal Turtulli, i cili ishte nga Korça dhe i përkiste besimit fetar ortodoks. Duhet rikujtuar se gjithë arsyetimi i kërkesave dhe pretendimeve greke bazohej në kriterin fetar. Ndërkohë që nuk duhej harruar fakti, se Shqipëria Jugore ose “Epiri” kishin pasur gjithmonë të njëjtat zakone dhe ndjenja

⁸⁷ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 293.

⁸⁸ Luan Omari, *Çështja e pakicave kombëtare*, “Guttenberg”, Tiranë, 2014, f. 47.

⁸⁹ Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi Etnik Fuqitë e mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*. Vep. e cit., f. 201.

⁹⁰ Po aty, f. 201.

shpirtërore, si gjithë pjesa tjetër e Shqipërisë. Gjuha e folur ishte e njëjtë me gjuhën e të gjithë shqiptarëve si në Jug ashtu dhe në Veri.⁹¹ Dalja e delegatit shqiptar përpara Komisionit për mbrojtjen e pikëpamjeve shqiptare nuk mund të mos bënte një efekt të veçantë. Në ndërhyrjen e tij të gjatë Mihal Turtulli theksonte:

*“Dihet botërisht se në trevat që grekët e quajnë Epiri i Veriut, kurse ne shqiptarët e quajmë Shqipëria e Jugut, nuk ka asnjë grek. Unë jam prej Korçe. Kam punuar si mjek në këtë qytet. Unë shpall këtu në mënyrë të prerë se nuk ka asnjë banor grek, as në qytet, as në rrethin e Korçës. Grekët i quajnë grekë ata që janë të fesë ortodokse; unë jam ortodoks, por nuk jam grek. Bullgarët dhe serbët janë ortodoksë, nuk janë grek. Epiri nuk ka qenë një pjesë e Greqisë. Shkollat greke atje janë në të vërtetë shkolla ortodokse shqiptare”.*⁹²

Në këtë mënyrë, pala shqiptare me të drejtë hidhte poshtë tezën mbizotëruese greke (dhe serbe), e cila e identifikonte kombësinë duke u bazuar te feja e përbashkët ortodokse. Ekzistenca e disa besimeve fetare në Shqipëri i kishte shtyrë mbështetësit e shqiptarizimit të përpiqeshin të ndërtonin një komb përtej përkatësive fetare, duke vënë më tepër theksin tek bashkësia e gjuhës, e gjakut, origjina e të parëve, zakoneve të përbashkëta dhe të territorit. Thënë ndryshe, ideja e nacionalizmit shqiptar mbështetej në ndërtimin e një kombi multifetar.

Duke u rikthyer te fjalimi i M. Turtullit, ai vazhdonte:

*“Thonë po ashtu se ne kemi arsim grek. Unë vetë kam përfituar nga ky arsim. Nuk është ndonjë gjë e jashtëzakonshme, po të merret parasysh kisha jonë dhe arsimi ynë. Por shumica nuk është greke, ajo është shqiptare”.*⁹³

Në vazhdim të paraqitjes së tij, ai ndalej edhe në disa aspekte të ndryshme të debatit, duke i trajtuar ato si dëshmitar i drejtpërdrejtë i atyre ngjarjeve. Kështu, M. Turtulli

⁹¹ Enver Bytyci, *Shqiptarët, serbët dhe grekët*, “KOHA”, Tiranë, 2005, f. 80.

⁹² Tajar Zavalani, *Histori e Shqipërisë*, “PHONENIX”, Londër, 1998, f. 255.

⁹³ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 294.

shprehej mbi çështjen e shkollave greke, ku kishte qenë drejtor, dhe me këtë rast ai parashtronte dhe historinë e ndërlikuar të shkollës shqipe. Ai hidhte poshtë pretendimin se shkollat greke ishin një provë e helenizimit të këtyre trevave, duke e arsyetuar mungesën e shkollave shqipe me ndalimin e Stambollit, i cili pengonte ndërgjegjësimin kombëtar dhe synonte ta mbante Shqipërinë myslimane si bastionin e fundit të pranisë turke në Ballkan. Kishte qenë pikërisht politika e ndjekur nga Porta e Lartë shkaku që gjuha shqipe të mos përhapej, të shkruhej dhe mësohej nëpër shkolla. Për pasojë, turqishtja mbetej si gjuhë e institucioneve, ndërsa greqishtja në jug të vendit zhvillohej si gjuhë e liturgjisë fetare dhe e tregëtisë.⁹⁴ Si provë të karakterit shqiptar të atyre zonave, M.Turtulli përmendte Protokollin mbi autoniminë e Krahinës së Korçës të dhjetorit 1916,⁹⁵ e cila mbante firmën e gjeneralit francez Descoins. Ai jo vetëm lejonte njohjen reale mbi të dhënat në këtë vend por shoqërohej edhe me një raport të hollësishëm drejtuar Komandantit të “Armatës së Lindjes” gjeneralit Sarraill.⁹⁶

Në atë kohë, falë prezencës së trupave franceze, ishte vendosur që gjuha shqipe të ishte gjuha zyrtare. Madje, edhe në ato fshatra me popullsi ortodokse, fakti që popullsia nuk nguronte të shprehte lirisht ndjenjat shqiptare, sillte çeljen e shkollave ku do të mësohej gjuha shqipe.⁹⁷ Çelja e shkollave në gjuhën shqipe, detyronte në një farë mënyre edhe kishën ortodokse, e cila për t’u përshtatur me gjendjen e re shtetërore, pak nga pak do të shkonte drejt autoqefalisë së saj. Ky fakt ishte shenja që tregonte fundin e helenizimit të krahinës së Korçës. Qeveria dhe kisha greke e kishin kuptuar tendencën e zhvillimit të këtij

⁹⁴ Enver Bytyci, *Shqiptarët, serbët dhe grekët*, vep. e cit., f. 88.

⁹⁵ Aben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, vep. e cit., f. 237.

⁹⁶ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 294.

⁹⁷ Po aty, f. 295.

procesi historik dhe ishin munduar t'i kundërshtonin me forcë këto ndryshime të natyrshme në jetën kombëtare shqiptare. Këto ndryshime do të shkaktonin lindjen e polemikave midis Shqipërisë dhe Greqisë, të cilat kishin karakter politik dhe nuk kishin të bënin me garantimin e të drejtave të minoritetit grekofon. Mund të thuhet se ndërhyrja e delegacionit shqiptar shënonte një moment të ri në zhvillimin e debatit. Dëshmi e këtij ndryshimi mund të konsiderohej pyetja që kryetari i seancës i bënte delegatëve shqiptar, se cilat do të ishin garancitë që do t'i jepej popullsisë jo shqiptare të Shqipërisë së Jugut.⁹⁸ Përgjigjja ishte e se do të jepeshin të gjitha garancitë që vendet e qytetëruara u jepnin minoriteteve që ndodheshin në territoret e tyre.⁹⁹ Kjo deklaratë e delegacionit përpara Konferencës së Paqes mund të konsiderohej si akti i parë i angazhimit të shtetit shqiptar për respektimin e të drejtave të minoriteteve pas Luftës së Parë Botërore.¹⁰⁰ Përgjigjja e delegatëve shqiptarë konsiderohej e besueshme, pasi nacionalizmi shqiptar krahasuar me atë të shteteve të tjera ballkanike, kishte një përhapje të ngadaltë si pasojë e një zhvillimi ekonomik të kufizuar, mungesa e rrjetit të komunikimit efikas, një masë e lartë e analfabetizmit, zhvillimi i dobët i arsimit dhe veçanërisht një mungesë e theksuar e shtetit që do të prodhonte këtë nacionalizëm në kuadrin e një konstruksioni shtetëror.¹⁰¹ Në këtë kuadër, një pengesë themelore kishte qenë edhe ekzistenca dhe prania e besimeve fetare të ndryshme. Po ashtu, edhe presioni fuqishëm nationalist i vendeve fqinje kishte luajtur një rol shumë të madh në pengimin dhe modelimin e nacionalizmit shqiptar.¹⁰² Të gjithë këta faktorë së bashku luanin një rol të rëndësishëm në zhvillimin e nacionalizmit shqiptar pas Shpalljes së

⁹⁸ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 295

⁹⁹ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, vep. e cit., f. 237.

¹⁰⁰ Luan Omari, *Çështja e pakicave kombëtare*, vep. E cit., f. 48.

¹⁰¹ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 30.

¹⁰² Po aty, f. 30.

Pavarësisë së Shqipërisë. Ata bënë të mundur që nacionalizmi shqiptar të mos merrte një karakter agresiv dhe aq më tepër një karakter përjashtues. Këto rrethana dhe tipare të nacionalizmit shqiptar kishin pasur një ndikim të madh edhe në ndërtimin e raporteve të tij me pakicat e ndryshme që ekzistonin në territoret shqiptare para dhe pas krijimit të shtetit shqiptar. Në mbyllje të fjalës së delegacionit shqiptar, M. Konica shprehte dy rezerva. E para kishte të bënte me Protokollin e Korfuzit, i cili ishte nënshkruar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit në maj të vitit 1914. Protokolli ishte një njohje e autonomisë së Shqipërisë së Jugut si rrjedhojë e “kryengritjes vorioepirote”, që organizohej nga Greqia me qëllim realizimin e një parapërgatitjeje për shkëputjen e trojeve jugore.

Mehmet Konica ndalej posaçërisht te Protokollin e Korfuzit duke e quajtur atë “të firmosur nën presionin e Greqisë”, një akt që parashikonte një autonomi me prirje të qarta separatiste, një hap drejt shkëputjes. Regjimi i pakicave që do të vendosej në Shqipëri, nuk mund të ngrihej mbi një bazë të tillë.¹⁰³ Rezerva e dytë kishte të bënte me kuadrin e përgjithshëm të caktimit të kufirit në jug. Në këtë kuadër nuk mund të lihej mënjane çështja çame. Çamëria theksonte ai, “është një krahinë që shtrihet deri në Prevezë”, aty “ka një shumicë dërrmuese shqiptarësh, me një popullsi të përgjithshme prej 60.000 banorësh, 40.000 prej të cilëve janë shqiptarë myslimanë, 14.000 shqiptarë të krishterë dhe vetëm 6.000 grekë”.¹⁰⁴ Delegati britanik shprehte habinë e tij, pasi bëhej fjalë për një krahinë që ishte pjesë e Greqisë, në një kohë kur Athina kërkonte të merrte dhe jo të jepte territore. Ndërhyrjes së delegatit britanik i përgjigjej M. Turtulli, i cili kujtonte parimin e kombësisë që duhej t’i përmbahej edhe Greqia. Por delegacioni shqiptar kundërshtonte tezën e

¹⁰³ Adrian Papajani, *Të drejtat e pakicave*, Elbasan, Sejko, 2005, f. 93.

¹⁰⁴ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 295.

qeverisë greke, se popullsia në Shqipërinë e Jugut kishte ndërgjegjje kombëtare greke. Ai propozonte zhvillimin e një referendumi në territoret shqiptare dhe në disa zona të Greqisë Veriore që banoheshin nga shqiptarët. Sipas kërkesës së palës shqiptare këto zona do të vendoseshin nën autoritetin e ushtrisë amerikane. Të njëjtin sugjerim kishte paraqitur edhe kryeministri grek Venizellos më 24 shkurt, por kjo ishte vetëm një lëvizje diplomatike me qëllim që të krijonte bindjen e ekzistencës të një shumice greke në rajon. Lideri grek, duke ndjerë rrezikun e një dështimi, do të tërhiqej më vonë nga një propozim i tillë. Delegacioni shqiptar do të mbaronte ndërhyrjen e vetë para Komisionit dhe pjesëmarrja e tij në debatin përpara Fuqive të Mëdha, do të vlerësohej si një vepër e çmuar kombëtare, e cila do të jepte frytet e saj në një moment shumë të vështirë të historisë së popullit shqiptar.¹⁰⁵

3.4. Çështja “vorio-epiriotë” në Konferencën e Paqes

Në Konferencën e Paqes do të merrte pjesë edhe një delegacion, i cili pretendonte se ishte shprehje e vullnetit të “popullsisë së Epirit”, por realisht ishte frymëzuar nga Greqia për të shtuar vlerën e pretendimeve të saj.¹⁰⁶ Delegacioni do të dëgjohej nga Komisioni gjatë pjesës së dytë të seancës së 27 shkurtit. Në emër të kësaj përfaqësie fjalën e merrte njëra nga figurat e njohura të Protokollit të Korfuzit mbi autonominë vorio-epiriotë, Karapanos.¹⁰⁷ Ai ndërhynte disa herë duke iu përgjigjur pyetjeve që i drejtonte Komisioni. Gjithë diskutimi përqëndrohej rreth argumentave të parashtruara më para, ndër të cilat

¹⁰⁵ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 296.

¹⁰⁶ Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi Etnik Fuqitë e mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*. Vep. e cit., f. 198.

¹⁰⁷ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 296.

vendin qendror e zinte përsëri përkatësia fetare e popullsisë së Shqipërisë së Jugut. Delegacioni epiriot nënvizonte antagonizmin e elementit shqiptaro-mysliman dhe elementit të krishter grek, që ishin thellësisht të ndryshëm nga njëri-tjetri.¹⁰⁸ Por ky qëndrim ishte i gabuar, pasi identifikimi i kombit shqiptar po ndërtohej nëpërmjet një bashkëpunimi paralel midis bektashizmit dhe krijimit të një kishe ortodokse shqiptare autoqefale, një katolicizmi gjithnjë e më të angazhuar në çështjet e ndërtimit të identitetit shqiptar dhe së fundi përmes një islami, i cili kishte si motiv të qënësishëm një model dhe natyrë specifike shqiptare dhe evropiane.¹⁰⁹ Midis këtyre faktorëve ndërveprues, atdhetarët shqiptar, përpiqeshin të ndërtonin një islam liberal dhe tolerant, i cili duhej të kishte një advokacion të përshtatëshëm për Evropën dhe i pranueshëm prej saj. Kjo ishte, natyrisht, një sfidë jo e pakapërcyeshme për të legjitimuar ekzistencën e një kombi me shumicë myslimane në Evropë.

Kjo sfidë bëhej shumë e vështirë për t'u fituar, jo vetëm për shkak të paragjykimëve evropiane të kohës, por sidomos, prej propagandës agresive greke, por edhe serbe, që synonte ndalimin e krijimit të një shteti shqiptar, copëtimin e territoreve shqiptare dhe spastrimin etnik të shqiptarëve myslimanë nga trevat e tyre. Kuptohej që në rrethana kaq të vështira, toleranca dhe pranimi i minoriteteve të krishtera ishte një detyrë që kërkonte më shume impenjim nga atdhetarët shqiptarë. Karapanos vazhdonte të argumentonte duke theksuar se përbërja etnike e trevave jugore ishte ndryshuar me dhunë nga xhonturqit (turqit e rinj).¹¹⁰ Ai tentonte të vinte në dukje faktin se elementi shqiptar nuk ishte autokton por i

¹⁰⁸ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 296.

¹⁰⁹ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 31.

¹¹⁰ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, vep. e cit., f. 237.

ardhur. Megjithatë, ai pohonte se popullsia myslimane nuk duhej nënvlerësuar, interesat e tyre ishin të lidhura me ato të popullsisë që banonte në jug dhe nuk mund të ndaheshin nga njëra-tjetra.¹¹¹ Karapanos argumentonte se, shqiptarët ishin në vendin e vet në veri, kurse në jug turqit ishin përpjekur ta shqiptarizonin vendin duke krijuar rrethe shqiptare atje ku nuk kishte patur fare shqiptarë.¹¹² Karapanos si pjesëtar i “qeverisë së Zografos” dhe pjesëmarrës aktiv në të ashtuquajturin revolucion vorioepirot, prekte disa ngjarje të verës 1914 lidhur me “Protokollin e Korfuzit”. Sipas tij, marrëveshja ishte jo vetëm një lëshim në favor të autonomisë vorioepirote brenda kufijve të shtetit shqiptar, por edhe një konstatim i paaftësisë së shqiptarëve për vetëqeverisje.

Por ky konstatim nuk ishte i saktë pasi, revolucionin vorioepirot do të vihej në lëvizje nga Greqia fill pas caktimit të kufirit greko-shqiptar nga ana e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK). Në Gjirokastër do të organizohej një kongres panepirotik dhe më 17 shkurt 1914 do të shpallej autonomia e Vorio-Epirit me një qeveri të përkohshme, kryetar i së cilës do të zgjidhej Jeorjios Zografos, ish-ministër i Jashtëm i Greqisë.¹¹³ Caktimi i kufirit greko-shqiptar dhe revolucionin vorioepirot (i mbështetur nga Greqia) ishin dy nga shkaqet kryesore që çonin në shpërthimin e konflikteve midis forcave greke dhe atyre shqiptare. Për qetësimin e situatës ndërhynte KNK, i cili organizonte në Korfuz mbledhjen midis përfaqësuesve të tij dhe atyre të qeverisë autonome të “Vorio-Epirit”.¹¹⁴

Gjatë kësaj mbledhje në 1914 nënshkruhej Protokollin e Korfuzit, i cili ishte rezultat i negociatave të zhvilluara midis KNK-së dhe qeverisë autonome të Epirit, pa pjesëmarrjen

¹¹¹ Aben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, vep. e cit., f. 238.

¹¹² Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 297.

¹¹³ Filip Liço, *Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare*, vep. e cit., f. 110.

¹¹⁴ Po aty, f. 111.

aktive të palës shqiptare. Në dispozita e ndyshme të Protokollit nuk përmendej asnjëherë termi “Vorio Epir”. Ky term do të hynte për herë të parë në skenën politike në vitin 1913, gjatë Konferencës së Ambasadorëve. Protokolli në dispozitën nr. 9, parashikonte që në prefektuarat e Korçës dhe Gjirokastrës, gjuha shqipe dhe greke të ishin të lira dhe të përdoreshin përpara autoriteteve dhe në seancat gjyqësore.¹¹⁵ Por liria e përdorimit të gjuhës kufizohej nga dispozita nr. 8, ku trajtohej problemi i shkollave. Kjo dispozitë parashikonte që në shkollat e komuniteteve ortodokse arsimi të zhvillohej në gjuhën greke.¹¹⁶

Përrjashtim nga ky kufizim bëhej në tre klasat e fillores ku së bashku me greqishten do të mësohej edhe gjuha shqipe. Përveç mësimi fetar, i cili parashikohej të zhvillohej vetëm në gjuhën greke, Protokolli i Korfuzit parashikohej të zbatohet në prefekturat e Korçës dhe Gjirokastrës ku shumica e popullsisë ortodokse ishte shqipfolse.¹¹⁷ Popullsia minoritare grekophone kishte vetëm në prefekturën e Gjirokastrës. Në rrethin e Gjirokastrës kishte 39 fshatra grekophone në Dropull dhe 6 në Pogon, ndërsa në rrethin e Delvinës numëroheshin afro 62 fshatra. Gjithshtu kishte 2 fshatra grekophone në Përmet dhe 3 fshatra në Himarë.¹¹⁸ Protokolli i Korfuzit nuk do të zbatohet për shkak të fillimit të Luftës së Parë Botërore dhe për këtë arsye delegacioni vorio-epiriot nuk duhej të pranohej në Konferencën e Paqes. Për më shumë, pjesa dërrmuese e popullsisë e të ashtuquajturit “Vorio Epir” për nga përbërja etnike ishte shqiptare dhe ky delegacion nuk ishte shprehje e vullnetit popullor. Dëgjimi i delegacionit “Vorio Epiriot” tregonte qëndrimin e padrejtë që Fuqive të Mëdha mbanin kundrejt çështjes shqiptare. Përfundimi i dëgjimit të palëve

¹¹⁵ Filip Liço, *Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare*, vep. e cit., f. 112.

¹¹⁶ Po aty, f. 112.

¹¹⁷ Po aty, f. 112.

¹¹⁸ Po aty, f. 112.

përpara Komisionit tregonte një mospërputhje mbi të dhënat dhe kriteret ku bazoheshin Greqia dhe Shqipëria në përcaktimin e kombësisë së popullatës që jetonin në Shqipërinë e Jugut.

3.5. Fuqitë e Mëdha dhe përcaktimi i kufirit të Shqipërisë së Jugut

Qysh në seancën e parë të 12 shkurtit delineoheshin qartë qëndrimet e përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha rreth pretendimeve të Greqisë mbi territoret jugore të Shqipërisë. Kryetari i seancës, francezi Jules Cambon, pasi bënte disa arsyetime të përgjithëshme mbi përzierjen e racave në Evropën Lindore, veçanërisht në hapësirat e ish Perandorisë Osmane, si kriter të përcaktimit të kombësisë vendoste përkatësinë fetare. Dy përfaqësuesit e tjerë të Francës Gout dhe Laroche shpreheshin më drejtëpërdrejtë dhe mbronin haptazi anën e rivendikimeve greke. Kundër pretendimeve greke shprehej hapur delegati amerikan Day. Ai deklaronte se ishte kundër zgjidhjes së propozuar nga Venizellos, sepse në kujtesën e tij, ato nuk përputheshin e me kufijtë etnikë. Sipas diplomacisë amerikane, propozimi i palës greke për Shqipërinë e Jugut, këpuste marrëdhëniet ekonomike, trashëgimitë kombëtare dhe lidhjet fisnore, ku këto të fundit konsideroheshin si lidhjet më të fuqishme mes shqiptarve.¹¹⁹ Mbi të gjitha, për amerikanët, gjuha ishte përcaktuesi kryesor i kombësisë, pavarësisht nga problemet e dygjuhësisë apo trashëgimeve dhe shënjesve të tjerë të identitetit. Përfaqësuesi i Italisë De Martino, që paraqitej si njohësi më i mirë i çështjes shqiptare, sillte një varg argumentash për të

¹¹⁹ Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi Etnik Fuqitë e mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*. Vep. e cit., f.190.

kundërshtuar pretendimet greke. Ai argumentonte, midis të tjerash, se kombësia shqiptare nuk mund të përcaktohej lehtë, pasi feja aty nuk ishte një element determinues, duke konstatuar që në veri kishte katolikë dhe jugu i Shqipërisë banohej nga ortodoksë me kombësi shqiptare.¹²⁰

De Martino pasohej nga kolegu i tij kolonel Castoldi, i cili sillte përvojën e tij si ish anëtar i Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve të vitit 1913, që kishte përcaktuar vijën kufitare midis Shqipërisë dhe Greqisë. Në atë rast sipas tij, Konferenca e Londrës e kishte përjashtuar kriterin fetar, si element bazë të kombësisë dhe e ngarkonte Komisionin të bazohej para së gjithash tek gjuha. Ai e përforconte tezën e tij, duke shtuar se procesverbalet dhe hartat përkatëse ishin hartuar pikërisht mbi këtë bazë. Në vazhdim të debatit, përfaqësuesi francez Laroche sillte si argument në favor të pretendimeve greke ngjarjet e vitit 1914 në jug të Shqipërisë, prej të cilave lindte “autonomia vorio-epirote”. Ai e quante “Qeverinë e Zografos” si një manifestim të vullnetit të popullsisë së këtyre trevave për t’u bashkuar me Greqinë. Por, mbi këtë pikë kolonel Castoldi shprehte kundërshtime dhe shprehej se qeveria epirote nuk kishte qënë asnjëherë shprehje e vullnetit popullor. Dëshmi kishin qënë mizoritë e andartëve, vrasjet dhe djegiet e fshatrave, shpërnguljet e mijëra banorve në rrethinat e Vlorës për t’iu shpëtuar mizorive greke.¹²¹ Gjatë seancës së parë binte në sy pozicioni disi më i tërhequr i përfaqësuesit të Britanisë së Madhe, Sir Eyre Crowder. Ai deklaronte se do të priste rezultatet që do të arriheshin pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Mbledhja e parë karakterizohej nga dy qëndrime: njëri, i përfaqësuar nga

¹²⁰ Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi Etnik Fuqitë e mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*. Vep. e cit., f. 191.

¹²¹ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 279.

delegatët e Francës dhe të Britanisë së Madhe në mbështetje të kërkesave greke dhe i dyti, i përfaqësuar nga delegatët e SHBA dhe sidomos të Italisë, që shprehnin rezerva lidhur me këto kërkesa. Seanca e dytë zhvillohej më 18 shkurt dhe delegacionet duhet të dilnin me një zgjidhje konkrete për çështjen e vijës kufitare midis Shqipërisë dhe Greqisë. Delegati i SHBA Day, përforconte pozicionin e tij duke hequr një vijë në një hartë të veçantë. Ai e arsyetonte këtë veprim duke thënë se nisej nga dy parime:

- 1) Parimi i parë synonte të ruante rrugët e komunikimit për të dy popujt, grekët do të kishin rrugën në drejtim të Janinës, kurse shqiptarët do të kishin atë në drejtim të Vlorës:
- 2) Parimi i dytë synonte të ndante të dy shtetet sipas përbërjes së popullsisë.¹²²

Në arsyetimin e tij, Day ndalej edhe në statistikën gjuhësore që ata zotëronin, ku sipas tij, në veri shumica dërrmuese flisnin shqip, kurse në jug kishte 35.000 grekë dhe 50.000 banorë shqipfolës.¹²³ Sipas këtyre të dhënave, delegati amerikan dilte në përfundimin se, pjesa veriore e krahinës në diskutim ishte me prirje shqiptare, kurse ajo jugore mund t'i lihej Greqisë (Gjirokastrën dhe rrethinat). Në qëndrimin e tij, delegati amerikan i përmbahej kriterit etnik të popullsisë dhe ky aspekt e shtynte atë të përsëriste rezervat kundrejt pretendimeve territoriale të shtetit helen.¹²⁴ Si përfundim, Day vinte në dukje nevojshmërinë e një studimi të thellë të çështjes, që do ishte në interes jo vetëm të Greqisë, por edhe për të gjithë rajonin e Ballkanit.

¹²² Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 280.

¹²³ Po aty, f. 280.

¹²⁴ Po aty, f. 280.

Qëndrimin britanik e paraqiste në seancë Sir Robert Borden. Ai e ndante Shqipërinë Jugore në dy pjesë: në veri dhe në jug të lumit Vjosë. Në pjesën jugore të lumit, ai vendoste rrethet e Himarës, Gjirokastrës dhe Delvinës, për të cilat deklaronte se ishin kryesisht greke nga gjuha dhe ndjenjat. Borden shprehej se delegatët britanikë e kishin të pamundur t'i përmbaheshin përsëri kufirit të vendosur nga Protokollin i Firences. Kjo sepse delegatët britanikë bazoheshin në arsyetimin se në Shqipërinë e Jugut banonte një pjesë e rëndësishme e popullsisë që dëshironte bashkimin me Greqinë. Ndryshe nga zgjidhja e paraqitur nga delegati amerikan, ai britanik e linte të hapur çështjen që i përkiste zonave në veri të Vjosës. Borden e pranonte se në rrethet e Leskovikut, Kolonjës dhe Korçës elementi shqiptar përbënte shumicën, por njëjtë të drejtën e grekëve kur pohonin se ato zona kishin elemente të rëndësishëm greke.¹²⁵ Për këto arsye delegatët britanikë rezervonin vendimin e tyre përfundimtar lidhur me territoret, që në atë periudhë konsideroheshin si shqiptare. Debati që fillimisht po orientohej pro kërkesave greke, merrte një përkrahje tjetër nga ndërhyrja e delegatve italian, De Martino dhe kolonel Castoldi. Të dy delegatët e përqëndruan vëmendjen tek përbërja e popullsisë së krahinave në diskutim. Ata vazhdonin prezantimin e tyre duke vendosur si kriter bazë për përcaktimin e popullsisë gjuhën e folur.

Duke rikujtuar trazirat e vitit 1914, ata theksonin se ato nuk ishin vepër e popullsisë vendase por e bandave greke që përbëheshin kryesisht nga grekë të ardhur nga Kreta.¹²⁶ Në përfundim të ndërhyrjes së tyre, delegatët italianë deklarorin se kufiri i caktuar në vitin 1913 ishte, padyshim, ai që i afrohej më shumë një ndarje të drejtë midis Shqipërisë dhe Greqisë. Këtë tezë e përforcuan edhe më tej duke iu përmbajtur Protokollit të Firences. Ajo

¹²⁵ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 281.

¹²⁶ Po aty, f. 282.

vijë kufitare, shpreheshin ata, u përgjigjet për më së miri arsyeve etnike, si i vetmi kriter që mund të garantonte një paqe të qëndrueshme. Ndërsa pikëpamja franceze parashtrohej nga delegati Laroche. Që në fillim të diskutimit të tij në bazë të gjithë arsyetimeve qëndronte elementit fetar.¹²⁷ Delegati francez e pranonte ekzistencën e shqiptarëve myslimanë sikurse edhe atyre të krishterë. Për këtë arsye, sipas Laroche zgjidhja më llogjike do të ishte ndarja e popullsisë sipas përkatësisë fetare, ku myslimanët do t'i lireshin Shqipërisë dhe të krishterët Greqisë. Duke vepruar në këtë mënyrë, mendohej se do të eliminohej çdo bazë e një konflikti fetar dhe do të vendosej një paqe e përhershme midis dy vendeve. Në arsyetimin e tij, delegati francez i kushtonte një vëmendje të veçantë, atë që e quante “rruga e Sarandës”, të cilën ai e konsideronte të rëndësishme për atë pjesë të Epirit të Veriut, që edhe dy delegacionet (amerikane dhe britanike) e tjera mendonin se duhej t'i jepej Greqisë.¹²⁸ Në mbyllje të seancës, Komisioni vendoste që, pas një shqyrtimi tërësor të çështjeve, të dëgjoheshin palët e interesuara. Pasi dëgjonte të gjitha delegacionet, Komisioni vinte në dukje rëndësinë për të marrë një vendim lidhur me kufirin në “Epir”, me qëllim që ekspertët mund të nxirrnin raportet e tyre. Delegati amerikan Day ripërsëriste edhe një herë qëndrimin e tij për krahinën që shtrihej midis Drinos dhe Vjosës.

Ai tregohej i gatshëm të bënte disa lëshime, me qëllim që vija e sugjeruar nga Amerika të takohej me atë të sugjeruar nga Franca dhe Anglia. Bëhej fjalë për Gjirokastrën që Day kishte pranuar që më parë t'i lihej Greqisë. Përsa i përkte vijës kufitare drej veriut, delegati amerikan tregohej i prerë dhe nuk pranonte që të diskutohej përsëri vija e propozuar nga delegacioni francez, e cila parashikonte që rrethi i Korçës t'i kalonte

¹²⁷ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f. 282.

¹²⁸ Po aty, f. 283.

Greqisë. Me ndërhyrjen e tij, delegati anglez Sir Eyre Crowe merrte një qëndrim edhe më të qartë në favor të kërkesave greke. Ai deklaronte se politika më e mirë që duhej të ndiqej për interesin e këtyre zonave, ishte që të plotësoheshin kërkesat e palës greke. Pavarësisht faktit, se ai pranonte që në ato zona kishte një element mbizotërues shqiptar nga pikëpamja numerike, shtonte se nuk duheshin marrë për bazë argumentet etnike. Diplomcia britanike nuk ishte e shumë e interesuar në ndarjen e popullsisë sipas përbërjes së etnike, për atë element i rëndësishëm ishte mbrojtja e interesave të saj në Mesdheun Lindor, përfshi rrugën e Indisë dhe ngushticat.¹²⁹

Debati do të vazhdonte më tej në Komision, duke lënë mënjanë konsideratat etnike dhe fokusohet mbi aspektet ekonomike dhe strategjike. Diskutohej kryesisht për rrugën Korçë-Sarandë, rreth së cilës mendimet e delegatit francez dhe atij italian binin ndesh me njëri-tjetrin. Si përfundim, në fund të seancës votimet zhvilloheshin për dy vijat kufitare, për atë që quhej “vija midis Vjosës dhe Drinos”, e cila parashkonte që Gjirokastra me rrethet t’i lireshin Greqisë. Në favor të kërkesave greke votonin delegatët e tre Fuqive të Mëdha: ata të Francës, Britanisë së Madhe dhe SHBA. Kurse për pjesës veriore dhe lindore të “Epirit të Veriut”, që përfshinin rrugën Korçë-Leskovik dhe Sarandë, votat ishin të barabarta, ku votonin pro delegacioni francez dhe ai anglez, kurse delegacioni amerikan dhe ai italian ishin kundër kësaj zgjidhje. Në fund të seancës mund të vrehet se, Anglia dhe Franca ishin të orientuara pothuajse në favor të pretendimeve territoriale greke mbi gjithë Shqipërinë Jugore (Gjirokastra dhe Korça), kurse SHBA jepte pëlqimin vetëm për të parën dhe përjashtonte me forcë shpëputjen e Korçës nga territoret shqiptare. Ndryshe qëndronte

¹²⁹ Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi Etnik Fuqitë e mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*. Vep. e cit., f. 192.

pozicionimi i Italisë, ajo shprehej në favor të rikonfirmimit të kufijve të vendosur në 1913. Siç mund të kuptohet nga diskutimet në gjirin e Komisionit, asnjë nga përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha nuk ishin plotësisht të angazhuar ndaj zgjidhjes së çështjes shqiptare duke marrë si kriter bazë elementin etnik apo kombëtar. Ky qëndrim përforcohej akoma më shumë kur këto dy elemente binin ndesh me interesat gjeopolitike të vendeve të tyre.¹³⁰

Mbyllja e Konferencës së Paqes tregonte paaftësitë e Fuqive të Mëdha për të rënë dakord mbi kufirin greko-shqiptar. Çështja ndërlikohej nga prezenca e disa faktorëve që ishin: lidhja e elementit të krishterë me kishën ortodokse “greke”, ekzistenca e shkollave greke, padituria e thellë e Europës në lidhje me racën shqiptare dhe lidhja e saj sentimentale me Greqinë.¹³¹ Ndoshta Fuqitë e Mëdha nuk arrinin të kuptonin faktin thelbësor që një i krishter greqishtfolës i Shqipërisë së Jugut nuk ishte domosdoshmërisht grek nga kombësia apo nga ndjenjat; dhe një shqiptar që fliste greqisht, bënte pjesë në kishën ortodokse dhe i dërgonte fëmijët e tij në shkolla greke paraqitej si grek nga ndjenjat.¹³² Edhe pse Konferenca e Paqes organizohej për të vendosur mbi kufijtë e shtetit të ri shqiptar dhe Greqisë, aty për herë të parë do të diskutohej mbi popullsinë minoritare që jetonte në vend. Ky fakt kishte një rëndësi të madhe pasi gjatë konferencës, Shqipëria, jo vetëm do të pranonte ekzistencën e pakicave por, do të merrte impenjimet e para në fushën e të drejtave të minoriteteve.

¹³⁰ Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi Etnik Fuqitë e mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*. Vep. e cit., f. 304.

¹³¹ Joseph Swire, *Shqipëria: Ngritja e një Mbretërie*, vep. e cit., f. 141.

¹³² Po aty, f. 141.

KAPITULLI IV: MINORITETET NË SHQIPËRI GJATË VITEVE

1920-1930

Shqipëria fillonte angazhimin në fushën e mbrojtjes së pakicave kombëtare pas Luftës së Parë Botërore, me pranimin e saj në Lidhjen e Kombeve. Realisht popullsia shqiptare ishte homogjene dhe pakicat përbënin një përqindje të vogël. Ndoshta kjo ishte edhe një nga motivet që shpjegonin arsyen e mungesës së konflikteve me përmbajtje etnike apo racore, gjatë historisë dhe zhvillimit të shoqërisë shqiptare.¹³³ Bashkëjetesa paqësore dhe trajtimi tolerant kundrejt minoriteteve bëhej e mundur nga nacionalizmi i zbehur shqiptar, i cili ishte ambientuar me diversitetin fetar të shoqërisë shqiptare. Këtu qëndronte dhe ndryshimi me shtetet fqinje ballkanike, të cilat ishin themeluar e konsoliduar si shtete homogjene dhe unitare nga pikëpamja fetare, gjë që kishte ndikuar shumë në zhvillimin e nacionalizmit dhe ekskluzivizmin etnik. Por ndryshe nga këto shtete që e konsideronin si parim themelor uljen e peshës specifike të minoriteteve kombëtare brenda kufijve të tyre, si rezultat i zhvillimit të vrullshëm të proceseve asimiluese apo politikave të konvertimit dhe spastrimit etnik, Shqipëria e ruante të pandryshuar peshën specifike të popullsisë së minoriteteve kombëtare.¹³⁴

Pakicat kombëtare në Shqipëri identifikoheshin për herë të parë, për nga pikëpamja numerike, gjatë regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, në vitin 1921. Në këtë regjistrim

¹³³ Beqir Meta, Monarkia.. vep. e cit., <https://www.shqiperia.com/Monarkia-Zogu-beri-me-prona-bujqit-minoritare-.12186/>

¹³⁴ Beqir Meta, Monarkia.. vep. e cit., <https://www.shqiperia.com/Monarkia-Zogu-beri-me-prona-bujqit-minoritare-.12186/>

për të vepruar me identifikimin përdorëshin disa kriterë për përcaktimin e përkatësisë së një pakice. Kriteri kryesor kishte të bënte me faktin që, personat e një minoriteti të shfaqnin karakteristika etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore të veçanta nga pjesa tjetër e popullsisë. Shteti shqiptar tradicionalisht kishte njohur si pakica kombëtare atë popullsi që kishte një komb mëmë, me të cilin kishin karakteristika të përbashkëta, si: lidhjen shpirtërore, gjuhën, zakonet, traditat, besimin fetar etj. Si pakica të tilla pranoreshin pakicat greke, maqedonase e malazeze, ndërsa romët dhe arumunët njiheshin dhe respektoheshin si pakica etnokulturore.

4.1. Minoriteti kombëtar grek

Minoriteti kombëtar grek për nga numri i popullsisë dhe kompaktiteti që ka në territorin, ku kjo popullatë është vendosur, hyn në grupin e minoriteteve të përcaktuara të ngushta. Ky lloj minoriteti është i përbërë nga një pjesë e popullsisë së një shteti tjetër, larguar historikisht dhe të vendosur në shtetin ku përfaqësohet si minoritet. Ai vendoset kryesisht në pjesët periferike dhe popullon zakonisht mjediset fshatare ose ndonjë qendër urbane lokale. Duke gëzuar këto karakteristika, minoriteti kombëtar grek ishte pakica e parë e njohur nga shteti shqiptar. Madje, mund të themi me plotë bindje, se çështja e pakicave kombëtare në Shqipëri indentifikohej për një kohë të gjatë me pakicën kombëtare greke. Kjo lidhej me angazhimin që merrte shteti i ri shqiptar, pas Luftës së Parë Botërore, për të njohur standardet e përcaktuara nga LK, që kishin të bënin me mbrojtjen e pakicave kombëtare. Sipas këtij angazhimi, minoritetit grek në jug të vendit i njihej e drejta e hapjes

së shkollave në gjuhën greke, të cilat funksiononin si shkolla private të subvencionuara nga qeveria greke. Nga të gjitha grupet minoritare që jetonin në territorin e Shqipërisë, minoriteti kombëtar grek, i cili ishte i përqëndruar në jug të Shqipërisë, ishte më i madhi në numër. Identifikimi i kësaj pakice lidhej kryesisht me aderimin e saj në kishën ortodokse dhe me përdorimin e përditëshëm të gjuhës greke.¹³⁵ Territoret ku jetonte ky minoritet njiheshin me terminologjinë përkatëse si “zona e pakicave”, e cila shtrihej në zona kufitare. Ky minoritet, pas pranimit të Shqipërisë në LK në 1921, njihte një përforcim të identitetit dhe të ndërgjegjjes së tij kombëtare. Konsolidimi i pozitive të këtij minoriteti arrihej veçanërisht me afirmimin e mësimin në gjuhën amtare dhe zgjerimin e të drejtave politike e sociale. Shumica e studiuesve pranojnë se kjo pakicë u vendos në zonat ku ajo banonte në fund të shek. XVIII si bujq në tokat e pronarëve shqiptarë. Fillimisht këta ishin punëtorë, por me kalimin e kohës filluan të stabilizoheshin në tokat ku punonin.¹³⁶ Pra, pakicat greke nuk ishin shqiptarë të greqizuar, por ishin grekë të ardhur nga Greqia. Sipas të dhënave të popullsisë të marra në vitin 1923 popullsia e shtetit shqiptar ishte 803.959 banor, ndërsa shtetas shqiptarë me kombësi greke ishin 33.706 banorë. Kështu popullsia e minoritetit grek më 1923 përbënte 4,2% të tërësisë së shtetasve shqiptarë.¹³⁷

Minoriteti grekofon ka qenë i përqëndruar pothuajse tërësisht në prefekturën e Gjirokastrës dhe të Korçës. Në prefekturën e Gjirokastrës bënë pjesë këto krahina: Gjirokastra, Saranda dhe Himara, kjo e fundit pas ndarjes së re administrative të bërë në fillim të viteve '20 do të kalonte në prefekturën e Vlorës. Në prefekturën e Gjirokastrës, ku

¹³⁵ Hugh Poulton, *The Balkans Minorities and States in Conflict*, Minority rights Group, London, 1991, f. 198.

¹³⁶ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 50.

¹³⁷ Po aty, f. 50.

banonte dhe numri më i madh i popullsisë minoritare greke, këto pakica ishin të vendosura në Luginën e Pogonit, në krahinën e Dropullit të Sipërm dhe atë të Poshtëm dhe në Rrëza e Zezë.¹³⁸ Në zonën e Dropullit, minoriteti grek do të mbërrinte fillimisht në gjysmën e dytë të shek. XVIII në pronat e agallarëve shqiptarë. Aty vendoseshin disa familje të veçanta me statusin e bujkut që kishin ardhur për nevoja ekonomike. Pjelloria e tokës në fushën e Dropullit sillte përmirësime të ndjeshme ekonomike për bujqit grek. Këto përmirësime ishin shkak i ardhjes së pjesëtarëve të tjerë të familjeve të këtyre pakicave dhe të stabilizimit të tyre në këto zona.¹³⁹

Në Fushëgropën e Delvinës pakica kombëtare greke ishte e vendosur në Vurgun e Delvinës, ku ata banonin në të njëjtën kohë, si në zona të veçanta kompakte, ashtu edhe në vendbanime të populluara me banorë të kombësisë shqiptare ose vllleh. Të tilla zona me popullsi të përzier, ishin fshatrat Biovizhde dhe Vllahopsillotorë, të cilat ndodheshin në luginën e Vjosës, në afërsi të kufirit grek. Fillimisht zona e Vurgut ishte e banuar nga një popullsi kompakte shqiptare.¹⁴⁰ Popullsia greke në këtë zonë, afrohej nga pronarët feudalë në periudhën e sistemit të çifligut, si bujq për të punuar tokat e Fushës së Vurgut. Pra dukuria e përzierjes së popullsisë është relativisht e re, në fund të shek. XVIII. Bashkëjetesa e popullsisë në këtë zonë do të çonte drejt unifikimit kulturor, e cila do të përfshinte brenda saj edhe faktorët shoqërorë e shpirtërorë. Zhvendosja e pakicave greke do të vazhdonte edhe me vonë, pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, kur shteti shqiptar do të konsolidonte strukturat qendrore. Ky konsolidim sillte edhe një zhvillim ekonomik në disa

¹³⁸ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 50.

¹³⁹ Po aty, f. 51.

¹⁴⁰ Po aty, f. 51.

zona të vendit, si pasojë ndodhnin dhe lëvizje demografike të pakicave greke. Shumë pjesëtarë të kësaj popullsie do të zhvendoseshin në qytetet kyesore, jo vetëm të Shqipërisë së Jugut por edhe në atë të Mesme. Kështu mund të përmendim qytetet e Gjirokastrës, Sarandës, Vlorës, Durrësit dhe Tiranës. Perzierja e popullsisë vendase me atë të ardhur nga Greqia, krijonte një kulturë të përbashkët ku ndërthureshin bashkë traditat, zakonet dhe doket greko-shqiptare. Si pasojë e kësaj përzierje, në shumë zona të Shqipërisë së Jugut banorët flisnin dy gjuhë, shqip dhe greqisht, por në shtëpitë e tyre zakonisht përdornin vetëm një, e cila rrjedhimisht ishte gjuha amtare. Mungesa e të dhënave të sakta statistikore mbi popullsinë shqiptare në përgjithësi dhe asaj minoritare greke në veçanti, detyronin qeverinë të paraqiste një raport jo të plotë pranë LK. Sipas qeverisë, shtetasit greqisht-folsës që jetonin brenda kufijve shqiptar nuk ishin më shumë se 16.000 banorë.

Këto të dhëna do të përgënjeshtroheshin më vonë nga Komisioni Hetimor për përcaktimn e kufijve që do të vizitonte Shqipërinë. Sipas të dhënave që arrinte të mblidhte Komisioni, vetëm në nënprefekturën e Delvinës jetonin mbi 15.150 nënshtetas minoritarë. Përveç popullsisë së Delvinës, në fshatrat midis Libohovës përgjatë kufirit grek deri në afërsi të Psiloterë që ndodhej në lindje, dhe në pjesën perëndimore të luginës së Gjirokastrës, popullsia ishte grekofone, ose më saktësisht kishin greqishten si gjuhë amtare.¹⁴¹ Duke u përmbajtur numërimit të popullsisë që bëhej në mars të 1921 për qëllime elektorale, në gjithë prefekturën e Gjirokastrës kishte 33.313 persona me kombësi greke.¹⁴² Në nënprefekturën e Himarës, e cila fillimisht ishte pjesë e prefekturës së Gjirokastrës dhe

¹⁴¹C 7811, Report of the Commission of Enquiry in Albania from Decembre 19th, 1922 to February 1st, 1923, J.J. Sederholms, 2 May 1923, f. 45.

¹⁴² Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 571.

me pas do të kalonte në atë të Vlorës, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë fliste dy gjuhë. Si përfundim, sipas Komisionit, në Shqipërinë e Jugut popullsia me kombësi greke oshilonte nga 35.000 deri në pothuajse 40.000 banorë.¹⁴³ Propaganda panhelenike pretendonte se numri i minoritetit grek që jetonte në këto treva arrinte në 61.110 banorë, por siç kujtonte Komisioni, rreth 15.000 grekofonë të kësaj popullate totale, jetonin në kazanë e Pogonit, e cila i përkiste Greqisë në atë kohë dhe nuk mund të llogaritej.¹⁴⁴ Po ashtu, kjo propagandë për nënprefekturën e Leskovikut jepte një popullsi grekofone prej 6.100 banorë, shifër e cila ishte e ekzagjeruar. Komisioni duke llogaritur dhe gabimet e mundshme arsyetonte se numri i përgjithshëm i popullsisë minoritare greke nuk mund të ishte më shumë se 40.000 banorë. Po t'i krahasoje këto të dhëna me ato të qeverisë së përkohshme të Zogërit në 1914, e cila pretendonte se në "Epirin e Veriut" banonin rreth 47.889 banorë grekofon, rezultonte se shifrat ishin shtuar me 10.000 banorë.¹⁴⁵

Duke mbledhur të gjithë popullsinë e trevave të Shqipërisë së Jugut, të cilat përfshinin prefekturën e Korçës dhe të Gjirokastrës, me përjashtim të nënprefekturës së Pogradecit (të cilën shteti grek nuk e konsideronte pjesë të "Epirit të Veriut") dhe rrethin e Himarës, popullsia grekofone përbënte 17% të popullsisë totale ose një të gjashtën e saj.¹⁴⁶ Gjithë pjesa tjetër e popullsisë së Shqipërisë së Jugut në shtëpitë e tyre flisnin gjuhën shqipe. Përsa i përkiste qytetit të Korçës, sipas statistikave të kohës, aty nuk bantonte asnjë person që t'i përkiste minoritetit grek.

¹⁴³Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 571.

¹⁴⁴Po aty, f. 571.

¹⁴⁵MPJ, dosja 211, Marrë prej raportit të Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve, Du Journal Officiel, Maj 1923, f. 241.

¹⁴⁶Po aty, f. 241,

4.2. Minoriteti kombëtar maqedonas

Pakica kombëtare maqedonase ishte e përqendruar në zonën e Prespës. Kjo zonë shtrihet në skajin juglindor të Shqipërisë, në kufi me shtetet fqinje të Greqisë dhe Maqedonisë [sot - Maqedonia e Veriut]. Popullsia që jetonte në këtë zonë, në familjet e tyre, flisnin një gjuhë e njohur më emrin “dialekt maqedon”, e cila kishte disa ngjashmëri me bullgarishten. Meqënëse nuk kishte të dhëna të sakta ishte disi e vështirë të vërtetohej nëse banorët ishin bullgarë të vërtetë apo maqedonas. Gjithësesi, banorët e konsideronin veten maqedonë, pavarësisht, se gjatë atyre viteve nuk ishte krijuar akoma Republika e Maqedonisë. Një ndër të paktat hetime të bëra në ato vite, janë ato të gjeneralit Telini, i cili vepronte në kuadër të një komisioni ndërkombëtar të caktuar nga Këshilli i Ambasadorëve që do të përcaktonte kufijtë ndarës midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Komisioni nuk do ta mbaronte punën e tij pasi Telini do të mbetej i vrarë në një atentat, në rrugën që të çonte nga Janina për në Kakavijë. Telini jepte disa të dhëna mbi fshatrat maqedonase, të cilat i kishte vizituar personalisht. Të dhënat e tij kishin të bënin me numrin e shtëpive pasi numrin e popullsisë nuk kishte mundur ta verifikonte. Sipas tij, në Ljubaniste kishte 15 shtëpi të banuara nga maqedonas që punonin në pronat e bejlerve shqiptarë. Në bregun perëndimor të liqenit të Prespës bënin pjesë disa fshatra të banuara nga fshatarë maqedonas, ku numri gjithsej arrinte në 209 shtëpi.¹⁴⁷ Fshatrat ishin: Knosko, Bezmiste, Gorica, Glomboc, Sulim, Pustec, Laisika dhe Crnovha.¹⁴⁸ Shumica e fshatarve punonte në pronat e shqiptarve dhe një pjesë në pronat e veta. Ai vazhdonte më tej duke u

¹⁴⁷ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 654.

¹⁴⁸ Po aty, f. 113.

ndalur në fshatrat Roho dhe Grazden. Në këto dy fshatra numëroheshin 108 shtëpi në të cilat shkollat dhe influenza greke kishin pasur një ndikim të madh, aq sa e konsideronin veten grekë.¹⁴⁹ Në bregun perëndimor të liqenit të Prespës ndodheshin dy fshatra të varfëra dhe gjithsej numëroheshin 22 shtëpi.¹⁵⁰ Një fshat tjetër i lokalizuar nga Telini ishte ai i Vrnikut i përbërë nga 30 shtëpi. Në grupin e fundit bënin pjesë fshatrat: Labanica, Kostonec, Pelikat dhe Smilica. Në këto fshatra kishte 348 shtëpi të banuara nga maqedonas dhe ndikimi grek kishte epërsi mbi primitivitetin maqedonas.¹⁵¹ Të dhënat e paraqitura nga gjenerali italian nuk ishin të plota pasi linin jashtë kësaj liste disa fshatra që më vonë nga pikëpamja administrative do të bënin pjesë në komunën e Prespës. Kjo komunë mbledhte në vetvete disa fshatra maqedonase të cilët ishin: Lajthiza, Pusteci, Zaroshka, Çerja, Shulini, Gollomboqi, Gorica e Vogël, Bezmishti dhe Gorica e Madhe, si dhe fshatin Vermik në zonën e Devollit. Banorët e kësaj zone merreshin kryesisht me bujqësi, blegtori dhe peshkim. Fshatrat e zonës së Prespës, në fillim të vitit 1920 do të bënin pjesë në zonën neutrale të delineuar nga Komisioni i Përcaktimit të Kufirit greko-shqiptar, të cilët më vonë do t'i jepeshin Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve.

Por popullsia e kësaj zone dallonte nga ajo e Gollobordës në të cilën, në vitin 1913 rezultonin 20 vendbanime dhe rreth 60% e banorëve i përkisnin besimit fetar mysliman. Ndërsa në Shqipëri numri i popullsisë së minoritetit maqedonas sipas të dhënave statistikore të vitit 1927 shkonte në 6.655 banorë. Është e domosdoshme të nënvizohet, se shteti shqiptar kundrejt kësaj pakice nuk ndërmori asnjë politik asimiluese dhe gjithashtu,

¹⁴⁹ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 654.

¹⁵⁰ Po aty, f. 654.

¹⁵¹ Po aty, f. 654.

nuk u përpoq të ndryshonte emrat e fshatrave, të cilë ishin në gjuhën sllave.¹⁵² Gjatë viteve ‘20-‘30, minoriteti kombëtar maqedonas nuk do të gëzonte statusin e minoritetit, sipas legjislacionit shqiptar. Ky status do t’i njëhej pas Luftës së Dytë Botërore, me krijimin e Republikës së Maqedonisë, si shtet anëtar i Federatës Jugosllave.

4.3. Minoriteti kombëtar serbo-malnez

Minoriteti kombëtar serbo-malnez për nga përbërja numerike, është pakica më e vogël në Shqipëri. Ky minoritet është i përqëndruar në veri të Shqipërisë, kryesisht në veri të qytetit të Shkodrës dhe në disa fshatra të vegjël të komunës Gruemirë-Vrakë (Borici i Vogël Omaraj, Gril).¹⁵³ Fshatrat ndodhen pranë liqenit të Shkodrës në afërsi të kufirit me Malin e Zi. Pjesëtarët e këtij minoriteti mendohet se kanë ardhur në rajonin e Shkodrës nga mesi i shek. XIX si refugjatë politikë. Por disa autorë saktësojnë se kjo popullsi rrjedh prej refugjatëve malnez, të cilët emigronin në viset shqiptare për t’u shpëtuar hakmarrjeve që kishin filluar në vendin e tyre.¹⁵⁴ Ndoshta ky fakt i emigrimit i ka shtyrë shumë autorë ta konsiderojnë këtë popullsi si “minoritet gjuhësor”. Popullsia minoritare në këto zona, e cila njëhej si “malazeze”, do të parashtronte pretendimin më vonë që të quhej minoritet kombëtar “serbo-malnez”. Lidhur me numrin e këtij minoriteti ka pasur të dhëna të ndryshme të cilat, jepnin shifra pak a shumë të përafërta. Sipas tyre rezultonte se në periudhën midis dy Luftërave Botërore popullsia malazeze arrinte deri në 1.500 banorë. Por në një shkresë, që Ministria e Punëve të Brendshme i kërkonte prefekturës së Shkodrës të

¹⁵² Hugh Poulton, *The Balkans Minorities and States in Conflict*, Minority Rights Group, London, 1991, f. 202.

¹⁵³ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 639.

¹⁵⁴ Po aty, f. 120.

dhëna mbi popullsinë në Shkodër dhe në katundin e Vrakës, nënvizohej se në këto zona të gjithë nënshtetasit ishin shqiptarë dhe flisnin shqip në shtëpitë e tyre. Ky dokument më tej saktësonte se në katundin e Vrakës ndodheshin 151 shtëpi me një popullsi prej 1855 frymë, të cilët në familjet e tyre flisnin sllavisht por njëkohësisht njihnin dhe gjuhën shqipe.¹⁵⁵ Ndërsa në qytetin e Shkodrës, ortodoksët përmbledheshin në 170 shtëpi me një numër prej 705 banorë, ndër të cilët 649 flisnin shqip e 45 sllavisht, këta të fundit deklaroheshin si nënshtetas jugosllav. Nga këta 45 banorë, 4 prej tyre flisnin gjuhën sllave e shqip dhe ishin nënshtetas rus. Gjithashtu, në Shkodër kishte dhe 7 nënshtetas grek, të cilët flisnin si greqisht ashtu dhe shqip.¹⁵⁶ Prezenca e kësaj pakice shumë herë do të përdorej nga propaganda serbe për të vërtetuar ekzistencën e një minoriteti të madh serb në Shqipëri.

4.4. Minoriteti etnokulturor arumun

Pakicat etnokulturore arumune klasifikohen në ato pakica, të cilat nuk përbëjnë një pjesë të një kombi që është shkëputur mekanikisht nga shkaqe historike për të mbetur në një vend fqinj. Kjo pakicë i është nënshtruar një ndryshimi historik, si pasojë e kohës së gjatë dhe largësisë nga vendi i origjinës. Minoriteti arumun historikisht ka jetuar në raporte shumë të mira me popullsinë shqiptare dhe ishte i përqëndruar kryesisht në Shqipërinë e Mesme e atë Jugore. Për të identifikuar këtë minoritet, janë përdorur një pluralitet emërtime, përveç termit “arumun” thirren edhe “vlleh” ose “çobenj”. Termi “arumun” të çon në keqkuptim dhe shpesh herë të ngatërron me rumunët, megjithëse, origjina e tyre

¹⁵⁵ MJP, dosja 163, korrispondencë e Ministrisë së Punëve të Brëndeshme, Tiranë, 1922, f. 14.

¹⁵⁶ MJP, dosja 164, Mbi shkollat slavishte të Shkodrës e të katundit Vrakë, Tiranë, 1922, f. 13.

është shumë e hershme, shkon deri në kohën e Romës Antike. Fillimisht ata shfaqeshin si masë nomade blegtorale, e cila më vonë me stabilizimin, dalëngadalë kalonte në veprimtari të tjera ekonomike, si: në fshat me bujqësi dhe nëpër qytet me zejtari. Popullsia e hershme arumune do të stabilizohej në zonat rurale të Myzeqesë të Fierit dhe të Vlorës, të Frashërit në Përmet, në Mokër të Pogradecit, në Kolonjë, si dhe në disa qytete, si: Korçë, Tiranë, Berat, Elbasan dhe Durrës. Sipas disa studjuseve, kryesisht arumunë, në vitin 1920, ata përbënin minoritetin etnik më të madh në numër. Ata formonin një grup prej rreth 20.000 vetash dhe flisnin një gjuhë të afërt me rumanishten. Minoriteti arumun në Shqipëri mund të klasifikohet në katër grupe të mëdha: myzeqarët, grabovarët, frashërotët dhe voskopjarët.¹⁵⁷ Myzeqarët jetonin kryesisht në zonën e Fierit dhe atë të Beratit.

Ata ishin të vetmit arumunë të vendosur në zonë fushore dhe merreshin me agrikulturë. Mund të përmendim disa qendra si psh: në zonën e Fierit ishin Skrofotina, Frakulla, Selishta dhe në Vlorë ndodheshin Gradishti dhe Karbunara. Gjithashtu, ky grup ishte vendosur edhe në disa qendra të tjera siç ishin: Divjaka, Kavaja, Durrësi dhe Tirana. Grupi i frashërotëve, merrenin këtë emër nga fshati Frashër, ishin të ardhur nga Korça por që ishin më të paktë në Miçea, Selenicë dhe Tremishta.¹⁵⁸ Grupi i tretë i arumunve janë grabovarët, të cilët jetonin në fshatrat afër Pogradecit: Grabova dhe Nica. Grupi i fundit janë voskopjarët, të cilët ishin më të shumtë në numër se grupet e tjera. Ata ishin vendosur në 14 fshatra si: Shipska, Plasa e Sipërme dhe e Poshtme, Dishnica, Pojani dhe Nikulica. Prejardhja e tyre, siç nënkuptohet edhe nga emri, ishte qyteti i Voskopojës.¹⁵⁹ Në

¹⁵⁷ Robert Collaku, *Arumunët e Shqipërisë histori dhe dokumente-figura të shquara*, EMAL, Tiranë, 2001, f. 51.

¹⁵⁸ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 60.

¹⁵⁹ Robert Collaku, *Arumunët e Shqipërisë histori dhe dokumente-figura të shquara*, vep. e cit., 51.

prefekturën e Elbasanit nga të dhënat statistikore, kishte 1. 329 banorë që flisnin gjuhën vllehe. Ata nuk kishin shoqata mirëbërëse, por kishin një kishë në qytetin e Elbasanit dhe një në fshatin Grabovë, e cila bënte pjesë në nënprefekturën e Gramshit. Përsa i përkiste mësimi të gjuhës së tyre amtare, ata nuk kishin një shkollë të vetën dhe fëmijët studionin në shkollat shtetërore.¹⁶⁰ Gjithashtu, në qytetin e Tiranës jetonte një komunitet i rëndësishëm arumun, ku sipas regjistrimeve të bëra në vitin 1923, rezultonte se banonin 908 shtetas të këtij minoriteti.¹⁶¹ Në malësinë e Voskopojës popullsia arumune vendosej në qytetin e Voskopojës, në fshatin Shipcke etj.¹⁶² Rënia ekonomike dhe shkatërrimi i qytetit të Voskopojës, detyronte popullsinë arumune të largohej dhe të vendosej në Manastir e pjesërisht edhe në qytete të tjera të Shqipërisë. Popullimi i vendit me arumunë të vonshëm do të bëhej nga popullsia e ardhur nga pllajat malore të Pindit në Greqi. Kjo popullsi do të ruante për shumë kohë karakterin e saj nomad blegtoral.

Pjesëtarët e këtij minoriteti flisnin si gjuhë të parë atë të vendit në të cilin ishin vendosur. Në zonat rurale komuniteti arumun ruante kompaktësinë e tij, në gjuhën e folur, doket e zakonet dhe përqëndrimin e lartë në lagjet e veta, ndërsa në qytetet avanconte procesi i asimilimit. Megjithatë, pavarësisht këtij procesi, ndërmjet pjesëtarëve të grupit përdorej vazhdimisht gjuha vllehe. Komuniteti dallohej për tolerancën, mirëkuptimin, bashkëpunimin dhe miqësinë me pjesën tjetër jovllahe të popullsisë shqiptare.

¹⁶⁰MJP, Dosja 101, korrespondencë e Prefekturës së Elbasanit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brëndëshme, Elbasan, 1922, f. 35.

¹⁶¹ Vangjel Shundi, *Arumunët e Shqipërisë histori dhe dokumente*, "Globus", Tiranë, 2001, f. 28.

¹⁶² Adrian Papajani, *Të drejtat e pakicave*, Elbasan, Sejko, 2005, f. 106.

4.5. Minoriteti etnokulturor rom

Siç u saktësua për pakicën etnokulturore arumune në paragrafin pararendës, edhe pakica etnokulturore rome klasifikohet në ato pakica, të cilat nuk përbëjnë një pjesë të një kombi që është shkëputur mekanikisht nga shkaqe historike për të mbetur në një vend fqinj. Kjo është një pakicë për të cilën nuk rezulton të jetë bërë ndonjë studim serioz dhe për këtë arsye mungojnë të dhëna statistikore të besueshme. Romët në Shqipëri ishin të shpërndarë në pjesë të ndryshme të territorit, kryesisht përqëndroheshin në Shqipërinë e Mesme dhe atë Jugore. Vendbanimet e këtij minoriteti ishin të përqëndruara, përgjithësisht në rrethet e Fierit, Beratit dhe Tiranës. Mënyra e jetesës nomade dhe shtegëtimi nga një krahinë në tjetrën, ka qenë dhe një nga arsyet e mungesës së regjistrimeve të kësaj popullsie. Pavarsisht shtegëtimeve, romët mund t'i ndanim në dy kategori: shëtitës dhe joshëtitës. Të parët ishin shëtitës dhe blerës kuajsh, thurnin shporta e kanistra, kurse të dytët punonin si kovaçë, bakërpunues muzikantë dhe valltarë.¹⁶³ Studiues të ndryshëm mendojnë se romët janë popull me origjinë nga India Veriperëndimore. Mendohet se fillimisht ata ishin mercenarë të cilët u skllavëruan gjatë pushtimit mysliman, rreth 1000 vjet pas lindjes së Krishtit. Ardhja e romëve në Shqipëri, sipas të dhënave historike, presupozohet se daton rreth shek. të XV me pushtimin otoman. Sipas disa të dhënave të pakonfirmuara të vitit 1920, në Shqipëri kishte 20.000 romë.¹⁶⁴ Përgjithësisht ndaj kësaj popullsie në vendin tonë nuk ka pasur diskriminim zyrtar, por më së shumti përbuzje shoqërore. Komuniteti rom ishte i paragjykuar nga popullsia vendase duke shprehur haptasi një nënvlerësim të kulturës

¹⁶³Faik Konica, *Shqipëria: Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore*, Shtëpia botuese "55" Tiranë, 2010, f. 69.

¹⁶⁴ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 123.

së tyre. Shpesh herë kjo popullsi diskriminohej duke u mohuar të drejtat për të shpalosur
haptazi kulturën e tyre dhe për të patur një jetë dinjitoze.

KAPITULLI V: ANTARËSIMI NË LIDHJEN E KOMBEVE DHE HETIMET E KOMISIONI NDËRKOMBËTAR NË SHQIPËRI

5.1. Përpyjekjet për konsolidimin e institucioneve kombëtare dhe Kongresi i Lushnjës

Ndërkohë që punimet e Konferencës së Paqes nuk e largonin rrezikun e coptimit të shtetit të sapo formuar, në Shqipëri fillonte të zhvillohej një fushatë e zjarhtë për të thirrur një kuvend mbarëkombëtar, në të cilin mund të shprehej lirisht vullneti i popullit shqiptar. Në këto rrethana vendosej të mbledhej në Lushnjë një kuvend i kryesuar nga Aqif Pashë Elbasani, në të cilin do të merrnin pjesë 56 delegatë të zgjedhur nga këshillat e ngritura në çdo rreth të vendit. Ai do t'i zhvillonte punimet nga 21 - 31 janar 1920.¹⁶⁵ Synimi i Kongresit ishte rimëkëmbja e shtetit të pavarur shqiptar të krijuar më 28 Nëntor 1912.¹⁶⁶ Vendimet e para të ndërmarra ishin: të shpallte të rrëzuar qeverinë e Durrësit, krijimin e Këshillit të Lartë të Shtetit dhe të Këshillit Kombëtar. Kongresi miratonte dhe “Bazat e Kanunores”, një dokument që do të njihej më shumë me emrin “Bazat e Statutit të Lushnjës”. Ky akt kushtetues, ndonëse i referohej kryesisht organizimit dhe kompetencave të Këshillit të Lartë, në të vërtetë përcaktonte parimet e përgjithshme të gjithë veprimtarisë shtetërore.¹⁶⁷ Rëndësi të veçantë kishte krijimi i “Këshillit të Regjencës”, i cili përbëhej prej

¹⁶⁵ Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi Etnik Fuqitë e mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*, vep. e cit., f. 240.

¹⁶⁶ Aben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, vep. e cit., f.255.

¹⁶⁷ Luan Omari, *Sistemi parlamentar, Lindja dhe evolucioni i parlamentarizmit*, Botimi i Katër, “Elena Gjika”, Tiranë, f. 162.

katër anëtarësh, që përfaqësonin katër besimet fetare të asaj kohe në Shqipëri. Ata ishin: Aqif Pashë Elbasani i sektit bektashi, imzot Luigj Bumçi ipeshkev katolik i Lezhës, doktor Mihal Turtulli ortodoks nga Korça dhe Abdi bej Toptani mysliman sunit nga e njëjta familje e madhe e Esat Pashës.¹⁶⁸ Këshilli do të ushtronte pushtetin epror deri sa të mbetej vakant fronin e monarkut. Kongresi i Lushnjës e ruante këtë formë qeverisjeje, sepse nisej nga ideja e afirmimit të vazhdimësisë së shtetit shqiptar të pavarur, ekzistenca e të cilit ishte njohur edhe nga Konferenca e Ambasadorëve më 1913, në formën e monarkisë.

Kongresi vendoste shkarkimin e qeverisë së Durrësit dhe zgjidhte një qeveri të re, të kryesuar nga Sulejman Bej Delvina.¹⁶⁹ Në këtë qeveri do të përfaqësoheshin të gjitha besimet fetare dhe rrymat politike shqiptare. Gjithashtu, Kongresi i Lushnjës vendoste krijimin e një kuvendi ose senati, që do të mblidhej në Tiranë dhe do të përbëhej nga 37 antarë, të zgjedhur nga vetë Kuvendit sipas propozimit të delegatëve të prefekturave përkatëse dhe në bazë të numrit të popullsisë së këtyre prefekturave, sipas kriterit një përfaqësues për rreth 20.000 banorë.¹⁷⁰ Senati i dalë nga Kongresi i Lushnjës, nuk do të ishte një dhomë e dytë, por një parlament i mirëfilltë monokameral. Përsa i përkiste kompetencave, Këshilli Kombëtar ishte organi ligjvënës i shtetit. Statuti i Lushnjës i jepte një epërsi të dukshme dhe një pavarësi të plotë Këshillit Kombëtar në raport me Këshillin e Lartë. Ky i fundit nuk gëzonte të drejtën e vetos pezulluese për ligjet e miratuara nga parlamenti, prerogative, që zakonisht i përkiste kryetarit të shtetit. Edhe pse Këshilli i Lartë caktonte qeverinë, ajo duhej të merrte votëbesimin e Këshillit Kombëtar dhe mund të

¹⁶⁸ Albert Mousset, *Shqipëria përballë Evropës (1912-1929)*, "DITURIA", Tiranë, 2004, f. 27.

¹⁶⁹ Aben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, vep. e cit., f.256.

¹⁷⁰ Po aty, f. 257.

shkarkohej nga ky Këshill në rast se votohej një mocion mosbesimi. Për më tepër, në rast mosmarrëveshje ndërmjet këtyre dy organeve lidhur me formimin e qeverisë, Këshilli i Lartë ishte i detyruar të thërriste Mbledhjen Kombëtare, e cila mund të vendoste rrëzimin e Këshillit të Lartë ose shpërndarjen e Këshillit Kombëtar.

Gjatë periudhës së shkurtër të ekzistencës së tij, Këshilli Kombëtar ndërmerre një veprimtari të konsiderueshme legislative dhe mbante një qëndrim të pa tundshëm kundrejt vendimeve të Fuqive të Mëdha.¹⁷¹ Kështu në 2 shkurt delegatët do të organizonin një protestë kundër marrëveshjes së Londrës, ku spikasin qartë ndjenjat kombëtare. Aty shkruhej se Kuvendi Kombëtar i mbledhur i Lushnjës ngrihej kundër vendimit që dënonte një shtet asnjnjës dhe njërin nga kombet më të vjetra të Evropës.

Kuvendi kërkonte pavarësinë e plotë të Shqipërisë në kufijtë e saj etnografike dhe natyrore, duke ndrequr në këtë mënyrë padrejtësitë e shkaktuara nga Kongresi i Berlinit dhe Konferenca e Ambasadorëve e vitit 1913.¹⁷² Ai vendoste që të mos pranonte asnjë mandat ose protektorat të huaj. Shqiptarët ishin gati të flijonin gjithçka, deri në pikën e fundit të gjakut, për të penguar çdo vendim që kërcënonte pavarësinë dhe integritetin e tyre kombëtar.¹⁷³ Dukej qartë se atdhetarët shqiptarë ishin të vendosur të luftonin për të siguruar ekzistencën dhe integritetin territorial të shtetit të sapo formuar shqiptar.

¹⁷¹ Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi Etnik Fuqitë e mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*, vep. e cit., f. 254.

¹⁷² Albert Mousset, *Shqipëria përballë ...*, vep. e cit., f. 28.

¹⁷³ Po aty, f. 28.

5.2. Statuti i Zgjeruar i Lushnjës dhe sanksionimi i parimit të barazisë të qytetarëve përpara ligjit

Ndërkohë që Kongresi i Lushnjës, përqëndronte pothuajse gjithë veprimtarinë në elaborimin e reformës kushtetuese dhe masave që duheshin marrë kundër vendimeve të Fuqive të Mëdha për coptimin e Shqipërisë, Kongresi i Zgjeruar i Lushnjës aprovonte një kushtetutë më të plotë të shtetit shqiptar. Kështu, në dispozitat e përgjithshme sanksionohej ndarja e pushteteve, Këshilli i Lartë do të zinte përkohësisht vendin e Mbretit me të drejta e detyra të përcaktuara nga Statuti. Pushteti legjislativ do të ushtrohej nga Parlamenti, i cili do të përbëhej prej deputetësh të zgjedhur nga populli nëpërmjet një votimi universal të përcaktuar me ligj. Pushtetit ekzekutiv, do t'i përkiste Këshillit të Lartë që do ta ushtronte nëpërmjet Kabinetit. Pushteti gjyqësor do të ushtrohej nga gjykatat, të cilat në dhënien e gjykimeve të veta nuk do të vareshin prej asnjë tjetër autoriteti veçse prej atij të ligjit.

Por Statuti i Zgjeruar shkonte përtej ndarjes së pushteteve, ai kapitullin e tretë ja dedikonte të drejtave të qytetarve. Në njohjen e këtyre të drejtave, Statuti nisej nga ndarja e lirive të shtetasve në dy grupe, në të drejtat civile dhe ato politike.¹⁷⁴ Në të drejtat civile ai përfshinte: barazinë përpara ligjit, atë në procesin gjyqësor si dhe në vënien e taksave dhe tatimeve etj.¹⁷⁵ Këto të drejta parashikoheshin në Art. 110 të Statutit ku nënvizohej se: të gjithë qytetarët pa ndryshim nënshtetësie, janë të barabartë përpara ligjit dhe gëzojnë të drejta civile të barabarta, përveç përjashtimeve të përcaktuara me ligj.¹⁷⁶ Të drejtat civile sipas nenit, u njiheshin si shtetasve shqiptarë, ashtu edhe të huajve që jetonin në territorin e

¹⁷⁴ Luan Omari dhe Aleks Luarasi, *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri*, "Luarasi", Tiranë, 2005, f.342.

¹⁷⁵ Po aty, f. 342,

¹⁷⁶ Aleks Luarasi, *Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri*, "Luarasi", Tiranë, 1999, f.

vendit. Në grupin e të drejtave politike Statuti përfshinte: barazinë për t'u pranuar në çdo nëpunësi civile dhe ushtarake, liritë e fjalës e të shtypit, të drejtën e mbledhjes dhe të organizimit të shoqërive etj.¹⁷⁷ Këto të drejta parashikoheshin në Art.111, sipas të cilit: të gjithë nënshtetasit gëzojnë baraz të drejtat politike dhe pranohen në të gjitha nëpunësit civile e ushtarake përveç përjashtimeve të caktuara me ligj.¹⁷⁸ Edhe pse këto nene nuk përmendnin konkretisht të drejtat e minoriteteve, ato ishin një dëshmi për rolin e rëndësishëm që merrte Statuti në konsolidimin dhe modernizimin e vendit. Ky modernizim evidentohet edhe më shumë nga neni 93, i cili theksonte së shteti shqiptar nuk kishte fe zyrtare. Neni parashikonte se të gjitha fetë dhe besimet ishin të nderuara dhe se liria e ushtrimit dhe e praktikimit të tyre ishin të siguruar. Feja gjithashtu, nuk duhej të formonte në asnjë mënyrë pengime juridike dhe kurrsesi nuk duhej të përdorej për qëllime politike.

Ideatorët e “Statutit të Zgjeruar të Lushnjës” nëpërmjet këtyre ligjeve përpiqeshin, nga njera anë, të shkëputnin njëherë e përgjithmonë mbetjet e regjimit osman, dhe, nga ana tjetër, t'i dërgonin një mesazh LK rreth dëshirës së madhe që kishte populli shqiptar në formimin e një shteti demokrat dhe liberal. Me anë të një vendimi, më 11 shkurt 1920, qeveria e dalë nga vullneti i popullit do të vendosej në Tiranë. Më vonë, më 27 mars, do të mbledhej dhe zhvillonte punimet deri në 19 dhjetor Këshilli Kombëtar, që ishte zgjedhur në Kuvendin e Lushnjës. Arritjet e lëvizjes kombëtare shqiptare do të kulminonin në verën e vitit 1920, me disfatën e ushtrisë italiane në luftën e Vlorës. Kjo disfatë e detyronte qeverinë e Romës të arrinte një marrëveshje me qeverinë shqiptare të Tiranës. Marrëveshja parashikonte që Italia, jo vetëm të njihte qeverinë e Tiranës por dhe duhej të hiqte dorë nga

¹⁷⁷ Luan Omari dhe Aleks Luarasi, *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri*, vep. e cit., f.342.

¹⁷⁸ Aleks Luarasi, *Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri*. Vep. e cit., f. 79.

pushtimi i Vlorës. Megjithatë, Italisë i njihej e drejta, të mbante të pushtuar ishullin e Sazanit, në të cilin kërkonte të ndërtonte një bazë ushtarake. Me disfatën e Italisë në Vlorë binte një nga pengesat kyesore që çonin drejt konsolidimit dhe unifikimit të shtetit shqiptar.

Ndërkohë në veri, ushtritë e Mbretërisë serbo-kroate-slllovene sulmonin vendin në drejtim të luginës së Drinit dhe kërkonin të zotëronin krahinën e Shkodrës. Por, me aderimin e Shqipërisë në LK, forcat serbe do të tërhiqeshin në vijën kufitare që ishte përcaktuar nga marshalli francez d'Esperej kur ishte shpallur armëpushimi. Ndërsa në Shqipërinë e Jugut, Greqia përqëndronte përpjekjet e saj në aneksimin e krahinës së Korçës dhe Gjirokastrës, të cilat ajo i konsideronte si krahina helene. Por, reagimi i patriotëve shqiptarë i detyronte grekët të hiqnin dorë nga synimet e tyre dhe të nënshkruanin në 1920 marrëveshjen e Kapshticës, me anë të së cilës zotoheshin se nuk do të depërtonin në këto krahina, pa u marrë një vendim përfundimtar në Konferencën e Paqes në Paris. Pavarësisht impenjimeve të marra, qeveria e Athinës nuk do të hiqte dorë nga krahinat e jugut, pasi sipas saj ato banoheshin nga një popullsi që i përkiste kombësisë greke.

Këto pretendime qeveria greke do t'i paraqiste më 26 qeshor 1921 përpara Këshillit të LK. Të gjitha këto vështirësi mbi unifikimin dhe konsolidimin e shtetit shqiptar, ndikonin në zhvillimin e ndërgjegjjes kombëtare të popullit shqiptar. Shqipëria, si shtet i ri, kishte një popullsi prej më pak se një milion banorë dhe ishte shteti më i prapambetur ekonomikisht dhe intelektualisht në gadishullin ballkanik.¹⁷⁹ Këto vështirësi çonin drejt përfundimit të veprimtarisë së Këshillit Kombëtar. Si rrjedhojë, në 5 dhjetor 1920 dilte ligji mbi zgjedhjet, i cili nuk miratohej nga organi legjislativ, por nga ai ekzekutiv. Ky akt

¹⁷⁹ Ferdinand Schevill, *Ballkani Historia dhe Qytetërimi*, Shtëpia Botuese "UEGEN", Tiranë, 2002, f. 416.

shkelte qartë vendimin e Kongresit të Lushnjës, i cili parashikonte se Këshilli Kombëtar i caktuar prej tij do t'i linte vendin një Asambleje Kushtetuese. Në një situatë politike të destabilizuar, qeveria do t'i kërkonte Këshillit të LK pranimin e saj si shtet i pavarur me të drejta të plota dhe të barabarta me shtetet anëtare të kësaj organizate ndërkombëtare.

5.3. Anëtarësimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve

Më 17 dhjetor të 1921, Këshilli i LK pranonte Shqipërinë si shtet anëtar dhe i pavarur me të drejta të plota. Anëtarësimi vendoste përgjithmonë çështjen e statusit ndërkombëtar të Shqipërisë, duke e shpallur shtet të pavarur, ashtu si kishte qenë përpara Luftës së Parë Botërore. Pranimi në LK i siguronte të drejtën Shqipërisë që, asnjë nga Fuqitë ose shtet fqinj, të pretendonte të drejta të veçanta mbi territorin e saj. Sigurisht çështja e anëtarimit të Shqipërisë do të shoqërohej me debate të zjarra në gjirin e Asamblesë, sepse neni 1 i statutit thoshte që “mund të bëhet shtet anëtar i LK çdo shtet që qeverisej lirisht”.¹⁸⁰ Për zgjidhjen e kësaj çështje ngarkohej një komision, i cili do të paraqiste një raport dhe do të propozonte shtyrjen e pranimin të Shqipërisë.¹⁸¹ Dokumenti i përgatitur nga Komisioni shprehte pasiguritë e tij mbi dy çështje. E para kishte të bënte me Traktatin e Londrës i nënshkruar më 15 korrik 1913, të cilin e prezantonte si të vjetëruar.¹⁸² Komisioni shprehte pasiguri mbi vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare, që ishte firmosur nga Konferenca e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha. Çështja e dytë ku

¹⁸⁰ Ksenofon Kristafi, *95 vjet më parë, Shqipëria në Lidhjen e Kombeve*, <http://balkanweb.com/gazetashqiptare/95-vjet-me-pare-shqiperia-ne-lidhjen-e-kombeve>.

¹⁸¹ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes Shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f.341.

¹⁸² Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi Etnik Fuqitë e mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*. Vep. e cit., f. 274.

vreheshin pasiguri, ishte kushtetuta e hartuar më vonë për Principatën shqiptare dhe përcaktimi i kufijve. Duhej vendosur nëse këto dy akte kishin forcën e ligjit dhe nëse e lejonin të konsiderohej Shqipëria si një shtet me kufij të përcaktuar mirë. Lidhur me çështjen e parë, seksioni juridik i LK, deklaronte se Traktati i Londrës ishte akoma në fuqi. Gjithashtu, edhe për çështjen e kufijve të Shqipërisë dhe statutit organik, seksioni jepte mendim pozitiv. Duhej kujtuar në këtë rast Protokolli i Firences, firmosur nga FM, i cili gjatë mbledhjes së tij vendoste të njihte kufijtë e Shqipërisë. Përsa i përkiste Statutit Organik të Shqipërisë, ai ishte përpunuar nga Komisioni Ndërkombtar i Kontrollit. Protokolli i Firences kishte një rëndësi të madhe për Shqipërinë pasi, jo vetëm detyronte ushtritë e huaja të zbraznin territorin e saj, por edhe emëronte një princ shqiptar me pëlqimin e Fuqive të Mëdha. Përveç këtyre fakteve ekzistenca e Shqipërisë si shtet sovran dhe i pavarur nuk mund të vihej në diskutim. Kjo sepse po të ishte ndryshe, LK do të binte në kundërshtim me ekzistencën e saj, që kishte si qëllim garantimin e të drejtës së popujve dhe ruajtjen e paqes në botë. Sipas komisionit ishte e domosdoshme që anëtarësimi të vendosej pasi të përcaktohej statusi i saj ndërkombëtar. Pavarësisht anëtarësimit në organizatën ndërkombëtare, Këshilli vendoste që çështja e kufijve mbetej akoma e hapur.¹⁸³

Ky vendim ndikohej shumë nga punimet e Konferencës së Ambasadorëve, ku FM nuk kishin marrë një vendim rreth kufijve të shtetit shqiptar. Duhet theksuar se fillimisht Konferenca, të ashtuquajturin “Epiri i Veriut”, ia kishte caktuar Greqisë. Sigurisht, përfaqësuesit e FM ndikoheshin në dhënien e këtij vendimi nga prezenca e popullsisë

¹⁸³ C 975/211/90, Memorandum submitted by his Majestys Government to Conference of Ambassadors, British Embassy, Paris, July 20, 1921.

minoritare greke.¹⁸⁴ Megjithatë, KKK dëshironte sa më shpejt marrjen e një vendimi nga ana e Konferencës së Ambasadorëve, e cila më 9 nëntor 1921, vendoste zyrtarisht njohjen e qeverisë shqiptare dhe Shqipërinë si një shtet sovran dhe independent.¹⁸⁵ Pranimi i vendit si anëtar në LK kishte një rëndësi të madhe, sepse në këtë mënyrë kjo organizatë ndërkombëtare, e pranuar universalisht nga të gjitha shtetet, detyrohej t'u dilte zot të drejtave të popullit shqiptar. Si anëtare e Lidhjes, Shqipërisë i njëhej e drejta të ankohej përpara kësaj organizate kundër atyre që kërcënonin integritetin e saj territorial.

5.4. Deklarata mbi mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri

Në planin ndërkombëtar shteti shqiptar ndërmerre një hap të rëndësishëm, duke u pranuar në LK si anëtar me të drejta të plota dhe të barabarta me shtetet e tjera. Anëtarësimi në këtë organizatë ndërkombëtare kushtëzohej me nënshkrimin nga qeveria shqiptare të “Deklaratës mbi Mbrojtjen e Minoriteteve”. Kjo deklaratë do të firmosej nga i deleguari shqiptar, Imzot Fan Noli dhe më pas do të ratifikohej nga Parlamenti Shqiptar.¹⁸⁶ Asambleja e Lidhjes së Kombeve, përpara se të votonte pranimin e Shqipërisë, adaptonte këtë rekomandim: me rastin e pranimin të Shteteve Baltike e Kaukaziane dhe të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, Asambleja kërkonte që këto shtete duhej të merrnin masat e nevojshme për të zbatuar parimet e Traktateve të Minoriteteve dhe duhej të rregullonin me Këshillin detajet që kërkoheshin për të vënë në zbatim këtë kërkesë.¹⁸⁷ Këto akte kishin një

¹⁸⁴ C 16554/580/90, The Marquess Curzon of Kedleston to Lord Harding, Foreign Office, August 17, 1921.

¹⁸⁵ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942*, “Marin Barleti”, Tiranë, 1995, f. 183.

¹⁸⁶ MJP, *Dosja 102, korrespondencë e Ministrisë së Arsimit*, Tiranë, 1922, f. 30.

¹⁸⁷ Vladimir Ortakovski, *Minorities in the Balkans*, “Transnational Publishers”, Ardsley, 2000, f. 113.

rëndësi të veçantë, sepse realizonin për herë të parë, në një formë të qartë e të përshtatshme, daljen e çështjes së pakicave kombëtare nga kuadri i së drejtës së brendshme të shteteve dhe afirmimin e saj si një institut i rëndësishëm i së drejtës ndërkombëtare.¹⁸⁸ Gjithashtu, edhe qeveria greke, nëpërmjet drejtorit të Sekretarisë së Përhershme Greke në LK, i dërgonte Sekretarit të Përgjithshëm të LK një memorandum me anën e të cilit kërkonte që Shqipëria të merrte përgjegjësinë për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për regjimin e minoriteteve, duke bërë edhe propozimet përkatëse për:

- Rindërtimin dhe mirëmbajtjen e kishave ortodokse.
- Të gjithë nënshtetasit shqiptarë që u takonin minoriteteve të kishin të njëjtën trajtim si dhe nënshtetasit shqiptarë, garancinë përpara ligjit dhe me shpenzimet e veta të ngrinin institucione fetare e gjuhësore të të gjitha niveleve dhe të gëzonin venomet që kishin pasur gjatë okupacionit turk.¹⁸⁹

Ministri i Jashtëm i Shqipërisë përgjigjej se pranonte me rezervë kërkesat e përfaqësuesit grek në LK. Këto rezerva kishin të bënin me kërkesën e paraqitur nga pala greke për ruajtjen në Shqipëri të venomeve fetare dhe arsimore që gëzonte kombi grek prej shekujve në tokat e Perandorisë Osmane.¹⁹⁰ Pranimi i venomeve cënonte drejtpërdrejt, jo vetëm sovranitetin e shtetit të ri shqiptar por dhe u mohonte shqiptarëve ortodoksë të drejtën për t'u arsimuar në gjuhën amtare. Duhet rikujtuar se gjatë sundimit osman ishte e ndaluar hapja e shkollave shqipe dhe popullsia ortodokse shqiptare arsimohej në gjuhën

¹⁸⁸ Elona Rizo, *Vështrim historik mbi përpjekjet për përcaktimin e përkufizimit të minoriteteve*, Jus&Justicia 1, Nr. 1, Tiranë, 2008, f. 112.

¹⁸⁹ Filip Liço, *Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare*, vep e cit. , f. 114.

¹⁹⁰ Po aty, f. 115.

greke.¹⁹¹ Për arsyet e lart përmendura kërkesa që kishte të bënte me venomet nuk përfshihej në deklaratën e qeverisë shqiptare. Përsa i përkiste pjesës tjetër së marrëveshjes, qeveria shqiptare nuk hezitonte t'i komunikonte Sekretarit të Përgjithshëm se, Shqipëria aderonte plotësisht në Kartën e të Drejtave të Përgjithëshme të Minoriteteve dhe e konsideronte si detyrë të saj, që të informonte Asamblenë mbi situatën e minoriteteve dhe masat që do të merreshin në këtë vend. Deklarata detyronte qeverinë shqiptare t'i kalonte LK të dhëna të detajuara mbi komunitetet fetare dhe pakicat kombëtare në vend. Të dhënat duhet të tregonin jo vetëm numrin e popullsisë minoritare por edhe kishat, manastiret, shkollat, shoqëritë mirëbërëse, të cilat i përkisnin minoriteteve. Gjithashtu, në Shqipëri do të dërgohej një komision ndërkombëtar, i cili do të hetonte jo vetëm ndarjen e vijës kufitare me Greqinë në jug dhe me Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene në veri, por do të verifikonte edhe gjendjen në të cilën ndodheshin pakicat në vend. Me këto premisa, më 2 tetor 1921, përfaqësuesi i Shqipërisë firmoste, përpara KLLK, Deklaratën mbi të Drejtat e Minoriteteve në Shqipëri.¹⁹² Ky dokument ratifikohej nga Parlamenti Shqiptar më 2 shtator 1921.¹⁹³ Ai përbëhej nga shtatë artikuj, të cilët po i rendis si më poshtë:

Art.1 - Marrëveshjet që përmban kjo deklaratë do të quhen si ligje themelore në Shqipëri. Asnjë ligj, asnjë rregullore dhe vepër zyrtare nuk do të jetë në kundërshtim me këto marrëveshje, si dhe asnjë ligj, asnjë rregullore, a vepër zyrtare nuk do të ketë më tepër fuqi nga këto marrëveshje. Ky parim vlen dhe për të ardhmen.

Art.2 - Të gjithë ndenjësve të Shqipërisë do t'u garantohet një mbrojtje e plotë e jetës dhe lirisë së tyre, pa dallim lindje, kombësie, gjuhe, race dhe feje.

Të gjithë banorët e Shqipërisë do të kenë të drejtë të përdorin lirisht fenë dhe besimin e tyre deri sa këto të mos jenë në kundërshtim me qetësinë publike dhe zakonet. Secili do të ketë të drejtë të ndërrojë fenë.

¹⁹¹ Filip Liço, *Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare*, vep e cit. , f. 115.

¹⁹² MPJ, *dosja 102, Minorities in Albania, League of Nations*, Geneva, 1922, f. 141.

¹⁹³ MPJ, *dosja 102, Tiranë, 1922*, f. 30.

Masat e posaçme do të merren për muhamedanët për rregullimin, të njehësura me zakonet muhamedane, të çështjeve të të drejtave fëminore edhe të statutit personal.

Art.3 - Të gjithë ata që kanë lindur në Shqipëri dhe që nuk kanë lindur nënshtetas të një shteti tjetër do të quhen vetvetiu (ipso fakto) nënshtetas shqiptar.

Ata që kanë qenë ndenjës në Shqipëri përpara luftës, gratë e tyre dhe bijtë e vegjël, nën moshën 18 vjeç, do të kenë të drejtë, në qoftë se e dëshirojnë, të bëhen qytetarë shqiptarë brenda dy viteve që nga data e kësaj deklarate (2 tetor 1921).

Do të quhen nënshtetas grek, vetvetiu dhe pa asnjë formalitet, nënshtetasit shqiptarë, të cilët në datën e të vënit në veprim të traktatit midis Fuqive të Mëdha dhe Greqisë, të nënshkruar në Sevër më 10 gusht 1920, ndodheshin ndenjës në viset që i jepeshin Greqisë me anë të traktatit të bërë më 1 janar 1913. Megjithëkëtë, të lartëpërmendurit do të kenë të drejtë të zgjedhin nënshtetësinë shqiptare ashtu si është treguar në art. 3 të Traktatit të Sevër dhe as një pengim do t'u bëhet në zbatimin e kësaj të drejte. Kjo e drejtë zgjedhje e nënshtetësisë duhet të bëhet brenda vitit që nga data e të vënit në veprim të këtij traktati (të Sevër).

Shqipëria është gati t'u shtrohet porosirave që do t'i bëhen nga ana e Këshillit të Shoqërisë së Kombeve, mbi emigracionin e të dy palëve edhe me vullnetin e atyre që përbëjnë minoritetet etnik.

Art.4 - Të gjithë nënshtetasit shqiptar janë të barabartë përpara ligjit edhe gezojnë të gjitha ato të drejta civile e politike pa dallim race, gjuhe a feje.

Në Shqipëri do të zbatohet një sistem zgjedhjeje, duke marrë parasysh të drejtat e minoriteteve, të racës, fesë dhe të gjuhës.

Ndryshimi i fesë, i besimit dhe i përdorimit të fesë nuk duhet të lëndojë asnjë nënshtetas shqiptar përse i përket përfitimit mbi të drejtat civile e politike të tij e veçanërisht mbi praninë e tij në shërbim të shtetit në nënpunësira, në ndarjen dhe në ushtrim të mjeshtërive të ndryshme e industrisë.

Nënshtetasve shqiptarë të çdo gjuhe nuk do tu vihet asnjë ngushtim në përdorimin e lirë të gjuhës së tyre, si në marrëdhënie private, tregtie, ashtu edhe në çështje feje, shypi, botim të ç'do lloji dhe për mbledhjet botnore.

Me gjithë që qeveria shqiptare ka vendosur një gjuhë zyrtare, do tu jepen lehtësira të përkatëshme nënshtetasve shqiptarë që flasin një gjuhë tjetër nga ajo zyrtare, për përdorimin e gjuhës së tyre si me fjalë ashtu dhe me shkrim përpara gjyqeve.

Art.5 - Nënshtetasi shqiptar që bën pjesë në minoritete të racës, fesë a të gjuhës, do të ketë gjithë ato të drejta dhe sigurime që kanë nënshtetasit shqiptarë. Këta do të kenë sidomos një të drejtë të njëanëshme që të mbajnë, të drejtojnë e të kontrollojnë, me të ardhurat e tyre, apo të krijojnë në kohën e ardhme, shkolla mirëbërëse, fetare a shoqërore,

shkolla e të tjera ndërtesa mirërritjeje, duke patur të drejtën të përdornin lirisht gjuhën e vet e duke vepruar lirisht në fenë e tyre.

Qeveria shqiptare brenda gjashtë muajve që nga data e kësaj deklarate do t'i paraqesë Këshillit të Shoqërisë së Kombeve shpjegime të plota përsa i përket statutit legal të komuniteteve fetare, kishave, manastireve, shkollave, shoqërive mirëbërëse të minoriteteve të racës, fesë, edhe gjuhës.

Qeveria shqiptare do të marrë parasysh të gjitha porositë që Shoqëria e Kombeve do t'i japë në këtë pikë.

Art.6 - Sa për çështjen e mësimi botor, nëpër qytet e krahinat ku banon një përpjestim i mjaftueshëm i nënshtetasve shqiptarë që nuk flasin gjuhën zyrtare, qeveria shqiptare do tu akordojë lehtësira të posaçme për të siguruar që fëmijët e këtyre nënshtetasve, në shkollat fillore tu jepet mësimi në gjuhën e vet. Po kjo deklarat nuk e ndalon aspak qeverinë shqiptare që të vendos në këto shkolla mësimin e gjuhës shqipe si gjuhë të detyrueshme.

Në qytetet e në krahinat ku ndodhet një përpjestim i mjaftueshëm nënshtetas shqiptarë prej minoriteteve të racës, fesë a gjuhës, këtyre do t'u sigurohet një pjesë e drejtë e shumave që mund të ndahen prej të hollave botore (fonds public) të buxhetit të shtetit, fshatrave a të tjerave për qëllime mirërritje, feje a mirëbërjeje.

Art.7 - Artikujt e lart-shënuar të kësaj deklarate vihen në veprim për minoritetet e racës, fesë a gjuhës. Kjo deklaratë përbën një detyrim të interesit ndërkombëtar dhe do të vihen nën sigurimin e Shoqërisë së Kombeve. Kjo nuk mund të modifikohet pa pëlqimin e shumicës së Këshillit të Shoqërisë së Kombeve.

Si çdo anëtar i Këshillit të Shoqërisë së Kombeve do të ketë drejtë t'i tërheqë vërejtjen e Këshillit mbi rrezikun e mospërmbylljes së ndonjëres të këtyre detyrimeve, edhe Këshilli mund të veprojë në mënyrë të tillë që të japë rekomandime për realizimin e këtyre detyrimeve.

Në qoftë se midis Shqipërisë dhe një Fuqie tjetër anëtare të Këshillit të Shoqërisë së Kombeve, lind një ndryshim pikëpamjesh mbi çështje të drejtash e veprimesh të artikujve të lartpërmendur, ky ndryshim pikëpamjesh mbi çështje të drejtash të artikujve të lartpërmendur do të quhet si një mosmarrëveshje që ka karakter ndërkombëtar si pas rregullores të paktit të Shoqërisë së Kombeve. Ç'do mosmarrëveshje e tillë do të dërgohet, nëqoftëse e kërkon nga ana tjetër, në Gjyqin e Përhershëm të Drejtësisë Ndërkombëtare. Vendimi i këtij Gjyqi do të jetë i pa diskutueshëm dhe do të ketë fuqinë e vleftën e një vendimi dhënë në themel të artikullit 13 të Paktit.¹⁹⁴

Deklarata kishte rëndësi të veçantë pasi, siç e theksonte edhe art. 1, artikujt që e përbënin atë do të quheshin ligje themeltare në Shqipëri. Kjo e bënte të kishte fuqi mbi

¹⁹⁴ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 561.

ligjet dhe regulloret, si pasojë çdo akt ligjor në kundërshtim me deklaratën do të humbiste fuqinë e tij. Art.2 merrte në mbrojtje të gjithë nënshtetasit shqiptarë pa dallim lindje, kombësie, gjuhe, race a feje. Deklarata kishte një spektër të gjerë dhe garantonte mbrojtjen e gjithë nënshtetasve.¹⁹⁵ Ky dokument vlerësohej për garantimin dhe promovimin e liberalizmit fetar. Ai gjithashtu, dekretonte marrjen e masave të posaçme për rregullimin e të drejtave të familjes të njesuara me zakonet muhamedane për popullsinë e këtij besimi. Problemi qëndronte në faktin se nuk bëhej e qartë se për çfarë të drejtash konkrete bëhej fjalë. Art. 3 i kësaj deklarate e lidhte çështjen e nënshtetësisë së shqiptarve të trojeve të aneksuara nga Greqia me Traktaktet e Servës të 10 gushtit 1920.¹⁹⁶ Këtyre banorve u jepej mundësia të zgjidhnin dhe nënshtetësinë shqiptare, gjë që vinte në dukje përkatësinë kombëtare shqiptare të kësaj popullsie. Një mundësi e tillë ishte përcaktuar edhe në këto traktate. Kjo mundësi nuk do t'i jepej kësaj popullsie, pasi më vonë Greqia do t'i shkelte këto marrëveshje. Në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë, ky artikull lejonte, në një formë të limituar, emigrimin vullnetar të nënshtetasve të lartpërmendur dhe të minoriteteve etnike.¹⁹⁷

Nëpërmjet art.4, Deklarata sanksiononte barazimin përpara ligjit të të gjithë nënshtetasve dhe njëkohësisht, garantonte të gjitha të drejtat civile e politike pa dallim race, gjuhe apo feje. Për shtetin shqiptar do të bëheshin problem të drejtat politike për grupet fetare dhe gjuhësore. Kjo për arsye se këto grupe nuk lidheshin ose nuk kishin të bënin me përkatësinë kombëtare. Shpesh herë ato do të shfrytëzoheshin nga forcat e huaja dhe do të përbënin një pengesë për formimin e një shteti kombëtar të centralizuar. Në paragrafin e dytë

¹⁹⁵ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 561.

¹⁹⁶ Po aty, f. 561.

¹⁹⁷ Po aty, f. 561.

përcaktoheshin më qartë të drejtat politike duke theksuar që: në Shqipëri do të zbatohet një sistem zgjedhjesh, i cili do të merrte në konsideratë të drejtat e minoriteteve të racës, fesë dhe gjuhës.¹⁹⁸ Lidhur me të drejtat e minoriteteve, art.5 ishte shumë i rëndësishëm pasi u garantonte minoriteteve të racës, fesë dhe gjuhës të mbanin, të drejtonin dhe të kontrollonin me të ardhurat e tyre, shoqëri mirëbërse, fetare a shoqërore dhe shkolla. Kjo nënëkuptonte që qeveria shqiptare zotohej përpara LK të lejonte hapjen e shkollave të minoriteteve. Hapja e këtyre shkollave ishte një e drejtë mjaft liberale, e cila më vonë do të vinte në vështirësi qeverinë shqiptare, kur ajo do të përpiquej të integronte pakicat kombëtare.

Përmbushja e këtyre detyrimeve ishte dhe një provë për shtetin shqiptar, i cili duhej të tregonte aftësitë e tij përpara partnerëve ndërkombëtar.¹⁹⁹ Gjithashtu, sipas paragrafit të dytë të Deklaratës, qeveria shqiptare brenda gjashtë muajve, që nga data e ratifikimit të këtij dokumenti duhej t'i paraqiste KLLK një raport të plotë lidhur me statutin legal të komuniteteve fetare, kishave, manastireve, shkollave, shoqërive mirëbërëse të racës, fesë edhe gjuhës.²⁰⁰ Qeveria shqiptare fillimisht nuk do të mund të përmbushte angazhimet e marra përpara LK. Me anë të një telegrami dërguar Lidhjes thuhej se: “Qeveria shqiptare e kishte materialisht të pamundur të paraqiste gjatë takimit të radhës së Këshillit, një raport mbi statutin, për faktin se të dhënat e nevojshme për këtë qëllim nuk ishin mbledhur. Qeveria shqiptare deklaronte, sidoqoftë, se do të bënte çdo lloj përpjekje që t'i dërgonte këtë raport Këshillit sa më shpejt që të siguronte të gjitha informacionet e kërkuara nga Art.

¹⁹⁸ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 562.

¹⁹⁹ MPJ, *dosja 211, Rezervat me rëndësi*, Tiranë, 1923, f. 122.

²⁰⁰ MPJ, *dosja 102, Minorities in Albania*, League of Nations, Geneva, 1922, f. 141.

5 i Deklaratës.²⁰¹ Gjithësesi, gjatë sesionit të Këshillit të Lidhjes së Kombeve në maj 1922, delegacioni shqiptar kërkonte më shumë kohë që të paraqiste një raport më të hollësishëm rreth legjislacionit që kishte të bënte me minoritetet.²⁰² Këtë detyrë delegacioni e përmbushte më 7 korrik të po atij viti. Në raportin që përmbante të dhënat mbi gjendjen e minoriteteve në Shqipëri thuhej: se ligjet që ishin në fuqi, mënyra e trajtimit të minoriteteve, rregullat dhe praktika e vendit, siguronin plotësisht barazinë e të drejtave publike, civile dhe sociale, pa dallim race, gjuhe dhe feje. Raporti, përveç të dhënave për trajtimin e minoriteteve, përmbante dhe një informacion të rëndësishëm për raportet e tolerancës dhe harmonisë fetare që po ndërtoheshin në shtetin shqiptar.²⁰³ Paragrafi i fundit i Art. 5 thoshte se: “Qeveria shqiptare do të marrë në konsideratë të gjitha rekomandimet që do t’i sugjerohen prej Shoqërisë së Kombeve mbi këtë pikë”. Ky paragraf ishte i rëndësishëm pasi sanksiononte pavarësinë dhe sovranitetin e shtetit shqiptar. Këtij teksti nuk mund t’i jepej kuptim jashtë kuadrit të paragrafit të parë të Art.5, domethënë, rekomandimet e mundëshme që janë parashtruar me këtë tekst duhej të kufizoheshin ngushtësisht vetëm në zotimin që përmbante paragrafi i parë.²⁰⁴ Me sa duket, qëllimi i LK në këtë paragraf ka qënë dëshira e saj në orientimin e qeverisë shqiptare në hapat e para të jetës së saj politike të pavarur. Këtë dëshirë LK do ta tregonte me dërgimin në Shqipëri të një komisioni, i cili do të kishte dy detyra kryesore: e para kishte të bënte me largimin e trupave të huaja ushtarake nga territori i Shqipërisë dhe dyta të mblidhte të dhëna mbi popullsinë minoritare që jetonte në zonat kufitare, sidomos në Shqipërinë e Jugut.

²⁰¹ MPJ, *dosja 102, Minorities in Albania*, League of Nations, Geneva, 1922, f. 142.

²⁰² Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 565.

²⁰³ Po aty, f. 565.

²⁰⁴ Dhimitër Berati, *Shënime historike mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Lidhjen e Kombeve, “Husi Borshi”*, Tiranë, 2007, f. 82.

5.5. Komisioni Ndërkombëtar dhe hetimet mbi popullsinë në Shqipëri

Gjatë vitit 1921, Shqipërisë i duhej të luftonte për zgjidhjen e dy çështjeve tepër të rëndësishme për të siç ishin: njohja e qeverisë në arenën ndërkombëtare dhe përcaktimi i kufijve. Organet kompetente që duhej të jepnin një zgjidhje definitive këtyre çështjeve ishin Konferenca e Ambasadorëve dhe Lidhja e Kombeve. Konferenca e Ambasadorëve, e cila pretendonte se ishte kompetente mbi vendosjen e kufijve,²⁰⁵ po vononte t'i jepte një zgjidhje definitive çështjes shqiptare. Pas një periudhe të gjatë hezitimi të këtij organi ndërkombëtar, shteti shqiptar ishte i pasigurt dhe kërcënohej nga politikën ekspansioniste të vendeve fqinj. Për të dalë nga kjo situatë indiferentizmi, Shqipëria vendoste të parashtronte një ankesë përpara LK. Përfaqësuesi i Shqipërisë, Mgr. Fan Noli, deklaronte se Konferenca e Ambasadorëve nuk ishte kompetente të vendoste mbi kufijtë e Shqipërisë, pasi misioni i saj ishte që të merrej me fatin e palëve ndërluftuese, vendosur sipas traktateve.²⁰⁶

Sikurse ishte deklaruar shumë herë, gjatë Luftës së Parë Botërore, Shqipëria kishte shpallur neutralitetin e saj.²⁰⁷ Për më shumë, sipas Nolit, Konferenca e Ambasadorëve kishte mbi tre vjet që diskutonte mbi këtë çështje pa arritur që të merrte një vendim përfundimtar. Për t'i dhënë zgjidhje kërkesës së palës shqiptare, LK kërkonte që çështja e kompetencave të dërgohej përpara një komisioni juridik. Qeveria shqiptare shpresonte që të ishte Lidhja e Kombeve dhe jo Konferenca e Ambasadorëve, që të vendoste mbi çështjen e kufijve, pasi kjo organizatë gëzonte një prestigj të lartë tek populli shqiptar. Konferenca e Ambasadorëve do ta mbante pezull problemin shqiptar nga qershori deri në fillim të nëntor

²⁰⁵ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, vep. e cit., f.352.

²⁰⁶ Justin Godart, *Shqipëria në 1921*, Urtësia Bektashiane, Tiranë, 2015, f. 254.

²⁰⁷ Po aty, f. 258.

1921. Do të ishte iniciativa e palës shqiptare që do të detyronte LK t'i jepte një zgjidhje përfundimtare kësaj çështjeje. Më 25 qershor, Shqipëria rezervonte kërkesën e saj përpara Asamblesë duke refuzuar njohjen e kompetencës së Konferencës së Ambasadorëve dhe kërkonte një zgjidhje të menjëhershme të grindjes që kishte lindur për kufijtë e saj me qeveritë e Athinës dhe të Beogradit.²⁰⁸ Këshilli vendoste të diskutonte mbi këtë kërkesë në fund të muajt gusht. Gjatë diskutimit, Këshilli prante që në Tiranë kishte një qeveri të zgjedhur dhe për pasojë ishte e domosdoshme që në Shqipëri të dërgohej një komision hetimi që do të zgjidhte çështjen e kufijve.

Më 2 shtator 1921, Asambleja e LK votonte njëzëri rezolutën, e cila vinte në dukje faktin që shteti serbo- kroato-sllloven dhe Greqia njihnin Fuqitë Kryesore Aleate si organe kompetente për të vendosur mbi kufijtë e Shqipërisë.²⁰⁹ Ajo gjithashtu, i rekomandonte Shqipërisë që të prante vendimet që do të dilnin nga Fuqitë Kryesore Aleate dhe Bashkëpunëtore. Përfaqësuesit e katër fuqive fituese (Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Japonia), ishin të mendimit se duhej të vërtetohej vija e kufijve të Shqipërisë ashtu siç ishte vendosur në 1913 nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës.²¹⁰ Duke qënë të mendimit, nga ana tjetër, se kufijtë jugorë të Shqipërisë ishin vendosur në terren nga komisioni i ndarjes së kufijve që kishte hartuar protokollin përfundimtar të punëve të tij në Firence, më 17 dhjetor të 1913, dhe që komisionit të ndarjes së kufijve të veriut dhe të lindjes i ishte dashur të ndërpriste punën më 1914 për shkak të operacioneve luftarake. Kështu vendosej që:

²⁰⁸ Albert Mousset, *Shqipëria përballë ...* vep. e cit., f. 34.

²⁰⁹ Justin Godart, *Shqipëria në 1921*, vep. e cit., f. 263.

²¹⁰ Po aty, f. 254.

- I. Qeveritë nënshkruese të këtij vendimi njihnin qeverinë e Shqipërisë dhe shtetin e saj si sovran dhe të pavarur.
- II. Një komision i përbërë nga katër anëtarë të caktuar nga qeveritë nënshkruese të këtij vendimi do të ngarkohej sa më shpejt të ishte e mundur, të përvijonte në terren vijën kufitare në veri, veri-lindje të Shqipërisë.
- III. Për të siguruar marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë ndërmjet shteteve të vendosura në të dy anët e kufirit, të dhënat e komisionit duhej të mbanin parasysh, sa të ishte e mundur, kufijtë administrativë dhe interesat lokale. Ai do të duhej të rregullonte veçanërisht vijën e caktuar në 1913 nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës.²¹¹

Duke respektuar vendimin e FM, Asambleja e LK i lutej Këshillit të emëronte menjëherë një komision prej tre antarësh të paanshëm, të cilët duhej të vëshgonin mbi gjendjen në Shqipëri.²¹²

Komisioni ndërkombëtar për përcaktim e kufijve të Shqipërisë, do të nisej nga Gjeneva më 13 nëntor dhe do të mbërrinte në Durrës më 19 nëntor 1921,²¹³ ai më pas do të vazhdonte rrugën drejt Tiranës. Detyrat e tij ishin të përcaktuara qartë, gjatë muajit nëntor, nga Sekretari i Përgjithëshëm i LK.

Komisioni duhej:

²¹¹ Justin Godart, *Shqipëria në 1921*, vep. e cit., f. 269.

²¹² Po aty, f. 264.

²¹³ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 569.

- I. T'i raportonte në mënyrë të detajuar Këshillit të Lidhjes së Kombeve mbi ekzekutimin e vendimeve që Fuqitë e Mëdha dhe Aleatët e tyre kishin marrë mbi caktimin e kufijve në Shqipëri. Këtu përfshiheshin edhe raportet që kishin të bënin me shqetësimet që ndodhnin në afërsi të zonave kufitare.
- II. Të raportonte, nëse e vlerësonte të nevojshme, pikëvështrimin e vet.
- III. Nuk duhej të vepronte në asnjë mënyrë pa u konsultuar me Fuqitë e Mëdha dhe Aleatët e tyre.
- IV. Duhej t'i dërgonte periodikisht një raport të ngjarjeve më të rëndësishme Sekretarit të Përgjithëshëm.
- V. Gjithashtu, Komisioni duhet t'i dërgonte një vlerësim të detajuar të shpenzimeve për muajin dhjetor 1921, të cilat duhej të miratoheshin nga Këshilli.²¹⁴

Më 19 nëntor 1921 Këshilli adoptonte një rezolutë sipas së cilës, Komisioni Hetimor në përputhje me rezolutën e 6 tetorit duhej të ndiqte udhëzimet e mëposhtme:

- I. Komisioni duhej të mbante të informuar Këshillin mbi tërheqjen e trupave serbo-kroate-slllovene dhe atyre shqiptare nga zona e demarkacionit, aprovuar nga Konferenca e Ambasadorëve më 18 nëntor 1921. Komisioni gjithashtu, duhej të ishte në dispozicion të autoriteteve lokale që të ndihmonte me evakuimin duke evituar aksidentet e mundshme.
- II. Komisioni duhej të verifikonte se asnjë ndihmë e jashtme nuk duhej t'u ofrohej kryengritësve të mundshëm lokalë, që të vinte në rrezik paqen në Shqipëri.

²¹⁴ C 517, 1921, VII, *Extrants from and summaries of documents concerning the Commission of Enquiry in Albania*, League of Nations, 20 decembre 1921, f. 2.

Komisioni për më shumë, duhej t'i paqiste Këshillit masa që të kishin si qëllim parandalimin e kryengritjeve.²¹⁵

Komisionit me të mbërritur në Shqipëri do t'i bënte përshtypje pritja entuziaste që do t'i bënte populli shqiptar. Kjo pritje që shpjegohej me prestigjin e lartë që LK gëzonte pranë qeverisë shqiptare, linte një sodisfaksion të këndshëm tek anëtarët e komisionit.²¹⁶ Komisionerët nga ana e tyre, e shpjegonin këtë qëndrim të popullit me faktin se LK kishte mbështetur dhe promovuar krijimin e një shteti të pavarur shqiptar. Gjithashtu, Lidhja kishte shprehur dëshirën e saj që në të ardhmen të siguronte një mbështetje të vendosur në zhvillimin e vendit, jo vetëm në aspektin politik por dhe atë ekonomik. Komisioni e shihte absolutisht të nevojshme që pjesëtarët e tij të njiheshin plotësisht me klimën politike të vendit dhe për këtë ata takoheshin me kryeministrin M. Pandeli Evangjelin dhe politikan influent të asaj kohe. Nga këto takime dukej qartë se jo vetëm populli por edhe forcat politike dëshironin një Shqipëri të pavarur. Me këto objektiva ishin formuar dhe tre partitë kryesore: Partia Popullore, ajo Progresiste dhe Partia e Pavarur. Komisioni fillimisht përbëhej prej tre anëtarësh, të cilët ishin: kolonel Schaefer, prof. J.J. Sederholm dhe majori J. C. Meinich.²¹⁷ Gjithashtu, ai kishte dhe një sekretar të përgjithëshëm, i cili ishte M. de Pourtales. Profesor Sederholm më 1 dhjetor 1921, do të zinte vendin e zotit M. Rolf Thesleff, i cili do të kthehej në vendin e tij për shkak të problemeve shëndetësore. Koloneli Schaeferë prezantonte vetveten si anglofil që kishte mbaruar studimet në Angli. Gjithashtu,

²¹⁵ C 547, M 150, 1921. VII, *Extracts from and summaries of documents concerning the commission of enquiry in Albania*, League of Nations, f. 3.

²¹⁶ C 512, M 387, 1922, *De la Commission D'enquete sur ses travaux*, Societe des Nations, 20 Decembre 1921, f.2.

²¹⁷ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 569.

koloneli kishte shërbyer për shumë vite në Egjypt në ushtrinë britanike dhe më pas ishte zhvendosur në Turqi. Në vitin 1878 ai kishte vizituar Shqipërinë i punësuar si përkthyes në ushtrinë turke gjatë luftërave ballkanike.²¹⁸

5.5.1. *Kryengritja e fiseve katolike të Mirditës kundër monopolit të pushtetit mysliman të Tiranës*

Misioni i Komisionit Ndërkombëtar për përcaktimin e kufijve do të zgjaste një muaj. Më 27 nëntor ai do të nisej drejt Shkodrës ku do mbledhte të dhëna të detajuara rreth ngjarjeve që kishin ndodhur në këtë zonë. Qëllimi i këtij udhëtimi ishte vizita e fshatit Tarabosh që ndodhej në territorin shqiptar.²¹⁹ Ky fshat, sipas infomatave ishte i okupuar nga trupat serbe dhe Komisioni dëshironte ta vërtetonte duke e inspektuar personalisht. Më tej, udhëtimi do të vazhdonte drejt Mirditës, më konkretisht në Orosh, ku trupat serbe përbënin një shqetësim konkret për rendin e kësaj treve.²²⁰ Në Orosh, Komisioni mbërrinte në 9 dhjetor ku pritej nga kryeplaku dhe prifti katolik i fshatit. Gjatë kësaj periudhe, plaste kryengritja e Dibrës dhe Komisioni do të qëndronte deri në përfundimin e saj, pasi Këshillit të LK i shkonte një ankesë nga “Ministri i Arsimit të Republikës së Mirditës”.²²¹ Kjo Republikë do të shprehej se përfaqësonte interesat e fiseve katolike të Mirditës, të cilët nuk dëshironin të ishin pjesë e një shteti të dominuar dhe udhëhequr nga shumica myslimane. Mirëditërit dhe prijësi i tyre Marka Gjoni, e paditën këtë qeveri se po përgatiste kthimin e

²¹⁸ C 1195, M 145, 18.01.1922, f. 7.

²¹⁹ C 512, M 387, 1922, *De la Commission D'enquete sur ses travaux*, Societe des Nations, 20 Decembre 1921, f. 3.

²²⁰ Po aty, f. 3.

²²¹ Berati Dhimitër, *Shënime historike mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Lidhjen e Kombeve*, vep. e cit., f. 15.

sundimit turk.²²² Me këtë pretekst, në shtator të 1921, në Mirditë shpërthente një kryengritje e udhëhequr nga Marka Gjoni, i cili shpallte “Republikën e Pavarur të Mirditës”. Prijësi i Mirditës e paraqiste kryengritjen si një kundërveprim ndaj monopolit mysliman të pushtetarëve në Tiranë.²²³

Por, gjatë qëndrimit në këtë zonë Komisioni konstatonte se udhëheqësi i kryengritjes ishte shtyrë nga ambicjet e tij personale. Ai, falë prestigjit dhe ndikimit që gëzonte në këto zona, kishte shpallur veten e tij si udhëheqës i shtetit të pavarur të Mirditës. Nëpërmjet një politike mashtruese, arrinte të manipulonte popullsinë, duke aluduar se qeveria e Tiranës e mbështetur nga mazhoranca myslimane, kishte ndërmend të ndalonte predikimin e fesë katolike në Mirditë. Kryengritja nuk kishte sukses, pasi pjesa më e madhe e popullsisë rrinte pasive gjatë gjithë trazirave. Kryengritësit do të vazhdonin luftën e tyre pa pushim për disa muaj falë armatimeve dhe municioneve që siguroheshin nga ushtria serbe, e cila ishte e dislokuar në Arras, disa kilometra larg nga Oroshi.²²⁴ Rreth mesit të nëntorit, arrihej marrëveshja në LK për demilitarizimin e zonave neutrale në veri dhe trupat e jugosllave filluan të tërhiqeshin në territorin e tyre. Një rol të rëndësishëm pati dhe Komisioni, i cili nëpërmjet një telegrami i kërkonte Sekretarit të Përgjithëshëm të përdorte peshën e tij pranë qeverisë së Beogradit për demilitarizimin e zonës. Mungesa e mbështetjes nga ana e forcave ushtarake jugosllave bënte që Marka Gjoni të braktisej nga përkrahësit e tij. Nga fundi i nëntorit, qeveria e Tiranës dërgonte një përfaqësues, i cili do të ndërmernte një politikë pajtuese shumë të suksesshme. Më 28 nëntor, në ditën e Pavarësisë

²²² Albert Mousset, *Shqipëria përballë ...*, vep. e cit., f. 34.

²²³ Po aty, f. 35.

²²⁴ C 542. M 387. 1921. VII, *League of Nations, Report of the Commission of Enquiry on its work from November 19th to December 20th, 1921*, f. 3.

dekretohej dita e amnistisë së përgjithshme. Me mbërritjen e Komisionit në 9 dhjetor në Orosh, lëvizja kryengritëse kishte mbaruar dhe paqja kishte triumfuar.²²⁵ Nga raportet që Komisioni i dërgonte LK, nënvizohej fakti që lëvizja kryengritëse e Mirditës, nuk kishte si qëllim mbrojtjen e minorancës katolike nga mazhoranca myslimane, por lindëte nga ambicjet personale të Marka Gjonit.²²⁶

Më 11 dhjetor, pjesëtarët e Komisionit vazhdonin drejt Lurës në drejtim të kufirit serb, duke kaluar lumin Drin në afërsi të Arrasit. Bëhej fjalë për zonën ku gjatë verës ishin zhvilluar luftimet më të ashpra. Këto zona, në përputhje me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve po evakuoheshin nga trupat serbe në mënyrë paqësore.²²⁷ Komisioni kishte si objektiv të vizitonte Dibrën për të hetuar më nga afër sjelljen e popullsisë shqiptare gjatë evakuimit të zonës neutrale. Më tej, plani parashikonte që Komisioni të kalonte përmes territorit serb drejt Strugës, rrugës për në Korçë, me qëllim që të inspektonte kufirin jugor. Por kriza politike që shpërthente në Tiranë, detyronte pjesëtarët e Komisionit të ktheheshin urgjentisht në Tiranë. Aty do të bashkohej dhe koloneli Schaefer, i cili kishte mbërritur nga Shkodra më 11 dhjetor.²²⁸ Ai raportonte se, edhe në rrethin e Shkodrës dhe Taraboshit, evakuimi nga trupat serbe kishte vazhduar qetësisht pa probleme. Tërheqja e trupave arrihej falë ndërhyrjes së LK, e cila vendoste që kufijtë e Shqipërisë të ishin ato të vendosura në 1913.²²⁹ Nga fundi i dhjetorit situata në zonat kufitare veriore ishte normalizuar dhe Komisioni vendoste të vazhdonte detyrën e tij në territorin shqiptar duke lëvizur drejt jugut

²²⁵ C 517, 1921, VII, *Extrants from and summaries of documents concerning the Commission of Enquiry in Albania*, League of Nations, 20 decembre 1921, f. 3.

²²⁶ Po aty, f.3.

²²⁷ Po aty, f. 3.

²²⁸ C 512, M 387, 1922, *De la Commission D'enquete sur ses tranaux*, Societe des Nations, 20 Decembre 1921, f. 5.

²²⁹ Po aty, f. 4.

të vendit. Kështu, në fillim të janarit, pjesëtarët e Komisionit do spostoreshin në drejtim të kufirit grek për të vazhduar hetimin e tyre në përcaktimin e vijës kufitare jugore. Duke rënë dakord midis tyre, në fund të dhjetorit, ata niseshin në rrugë detare nga Durrësi për në Vlorë dhe kalonin në afërsi të Sazanit, i cili ishte akoma i pushtuar nga ushtria italiane. Komisioni pritej me entuziazëm nga populli i Vlorës dhe do të konstatonte se Shqipëria e Jugut kishte një kulturë më të zhvilluar se pjesa tjetër e vendit.²³⁰ Ndjenjat dhe dëshirat patriotike për një Shqipëri të pavarur ishin rrënjësuar thellë në këto treva. Nga Vlora Komisioni nisej për në Korçë, duke marrë nga popullsia e qyteteve, që ndodheshin përgjatë rrugës, një mirëseardhje të ngrohtë dhe një mirënjohje të thellë për LK.

5.5.2. Lëvizja patriotike dhe mungesa e minoritetit grek në Korçë

Me të mbërritur në Korçë, komisionerët fillimisht do të drejtoheshin drejt Shën Naumit dhe Manastirit, në jug të liqenit të Ohrit, ku vërenin prezencën e trupave serbe. Këto dy zona do t'i liqeshin përfundimisht Jugosllavisë në gusht të 1925. Ata sugjerorin që linja e demarkacionit të shtrihej nga liqeni i Ohrit deri në veri të kufirit grek.²³¹ I këtij mendimi ishte dhe Konferenca e Ambasadorëve, e cila sugjeronte zbrazjen e këtyre zonave nga ana e ushtrisë serbe. Tërheqja e trupave duhej të bëhej paqësisht, në mënyrë që Mbretëria serbo-kroate-sllovene mos të ndihej e kërcënuar në integritetin territorial të saj.²³² Në krahinën e Korçës verifikohej se 24 fshatra në perëndim të liqenit të Prespës deri në jug

²³⁰ C 93, M 48, 1922, *Report of the Commission of Enquiry*, League of Nations, Geneva, 26 January 1922, f.6.

²³¹ Po aty, f. 6.

²³² MPJ, dosja 131, *Korespondencë e Legatës shqiptare në Parisë drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme*, Paris, 2 janar 1925, f. 514.

në Kapshticës ishin të okupuara nga ushtria greke, koloneli i së cilës deklaronte se nuk kishte marrë asnjë urdhër për evakuim.²³³ Këto fshatra kishin qenë pjesë përbërse e kazasë së Korçës, të cilat sipas marrëveshjes së arritur me Protokollin e Londrës duhet t'i përkisnin Shqipërisë. Stipulatet e Konferencës së Londrës të vitit 1913, në paragrafin 2 sipas Protokollit, përcaktonin se brigjet jugore dhe perëndimore të liqenit të Ohrit, nga Lini tek Manastiri i Shën Naumit duhet t'i përkisnin tërësisht Shqipërisë. Duhet kujtuar se me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, Komisioni i Përcaktimit të Kufijve në vitin 1913-1914 ishte detyruar të ndërpriste hetimet pa përcaktuar vijën kufitare në këtë zonë.²³⁴ Manastiri nuk ishte evakuar akoma dhe banohej nga popullsia serbe. Meqënëse vija kufitare nuk ishte vendosur akoma, Komisioni konsideronte të nevojshme të përqëndrohej në përcaktimin e kufirit që shkonte nga liqeni i Ohrit deri tek vija që ishte përcaktuar në vitin 1913. Propozohej që zona neutrale, e cila në atë kohë mbaronte në Lin, duhej të zgjerohej dhe të përfshinte bregun jugor të liqenit të Ohrit deri në kufi me Greqinë (liqeni i Prespës). Sipas këtyre sugjerimeve mund të shmangeshin të gjitha mosmarrëveshjet, deri sa Manastiri e Shën Naumi të evakuoeshin. Këto dy zona fillimisht Konferenca e Ambasadorëve, me vendim të 6 dhjetorit 1922, do t'ia caktonte Shqipërisë por, Jugosllavia e kundërshtonte dhe do të kërkonte rishikimin e vendimit. Për zgjidhjen e kësaj çështjeje, do të ishte e nevojshme arritja e një marrëveshje midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Marrëveshja do të parashikonte që Manastiri dhe Shën Naumi t'i kalonin Jugosllavisë, kurse Shqipërisë në këmbim do t'i jepej katundi Peshkopi.²³⁵ Duke u rikthyer tek çështja e përcaktimit të zonës

²³³ C 517, 1921, VII, *Extrants from and summaries of documents concerning the Commission of Enquiry in Albania*, League of Nations, 20 decembre 1921, f. 9.

²³⁴ C 93, M 48, 1922 VII, *Report of the Commission of Enquiry*, f. 4.

²³⁵ Po aty, f. 2.

neutrale, kjo ishte detyrë e KLLK që sugjerimet e tij t'i paraqiste në Konferencën e Ambasadorëve. Kështu në mbledhjen e mbajtur më 12 janar 1922, KLLK merrte një vendim sipas këshillave të paraqitura nga Komisioni dhe vendoste që:

- I. Sipas dëshirës së shprehur nga Konferenca e Ambasadorëve, Komisioni duhej të vazhdonte drejt zonës neutrale për të verifikuar, nëpërmjet hetimeve në vend, që zona në çështje duhej të evakuohej plotësisht nga trupat e të dy vendeve;
- II. Pas inspektimit të zonës neutrale, Komisioni duhej të takonte në Shkodër Komisionin e Përcaktimit të Kufijëve të ngritur nga Konferenca e Ambasadorëve.²³⁶

Si rezultat i hetimeve, komisionerët ishin të mendimit se ekzistonte dëshira nga të dyja palët që të respektohej zona neutrale. Për Komisionin edhe çështja e përcaktimit të kufirit shqiptaro-grek e kazasë së Korçës paraqiste një vështirësi të madhe, pasi Komisioni i Përcaktimit të Kufijve i vitit 1913 nuk e kishte delinear vijën kufitare. Megjithatë, në raportin e tij Komisioni i bashkëngjiste një hartë të rrethit të Korçës, e cila do të ndimonte Këshillin të kishte një vizion të qartë mbi situatën e kësaj zone. Ai vazhdonte udhëtimin në vijën kufitare dhe zbulonte që skalioni i parë i ushtrisë greke shtrihej nga fshati i Konskos deri në bregun perëndimor të Liqenit të Prespës, duke përfshirë gjithë gadishullin që ndodhej afër liqenit, dhe ndiqte vijën përmes fshatrave të Zagradec, Vrnica, Kapshticë, Tresnik, Novosel dhe Slimnica. Sipas qeverisë shqiptare, gjithë këto fshatra dhe shumë të

²³⁶ C 6071/735/90, *General report on Albania presented by the Commission of Enquiry to the Council of the League of Nation*, April 24, 1922, f. 2.

tjera ishin pjesë e kazasë së Korçës.²³⁷ Këto deklarata konfirmoheshin nga dokumentet zyrtare të Perandorisë Osmane, të cilat listonin emrat e këtyre fshatrave dhe provincës ku bënin pjesë, me qëllim taksimi. Duke shfletuar dokumentat, 26 fshatrat e listuar në fillim të vitit 1922 ishin akoma të okupuara nga ushtria greke. Përfundimisht, sipas marrëveshjes që do të arrihej në gusht 1925, Greqia tërhiqej vetëm nga 14 fshatra të krahinës së Korçës.²³⁸

Sipas mendimit të Komisionit, ishte e nevojshme të vendosej një zonë neutrale në këto fshatra të okupuara nga ushtria greke, duke marrë si shembull formimin e zonës neutrale në kufirin serbo-kroat-sllloven. Për të arritur këtë qëllim, Komisioni përpiqej të takonte Komandantin e divizionit të Florinës, por nuk ja arrinte qëllimit. Komisioni arrinte të komunikonte me telefon dhe informohej që ushtria greke nuk kishte marrë urdhër që të tërhiqej nga këto zona. Megjithatë, marrëdhëniet në pikat kufitare ndërmjet grekëve dhe shqiptarëve ishin të mira, përveç disa aksidenteve që kishin ndodhur në pikat kufitare. Kështu, Komisioni kishte marrë disa informata, se ushtria greke kishte ndaluar hyrjen në territorin shqiptar të disa shtetasve dhe nuk i lejonte ata të ktheheshin në Korçë. Gjithashtu, raportohej se shumë shtetas më nënshtetësi shqiptare u ishin konfiskuar pashaportat nga qeveria greke. Ndalimi i lëvizjes së banorëve drejt Korçës po e rëndonte gjendjen e tyre, pasi u mohojë e drejta e lëvizjes dhe e shkëmbimit të mallrave. Në zonën e Maqedonisë, që ishte e okupuar nga trupat greke, raportohej se pronarët shqiptarë ishin detyruar nga autoritet greke të shisnin tokat e tyre me një çmim shumë të ulët.²³⁹ Këto ankesa, Komisioni nuk pati mundësi t'i verifikonte pasi nuk lejohej nga ushtria greke të bënte një hetim të

²³⁷ C 93, M 48, 1922 VII, *Report of the Commission of Enquiry*, f. 6.

²³⁸ Georges Castellan, *Histori e Ballkanit (shekulli XIV-XX)*, "Çabej", Tiranë, 1996, f. 451.

²³⁹ C 781, *Commission of Enquiry in Albania, Report of Activities from December 19th, 1922, to February 1st, 1923*, J.J. Sederholm, 2 May 1923, f. 43.

detajuar. Për zgjidhjen e këtyre problemeve ishte e nevojshme që, KLLK t'i kërkonte Konferencës së Ambasadorëve të përshpejtonin zgjidhjen e çështjes së kufirit. Vetëm duke përcaktuar vijën kufitare Shqipëria dhe Greqia mund të mbanin marrëdhënie diplomatike të rregullta.

Përsa i përkiste etnisë së popullsisë që jetonte në krahinën e Korçës, Komisioni e vinte në dukje faktin se, ajo ishte tërësisht shqiptare dhe popullsia greke që jetonte aty ishte e papërfillshme.²⁴⁰ Këtë qëndrim ka mbajtur dhe Edith Durham, e cila duke vizituar gjithë Shqipërinë shkruante në lidhje me krahinën e Korçës se: “gjithçka këtu është shqiptare”.²⁴¹ Për këtë arsye mund të ishte e llogjikshme që popullsia do të kundërshtonte çdo ndërhyrje të jashtme si për çështjet fetare dhe ato të politikës së pakicave kombëtare. Megjithatë, Komisioni e ndante popullatën në dy grupe: në nationalist dhe në grekofil. Në grupin e parë përfshiheshin gjithë banorët myslimanë dhe një pjesë e konsiderueshme e banorëve që i përkisnin fesë ortodokse.²⁴² Grupi nationalist mbështetej nga shqiptarët që ishin kthyer nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ishin patriotë të pakompromentuar. Qëllimi i tyre ishte spastrimi i menjëhershëm dhe i plotë i çfarëdolloj ndjenje që kishte të bënte me helenizimin. Ata ishin mbështetësit kryesor të mbylljes së shkollave greke dhe ndalimit të përdorimit të gjuhës greke gjatë shërbesave fetare. Objektivi i tyre ishte krijimi i Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare, e cila duhej të ishte e pavarur nga Kisha greke.

Në grupin grekofil përfshiheshin të gjithë elementët konservatorë ortodoks, të cilët gjatë sundimit turk ishin mbështetës të Greqisë. Këta elementë ishin edukuar në shkollat

²⁴⁰ C 93, M 48, 1922 VII, *Report of the Commission of Enquiry*, f. 5.

²⁴¹ Edith Durham, *Brenga e Ballkanit*, “Argeta LMG”, Tiranë, 2009, f. 228.

²⁴² C 93, M 48, 1922 VII, *Report of the Commission of Enquiry*, f. 5.

dhe universitetet greke, dukë qëndruar kështu nën ndikimin e kulturës helene. Ata ishin në kundërshtim me shpalljen e Kishës Autoqefale Shqiptare.²⁴³ Grekofilët kishin fituar një mbështetje të plotë nga tregëtarët, të cilët kishin interes të mbanin marrëdhënie të mira me Greqinë. Së fundmi, në këtë kategori hynin dhe banorët me nivel të ulët kulturor, të cilët e kishin të vështirë të shkëputeshin nga ritet tradicionale. Grekofilët kishin mbështetjen e klerit dhe veçanërisht të Mitropolit grek, që punonte haptazi për shkëputjen e jugut të Shqipërisë dhe bashkimit të saj me Greqinë.²⁴⁴ Pas vizitës në Korçë, Komisioni, ose më saktë njëri prej pjesëtarve të tij, prof. Sederholms, do të zhvendosej në Gjirokastrë dhe ku do të vazhdonte hetimet e tij për katër ditë. Fakti që udhëtonte vetëm, i jepte mundësi “profesorit” të bisedonte me nënshtetas të të dyja etnive, të cilët përgjigjeshin përgjithësisht në mënyrë të sqartë. Qëndrimi korrekt i Komisionit përshëndetej nga Kryeministri Xhafer Ypi, i cili shprehte një mirënjohje të përzemërt për punën që ishte kryer deri në atë kohë.

Kryeministri mendonte se prania e Komisionit kishte ndihmuar në parandalimin e rrezikimit të paqes në vend. Meqënëse ky kërcënim nuk ishte zhdukur akoma, ai dhe qeveria shqiptare mendonte se, Komisioni duhet e vazhdonte punën për një periudhë akoma më të gjatë. Për këtë arsye qeveria i kërkonte Këshillit ta shtynte për më tej largimin e Komisionit nga territori shqiptar. Përveç këtij aspekti, qeveria i kërkonte LK që t’i ofronte një mbështetje në sferën ekonomike, e cila do të ndihmonte edhe në stabilitetin politik të vendit.²⁴⁵ Falë punës hetimore të zhvilluar në territorin e Shqipërisë nga Komisioni do të vendoseshin edhe kufijtë përfundimtar të saj. Kështu në 30 korrik të vitit 1926, nënshkruhej

²⁴³ C 93, M 48, 1922 VII, *Report of the Commission of Enquiry*, f. 5.

²⁴⁴ Po aty, f. 5.

²⁴⁵ C. 5236, M. 155, 1922, *Korespondencë e Xhafer Ypit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve*.

në Paris protokolli i fundit prej ambasadorëve të Anglisë, Francës, Italisë dhe Japonisë si dhe prej përfaqësuesve të Jugosllavisë, Greqisë dhe Shqipërisë.²⁴⁶ Ky akt ndërkombëtar mbyllte përfundimisht çështjen e njohjes së kufijve nga shtetet fqinje dhe dekretonte pavarësinë territoriale të Shqipërisë.

5.6. Situata politike në Shqipërinë e Jugut

Një nga problemet kryesore me të cilën duhej të përballej KH kishte të bënte me të ardhmen politike të “Epirit të Veriut”. Kjo pasi Greqia dhe minoriteti grek që jetonte në Shqipërinë e Jugut, nuk pajtoheshin me idenë se e ardhmja e këtyre trevave ishte vendosur përfundimisht nga Konferenca e Ambasadorëve. Mosnjohja e trevave të jugut, si pjesë e pandashme e Shqipërisë nga shteti grek, ndikonte negativisht në marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve fqinj. Për Komisionin nuk kishte dyshim se pjesa më e madhe e popullsisë dëshironte të ishte pjesë përbërëse e një Shqipërie sovrane. Këtë dëshirë të popullsisë e mbështeste edhe KKK, i cili kishte deklaruar shumë herë, se nuk do të merrte në konsideratë asnjë ankesë që kishte si qëllim ndryshimin e këtij vendimi. Qëndrimi kërcënues i Greqisë dhe gjendja e vështirë ekonomike në të cilën ndodhej vendi, kishte krijuar një situatë pakënaqësie, sidomos, në popullsinë ortodokse.²⁴⁷ Korça dhe Gjirokastra ishin dy qytetet që paguanin pjesën më të madhe të taksave që kishte vendosur shteti shqiptar, ndërkohë që vetëm një pjesë e vogël e këtyre shumave kthehej pas dhe përdorej

²⁴⁶ Aurela Anastasi, *Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)*, Shtëpia botuese “PEGI”, Tiranë, 2007, f. 153.

²⁴⁷ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f.333.

për nevojat që kishin këto zona.²⁴⁸ Patriotët korçarë, që kishin qënë mbështetësit kryesorë të themelimit të Shqipërisë së pavarur, shpresonin që shteti i ri të mos ishte më një provincë e Turqisë, por një shtet modern bazuar në laicitetin e institucioneve. Për këtë arsye, ata kërkonin që të kishin një peshë domethënëse në administratën shtetërore, e cila në shumë aspekte duhej të pasqyronte kulturën dhe rëndësinë ekonomike të zonës së tyre.²⁴⁹ Kërkesat ishin një kundërpërgjigje e punësimit në Tiranë të shumë ish - oficerëve myslimanë gjirokastritë, të cilët kishin shërbyer në ushtrinë turke. Gjithashtu, në një farë mënyre edhe patriotët ortodoksë shqiptarë ishin mbajtur larg nga jeta politike. Kjo pakënaqësi do të vrehet gjatë zgjedhjeve politike parlamentare, ku në qytetin e Korçës nga 8.000 qytetarë ortodoksë me të drejtë vote, vetëm 220 prej tyre merrnin pjesë në votime.²⁵⁰

Ky qëndrim i popullsisë së krishtere, ndikohej nga disa politikanë, të cilët për të arritur interesat e tyre personale, kërkonin krijimin e një situatë të privilegjuar në favor të elementit të krishterë në jug.²⁵¹ Abstenimi ndaj votës do të detyronte qeverinë që të jepte disa garanci mbi një angazhim më aktiv të popullsisë ortodokse në jetën politike dhe garantimin e zgjedhjeve të lira në ardhmen. Por, për situatën politike dhe në veçanti për sistemin zgjedhor do të kishte ankesa në Shqipërinë e Jugut. Kështu, popullsia ortodokse pretendonte se sistemi i votimit që ishte mazhoritar dhe indirekt nuk ishte i favorshëm për ta. Dyshimet shtoheshin po të analizoheshin me imtësisht dhe ndarjet e zonave elektorale që parashikonte sistemi. Kështu popullsia e krishterë e zonës së Himarës prej 6.000 banorë

²⁴⁸ C 7811, The enquiry in Southern Albania, Report by the Commission of Enquiry, League of Nations, 2 May 1923, f. 9.

²⁴⁹ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f.333.

²⁵⁰ Po aty, f. 365.

²⁵¹ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942*, "Marin Barleti", Tiranë, 1995, f. 170.

ishite përfshirë në Prefekturën e Vlorës, popullsia e së cilës ishte kryesisht myslimane.²⁵² Nga të dhënat mbi popullsinë në këtë Prefekturë llogaritej të kishte një mazhorancë myslimane prej 28.000 dhe një minorancë ortodokëse prej 13.000 banorë. Po ashtu, edhe në Prefekturën e Korçës, e cila përfshinte rrethin e Pogradecit, popullsia që i përkiste fesë myslimane ishte në mazhorancë. Të dhënat statistikore tregonin që, popullsia myslimane llogaritej në 72.000 banorë kurse ajo e krishterë në 48.000 banorë.²⁵³ Përfaqësuesit e jugut ishin të mendimit se po të bashkohej popullsia e krishterë në zona të veçanta zgjedhore ose të vendosej një lloj sistemi proporcional, ata do të ishin në gjendje të zgjidhnin përfaqësuesit e vet. Sikur të veprohej në këtë mënyrë, kuptohet se vendimet nuk do të merreshin vetëm nga mazhoranca myslimane.

Mosmarrëveshjet ndërmjet popullsisë së krishterë dhe asaj myslimane vreheshin edhe në zotërimin e tokave bujqësore. Pronarë të tokave ishin bejleret myslimanë, të cilët çifligjet e tyre i lëshonin me qera për t'i punuar fshatarët, që në shumicën e tyre ishin të krishterë. Qeramarrësit duhej të paguanin një të tretën e prodhimit të tyre pronarit të tokës. Mungesa e një legjislacioni të saktë mbi pronësinë e tokës bënte që pronarët e çifligjeve, shumë herë, të përdornin forcën e tyre duke u hequr tokën qeramarrësve. Do të duhej një dhjetëvjeçar që shteti shqiptar të aprovonte një sërë ligjesh, të cilët kishin si qëllim aplikimin e një reforme serioze agrare. Më konkretisht, do të ishte mbreti Zog ai që në vitin 1930 do të aprovonte ligjin mbi reformën agrare. Kjo reformë synonte të shpronësonte, sipas nenit 1, çdo pronë rurale që ndodhej në zotërimin fizik të institucioneve publike, si

²⁵² MPJ, dosja 211, *Komisioni i Hetimeve në Shqipëri*, 1923, f. 9.

²⁵³ C 7811, Report of the Commission of Enquiry in Albania from Decembre 19th, 1922 to February 1st, 1923, J.J. Sederholms, 2 May 1923, f. 11.

edhe të personave juridike ashtu edhe të shtetit.²⁵⁴ Natyrisht nga shpronësimi i këtyre pronave do të përfitonin të gjithë bujqit që ishin nënshtetasit shqiptarë, edhe ata që i përkisnin minoriteteve.

5.7. Protestat e popullsisë himariote kundër reformave të shtetit shqiptar

Studuesit helenë ndër vite janë munduar nëpërmjet studimeve të tyre ta paraqisnin popullsinë e Himarës si greke. Për të arritur në këtë përfundim ata, në mungesë të burimeve dokumentare historike, përdornin pikat e takimeve dialektore që flitej në Greqi me greqishten që flitej në tre fshatrat e krahinës së Himarës (Dhërmi, Palasë dhe Himarë).²⁵⁵ Kjo lloj qasje nga ana e studiusëve grekë nuk jepte rezultat bindës dhe tezat e tyre nuk gjenin baza të forta. Po të krahasoheshin rezultatet e disiplinave ndihmëse të historisë, siç ishin studimet e zakoneve, dokeve, këngëve, valleve, veshjeve, emrave të njerëzve, organizime shoqërore dhe e drejta zakonore, këto tre fshatra “greqishtfolëse” afronin me tepër me trevat e Labërisë.²⁵⁶ Gjithashtu, edhe përdorimi i gjuhës greke në këto fshatra, mund të shpjegohej me ndikimin që ushtronte kisha greko - fanariote në Shqipëri dhe, pjesërisht, me kontaktet tregtare që këto fshatra kishin pasur me qendra tregtare të afërta greke, kryesisht me Korfuzin dhe me ishujt e tjerë joniane.²⁵⁷ Duke parë këta tregues, shteti shqiptar popullsinë e nënprefekturës së Himarës e konsideronte përgjithësisht shqipfolse. Përrjashtim bënin, siç u nënvizua më lart, fshatrat Dhërmi, Palasë dhe Himarë, të cilat

²⁵⁴ *Ligje mbi Reformen Agrare*, Mbretëria Shqiptare, Kryesia e Keshillit Ministrues, Tiranë, 1930.

²⁵⁵ Luan Omari, *Çështja e pakicave kombëtare*, vep. E cit., f. 51.

²⁵⁶ Kristo Frashëri, *Himara dhe përkatësia etnike e himarjotëve*, Botimet Toena, Tiranë, 2005, f. 23.

²⁵⁷ Filip Liço, *Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare*, vep. e cit., f. 190.

Komisioni Hetimor nga të dhënat që zotëronte, i konsideronte pjesërisht minoritare.²⁵⁸ Pavarësisht të dhënave të mbledhura nga Komisionit Hetimor, këto fshatra nuk konsideroheshin si minoritare nga Ministria e Arsimit, duke parë se në këngë e në vajtime përdornin gjuhën shqipe.²⁵⁹

Qëndrimi shtetit shqiptar në këtë drejtim lidhej me faktin se, Himara historikisht ka qenë një krahinë me tipare të qarta kombëtare shqiptare. Në përforcim të tezës shqiptare vinin në ndihmë dokumentet historike që evokonin qëndresat e himariotëve kundër turqve. Këto qëndresa vijuan deri në shek. XVII dhe pushtuesit turq detyroheshin t'u njihnin banorëve të kësaj krahine pozitën e krahinave autonome (venomet). Marrvëshja e arritur me turqit parashikonte që krahina e Himarës të kishte disa privilegje ekonomike dhe administrative. Por ndoshta autonomia e arritur ndikonte në zbehjen e ndjenjës kombëtare shqiptare dhe forcimin e helenizimit të një pjese të popullit himariot. Helenizimi vazhdoi edhe pas çlirimit të Himarës, në vitin 1916, nga trupat greke. Shkollat greke të çelura në këtë krahinë kishin një funksion të dyfishtë. Ato mundësonin jo vetëm zhvillimin e gjuhës greke, por mbi të gjitha përdroreshin si mjet për përhapjen e propagandës greke.

Pas largimit të trupave italiane, në vitin 1920 dhe forcimit të shtetit shqiptar, populli himariot, nën ndikimin e Greqisë, do të ngrihej në protestë. Protestat, fillimisht kishin si qëllim rivendosjen e autonomisë dhe më vonë kundërshtimin e reformës arsimore të promovuar nga Ministria e Arsimit. Për rivendosjen e autonomisë, himariotët kërkonin që qeveria të respektonte zbatimin e venomeve. Siç u përmend më lartë, venomet ishin disa

²⁵⁸ MPJ, dosja 101, *Ministria e Punëve të Brendëshme*, Tiranë, 1921, f. 34.

²⁵⁹ MPJ, dosja 303, *Mbi shkollat e Himarës*, Tiranë, 1923, f. 7.

privilegje, sipas të cilave krahina e Himarës duhet t'i paguante shtetit një taksë vjetore në këmbim të një farë autonomie speciale. Autonomia bënte të mundur që shteti shqiptar të kishte mungesë të theksuar informacionesh rreth pasurisë që zotëronte popullsia e kësaj zone.

Të përkrahur edhe nga qeveria greke, himariotët emëronin disa përfaqësues, të cilët do të negocionin me qeverinë e Tiranës për çështjen e autonomisë. Ata vendosnin disa kushte përpara se të pranonin bashkimin e Himarës me pjesën tjetër të vendit. Sipas këtyre kushteve, qeveria duhet t'u garantonte: njohjen e venomeve ekonomike që kishte pasur kjo krahinë në kohën e pushtimit turk, e cila do të paguante një pagesë fikse si më parë; njohjen e plotë në çështjet fetare dhe pasuria e kishave të administrohej prej tyre siç kishte qenë deri në atë kohë; në shkollat e kësaj krahine gjuha shqipe të bëhej e detyrueshme dhe zyrtare; greqishtja do të mësohej si gjuhë e dytë atje ku populli do të shfaqte dëshirën.²⁶⁰ Fillimisht kërkesat e parashtruara nga përfaqësuesit himariotë pranoheshin nga qeveria, e cila u premtonte, gjithashtu, se do t'i paraqiste për diskutim edhe në parlament.²⁶¹ Marrëveshja e përkohëshme, krijonte mundësinë e zhvillimit paqësor të krahinës dhe lejonte forcimin e identitetit të ndërgjegjjes kombëtare shqiptare të saj. Por nga ana tjetër, pranimi i kërkesave nga qeveria shqiptare nuk ishte në përputhje me procesin e unifikimit dhe ndërtimin e institucioneve kombëtare. Ato përbënin rrezik, sepse, mund të shtynin popullsinë e ndonjë krahine tjetër të vendit për të kërkuar privilegje ekonomike dhe administrative.²⁶²

²⁶⁰ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 430.

²⁶¹ Po aty, f. 431.

²⁶² Po aty, f. 440.

Marrëveshja e arritur nga pala himariote dhe qeveria nuk do të diskutohej dhe ratifikohej nga Parlamenti shqiptar. Kjo do të bënte që venomet të mos pranoheshin ligjërisht dhe si pasojë nuk mund të njiheshin nga shteti shqiptar.²⁶³ Fillimisht, Ministria e Financave, i jepte urdhër prefekturës së Vlorës që të bënte regjistrimin, jo vetëm të popullsisë, por edhe atë të pasurive të paluajtshme dhe të gjësë së gjallë.²⁶⁴ Më tej i jepej urdhër Prefektit që të procedohej me mbledhjen e të dhjetës, ashtu si funksiononte sistemi tatimor në rang kombëtar. Privilegjet me natyrë ekonomike që i ishin bërë Himarës binin në kudërshtim me Statutin, i cili në bazë të nenit 99, parshikonte: asnjë privilegj nuk mund t'i bëhej askujt përse u përkiste pagave dhe taksave.²⁶⁵ Natyrisht, anulimi i privilegjeve taksore dhe regjistrimi i pasurisë shkaktonte protesta tek populli, përfaqësuesit e të cilit i drejtoheshin autoriteteve greke. Paria himariote i lutej qeverisë greke që të mos toleronte një padrejtësi të tillë. Kopjet e dorëshkrimeve të këtyre protestave qeveria greke ua paraqiste të gjithë përfaqësive të huaja në Athinë.²⁶⁶ Pavarësisht protestave të banorëve të krahinës së Himarës dhe ndërhyrjes së Greqisë në organet ndërkombëtare, qeveria shqiptare në përputhje të plotë me Statutin themeltar arrinte të zbatonte sistemin taksor që ishte në fuqi. Protestat e zhvilluara në krahinën e Himarës nuk kishin të bënin vetëm me heqjen e venomeve, por edhe me reformat në sistemin arsimor që qeveria shqiptare po ndërmerre.

Më konkretisht me numrin e orëve të mësimi që do të zhvilloheshin në gjuhën greke dhe emërimin e mësuesve, të cilët sipas ligjit duhet të ishin nënshtetas shqiptar. Në shkollat e tre fshatrave ku pretendohet që ishte e pranishme pakica kombëtare greke, në

²⁶³ MPJ, dosja 209, Tiranë, 1923, f. 11.

²⁶⁴ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 434.

²⁶⁵ Aleks Luarasi, *Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri*, Vep. e cit., f. 78.

²⁶⁶ MPJ, dosja 209, Tiranë, 1923, f. 10.

vitin 1922, qeveria vendoste pakësimin e orëve në gjuhën greke, nga tre orë në javë që kishte qënë një vit më parë, në një orë. Një pjesë e parisë së Himarës nuk ishin dakord me këtë vendim dhe i propozonin qeverisë disa ndryshime. Ata kërkonin që në tre fshatrat ku flitej shqip dhe greqisht (Dhërmi, Himarë e Palasë), të mësohej në klasat e treta dhe të katërta, gjuha greke nga tre orë në ditë dhe në klasat e para dhe të dyta nga dy orë në ditë.²⁶⁷

Në shkollat e katër fshatrave të tjera të krahinës së Himarës, që flitej vetëm gjuha shqipe, gjuha greke të mësohej vetëm në klasat e katërta, të pesta dhe të gjashta nga dy orë në ditë.²⁶⁸ Këto kërkesa fillimisht do të pranoheshin nga qeveria shqiptare. Edhe pse qeveria shqiptare ishte treguar shumë toleruese, kjo falë dhe presionit të fortë që po bënte Greqia, disa mësues përpiqeshin të pengonin zhvillimin e gjuhës shqipe, sipas programit arsimor të MA. Gjatë vitit 1923, banorët e tre fshatrave kërkonin që në shkollat e tyre të emëroheshin mësues të gjuhës greke, duke shprehur gadishmërinë që të paguanin vetë rrogat e tyre. Ata e arsyetonin këtë kërkesë me pretendimin se gëzonin statusin e minoritetit.²⁶⁹ Por, krahinën e Himarës shteti shqiptar e konsideronte si bilingue dhe si pasojë nuk gëzonte të drejtat e pakicave, të sanksionuara me firmosjen e Deklaratës mbi të drejtat e minoriteteve.

Kjo kërkesë hidhej poshtë edhe për faktin se, MA po ndërmernte disa reforma që kishin si qëllim unifikimin e sistemit arsimor dhe nënshtetësia e mësuesve duhet të ishte shqiptare. Pavarësisht protestave të ngritura nga një pjesë e popullsisë himariote, MA aprovonte futjen në program të gjuhës greke për një orë në ditë, duke filluar nga klasa e

²⁶⁷ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 436.

²⁶⁸ Po aty, f. 436.

²⁶⁹ Po aty, f. 451.

dytë. Këto lëshime sipas popullsisë himariote nuk ishin të mjaftueshme dhe vendosnin të mos lejonin fëmijët që të shkonin në shkollë. Ky veprim binte në kundërshtim me ligjin në fuqi, i cili parashikonte frekuentimin e detyrueshëm për shkollat fillore. Për këtë arsye Këshilli Arsimor merrte vendimin t'i dënonte të gjithë nëpërmjet gjobëvënies. Gjithashtu, Nënprefekti deklaronte se: ndalimi nxënësve për të shkuar në shkollë nga ana e prindërve ishte një veprim që do t'i konsideronte ata si antikombëtare dhe fajtor politik.²⁷⁰

Qëndrimi i Shqipërisë ndaj protestave të popullit të Himarës dënohej nga qeveria greke, e cila pretendonte se reformat e ndërmarra në arsim binin ndesh me sistemin e mbrojtjes së minoriteteve të LK. Sipas shtetit helen, reduktimi i orve të mësimi në gjuhën greke dhe zëvendësimi i mësuesve grekë me ata shqiptarë, ishte një sinjal i qartë se qeveria shqiptare po synonte “shqiptarizimin” e popullsisë greke të Himarës.²⁷¹

Sipas Greqisë, këto përpjekje të qeverisë shqiptare dhunonin të drejtat e fitura nga minoritetet me firmosjen e Deklaratës në vitin 1921, nga përfaqësuesi i qeverisë shqiptare. Por, për shtetin shqiptar krahina e Himarës nuk gëzonte statusin e minoritetit dhe si pasojë, vendimet e marra prej saj nuk përbënin asnjë shkelje të të drejtave të pakicave kombëtare. Për këtë motiv qeveria jepte urdhëra kategorike që mësimi i gjuhës greke të zhillohej lirisht në shkollat minoritare grekofone. Siapas rekomandimeve që parashikonte ligji mbi arsimin, qëndrimi i mbajtur nga shteti shqiptar ndaj popullsisë bilingue të Himarës tregonte edhe një herë faktin që Shqipëria respektonte impenjimet e marra përpara L.K.

²⁷⁰ MPJ, dosja 303, *Mbi shkollat e Himarës*, Tiranë, 1923, f. 6.

²⁷¹ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 608.

5.8. Të dhënat kontraditore mbi popullsinë dhe vështirësia në përcaktimin e pakicave

Komisioni gjatë hetimeve në territorin shqiptar nuk nguronte të theksonte se, shqiptarët ishin ndoshta i vetmi popull autokton në Ballkan. Falë relievit malor, kishte qenë e mundur të ruhej e paprekur raca shqiptare, kostumet dhe gjuha e tyre. Pavarësisht këtyre karakteristikave, kishte qenë gjithmonë e vështirë të krijohet një shtet që të bashkonte të gjithë shqiptarët nën udhëheqjen e një lideri të vetëm. Uniteti i kombit shqiptar, sipas Komisionit arrihej të kuptohej nga zakonet e përbashkëta, traditat e lashta dhe gjuha. Edhe pse kishte dallime ndërmjet toskërishtes dhe gegërishtes, ato nuk ishin gjë tjetër veçse ndryshime të dialektit.²⁷² Gjithashtu, pavarësisht faktit se prania e besimeve fetare të ndryshme kishte prodhuar ndonjë destabilizim të vogël në politikën e brendshme, konfliktet që ndodhnin vazhdimisht në vendet e tjera për shkak të fesë, pothuajse nuk ishin verifikuar asnjëherë në Shqipëri.

Në vend mbizotëronte në ndjenjë e jashtëzakonshme tolerance kundrejt përkrahësve të besimeve të ndryshme, duke i dhënë rëndësi lidhjeve të gjakut. Klerikët e tre besimeve (Katolik, Ortodoks dhe Islamik) shpesh herë shkonin së bashku për celebrimin e shërbimeve të shenjtë. Kjo provonte se ndjenjat e patriotizmit ishin shumë herë më të forta se ato fetare. Pavarësisht vënies në dukje të unitetit të popullsisë shqiptare, Komisioni nuk e mohonte se haste dhe vështirësi në përcaktimin e minoritetit grek.²⁷³ Kjo vështirësi konsistonte në faktin se kishte një mospërputhje nga burimet e të dhënave. Autorë të

²⁷² C 7811, The enquiry in Southern Albania, Report by the Commission of Enquiry, League of Nations, 2 May 1923, f. 12.

²⁷³ Po aty, f. 12.

ndryshëm nuk binin dakord si ta emëronin zonën, “Epir i Veriut” apo Shqipëri e Jugut. Disa autorë përfshinin në këtë zonë, gjithë territorin e përbërë nga Zagoria dhe Lunxhëria me popullsi ortodokse shqipfolse, nga Gjirokastra me krahinën e Kardhiqit, fshatrat e Tepelenës në jug të Vjosës, Kurveleshi dhe Bregdeti.²⁷⁴ Bregdeti si zonë i referohej nënprefekturës së Himarës, që më pas do të kalonte në prefekturën e Vlorës.

Autorë të tjerë, përjashtonin nënprefekturën e Pogradecit, e cila ishte pjesë përbërëse e prefekturës së Korçës. Një burim tjetër të dhënash përjashtonte nga kjo zonë, jo vetëm nënprefekturën e Pogradecit, por dhe pjesën veriore të kazasë së Përmetit dhe Tepelenës, ku pjesa më e madhe e popullsisë ishte myslimane. Vështirësia e përcaktimit të numrit të popullsisë minoritare qëndronte, gjithashtu, në faktin se pala greke, ndoshta e shtyrë nga dëshira për të përfituar toka në dëm të Shqipërisë, shpesh herë ngatërronte fenë me etninë. Ky gabim nga pala greke shpjegohej edhe me faktin se, për grekët feja ortodokse identifikohet me kombësinë greke. Për sa i përkonte përcaktimi të racës së popullsisë së Shqipërisë së Jugut, Komisioni e kishte të vështirë të dilte në një konkluzion.

Kjo pasi historikisht Shqipëria dhe Greqia, kishin qenë pushtuar vazhdimisht për shumë kohë të gjatë nga fuqi të huaja, derisa sa pushtuesit e huaj ishin përzier me popullsinë vendase.²⁷⁵ Por, vështirësitë që haste Komisioni mund të shpjegoheshin nga dy konstatime. I pari kishte të bënte me faktin se, në ato vite studiuesit e kohës mendonin që gjuha dhe raca ishin dy gjëra të njëjta. Konstatimi i dytë kishte të bënte me vetë Komisionin, antarët e të cilit, duke mos qenë njohës të mirë të historisë shekullore

²⁷⁴ Filip Liço, *Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare*, vep. e cit., f. 117.

²⁷⁵ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 373.

shqiptare, nuk merrnin në konsideratë disa nga faktorët që determinonin “racën shqiptare”.

Ky nocion shpjegohej mirë nga Faik Konica, sipas të cilit me fjalët “racë shqiptare” kuptohej:

*“një grup njerëzish, të cilët, meqë kanë jetuar së bashku për qindra vjet me radhë, duke folur të njëjtën gjuhë dhe duke jetuar të veçuar nga të tjerët, duke lidhur martesë ndërmjet tyre, deri në ditët tona kanë luftuar kundër popullatave të huaja pushtuese dhe paraqisnin disa tipare të përbashkëta të pamohueshme, si nga ana fizike e jashtme ashtu dhe nga temperamenti”.*²⁷⁶

Gjithsesi, Komisioni gjatë vizitave të tij në Gjirokastrë dhe Delvinë, vërente se një pjesë e vogël e popullsisë kishte karakteristika të përbashkëta me figurën klasike helenike.²⁷⁷ Ky këndvështrim i Komisionit mbi popullsinë e Gjirokastrës ishte korrekt, pasi në këtë krahinë, sipas statistikave që kishte në dispozicion qeveria jetonin afërsisht 28.000 nënshtetas që i përkisnin kombësisë greke.²⁷⁸ Kurse popullsia shqipfolse në zonat nën hetim kishte tipare racore lehtësisht të dallueshme që ishin karakteristike ilirike. Sipas Komisionit nuk kishte shenja që të tregonin urrejtje racore ndërmjet grekëve dhe shqiptarëve. Do të ishte e çuditshme po të ndodhte ndryshe, meqënëse një pjesë e konsiderueshme e popullsisë greke kishte origjinë shqiptare. Nga hetimet ishte pothuajse e pamundur të ngrije argumente me bazë racore në favor të Greqisë apo të Shqipërisë.

²⁷⁶ Faik Konica, *Shqipëria Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore*, Shtëpia botuese “55”, Tiranë, 2010, f. 60.

²⁷⁷ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 373

²⁷⁸ MPJ, dosja 141, Lozana, 15 qeshor 1923, f. 2.

5.9. Përfaqësimi i popullsisë në politikë dhe punësimi i saj në administratën lokale sipas besimit fetar

Shqipëria kishte një popullsi me një mazhorancë analfabete që ndikohej lehtësisht nga kulturat e jashtme dhe feudalizmi ishte akoma mbizotruar në shumë zona të vendit. Këto karakteristika ishin një pengesë për centralizimin e vendit, i cili duhej të realizohej duke lejuar një farë autonomie administratës lokale. Gjetja e një ekuilibri ndërmjet centralizimit dhe decentralizimit ishte një nga problemet më të rëndësishme për qeverinë shqiptare.²⁷⁹

Aq më shumë, kur disa elemente të popullsisë ndiqnin interesat e tyre duke shfrytëzuar diversitetin fetar që ekzistonte në vend. Ky diversitet do të ndikohej shumë nga ngjarjet që do të ndodhnin në Turqi, ku shumë oficerë myslimanë shqiptarë ishin formuar dhe kishin kryer shërbimin ushtarak. Ata ishin arsimuar në gjuhën turke dhe lexonin në gazetatat arritjet e turqve modernë në realizimin e një shteti të unifikuar islamik.²⁸⁰ Ky fakt i shtynte që të besonin që feja myslimane pajtohej me nacionalizmin modern. Rezultati kryesor e kësaj ringjalljeje të myslimanizmit do të ishte formimi i shtetit kombëtar me karakter fetar.

Nga ana tjetër, shtetet fqinje ballkanike po punonin me intesitet që ta paraqisnin Shqipërinë në arenën ndërkombëtare si një nga shtetet me prirje të theksuara islamike, ku të krishterët përbënin një minoritet. Ata e etiketonin me përbuzje si shtet muhamedan, i cili po mudohej t'i mohonte të drejtat pakicave të krishtere dhe si pasojë nuk gëzonte të drejta të

²⁷⁹Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 376.

²⁸⁰C 7812, *Final report of the Commission of Enquiry*, League of Nations, Geneve, 2 May 1923, f. 4.

ishte pjesë e familjes Evropiano-kristiane. Në këtë mënyrë, shteti i ri shqiptar rrezikonte të humbiste mbështetjen ndërkombëtare që me shumë mund e kishte fituar me anëtarimin në LK. Për të evituar izolimin ndërkombëtar, përpjekjet e qeverisë shqiptare përqëndroheshin në shkëputjen e ndjenjave me ngjyrë fetare nga dhomat e pushtetit politik, siç ishin administrata publike qendrore dhe parlamenti. Në administratën qendrore ishin të punësuar 98 nënpunës myslimanë dhe 65 të krishterë.²⁸¹

Këto të dhëna tregojnë qartë se shteti shqiptar nuk merrte parasysh përkatësinë fetare në punësimin e personelit në administratën qendrore. Laiciteti i shtetit shqiptar vihej re edhe në formimin e pushtetit ligjvënës, ku partitë politike mundoheshin që deputetët e përzgjedhur të përfaqësonin realisht popullsinë sipas përkatësisë fetare. Kjo tendencë vihej re në zgjedhjet e përgjithëshme parlamentare të mbajtura në 1920.²⁸² Në tabelën e mëposhtme jepet numri i deputetëve të ndarë sipas përkatësisë fetare të llogaritur në bazë të popullsisë të ndarë, edhe kjo sipas përkatësisë fetare, në prefekturat e Shqipërisë në vitin 1920.

²⁸¹ MPJ, dosja 102, Tiranë 1922, f. 131.

²⁸² Po aty, f. 128.

Numri i deputetve të ndarë sipas përkatësisë fetare të llogaritur me popullsinë e çdo prefekturë në vitin 1920

	Popullsi myslimane	Nr. deputet mysliman	Popullsi ortodokse	Nr. deputet ortodokse	Popullsi katolike	Nr. deputet katolik
Prefektura e Korçës	80.000	5	40.000	5	-	-
Prefektura e Gjirokastrës	57.000	5	68.000	6	-	-
Prefektura e Beratit	69.000	6	27.000	3	-	-
Prefektura e Vlorës	38.000	3	7.000	1	-	-
Prefektura e Elbasanit	90.000	6	6.000	2	-	-
Prefektura e Durrësit	75.000	6	7.000	1	-	-
Prefektura e Shkodrës	53.000	4	-	-	79.000	8
Prefektura e Dibrës	112.000	8	0	2	-	-
Shuma	570.000	43	155.000	20	79.000	8

Tabela nr.1²⁸³

Siç shihet nga të dhënat e tabelës, ajo që të binte në sy ishte fakti se në prefekturën Korçës, pavarësisht se, popullsia myslimane ishte dy herë më e madhe në numër se ajo ortodokse, të dyja grupet e popullsisë kishin nga pesë deputetë që do t'i përfaqsonin në Parlamentin shqiptar. Rast i veçantë ishte ai i prefekturës së Dibrës, ku popullsia që i

²⁸³ MPJ, dosja 102, Tiranë, 1922, f. 128.

përkiste besimit fetar ortodoks ose katolik mungonte, ajo ishte tërësisht myslimane. Në këtë prefekturë, ku sipas legjislacionit i takonte të kishte në total dhjetë deputetë në pushtetin ligjvënës, dy prej tyre i përkisnin besimit fetar ortodoks. Të dhënat mbi përfaqësimin e popullsisë në Parlament sipas përkatësisë fetare hidhnin poshtë pretendimet dhe akuzat e ngritura, veçanërisht nga Mbretëria serbo-kroate-slllovene dhe Greqia, se shteti shqiptar nuk ishte gjë tjetër veçse një shtet mysliman ku pakicave të krishtera u mohoheshin të drejtat e tyre. Nëqoftëse analizohej nga ana statistikore ndarja e përgjithshme e popullsisë shqiptare sipas përkatësisë fetare, vihej në dukje disa të dhëna. Përsa i përkiste popullsisë myslimane, e cila nga ana numerike përbënte 71% të gjithë popullsisë shqiptare, ajo përfaqësohej nga 60% e parlamentarëve. Popullsia ortodokse, e cila përbënte 20% të popullsisë në vend, përfaqësohej nga 28% e deputetëve. Pra, nga të dhënat statistikore popullsia ortodokse kishte një përfaqësim më të madh në parlament në krahasim me përqindjen që zinte në popullsinë e përgjithshme. Popullsia katolike përfaqësohej në mënyrë pothuajse lineare në parlament, pasi në shkallë kombëtare ajo përbënte 10% të popullsisë dhe deputetë që i përkisnin besimit katolik zinin 11% të vendeve në dhomën e ligjvënësit. Lidhur me përfaqësimin e elementit të krishter dhe minoritar në administratën publike lokale, në Shqipërinë e Jugut, Komisioni hetimor shprehte disa dyshime,²⁸⁴ të cilat Ministria e Punëve të Brendshme i hidhte poshtë duke deklaruar se ishin të pasakta.

Sipas kësaj ministrie, në prefekturat e Korçës dhe Gjirokastrës, pa marrë parasysh përkatësinë fetare, ishin emëruar nëpunës të krishterë, të cilët përbënin shumicën.²⁸⁵ Gjithashtu, edhe në Himarë nëpunësit e administratës lokale ishin të krishterë dhe për më

²⁸⁴ Luan Omari, *Çështja e pakicave kombëtare*, vep. e cit., f. 48.

²⁸⁵ MPJ, dosja 209, *Mbi çështjen e Himarës*, Tiranë, 1923, f. 11.

shumë, kishin pëlqimin e popullsisë vendase. MPB u përgjigjej edhe ankimeve të ngritura nga Z. Sederholmit, i cili shfaqte pakënaqësinë e tij rreth faktit, se në provincat e Korçës dhe Gjirokastrës, nëpunësit e administratës nuk ishin zgjedhur nga populli. Në përgjigjen e Ministrisë nënvizohej fakti se: as në Finlandë nëpunësit lokalë nuk zgjidheshin drejtpërdrejt nga populli, por emëroheshin nga qeveria.²⁸⁶ Për më shumë, ligji i administratës civile të shtetit shqiptar nuk e parashikonte diçka të tillë. Ky ligj fillimisht ndalej në paraqitjen e ndarjes së Shqipërisë në njësi administrative dhe sipas nenit 1, vendi ndahej në prefektura e nënprefektura dhe këto të fundit në krahina. Përsa i përkiste nëpunësve të administratës, ligji parashikonte në kreun III të titulluar: “Mënyra e emërimit dhe e zgjedhjes të nënpunësve”, zgjedhjen e nëpunësve me anë të emërimit. Më konkretisht neni 7, parashikonte se nëpunësit emëroheshin nga ana e ministrave që ishin të lidhur, këto të fundit ishin të detyruara të merrnin më parë dhe mendimin konsultativ të prefekturave. Kurse, MPB emëronte vetëm nëpunësit që ishin të lidhur me të.²⁸⁷

Ligji i administratës civile, tregonte karakterin unitar të shtetit shqiptar, i cili duke parë dhe rreziqet që i kanoseshin, jo vetëm brenda por dhe përtej kufijve, nuk mund të lejonte zgjedhjen e drejtpërdrejtë të nëpunësit të administratës lokale nga ana e popullit. Në realitet, antarët e Komisionit në një farë mënyre kishin të drejtë, pasi në zonat e pastra minoritare dyert e administratës shtetërore ishin të mbyllura. Personeli i komunave të këtyre zonave ishin shqiptar.²⁸⁸ Shtetasit që i përkisnin minoriteteve mund të ushtronin vetëm profesione të lira, si mjek, avokat dhe tregtar. Pavarësisht këtyre limiteve, shtetasit

²⁸⁶ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 360.

²⁸⁷ Kristo P. Luarasi, *Ligji i administratës civile të Shtetit Shqiptar*, Shtypshkronja “Mbrothësija”, Tiranë, 1922.

²⁸⁸ Filip Liço, *Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare*, vep. e cit., f. 317.

që i përkisnin minoriteteve nuk ishin të diskriminuar përpara ligjit, ata gëzonin të drejta të barabarta si gjithë shtetasit e tjerë.

5.10. Rekomandimet e Komisionit Ndërkombëtar mbi çështjen e minoriteteve

Më 12 maj 1922, Komisioni Hetimor paraqiste përpara Këshillit të LK raportin e tij final mbi hetimet në Shqipëri. Ky raport vinte në dukje se objektivi i parë, që kishte të bënte me tërheqjen e trupave të Mbretërisë serbo-kroate-slllovene nga zona neutrale vendosur nga të dy vendet, ishte kryer me sukses. Objektivi i dytë parashikonte që, Komisioni duhej të ekzaminonte dhe paraqiste përpara Këshillit, masa që të parandalonin shqetësimet e ndryshme që i paraqiteshin shtetit të brishtë shqiptar. Komisioni parashtronte disa rekomandime përpara LK, të cilat kishin të bënin me mbështetjen që duhej t'i ofrohej Shqipërisë për konsolidimin e brendshëm të saj. Mbështetja do të ofrohej kryesisht në fushën e ekonomisë dhe në përmirësimin e miradministrit të vendit. Sigurisht, për të verifikuar realizimin e këtyre objektivave, bashkë me qeverinë shqiptare, Komisioni kishte planifikuar që të rikthehej në Shqipëri.²⁸⁹ Rekomandimet do të mbështeteshin nga qeveria shqiptare, e cila shumë herë kishte nënvizuar suksesin e arritur nga Komisioni në eliminimin e përkohëshëm të rreziqeve që kërcënonin paqen e vendit. Komisioni ishte i bindur se një Shqipëri e lirë dhe e pavarur ishte një kusht themeltar për garantimin e një paqeje afatgjatë në rajonin e Ballkanit. Raporti tregonte gjithashtu, se Shqipëria zotëronte të gjitha elementet moralë dhe materialë, të cilat ishin bazat për krijimin e një shteti të pavarur. Aty nënvizohej me bindje të plotë ekzistenca e një kombi shqiptar, i cili shpesh

²⁸⁹ C7812, 2 May 1923, Final report of the Commission of Enquiry, League of Nations, f. 44.

herë ishte vënë në dyshim nga aktorët ndërkombëtarë.²⁹⁰ Megjithatë, në raport specifikohet se vendi nuk e kishte arritur akoma një qëndrueshmëri politike dhe zhvillim ekonomik të mjaftueshëm për t'i bërë ballë, si trazirave të brendshme dhe ndërhyrjeve të shteteve të huaja.²⁹¹ Për këtë arsye kishte nevojë për këshilla dhe mbështetje ekonomike nga ndërkombëtarët. LK e cila gëzonte një prestigj të padiskutueshëm në Shqipëri, ishte organi ndërkombëtar që duhej më mirë i strukturuar për të ofruar këtë mbështetje. Duke njohur më nga afër situatën në Shqipëri, Komisioni paraqiste përpara Këshillit rekomandimet që vijojnë më poshtë:

1. Kërkesës së qeverisë shqiptare, që kishte të bënte me mbështetjet për çështjet ekonomike, duhej t'i jepej një përgjigje pozitive nga LK. Gjithashtu, qeveria në bashkëpunim me ekspertë ndërkombëtarë, duhej të promovonte reforma që kishin si qëllim miradministrimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit.
2. Për të vëzhguar ecurinë e këtyre reformave, një nga pjestarët e Komisionit Hetimor duhej të kthehej në Shqipëri, që të ndiqte ngjarjet në vend dhe të konsultohet me qeverinë për zgjidhjen e tyre.

Në qoftë se Shqipërisë do t'i garantohej asistencë që kërkonte, ajo do të ishte në gjendje të stabilizohej dhe të bëhej faktor i përhershëm i paqes në Ballkan.²⁹² Pavarësisht arritjeve të kënaqshme të reformave që kishte ndërmarrë qeveria shqiptare, Komisioni vinte në dukje disa mangësi që duheshin plotësuar. Këto mangësi kishin të bënin me faktin që, populli dhe

²⁹⁰ MPJ, dosja 211, 1923, f. 216.

²⁹¹ C 7811, *The enquiry in Southern Albania, Report by the Commission of Enquiry*, League of Nations, 2 May 1923, f. 9.

²⁹² C 6071/735/90, General report on Albania presented by the Commission of Enquiry to the Council of the League of Nations, April 24, 1922, f. 8.

qeveria duhej të promovonin politika që kishin si qëllim: rritjen e solidaritetit ndërmjet grupeve të ndryshme etnike të popullsisë, zhvillimin ekonomik të vendit, inkurajimin e modernizimit të legjislacionit dhe promovimin e zhvillimit kultural.²⁹³ Edhe pse ekzistonin probleme të ndryshme ndërmjet pakicave dhe popullsisë vendase, në rekomandim konstatohet se qeveria shqiptare i trajtonte këto të fundit në mënyrë të kënaqshme.

Këtë e tregonte edhe fakti që pakicave nuk u ishin cënuar pasuritë dhe shkollat e hapura në zonat ku ato jetonin, ishin të njëjtat në numër sa dhe shkollat në viset e tjera të Shqipërisë. Ndërsa mungesën në rritjen e mëtejshme të numrit të shkollave të minoriteteve, Komisioni e lidhte me gjendjen ekonomike, e cila kishte patur të njëjtin impakt edhe për shkollat në gjuhën shqipe. Një hap i rëndësishëm për Shqipërinë ishte bashkëpunimi i mazhorancës myslimane me minorancën e krishterë, edhe pse këto dy grupe popullsie ishin pothuajse të barabarta në numër në Shqipërinë e Jugut. Ky bashkim, ose bashkëpunim, ishte absolutisht i rëndësishëm në procesin e modernizimit të shtetit. Megjithatë, siç e nënvizonte dhe vet Komisioni, në Shqipëri kishte nevojë të bëheshin një sërë refomash, të cilat do të jepnin mundësinë që besimtarët e besimeve fetare të ndryshme të jetonte në harmoni ndërmjet tyre.²⁹⁴ Sipas Komisionit, reforma agrare me të cilën po përballej qeveria kishte një rëndësi themeltare për zhvillimin e Shqipërisë. Kjo reformë nuk ishte shumë e vështirë për t'u realizuar, pasi pjesa më e madhe e çifligjeve ishin të vogla me sipërfaqe dhe një numër i konsiderueshëm fshatarësh zotëronin prona të tyre.²⁹⁵ Për më shumë, fakti që çmimi i tokës nuk ishte shumë i lartë jepte mundësi që gjithëkush do mund ta blinte dhe të

²⁹³ C 7812, *Final report of the Commission of Enquiry*, League of Nations, Geneve, 2 May 1923, f. 2.

²⁹⁴ Po aty, f. 3

²⁹⁵ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 369.

bëhej pronar. Gjithashtu, qeveria zotëronte dhe disa çifligje, të cilët në të kaluarën i përkisnin Perandorisë Osmane dhe mund t'i përdorte ato për të plotësuar kërkesat për tokë nga ana e fshatarëve.²⁹⁶ Lidhur me funksionimin e drejtësisë, Komisioni gjykonte se shteti i së drejtës, ishte pak a shumë në të njëjtin nivel me shtetet e tjera ballkanike. Ky vlerësim konfirmohej edhe nga popullsia minoritare gjatë hetimeve që Komisioni kishte bërë në zonat që kishte vizituar. Problem për popullsinë minoritare ishin masat shtrënguese që kishte marrë qeveria për lëvizjen e personave, të cilat binin ndesh me “Deklaratën mbi minoritetet” të firmosur nga shteti shqiptar. Një aspekt tjetër negativ i vënë në dukje nga Komisioni ishte edhe mosbesimi i popullsisë së krishterë kundrejt asaj myslimane. Kjo ndjenjë mosbesimi, gjithësesi, nuk kishte të bënte më fenë myslimane në vetëvete por me mënyrën se si kishte qeverisur administrata osmane gjatë pushtimit disa shekullor.

Ishte e vërtet se ndryshimet fetare kishin ndikuar disa herë negativisht në politikën e brendshme të vendit, por respekti dhe dashamirësia për fenë e njëri-tjetrit ishin të pamohueshme. Kjo shpjegohej me faktin se shqiptarët ishin të bashkuar nga lidhjet e gjakut, nga tradita dhe nga festat kombëtare e fetare të përbashkëta.²⁹⁷ Këtë tolerancë ndërmjet besimeve fetare e theksonte edhe Komisioni, i cili për më shumë shprehte bindjen e tij se feja islame në Shqipëri karakterizohej nga një fanatizëm jo radikal, që nuk ndihej i kërcënuar nga besimet të tjera.²⁹⁸ Në shumë raste vrehej një përpjekje e harmonizuar ndërmjet myslimanve dhe të krishterëve që të harronin kontraditat ndërmjet tyre, me qëllim zhvillimin e kulturës pak të emancipuar shqiptare. Kjo harmoni fetare mund të arrihej

²⁹⁶ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 369.

²⁹⁷ Tajar Zavalani, *Histori e Shqipërisë*, “PHOENIX”, Londër, 1998, f. 265.

²⁹⁸ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 370.

vetëm duke bashkuar Shqipërinë në një shtet unitar laik me administratë të fortë, e cila do të luftonte çdo përpjekje që shkonte kundër këtij qëllimi. Ky bashkim i periferisë me qendrën mund të arrihej duke krijuar një rrjet të mirë komunikimi. Gjatë kohës kur Komisioni vizitonte Shqipërinë, nuk kishte rrugë të mira që të lidhte Tiranën me Durrësin dhe Vlorën. Përsa i perkiste komunikimit, ndërmjet Korçës dhe Shqipërisë së Mesme, ai ishte pothuajse inekzistent, edhe ishte e pamundur transporti i mallrave të rënda.²⁹⁹ Ndërtimi i rrjetit rrugor ishte i vështirë për t'u realizuar pasi, pavarësisht faktit që Shqipëria nuk kishte borxhe të jashtme, burimet financiare ishin të limituara dha pa ndihmën e kapitaleve të huaja ishte e pamundur të rritej zhvillimi ekonomik i vendit.³⁰⁰

Qeveria shqiptare e priste me interes të madh raportin përfundimtar që Komisioni Hetimor kishte paraqitur pranë Sekretarisë së LK. Interesi i qeverisë ishte i kuptueshëm, pasi shteti i ri shqiptar për të siguruar ekzistencën e tij politike kishte nevojë të fitonte besimin e shteteve të mëdha dhe të LK. Vetëm duke fituar këtë besim mund t'u bëhej ballë intrigave të shteteve fqinje dhe diversitetit etnik e fetar që ekzistonte në vend. Besimi mund të fitohej vetëm me një administratë të lirë nga paragjykimet racore e fetare dhe duke u garantuar të drejta të barabarta të gjithë nënshtetasve që jetonin në territorin shqiptar.³⁰¹ Këto të drejta duhet të garantoheshin në përputhje me zotimet që qeveria shqiptare kishte marrë përpara Organizatës së LK.

²⁹⁹ C 706, M 417, *The economic and financial situation of Albania*, League of Nations, 20 October 1922, f. 8.

³⁰⁰ C 7570/735/90, *Supplementary Report of the Commission of Enquiry in Albania submitted to the Council*, May 12, 1922.

³⁰¹ MPJ, dosja 211, korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Tiranë, 1923, f. 226.

KAPITULLI VI: REFORMA ARSIMORE DHE BESIMET FETARE NË SHQIPËRI

6.1. Gjendja e arsimit në Shqipëri

Nënshkrimi i “Deklaratës mbi mbrojtjen e minoriteteve në Shqipëri” përcaktonte qartë se minoritet kishin të drejtë të ndërtonin dhe të mbanin shkolla në gjuhën e vet. Në Shqipëri gjatë vitit 1921, ekzistonin, përveç shkollave që drejtoheshin nga Ministria e Arsimit edhe shumë shkolla private fetare në të cilat procesi mësimor zhvillohej, përgjithësisht, në gjuhën e huaj. Në këto shkolla, që gjendeshin gjithandej në territorin shqiptar, mbizotëronte plotësisht edukimi fetar dhe jo ai laiko-qytetar. Ky aspekt ishte më i theksuar sidomos për shkollat që mbante kleri katolik, i cili kishte ndikim të fuqishëm në jetën shoqërore.³⁰² Të tilla mund të përmendim: Liceu shqiptaro-francez në Korçë dhe Shkolla Normale në Elbasan.³⁰³ Kurse shkollat publike shqiptare që drejtoheshin nga MA, mund të klasifikoheshin si në tabelën që vjon:

Numri i përgjithëshëm i shkollave në Shqipëri gjatë vitit 1921.

Shkolla fillore të larta me shtatë klasë	9
Shkolla fillore të larta me pesë klasë	29
Shkolla fillore të larta me tre klasë	22
Shkolla fillore të larta me dy klasë	472

Tabela nr.2³⁰⁴

³⁰² Dritan Spahiu, *Monarkia Shqiptare (1928 – 1939), Reforma arsimore e realizuar në periudhën e Mbretërisë Shqiptare*, Botimet Toena, Tiranë, 2011, f. 307.

³⁰³ C 706, M 417, *The economic and financial situation of Albania, League of Nations*, 20 Octobre 1922, f. 7.

³⁰⁴ Justin Godart, *Shqipëria në 1921*, vep. e cit., f. 154.

Tabela tregon qartë se niveli i sitemit arsimor në vend nuk ishte shumë i zhvilluar, kjo për shkak të ndalimit për shumë kohë që fuqitë e huaja pushtuese i kishin bërë hapjes së shkollave në gjuhën shqipe. Niveli i dobët i cilësisë së mësimit bënte që këto shkolla shërbenin më shumë si kurse kundër analfabetizmit dhe jo si vatra të mirëfillta edukimi, për të dhënë dije dhe kulturë.³⁰⁵

Por, pavarësisht këtyre vështirësive, dëshira për të mësuar në gjuhën amtare ishte shumë e madhe. Këtë e tregonte fakti që edhe pse në Shqipëri fillimisht shkolla nuk ishte e detyrueshme, klasat ishin plot me nxënës, sa që shpesh herë nuk kishte vend për t'u ulur. Tejmbushja e klasave vinte si pasojë e mungesave të strukurave dhe godinave, të cilat shpesh herë ishin të improvizuara. Në shumë krahina të Shqipërisë mungonin tekstet shkollore të shtypura në gjuhën shqipe dhe shkrimi mësohej në tabela murale, të bëra nga italianët.³⁰⁶ Për të ulur analfabetizmin, MA ndërmerre disa reforma në sistemin shkollos, të cilat kishin të bënin me unifikimin e programeve mësimore dhe të teksteve shkollore. Ishte e domosdoshme që programet mësimore të ishin unike për të gjitha shkollat e të njëjtit nivel dhe të kishin si qëllim forcimin e frymës kombëtare të vendit.³⁰⁷

Për kalimin e këtyre vështirësive, gjatë periudhës që shkonte nga 1920 deri në 1924 do të zhvilloheshin tre kongrese arsimore: në 1920 në Lushnjë, në 1922 në Tiranë dhe në 1924 përsëri në Tiranë. Në këto kongrese merreshin disa vendime të rëndësishme që kishin të bënin me:

³⁰⁵Dritan Spahiu, *Monarkia Shqiptare (1928 – 1939), Reforma arsimore e realizuar në periudhën e Mbretërisë Shqiptare* vep. e cit., f. 305.

³⁰⁶ Justin Godart, *Shqipëria në 1921*, vep. e cit., f. 154.

³⁰⁷Dritan Spahiu, *Monarkia Shqiptare (1928 – 1939), Reforma arsimore e realizuar në periudhën e Mbretërisë Shqiptare* vep. e cit., f. 306.

1. Krijimin e shkollave të njehësura kombëtare laike:
2. Zbatimin e arsimit fillor të detyruar edhe për vajza
3. Dërgimin jashtë shtetit të studentëve për mjekë, inxhinierë, agronomë, juristë, administratorë etj., që të punonin me kulturë për të ardhmen e kombit.³⁰⁸

Shumë të suksesshme ishin kurset e mbrëmjeve për të rritur të hapura në Tiranë dhe Vlorë. Klasat e para të këtyre qyteteve mblidhin shumë nxënës dhe një pjesë e mirë e tyre ishin mbi dyzet vjeç. Në ndihmë të sistemit arsimor vinin edhe shkollat private, të cilat kryesisht financoheshin nga komunitetet fetare. E tillë ishte shkolla e mbipopulluar e Jezuitve dhe e Françeskanëve në Shkodër. Në këtë qytet rreth 1500 nxënës të moshave të ndryshme ndiqnin rregullisht shkollat private.³⁰⁹

Por, shkollat fetare shteti shqiptar kërkonte t'i kufizonte sa më shumë ato dhe të vinte në funksion shkolla të reja laike, të lira nga sundimi i frymës fetare. Në Berat, shteti shqiptar do të hapte shkollën e mësuesve nga ku do të dilnin mësuesit e së ardhmes.³¹⁰ Si përfundim, MA vendoste të jepte bursat e para të studimit për vitin shkollor 1920-1921. Këto bursa i jepnin mundësi nxënësve më të mirë për të ndjekur studimet në shtetet evropiane perëndimore, siç ishin: Italia, Austria dhe Franca. Të gjitha këto përpjekje tregonin dëshirën e madhe të qeverisë dhe të popullit shqiptar për mësimin e gjuhës shqipe.

³⁰⁸ Asqeri Llanaj, *Kur historia flet vetë, (Vështrim krahasues i disa periudhave historike)*, vep. e cit., f. 57.

³⁰⁹ Justin Godart, *Shqipëria në 1921*, vep. e cit., f. 155.

³¹⁰ C 706, M 417, *The economic and financial situation of Albania*, League of Nations, 20 Octobre 1922, f. 7.

6.2. Unifikimi i sistemit arsimor dhe shtetëzimi i shkollave

Në fillim të viteve '20 sistemi shkollor në Shqipëri ishte i prapambetuar aq sa akoma nuk ishte vendosur për gjuhën letrare që duhej të përdorej në shkollat e gjithë vendit. MA po përpiqej të botonte sa më shpejt tekste të reja shkollore në gjuhën shqipe, të cilat do të ishin gati në vitin 1922. Në këto tekste, qeveria mendonte që të përdorte si gjuhë zyrtare dialektin e Elbasanit, i cili ishte i ndërmjetëshëm midis toskërishtes dhe gegërishtes. Përdorimi i gjuhës letrare nëpër shkollat e gjithë territorit shqiptar ishte një ndër arritjet më të mëdha që shteti kishte ndërmarrë në modernizimin dhe unifikimin e sistemit shkollor. Pavarësisht përpjekjeve të mëdha sistemi arsimor mbetej akoma problematik dhe zhvillimi i tij në zona të ndryshme të vendit nuk ishte i njëjtë. Në shumë raste mësimi zhvillohej gojarisht dhe nxënësit duhej ta shkuanin mësimin pasi mësuesi ua diktonte në dërrasë. Këto vështirësi në mësimdhënie, pavarësisht inteligjencës së fëmijve dhe entuziazmit të mësuesve, me kalimin e kohës do të bëheshin pengesë në zhvillimin e sistemit arsimor. Ndryshe qëndronte puna me zhvillimin e arsimit të mesëm në Shqipëri, organizimi i të cilit bëhej shumë i vështirë pasi kishte një mungesë të theksuar të teksteve dhe gjuha shqipe nuk ishte shumë e emancipuar. Gramatika dhe sintaksa nuk ishin shumë të zhvilluara dhe mungonte fjalori i gjuhës shqipe. Mungesa dhe përvetësimi i letërsisë shqiptare, kishte bërë që shumë nga fjalët më të zakonshme kulturore që përdorehin në gjuhën e përditshme të korespondonin me tuqishten dhe greqishten.

Një zhvillim të theksuar sistemi arsimor do të arrinte me shpalljen e Shqipërisë Mbretëri Parlamentare dhe të Trashgueshme. Qeveria e Mbretit Zog ishte e bindur se Shqipërisë i duhej një sistem shkollor i njësuar dhe laik, ku vetëm shteti do të kishte të

drejtën e plotë të kontrollit për cilësinë e shkollimit dhe të edukimit, pa e ndarë këtë detyrë me askënd tjetër, qoftë ky person privat apo organizëm i huaj.³¹¹ Mbretëria ishte e vendosur që të krijonte një arsim publik, i cili do të lehtësonte bashkimin moral e politik të shqiptarëve. Pra synimi i monarkisë ishte që nëpërmjet reformës shkollore të forcohej ndërgjegjja kombëtare shqiptare dhe karakteri kombëtar unik i shtetit shqiptar.³¹²

Për të arritur këtë qëllim, shteti shqiptar synonte të merrte disa masa të cilat parashikonin që arsimi fillor të bëhej i detyrueshëm dhe të ishte falas. Këto masa sanksionoheshin në Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare. Art. 206 parashikonte që: arsimi fillor për të gjithë shtetasit shqiptar është i detyrueshëm dhe në shkollat e shtetit të jepet falas. Këto masa kishin si qëllim uljen e analfabetizmit të popullit shqiptar dhe njëkohësisht, duke patur parasysh dhe varfërinë që mbizotëronte në vend, parashikohej që mësimi në shkollat fillore të jepej falas. Një masë tjetër e rëndësishme e ndërmarrë nga qeveria ishte shtetëzimi dhe kontrolli i arsimit nga shteti shqiptar. Ky kontroll i qeverisë shtrihej edhe mbi hapjen e shkollave të ndryshme private. Të drejtat e minoriteteve pasqyroheshin në Art. 207 të Statutit, i cili parashikonte që: në konformitet me ligjet dhe brenda në principet e programet të pranuar prej shtetit për shkollat e veta dhe kurdoherë nën kontrollin efektiv të qeverisë, vetëm shtetasit shqiptar mund të hapin shkolla të ndryshme private. Të huajt, në konformitet me ligjet, mund të lejohen vetëm për shkolla teknike e bujqësie me programe teorike-praktike. Gjithashtu, mund të hapen dhe prej komuniteteve fetare shqiptare shkolla fetare me lejen e ministrisë kompetente e në

³¹¹Dritan Spahiu, *Monarkia Shqiptare (1928 – 1939), Reforma arsimore e realizuar në periudhën e Mbretërisë Shqiptare*, vep. e cit., f. 308.

³¹²Po aty, f. 53.

konformitet me ligjet; numri i nevojshëm i shkollave fetare të çdo komuniteti, ashtu dhe numri i nxënësve të këtyre shkollave do të caktohet prej Ministrisë kompetente me vendimin e Këshillit të Ministrave.³¹³ Art.207 i Statutit Themeltar të Mbretërisë binte në kundërshtim me art. 5 të Deklaratës mbi minoritetet, firmosur nga Shqipëria si kusht për pranimin në LK. Paragrafi i parë i art. 207 theksonte se vetëm shtetasve shqiptarë u jepej mundësia të hapnin shkolla të ndryshme private, ndërkohë që, art. 5 u njihte të drejtën nënshtetasve shqiptarë që bënin pjesë në minoritete të racës, fesë a të gjuhës, të kishin të drejtë që të mbanin, të drejtonin e të kontrollonin, me të ardhurat e tyre, apo të krijonin në kohën e ardhme, shkolla mirëbërëse, fetare a shoqërore, shkolla e të tjera ndërtesa mirërritjeje, duke patur të drejtën të përdornin lirisht gjuhën e vet e duke vepruar lirisht në fenë e tyre. Art. 207 në paragrafin e dytë, e kufizonte të drejtën e të huajve përsa i përkiste hapjes së shkollave. Ai theksonte së të huajve u lejohej vetëm të kishin shkolla teknike e bujqësie me programe teori-praktike. Gjithashtu, në paragrafin e tretë, edhe komuniteteve fetare u limitohej e drejta për të hapur shkolla dhe drejtuar ato. Qeveria nëpërmjet ministrisë përkatëse, kishte të drejtë të përcaktonte jo vetëm numrin e shkollave që i nevojiteshin komuniteteve fetare por dhe numrin e nxënësve që do të kishte çdo shkollë. Ky qëndrim i shtetit shqiptar mbi arsimin pasqyrohej edhe në “Ligjin Organik të Arsimit”, aprovuar nga Parlamenti i Shqipërisë më 1928. Ligji përveçse konfirmonte arsimin fillor të detyruar, parashikonte sipas Art. 8 që: programet, oraret e mësimave si dhe hollësitat mbi zhvillimin e çdo lënde caktohet me një rregullore të veçantë nga Ministria e Arsimit.³¹⁴ Detyrat e MA përcaktoheshin më konkretisht në Art. 90, cili theksonte se drejtimi,

³¹³ Aleks Luarasi, *Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri*. Vep. e cit., f. 132.

³¹⁴ *Ligjet e Arsimit, Mbretëria Shqiptare*, Ministria e Arsimit, “Telegraf”, Tiranë, 1928, f. 2.

rregullimi e kontrollimi i arsimit botor i ngarkohej Ministrisë së Arsimit. Gjithashtu, sipas Art. 91, Ministri i Arsimit ishte autoriteti më i lartë i arsimit botor, ai ishte përgjegjës për të gjitha veprimet teknike, administrative dhe financiare. Ligji Organik i Arsimit konfirmonte rolin qendror që i jepej shtetit, i cili nëpërmjet MA-së, kontrollonte programet e mësimdhënies që aplikoheshin në shkollat e territorit shqiptar. Ky akt ligjor nënkuptonte se edhe shkollat e minoriteteve duhet të përdornin një program mësimor të aprovuar fillimisht nga MA. Pavarësisht mbylljes së shkollave private dhe kontrollit të programit mësimor nga ana e shtetit, “Ligji Organik i Arsimit” sipas Art. 10 pika a) lejonte që kush dëshironte mund të merrte mësim në shtëpi të vet.³¹⁵ Pajisja e këtyre nxënësve me libra e mjete të tjera shkollore (Art.11) ishte detyrë e prindërve ose kujdestarëve. Në vijim, Art.13 parashikonte që këta të fundit ishin të detyruar të lajmëronin Kryetarin e Komisionit shkollos të vendit dy javë para çeljes së vitit shkollos se me ç’mënyrë do t’u japnin mësimet e detyrueshme fëmijve të vet.³¹⁶ Parashikimi nga ana e ligjit e mundësisë së mësimdhënies në ambientet shtëpiake (ose mësimdhënie private), ishte ndoshta një lëshim që mbretëria shqiptare i bënte asaj pjese të popullsisë minoritare, e cila refuzonte që fëmijët e vet të frekuentonin shkollat ku programi mësimor të përcaktohej nga MA.

Më 1929 do të botohej ligji i komuniteteve fetare, në bazë të të cilit ndahej arsimit civil nga ai fetar. Ky ligj ndalonte klerët e besimeve të ndryshme të drejtën për arsimin e civilëve por, u jepte liri të plotë për sa i përkiste arsimit fetar të ulët e të lartë.³¹⁷ Art. 23 parashikonte që, Komunitetet për edukimin e klerit të tyre, në bazë të ligjeve të Shtetit, të

³¹⁵ *Ligjet e Arsimit, Mbretëria Shqiptare*, Ministria e Arsimit, “Telegraf”, Tiranë, 1928, f. 3.

³¹⁶ Po aty, f. 4.

³¹⁷ Dhimitër Berati, *Shënime historike mbi marrëdhëniet e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve*, vep. e cit., f. 78.

Statutit e të rregullores përkatëse mund të çelin shkolla fetare (seminare-medrese).³¹⁸ Ligji i komuniteteve kundërshtohet nga disa segmente të shoqërisë, të cilët kishin mbështetje nga jashtë Shqipërisë, sepse sipas tyre ai cënonte lirinë e arsimit të siguruar nga Statuti i vitit 1928, për të gjithë shtetasit dhe të huajt. Në të vërtetë, ky ligj kishte si qëllim parësor forcimin e ndjenjës kombëtare dhe jo ndalimin e mësimdhënies në shkollat fetare apo në shkollat e komuniteteve minoritare. Por, këto dispozita ligjore nuk arrinin efektin e dëshiruar, pasi shkollat e krijuar për arsimin civil, të ndara nga ato të që ishin krijuar për besimet e ndryshme që ekzistonin në Shqipëri, nuk arrinin të prodhonin një ndjenjë që të kishte si qëllim bashkimin moral të kombit. Këtë bashkim qeveria mendohej ta arrinte duke ndryshuar nenet 206 e 207 të ligjit kushtetues. Do të ishte Ministri i Arsimit Hilë Mosi, i cili i kërkonte Mbretit që në ligjin e ri të arsimit, që do të aprovohej, në përputhje me Statutin Themeltar të Shtetit, të futeshin dispozita të veçanta që të garantonin që vetëm shteti të kishte të drejtën të hapte dhe të mbante shkolla fillore.³¹⁹ Këto kërkesa do të viheshin në bazën e dekretit ligjor që do të aprovohej nga Asambleja Kombëtare e Shqipërisë. Nenet e mësipërme të Statutit Themeltar do të riformuloheshin dhe do të theksonin se: shkollat private të çdo kategorie që deri tani funksionojnë do të mbyllen.³²⁰ Më konkretisht neni 206 parashikonte:

- Mësimi dhe edukimi i shtetasve shqiptar janë një e drejtë ekskluzive e shtetit.

³¹⁸ *Dekret-ligje mbi formimin e komuniteteve fetare*, Tiranë, 1929, f. 5.

³¹⁹ Beqir Meta, *Monarkia Shqiptare (1928 - 1939)*, Botimet Toena, Tiranë, 2011, f. 309.

³²⁰ Filip Liço, *Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare*, vep. e cit., f. 116.

- Arsimi fillor për të gjithë shtetasit shqiptar është i detyrueshëm dhe jepet falas.

Shkollat private të çdo kategorie qofshin që kanë vepruar deri më sot mbyllen.

Ndërsa neni 207 parashikonte se: Shkollat fetare për përgatitjen e klerit të mbajtura prej komuniteteve fetare shqiptare, janë të lira dhe rregullohen me ligjë.³²¹ Mbasi miratoheshin nga Parlamenti për ndryshimet në Statut, Mbreti i shpallte ato me një dekret të veçantë. Me ndryshimet e ndërmarra arrihej të mbylleshin të gjitha shkollat private, si vendase dhe ato të huaja, duke i vendosur nën kontrollin e drejtëpërdrejtë të qeverisë. Sistemi i ri kushtetues arrinte të ndryshonte gjithë sistemin e arsimit.

Ky sistem kishte karakter gjithëpërfshirës që aplikohet si ndaj shumicës, ashtu edhe ndaj pakicave dhe ishte në përputhje me shpirtin e përgjithshëm të Deklaratës që Shqipëria kishte firmosur më 2 tetor 1921.³²² Në këtë periudhë, nismat e reja ligjore shpallnin arsimin fillor të detyrueshëm për të dyja sekset, nga gjashtë deri në trembëdhjetë vjeç. Ligji kërkonte të bëheshin ndryshime në të gjithë sistemin arsimor fillor dhe të mesëm, të krijohej arsimi profesional si dhe ndryshime në programet arsimore. Ligji gjithashtu, impononte hapjen e shkollave femërore në të gjitha qendrat e mëdha urbane.³²³ Në lidhje me ligjin që parashikonte mbylljen e shkollave private, për të shuar çdo protestë të mundshme nga pakicat grekophone, për shtetëzimin e shkollave, qeveria ndërmerre disa

³²¹ Beqir Meta, vep e cit., f. 315.

³²² Beqir Meta, *Lidhja e Kombeve dhe minoritetet në Shqipëri*, <http://www.forumishqiptar.com/threads/58759-Lidhja-e-Kombeve-dhe-minoritetet-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri>

³²³ Valentina Duka, *Historia e Shqipërisë 1912-2000*, "Kristalina-KH", Tiranë, 2007, f. 200.

vendime të rëndësishme. Ajo shtonte numrin e shkollave të minoritetit grek deri në 50, zgjidhte dhe emëronte një personel mësuesish që kishin kryer studimet në shkollat greke dhe jepte instruksion që arsimi në këto shkolla të zhvillohej kyesisht në gjuhën greke, gjuha shqipe do të mësohej si gjuhë zyrtare.³²⁴ Gjithashtu, për të siguruar në të ardhmen një personel arsimor të kualifikuar, qeveria do të akordonte bursa shteti për në Greqi studentëve më të talentuar të zgjedhur midis popullsisë grekofone. Pavarësisht shtrëngimeve dhe masave të ndërmarra nga shteti shqiptar lidhur me të drejtën e minoriteteve për të mësuar në gjuhën e tyre, sistemi arsimor shqiptar ishte një nga më liberalët në rajon. Shtetet fqinje, si Greqia dhe Jugosllavia, jo vetëm nuk lejonin hapjen e shkollave për minoritet që ndodheshin brenda kufijve të tyre, por ato mohonin me forcë ekzistencën e popujve që i përkisnin një etnie tjetër nga ajo zyrtare. Masat e marra nga qeveria shqiptare do të kundërshtoheshin me forcë, sidomos nga Greqia, përpara Këshillit të LK. Shumë herë shteti helen do t'i kujtonte qeverisë shqiptare angazhimet e marra nga ajo në arenën ndërkombëtare.

6.3. Shkollat e minoritetit grek në Shqipërinë e Jugut

Në Shqipërinë e Jugut shumë persona flisnin dy gjuhë: shqip dhe greqisht, por në shtëpitë e tyre zakonisht përdornin vetëm një, e cila rrjedhimisht ishte gjuha amtare. Popullsia greqisht-folse në Gjirokastrë dhe në Delvinë, përsa i përkiste të dhënave statistikore që shteti shqiptar kishte paraqitur përpara LK, në realitet ishte më e madhe në

³²⁴ Dhimitër Berati, *Shënime historike mbi marrëdhëniet e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve*, vep. e cit., f. 79.

numër. Autoritet shqiptare kishin deklaruar se minoriteti grek në zonat jugore shkonte deri në 16. 000 banorë.³²⁵ Por, sipas të dhënave që Komisioni kishte siguruar, vetëm në nënprefekturën e Delvinës kishte 15. 160 banorë që flisnin greqisht. Përveç banorëve të kësaj zone, duheshin llogaritur gjithë fshatrat midis Libohovës deri në kufirin grek dhe fshatrat në anën perëndimore të fushës së Gjirokastrës dhe pjesën jugore të qytetit.

Në gjithë këto zona popullsia që banonte ishte grekofone dhe gjuha e folur në shtëpi ishte ajo greke. Sipas llogaritjeve të numrit të popullsisë të bëra në mars 1921 për zgjedhjet e përgjithshme, në gjithë prefekturën e Gjirokastrës kishte 33. 313 persona që flisnin greqisht.³²⁶ Komisioni bënte një llogaritje të numrit të popullsisë që i përkisnin pakicave greke. Sipas kësaj llogaritjeje, gjithë popullsia minoritare e Shqipërisë së Jugut, e cila banonte brenda prefekturave të Korçës dhe Gjirokastrës, duke përfshirë dhe Himarën, përbente 17% të popullsisë së përgjithshme.³²⁷ Gjithësesi, pavarësisht kontraditave statistikore të ofruara nga shteti shqiptar mbi popullsinë minoritare greke, ishte e domosdoshme të theksohej se në pjesën më të madhe të fshatrave minoritare që kishin një farë rëndësie, ekzistonin shkolla të mbajtura nga buxheti i shtetit shqiptar, të cilat shërbenin pikërisht për ruajtjen dhe trashëgimin e gjuhës amtare. Shpenzimet në këto shkolla, sipas të dhënave që ofronte MA për vitin 1922, shkonin deri në 81.240 franga ari.³²⁸ Gjithashtu, nga të dhënat e ministrisë rezultonte se në prefekturën e Gjirokastrës shkollat që i përkisnin minoritetit grek ishin 39 dhe numri i nxënësve që i frekuentonin arrinte deri në 2.614.³²⁹ Në

³²⁵ Luan Omari, *Çështja e pakicave kombëtare*, vep. E cit., f. 49.

³²⁶ MPJ, dosja 221, Lidhja e Kombeve, 1923, f. 9.

³²⁷ MPJ, dosja 221, *Mbi shkollat grekofone*, 1923, f. 235.

³²⁸ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f.566.

³²⁹ MPJ, dosja 102, Tiranë, 1922, f. 131.

këto institucione shkollore stafi i mësuesve përbëhej nga 49 persona dhe mësimi zhvillohej tërësisht në gjuhën greke. Por sipas Komisionit, në disa shkolla minoritare kushtet mësimore nuk ishin shumë të përshtatshme për zhvillimin e orës së mësimi. Të tilla mund të përmendeshin ato shkolla që përbëheshin nga tre klasa, ku numri i nxënësve në çdo klasë ishte shumë i madh, në disa raste shkonte deri në 150. Në shumicën e shkollave kishte vetëm një mësues që zhvillonte procesin mësimor dhe mungonin mësueset femra, si pasojë, vajzat ishin të pashkolluara pothuajse në çdo fshat. Kurse shkollave e mesme, me dy ose tre klasa kishin ekzistuar kohë më parë, por ishin mbyllur gjatë pushtimit italian dhe nuk ishin hapur më. Për rihapjen e tyre, komuniteti minoritar ishte ofruar që t'i paguante vet shpenzimet e shkollës dhe pagat e mësuesve, por kjo mundësi nuk ishte lejuar. Qeveria shqiptare u ishte përgjigjur se ata nuk mund të kishin më shumë lehtësira se popullsia shqiptare.

Por, duke u mbështetur tek “Deklarata mbi minoritetet”, komunitetet që u përkisnin pakicave racore, gjuhësore dhe fetare, kishin të drejta të padiskutueshme, të kishin shkolla në gjuhën e tyre. Për këtë arsye, qeveria nuk kishte të drejtë t'i ndalonte ata që të paguanin për shpenzimet e shkollave dhe rrogat e mësuesve. Këto lëshime që tentoheshin t'i bëheshin, sidomos minoritetit grek, shkonin në një farë mënyre të cënonin sovranitetin dhe dinjitetin e shtetit shqiptar. Në Delvinë, komuniteti grek i ankohej Komisionit së autoritetet shqiptare shkollën e ndërtuar dhe themeluar nga greket e kishin kthyer në një shkollë për nxënësit shqiptar. Këtyre akuzave qeveria u përgjigjej se ishte e drejta saj që këto shërbime të përdreshin për të gjithë komunitetin, pa dallim kombësie. Për më shumë, qeveria ofronte disa të dhëna mbi shkollat, të cilat hidhnin poshtë pretendimet e ngritura nga ana e

pakicës greke se nuk po respektoheshin angazhimet e marra përpara LK. Qeveria theksonte se, në Prefekturën e Gjirokastrës kishte në veprimtari gjithsej 101 shkolla fillore të mbajtura me fondet e shtetit, nga këto 39 i përkisnin minoriteteve dhe 62 popullsisë shqiptare.³³⁰ Në qoftë se, merrej parasysh përpjesëtimi i popullsisë së përgjithshme, ku elementi minoritar përbënte vetëm 17% të banorëve të kësaj prefekturë e numri i shkollave të llogaritej me këtë përpjesëtim, elementit minoritar nuk duhet t'i takonin më tepër se 17 shkolla.³³¹ Në bazë të këtyre të dhënave, qeveria arrinte në përfundim se nëpërmjet buxhetit të shtetit ishin çelur më shumë shkolla minoritare dhe ishin lënë pas dore shkollat për popullsinë shqiptare. Sa për akuzat se në disa shkolla minoritare me shumë nxënës kishte vetëm një mësues, qeveria shqiptare i hidhte poshtë duke paraqitur disa të dhëna. Sipas saj, në fshatin Dhvrojan kishte katër mësues dhe një mësuese, kurse në fshatin Leshnoçes të Poliçanit kishte dy mësues.³³² Për problematikën e mbipopullimit të klasave, qeveria sqaronte se në ato klasa ku numri i nxënësve shkonte deri në 60 vetë ishte caktuar vetëm një mësues.

Kjo ishte në përputhje me ligjin organik arsimor, i cili për këtë numër nxënësish caktonte një mësues të vetëm për të zbatuar metodën kolektive të mësimi. Kështu Art. 25 i ligjit organik ishte i qartë pasi deklaronte se: një shkollë që kishte deri në 60 fëmijë do të kishte një mësues; kur numri i nxënësve arrinte 70 deri në 100 do të emëroheshin 2 mësues e për çdo 50 nxënës nga një mësues më tepër.³³³ Ligji organik arsimor zbatohet në mënyrë uniforme për të gjitha shkollat e shtetit shqiptar. I vetmi problem që vrehej ishte fakti se shumica e mësuesve ishin të vjetër dhe hasnin vështirësi në zbatimin e metodave të reja të

³³⁰ MPJ, dosja 211, Mbi shkollat grekofone, 1923, f. 235.

³³¹ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f.576.

³³² MPJ, dosja 221, Mbi shkollat grekofone, 1923, f. 236.

³³³ *Ligjet e Arsimit*, Mbretëria Shqiptare, Ministria e Arsimit, "Telegraf", Tiranë, 1928, f. 8.

mësimdhënies. Ankesa tjetër që banorët minoritarë ngrinin, ishte mungesa e mësueseve për vajzat nëpër zonat rurale. Qeveria mbi këtë problem argumentonte se: arsimi femëror ndër fshatra bëhej i mundur falë sistemit të shkollave të përziera. Në këto shkolla, vajzat zhvillonin mësimet deri në një farë moshe, kjo pasi në gjithë territorin e Shqipërisë nuk ekzistonin shkolla të veçanta femërore. Gjithashtu, edhe mungesa e personalit të posaçëm e bënin të pamundur arsimimin e mëtejshëm të vajzave. I vetmi fshat grekofon që kishte emëruar një mësuese të veçantë ishte ai i Dhrovjanit.³³⁴ Minoriteti grek ishte ankuar përpara Komisionit edhe për mbylljen e shkollave të mesme. Këtyre ankimeve qeveria u përgjigjej duke mohuar ekzistencën e tyre në të kaluarën. Sipas saj, në fshatin Dhrovjan kishte patur një shkollë fillore të lartë, të cilën komuniteti grekofon e quante “elenikon skolio”.³³⁵

Por kjo shkollë nuk ishte e mesme, ajo i përgjigjej kriterëve të një shkolle fillore të lartë e përbërë nga dy klasa. Qeveria hidhte poshtë edhe akuzat që kishin të bënin me ndalimin nga ana e saj të pagimit të mësuesve shtesë nga e komunitetit minoritar. Ajo i quante si të pavërteta pasi, mbi këtë çështje, nuk kishte shkuar asnjë kërkesë në drejtim të MA. Kjo ministri deklaronte se vetëm fshati i Podrishtit, i ishte drejtuar për çeljen e një shkolle me financimet e veta dhe leja ishte akorduar. Së fundmi, qeveria sqaronte edhe problemin e ndërtesës së shkollës në Delvinë, ku minoriteti e akuzonte se e kishte marrë për ta përdorur si shkollë të përbashkët. Për qeverinë çështja qëndonte komplet ndyshe nga e akuzat e ngritura. Në Delvinë një pjesë e popullsisë i përkiste minoritetit grek dhe shkolla e tyre ishte tepër e ngushtë që t’u përgjigjej nevojave për shkollimin e fëmijve. Për këtë qëllim, këshilli shkollor dhe bashkia vendosnin që të mernin me qera një ndërtesë më të

³³⁴ MPJ, dosja, 211, Tiranë, 1923, f. 236.

³³⁵ Po aty, f. 236.

madhe që të mund ta përdornin si shkollë.³³⁶ Vendimi parashikonte që ndërtesa të ndahej në dy pjesë dhe të përdorej si shkollë për djemtë, si për fëmijë shqiptar ashtu dhe për ata grekofon. Përsa i përkiste shkollës së vjetër greke, ajo do të përdorej për shkollimin e vajzave. Qeveria theksonte se këto ndryshime nuk ishin vendosur nga MA, por nga këshilli shkollor i vendit me pëlqimin e popullit. Në prefekturën e Vlorës, sipas të dhënave që prefekti i dërgonte MPB, popullsia e krishterë në këtë krahinë ishte prej gjuhës dhe gjakut shqiptar. Përsa i përkiste katundeve Dhërmi, Palas dhe Himarë, popullsia fliste greqisht, por sipas prefekturës këta nuk duheshin konsideruar si minoritet pasi flisnin shumë mirë edhe gjuhën shqipe.³³⁷ Pra për prefektin e Vlorës, kjo popullsi konsiderohej thjeshtësisht shqiptare. Pavarësisht këtyre vlerësimeve që i bëhej popullsisë së krahinës së Himarës, në këtë zonë kishte tri shkolla greke, tetë mësues dhe 318 nxënës.³³⁸

Nga këta tetë mësues të shkollave greke tre prej tyre jepnin mësim në gjuhën shqipe. Në këto shkolla, gjuha shqipe mësohej si gjuhë zyrtare dhe ato mbaheshin nga fondet e shtetit. Pavarësisht këtyre lëshimeve, një pjesë e popullsisë së Himarës pretendonte që gjithë mësimi të zhvillohej në gjuhën greke pasi ishin më në kontakt me popullsinë greke. Këto kërkesa të popullsisë himariote lidheshin më shumë me protestat e përgjithshme që po zhvilloheshin nga banorët pas vendimit që kishte marrë qeveria shqiptare mbi heqjen e autonomisë. Himara kishte një autonomi të veçantë në krahasim me territoret shqiptare, e cila kishte të bënte me disa privilegje taksore të trashëguara që nga

³³⁶ MPJ, dosja 221, *Mbi shkollat grekofone*, 1923, f. 236.

³³⁷ MPJ, dosja 101, *korrispondencë e Prefekturës së Vlorës drejtuar Ministrisë së Punve të Brendëshme*, Tiranë, 1921, f. 34.

³³⁸ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f.572.

sundimi turk, të venomene.³³⁹ Çështja e shkollave në Korçë kishte problematika të ndryshme pasi aty nuk kishte minoritete kombëtare apo gjuhësore. E gjithë popullsia, duke përfshirë edhe mbështetësit helenofil, ishin shqiptarë dhe gjuha e folur në shtëpitë e tyre ishte gjuha shqipe.³⁴⁰

Por në këtë zonë, para se të okupohej nga ushtria franceze, nuk kishte shkolla ku mësohej gjuha shqipe. Në Korçë në të gjitha shkollat për popullsinë e krishterë mësohej greqisht, madje edhe për shkëmbimet tregtare përdorej gjuha greke. Ndërsa popullsia myslimane frekuentonte shkolla ku mësimdhënia zhvillohej në gjuhën turke. Greqishtja ishte gjuha e kulturës për popullin ortodoks, dhe shumë shqiptarë nga Korça kishin mbaruar studimet dhe ishin formuar në universitetin grek të Athinës.³⁴¹ Por Korça nuk ishte vetëm një qendër e rëndësishme e kulturës greke, ajo ishte në një farë mënyre djepi i nacionalizmit shqiptar. Në këtë qytet hapej për herë të parë shkolla për vajzat “Mësonjëtorja e Korçës” ku mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe. Shkollat shqiptare që hapeshin në të gjithë territorin në 1908, gjatë kohës së revolucionit turk, do të mbylleshin të gjitha dy vjet më vonë dhe lëvizja mësimore shqiptare ndalonte zhvillimin e saj.³⁴²

Me fillimin e okupimit francez të rrethit të Korçës, më 1916, atdhetarët shqiptarë inkurajoheshin duke hapur “liceun francez” dhe shumë shkolla fillore në gjuhën shqipe. Liceu francez ishte një arritje e madhe pasi nxënësve u jepej mundësia, që përveç gjuhës shqipe, të studionin dhe një gjuhë të Evropës perëndimore. Nxënësit e liceut ishin të

³³⁹ MPJ, dosja 209, Mbi ankimet e disa himarjotëve, Vlorë 1923, f. 29.

³⁴⁰ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f.354.

³⁴¹ Po aty, f. 354.

³⁴² C 7811, Report of the Commission of Enquiry in Albania from Decembre 19th, 1922 to February 1st, 1923, J.J. Sederholms, 2 May 1923, f. 46.

moshave të ndryshme dhe përpara se të regjistroheshin këtu, kishin mësuar në shkolla ku mësimi ishte zhvilluar në gjuhë të ndryshme nga shqipja. Kjo pasi fëmijët shqiptarë kishin qenë të regjistruar në shkolla ku mësohej në greqisht, gjermanisht dhe italisht. Hapja e liceut francez mbështetej me vendosmëri nga qeveria shqiptare pasi shikohej si një mundësi për të ndihmuar në mbylljen graduale të shkollave greke. Qëndrimi i qeverisë kundër mësimëdhënies në gjuhën greke, në shkollat e frekuentuara nga nxënës shqiptarë kuptohej qartë, pasi shteti grek kërkonte të aneksonte me kembëngulje krahinat e Shqipërisë së Jugut.³⁴³

Gjithashtu, shpesh herë mësuesit, të cilët në pjesën më të madhe të rasteve ishin deklaruar në favor të lëvizjes pan-epirioite, kishin si qëllim përhapjen e propagandës pan-helenike.³⁴⁴ Për më shumë vendimi i qeverisë nuk binte ndesh as me “Deklaratën e minoriteteve”, pasi ky dokument i referohej vetëm të drejtës që kishin minoritetet të ndërtonin dhe administronin shkolla në gjuhën e tyre. Reformat që po ndërmernte shteti shqiptar kërkonin kohë për t’u realizuar, pasi popullsia ortodokse përdorte gjuhën shqipe për komunikimin e përditshëm, kurse greqishtja ishte gjuha e fesë, e letërsisë dhe e tregtisë.³⁴⁵ Pas armëpushimit, shkollat greke në Korçë rihapeshin, ndërmjet tyre edhe një gjimnaz, në të cilin vazhdonin të studionin nxënësit deri më 1922.³⁴⁶ Shumë nxënës nga rrethet e Korçës dhe Gjirokastrës, të cilët vinin nga familje që u përkisnin të dy besimeve fetare, vazhdonin të dërgoheshin me studime në shkollat e mira të Korfuzit. Pas firmosjes së deklaratës për mbrojtjen e minoriteteve në 1921, filloi të rritej numri i shkollave dhe

³⁴³ MPJ, dosja 211, *Komisioni i Hetimeve në Shqipëri*, 1923, f. 11.

³⁴⁴ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f.347.

³⁴⁵ Po aty, f.355.

³⁴⁶ MPJ, dosja 211, *Lidhja e Kombeve*, 1923, f. 12.

klasat ishin plot me nxënës. Ndërsa në lidhje me përgatitjen e mësuesve dhe cilësinë e mësimdhënies, vëreheshin disa mangësi që lindnin si pasojë e trajnimit jo të mirë të mësuesve.³⁴⁷ Gjithashtu, në shkollat shqiptare vihej re një mungesë e theksuar e teksteve mësimore dhe mjeteve të tjera shkollore, të cilat MA gjatë periudhës dhjetëvjeçare do të mundohej t'i siguronte.

6.4. Protestat e Greqisë kundër reformës arsimore

Përdorimi i gjuhës greke në kishat dhe shkollat e frekuentuara nga minoritetet, i shërbente qëllimeve ambicioze të shtetit helen. Greqia në dokumentat zyrtare të panumërta që dispononte mashtronte opinionin botëror duke vlerësuar, pa asnjë rezervë, se gjithçka që kishte të bënte me fenë ortodokse konsiderohej greke. Mbi këto argumente jo korrekte bazoheshin edhe të dhënat që kishin të bënin me popullsinë e Shqipërisë së Jugut. Këto të dhëna, me ndihmën e etnologëve grek, përdorehin nga qeveria e Zografit gjatë trazirave në “Epirin e Veriut”, për të justifikuar pretendimet e shtetit grek për aneksimin e trevave jugore të Shqipërisë. Ata klasifikonin popullsinë ortodokse si greke dhe atë myslimane si shqiptaro-turke. Propaganda grekofile pretendonte se në krahinat e Korçës, Gjirokastrës dhe në një pjesë të krahinës së Janinës, kishte 569 qytete dhe fshatra të banuara nga 116.888 helenë dhe 111.534 shqiptarë.³⁴⁸ Tabelat e mëposhtme paraqesin në mënyrë të detajuar të dhënat statistikore që zotëronte pala greke:

³⁴⁷ MPJ, dosja 221, *Mbi shkollat grekofone*, 1923, f. 238.

³⁴⁸ Justin Godart, *Shqipëria në 1921*, vep. e cit., f. 135.

Popullsia në krahinën e Korçës e ndarë sipas qeverisë greke në shqiptarë dhe grekë:

	Qytete fshatra	dhe Helene	Shqiptare	Shuma
Kaza e Korçës	139	32.873	35.807	68.680
Starovës	42	326	8.262	8.588
Kolonjës	52	11.269	9.615	20.884
Shuma	233	44.468	53.684	98.152

Tabela nr.3³⁴⁹

Popullsia në krahinën e Gjirokastrës e ndarë sipas qeverisë greke në shqiptarë dhe grekë:

	Qytete fshatra	dhe Helene	Shqiptare	Shuma
Kaza e Gjirokastrës	71	20.016	21.424	41.440
Himarës	13	6.188	4.460	10.648
Delvinës	85	17.295	4.645	21.940
Leskovikut	40	6.455	3.993	10.448
Tepelenës	33	6.093	6.727	12.820
Përmetit	81	10.823	12.251	23.074
Shuma	323	66.870	53.500	120.370

Tabela nr.4³⁵⁰

Popullsia në një pjesë të krahinës së Janinës e ndarë sipas qeverisë greke në shqiptarë dhe grekë:

	Qytete fshatra	dhe Helene	Shqiptare	Shuma
Pogoni	6	5.185	-	5.185
Filati	7	365	4.350	4.715
Shuma	13	5.550	4.350	9.900

Tabela nr.5³⁵¹

³⁴⁹ Justin Godart, *Shqipëria në 1921*, vep. e cit., f. 136.

³⁵⁰ Po aty, f. 136.

³⁵¹ Po aty, f. 136.

Sipas të dhënave të tre tabelave rezultonte që krahinat e lartpërmendura ishin përbërë: nga 569 qytete dhe fshatra, ku jetonin rreth 228.422 banorë. Nga këta banorë, sipas të dhënave që prezantonte propaganda greke, më shumë se gjysma, konkretisht 116.888 ishin më kombësi helene.³⁵² Natyrisht, konkluzionet e shtetit grek ishin të gabuara, sepse ndërmjet e atyre që klasifikoheshin si grek, pothuajse në mënyrë unanime, për nga raca dhe ndjenja kombëtare ishin shqiptarë. Duke shfrytëzuar këto statistika të rreme, qeveria greke protestonte disa herë pranë KLLK mbi reformën arsimore që po ndërmernte shteti shqiptar, e cila kishte si qëllim vënien nën kontroll të programit mësimor nga ana e shtetit të të gjitha shkollave që ndodheshin në territorin e Shqipërisë. Reforma arsimore e ndërmarrë nga qeveritë shqiptare do të arrinte kulmin e procesit të saj me shpalljen e Shqipërisë mbretëri.

Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare (1928) me nenet 206 dhe 207 parashikonte (siç u shpjegua më lart) që, për shkollat private, shtetasve të huaj u lejohej vetëm hapja e shkollave teknike dhe bujqësore me programet teorike-praktike. Për shkollat që mund të hapeshin nga komunitetet fetare, ligji parashikonte që ato të merrnin lejen përkatëse nga Ministria kompetente. Gjithashtu, ligji parashikonte që numri i shkollave fetare dhe numri i nxënësve të tyre do të caktohej nga Ministri kompetent me vendim të Këshillit të Ministrave. Por, këto reforma do të çonin në mbylljen e atyre shkollave greke të hapura në ato zona ku popullsia vendase ishte qartësisht shqiptare. Reforma e shtetëzimit të shkollave kundërshtohej nga Sekretari i Përhershëm grek pranë LK z. Dhendhranis, i cili paraqiste një notë, me të dhëna jo të sakta, ku ankohej se në Shqipëri, si pasojë e reformave arsimore, nuk ekzistonte asnjë shkollë dhe si rrjedhojë gjuha greke nuk mësohej në ato territore ku

³⁵² Justin Godart, *Shqipëria në 1921*, vep. e cit., f. 136.

jetonin pakicat greke.³⁵³ Këtyre protestave u përgjigjej i deleguari i Shqipërisë në LK, zoti Mehdi Frashri. Ai nënvizonte faktin se, ligji i aprovuar për reformën në arsim kishte karakter të përgjithshëm dhe nuk ishte bërë që të shkelte të drejtat e pakicave. Reforma në arsim bëhej në bazë të parimit të barazisë dhe nuk mund të privilegjonte një pakicë në dëm të shumicës. Për më tepër protestat e palës greke rreth neneve 206 e 207 të statutit, nuk mund të merreshin parasysh nga LK, pasi për këtë reformë qeveria shqiptare po ushtronte në formën e duhur të drejtën e saj sovranë. Qëndrimi jo diskriminues i qeverisë gjatë periudhës së Mbretërisë, vihej re në zbatimin e politikave favorizuese ndaj pakicave.

Shteti shqiptar do të financonte shkollat minoritare në një masë të konsiderueshme. Pesha specifike e shkollave minoritare, në raport me numrin e fshatrave dhe të popullsisë, ishte dy herë më e lartë se mesatarja e vendit.³⁵⁴ Kështu në zonat minoritare, kishte 1 shkollë për 829 banorë, ndërsa në popullsinë shqiptare të qarkut të Gjirokastrës kishte 1 shkollë për 1500 banorë.³⁵⁵ Gjithashtu, në fillim të viteve '30-të, me aplikimin e reformës së shtetëzimit të shkollave greke përqindja e nxënësve shqiptarë, në raport me fëmijët e moshës së detyrimit shkollor, ishte 36,29%, kurse ajo e fëmijëve të minoritetit grek 79,30%. Përqindja e nxënësve shqiptarë në krahasim me numrin e popullsisë ishte 4,8%, e atyre grekë 9,9%.³⁵⁶ Po të bëhej një krahasim midis frekuentimit shkollor të nxënësve në zonat minoritare dhe shkollave në Greqi, rezultonte se përqindja e nxënësve të moshës shkollore që frekuentonin shkollën në zonat minoritare të Shqipërisë ishte 79,30% kurse ajo

³⁵³ MPJ, dosja 164, *correspondencë e Ministrisë së Arsimit drejtuar MPJ, Tiranë, 1922, f. 8.*

³⁵⁴ Meta Beqir, *Monarkia Shqiptare (1928 – 1939), Politikat e shtetit shqiptar ndaj minoriteteve gjatë periudhës së monarkisë*, vep. e cit., f. 48.

³⁵⁵ Po aty, f. 48.

³⁵⁶ Po aty, f. 49.

e nxënësve grekë në Greqi ishte 75%.³⁵⁷ Për më shumë, qeveria e Mbretit Zog ishte përpjekur të eliminonte çfardo lloj shtrëngimi për sa i përkiste përdorimit të gjuhës amtare të minoriteteve, gëzimit të pasurisë dhe sigurimit të jetës. Gjatë këtyre viteve popullsia minoritare gëzonte, gjithashtu, lirinë e plotë të kultit; ritet në kisha kryheshin në gjuhën amtare; nxënësit merrnin edukim fetare në gjuhën e tyre dhe priftërinjtë caktoheshin nga vetë minoriteti. Protestat e Greqisë jo vetëm që ishin të pabazuara por, ato mbi të gjitha ishin të padrejta, pasi shteti helen pakicave shqiptare që jetonin në territorin e tij u kishte mohuar çdo të drejtë për hapjen e shkollave shqipe. Qeveria greke në fillim të viteve '20-të nëpërmjet një politike të dhunshme fillonte spastrimin etnik dhe mijëra familje shqiptare mbeteshin pa asnjë mjet jetese, si pasojë e konfiskimit të pasurive të paluajtshme që gjendeshin në Greqi.³⁵⁸ Ky spastrim do të fillonte me vendimin e marrë nga LK për formimin e Komisionit Misk në janar të 1923, i cili kishte si detyrë të merrte përsipër çështjen e shkëmbimit të popullsisë ndërmjet Greqisë dhe Turqisë.³⁵⁹

Në shkëmbimin e popullsisë do të kishte një peshë të madhe vendimi që do të merrnin pjesëtarët e Komisionit, të cilët ishin i deleguari i qeverisë greke, i deleguari i qeverisë turke dhe kryetari që ishte i deleguari i LK zoti E.E. Ekstrand. Përfaqësuesi grek dhe ai turk merrnin vendimin që të përfshinin në shkëmbim pothuajse gjithë popullsinë shqiptare që banonte në Greqi.³⁶⁰ Qeveria greke ushtronte një dhunë sistematike dhe

³⁵⁷ Meta Beqir, *Monarkia Shqiptare (1928 – 1939), Politikat e shtetit shqiptar ndaj minoriteteve gjatë periudhës së monarkisë*, vep. e cit., f. 49.

³⁵⁸ MPJ, *Bisedim në Këshillin e Shoqnisë së Kombevet mbi çështjen e minoritetit shqiptar dhe të pasunieve shqiptare në Greqi, qershor*, 1928, f. 4.

³⁵⁹ MPJ, dosja, 86, *Echange des populations Grecques et Turques musulmans d'origine albanaise en Grece*, Athenes, 1924, f. 24.

³⁶⁰ Émile Chanoux, *Mémoire de licence, Delle minoranze etniche nel diritto internazionale*, l'Università di Torino, 1927-1928, f.14.

burgoste popullsinë shqiptare, vetëm se ata deklaroin përpara Komisionit se ishin shqiptarë dhe nuk dëshironin të bëheshin pjesë e shkëmbimit të popullsisë.³⁶¹ Duke vepruar në këtë mënyrë, Greqia dilte kundër vendimeve të marra përpara LK. Marrëveshja e arritur, parashikonte se pala greke dhe ajo turke duheshin të merrnin parasysh, lidhur me shkëmbimin e popullsisë, jo vetëm gjuhën e folur nga populli por edhe vullnetin e popullsisë që nuk dëshironte të bëhej pjesë e shkëmbimit.³⁶²

Qeveria shqiptare protestonte, jo vetëm pranë Sekretariatit të LK por, ajo përpigjej të bindëte kryetarin e Komisionit Miks, zotin E.E. Ekstrand pa ja arritur qëllimit. Zoti Ekstrand në raportin e tij përfundimtar shkruante se, popullsia myslimane që jetonte në “Epirin e Jugut” deklaronte me vullnet të lirë kombësinë e saj turke. Sipas raportit vetëm një minorancë e vogël e popullsisë deklaronte se ishte shqiptare dhe kishte shprehur dëshirën që të mos përfshiheshin në shkëmbimin e popullsisë.³⁶³ Si rezultat i këtij qëndrimi të Komisionit, mijëra shqiptar shpronsoheshin me dhunë nga qeveria greke dhe detyroheshin të migronin në Turqi, ku do të liheshin në mjerim pa asnjë ndihmë nga shteti turk.³⁶⁴ Ngjarjet që kishin të bënin me shkëmbimin e popullsisë tregonin politikën që përdorte qeveria greke për trajtimin e minoriteteve. Greqia kërkonte me çdo kusht spastrimin etnik të popullsisë me kombësi shqiptare që jetonte në territoret e saj dhe ndërkohë protestonte në LK për reformën arsimore që po ndërmernte shteti shqiptar.

³⁶¹ MPJ, dosja 96, Athinë, 1924, f. 75.

³⁶² MPJ, dosja 86, *Moslems of Albanian origin in Greece*, 1923, f. 215.

³⁶³ MPJ, dosja 86, *Anex2. General report of the Delegation of the Mixed Commission entrusted with the investigation of the Albanian question*, Athens, 1924, f. 95.

³⁶⁴ MPJ, dosja 102, *Letter to associated press*, 1922, f. 302.

Megjithatë, protestat e Greqisë LK nuk i merrte parasysh dhe do të mbështeste reformën arsimore të ndërmarrë nga shteti shqiptar.

6.5. Shkollat e minoritetit malazez në Shqipërinë e Veriut

Në Shqipërinë e Veriut, përveç shkollave shtetërore, prej kohësh funksiononin edhe shkollat katolike, të cilat mbaheshin nga të ardhurat që siguronte kisha katolike. E tillë ishte shkolla e ciklit të lartë fillor e përbërë nga pesë klasa, që mbështetej financiarisht nga Kryepeshkopata katolike e Shkodrës.³⁶⁵ Shkollat private me karakter fetar, fitonin një rëndësi të veçantë nga momenti kur komunitetet fetare shqiptare, kalolike dhe ortodokse, nën drejtimin e kryesive të tyre, fitonin statusin e personit juridik. Ky kalim i rëndësishëm u siguronte komuniteteve:

- I. Të drejtën të menaxhonin kishat, manastiret dhe pronat e tyre, pa ndërhyrjen e shtetit;
- II. Të drejtën të disiplinonin juridikisht vartësit e tyre;
- III. Juridiksion të veçantë në çështjet e të drejtës së familjes, siç ishin martesat, divorcet, etj;
- IV. Të drejtën të pranonin dhe zotëronin donacione dhe trashëgimi të testamenteve në emër të komunitetit;

³⁶⁵ C 7810, *Report of the Commission of Enquiry on its work from February 1st to the beginning of April 1923*, League of Nations, 2 May 1923, f.2.

V. Të drejta të plota në krijimin e shkollave të niveleve të ndryshme mësimdhënie, në gjuhën e popullit mbi të cilin drejtuesit fetar kishin të drejtën e juridiksionit.³⁶⁶

Njohja e kishës ortodokse të statusit të personit juridik, i garantonte të drejtën e hapjes së shkollave për popullsinë që ndodhej nën juridiksionin e kishës. Pikërisht këtë të drejtë e shfrytëzonte pa hezitim komuniteti i vogël ortodoks i Shkodrës, i cili ishte nën varësinë e Kishës Autoqefale Jugosllave.

Komuniteti ortodoks i prefekturës së Shkodrës kishte dy shkolla të cilat, vërtetoheshin nga raportimet që prefektuara e këtij qyteti i drejtonte MPB. Këto shkolla ishin të subvencionuara nga kisha, e cila mbështetej nga shteti jugosllav dhe aty mësimi zhvillohej vetëm në gjuhën sllave.³⁶⁷ Ato ndodheshin konkretisht në qytetin e Shkodrës (ku nuk ekzistonte ndonjë pakicë kombëtare sllave) dhe në katundin e Vrakës. Çelja e tyre bëhej kur qyteti i Shkodrës me zonat përreth ishin nën sundimin e ushtrisë franceze, përpara se t'i bashkoheshin Shqipërisë. Shteti shqiptar, i ndodhur përballë problemeve të mprehta të ekzistencës së tij dhe nën presionin jugosllav, nuk kishte mundur të merrte ndonjë masë kufizuese.

Nga të dhënat që prefektuara kishte në dispozicion, nxënësit që frekuentonin shkollën në qytetin e Shkodrës ishin të gjithë nënshtetas shqiptarë dhe si pasojë funksionimi i saj binte në kundërshtim me ligjin mbi arismin. Ligji parashikonte, që nënshtetasit

³⁶⁶MPJ, dosja 102, Tiranë, 1922, f. 133.

³⁶⁷ MPJ, dosja, 164, Tiranë, 1922, f. 6.

shqiptarë ishin të detyruar të mësonin në shkollat shtetërore.³⁶⁸ Për më shumë, sipas informacioneve të prefekturës, këto dy shkolla financoheshin nga shteti jugosllav, pa kurrëfarë inspektimi apo kontrolli nga Inspektoriati i Arsimit.³⁶⁹ Lidhur me shkollën që ndodhej në qytetin e Shkodrës, prefekti në bashkëpunim me inspektorët e MA i kishin kërkuar drejtorit programin që ndiqte shkolla. Përgjigja që ata merrnin nga drejtori i shkollës ishte negative dhe si pasojë, shkollës i mohohej akreditimi nga qeveria shqiptare.³⁷⁰ Mungesa e paraqitjes së një programi të detajuar shkollor bënte që ky institucion të mos ishte i pajisur me lejen përkatëse nga shteti shqiptar.³⁷¹ Ndërsa mësimi në këtë shkollë nuk zhvillohej në gjuhën shqipe por në atë sllave, gjë që ishte në kundërshtim me Deklaratën që Shqipëria kishte firmosur përpara LK. Në këto kushte, MPJ miratonte kërkesën e bërë nga MA që shkolla të mbyllej, nëqoftëse nuk do të mësohej gjuha zyrtare, historia dhe gjeografia e Shqipërisë. Shkolla ortodokse e Shkodrës nëpërmjet drejtorit të saj refuzonte kërkesat e parashtruara nga qeveria shqiptare.

Mospranimi i këtyre kushteve, detyronte prefekturën e Shkodrës të urdhëronte në shtator të 1924 mbylljen e shkollës deri sa të pranohej programi mësimor i MA. Për të nxitur mbylljen e shkollave të financuara nga shteti jugosllav, qeveria shqiptare po përpiqej të hapte shkolla laike ku fëmijët e nënshtetasve shqiptarë të mësonin në gjuhën amtare. Në këtë drejtim mund të përmendim shkollën e hapur nga qeveria, e cila ishte një shkollë e ciklit të lartë të fillores. Kjo shkollë konsistonte në dy klasa por pretendohet që në të ardhmen të rritej kapaciteti i saj. Përpjekjet për formimin e shkollave fillore laike në

³⁶⁸MPJ, dosja 164, Tiranë, 1922, f. 164.

³⁶⁹Po aty, f. 10.

³⁷⁰Po aty, f.7.

³⁷¹MPJ, dosja 164, Mbi shkollat sllavishte, Tiranë, 1922, f. 10.

Shqipërinë e Veriut kundërshtoheshin nga komuniteti i krishterë dhe ai mysliman. Ky kundërshtim vinte nga prindërit, të cilët refuzonin të dërgonin fëmijët e tyre në shkolla ku mësimi do të zhvillohej për nxënësit e të dyja besimeve.³⁷²

Por, qeveria mendonte se vështirësia do të kalonte pasi përvoja e shkollave që frekuentohej nga fëmijët që i përkisnin besimeve fetare të ndryshme ishte pozitive. Të tilla ishin “Shkolla Profesionale Amerikane” në qytetin e Tiranës dhe “Liceu Francez” në Korçë, në klasat e të cilave mësonin nxënës që i përkisnin të tre besimeve fetare. Reformat e ndërmarra nga qeveria shqiptare për shtetëzimin dhe kombëtarizimin e shkollave arrinte një sukses të konsiderueshëm ashtu si dhe reformat e hartuara për modernizimin e shtetit.

6.6. Situata e shkollave të minoritetit etnokulturor arumun në Shqipëri

Çështja e shkollave arumune në Shqipëri, në krahasim me ato greke dhe malazeze, ka qenë më pak e debatuar, për faktin së arumunët janë një pakicë etnokulturore. Duke qenë e tillë, kjo pakicë nuk kishte një shtet kombëtar që të ndërhynte në punët e brendshme të Shqipërisë dhe si pasojë të krijonte debate midis shteteve në planin ndërkombëtar. Gjithashtu, vet shteti shqiptar nuk kishte hartuar një legjislacion për këto pakica dhe institucionet qendrore e lokale hezitonin ta trajtonin këtë çështje. Mungesa e legjislacionit bënte që këto institucione të ishin të paqarta se si do të trajtohej ky grupim popullsie. Aq më tepër kërkesës për çeljen e shkollave nga ana e komunitetit arumun, ose quhet ndryshe vllleh, autoritetet shqiptare i frikësoheshin, pasi mund të krijonte një precedent. Në fakt,

³⁷² C 7810, Report of the Commission of Enquiry on its work from February 1st to the beginning of April 1923, League of Nations, 2 may 1923.

ekzistonte mundësia që të shtoheshin përpjekjet për të hapur shkolla të huaja në vend, jo vetëm në zonat ku jetonte popullsia minoritare por edhe përtej tyre.

Nga ana tjetër, edhe minoriteti vllëh ishte i pavendosur në hapjen e shkollave në gjuhën e tyre. Dilema kishte të bënte me hapjen e shkollave në gjuhën vllehe apo rumune, sepse ky ishte një dallim i rëndësishëm që kishte të bënte me origjinën dhe identitetin e kësaj popullsie.³⁷³ Rumanishtja ishte dega e trungut të gjuhëve romane, e cila ishte shtrirë më shumë në Lindje se të tjerat.³⁷⁴ Përsa i përkiste gjuhës vllehe edhe pse kishte shumë ngjashmëri me rumanishten ruante veçoritë e veta. Për këtë arsye, qeveria shqiptare nuk i shikonte me sy të mirë kërkesat që bëheshin për hapjen e shkollave të reja rumune.

Ky qëndrim i qeverisë shpjegohej me faktin që, ajo i konsideronte vllëhët një grup etno-kulturor të veçantë, të cilët dallonin shumë nga rumunët. Për këtë qëllim, ishte i nevojshëm një studim i thelluar nëse vllëhët e Shqipërisë ishin të njëjtë me rumunët e Rumanisë. Sa për gjurmët e shkollave arumune, sipas studiuesve, mund t'i hasnim që në periudhën e sundimit otoman, përpara se të shpallej pavarësia e Shqipërisë.

Në vitin 1887 në qytetin e Korçës hapet shkolla e parë shqipe, por 3 vjet më parë në Korçë dhe Plasë ekzistonin dy shkolla në gjuhën arumune. Shkolla arumune, gjithashtu, do të hapeshin edhe në Shipcke, Grabovë, Nice, Llenge, Voskopojë, por edhe në Elbasan, Fier, Lushnjë, Pogradec etj. Të gjitha arrinin në 17 shkolla fillore dhe 1 gjimnaz në Berat.³⁷⁵ Një rol thelbësor, jo vetëm për subvencionimin por edhe për planin programor e pedagogjik të këtyre shkollave, pas viteve '20-të, do ta luante qeveria rumune. Gjithashtu, kjo qeveri do të

³⁷³ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 624.

³⁷⁴ Eqrem Çabej, *Shqiptarët midis perëndimit dhe lindjes*, "MçM", Tiranë, 1994, f. 86.

³⁷⁵ Robert Collaku, *Arumunët e Shqipërisë, histori dhe dokumente-figura të shquara*, vep. e cit., f. 35.

angazhohej në çeljen dhe financimin e shkollave private rumune. Duke bërë një përmbledhje të shpejtë të shkollave situata paraqitej si në tabelën e mëposhtme:

Shkollat arumune në Shqipëri përpara vitit 1912, të paraqitura në bazë të numrit të nxënësve dhe personelit për çdo lokalitet:

Lokalitetet	Nr i shkollave	Nr i nxënësve	Personeli
Korça	2	146	6
Vithkuqi	1	42	2
Frashëri	1	43	1
Llenga	1	46	2
Voskopoja	2	71	3
Nica	1	44	1
Plasa	2	151	4
Shipska	1	75	2
Berat	2	53	4
Elbasan	2	55	4
Grabova	1	30	1
Totali	16	756	1

Tabela nr.6³⁷⁶

Më fitoren e pavarësisë së Shqipërisë dhe sidomos mbas Luftës së Parë Botërore, në vend do të mbeteshin vetëm tre shkolla arumune, në Korçë, Plasë dhe Shipcke. Në vitin 1921, pavarësisht mungesës të një legjislacioni të qartë dhe pa lejen përkatëse nga autoritetet shqiptare, hapeshin katër shkolla vllehe në qarkun e Korçës. Përkatësisht, ato ndodheshin në qytetin e Korçës, në Plasë të Sipërme dhe në Shipcke. Mungesa e legjislacionit mbi këtë çështje vinte në debat MA me MPB, pasi kjo e fundit jepte urdhërin për funksionimin e shkollave vllehe. MA theksonte se kjo kompetencë, në qoftëse e shihte të arsyeshme, i takonte asaj. Por MPB arsyetonte veprimin e saj si në përputhje me angazhimet që shteti shqiptar kishte marrë në LK dhe se kishte vepruar në mënyrë të

³⁷⁶ Robert Collaku, *Arumunët e Shqipërisë, histori dhe dokumente-figura të shquara*, vep. e cit., f. 48.

ngjashme si në rastin e shkollave grekofone në jug dhe shkollës serbe në Shkodër. Shkollat rumune do të qëndronin hapur edhe pas vendimit të marrë, në korrik të 1922 nga Këshilli i Ministrave, për mbylljen e shkollave private. Në fillim të vitit 1924 në Shqipëri funksiononin disa shkolla rumune. Në qytetin e Korçës funksiononin dy shkolla: një për vajza dhe tjetra për djem, të përbëra nga katër klasa me dy mësues secila.³⁷⁷ Mësuesit ishin nënshtetas shqiptarë, me përjashtim të njërit që ishte nënshtetas serb. Në Plasë, kishte një shkollë për vajza dhe një për djem me dy mësues, njëri prej të dyve ishte nënshtetas serb. Përsa i përkiste shkollës së vajzave, mësuesi ishte nënshtetas serb. Në Shpëskë, kishte vetëm një shkollë për djem me katër klasa dhe një mësues, që ishte nënshtetas shqiptar.³⁷⁸

Ajo që binte në sy, ishte fakti që qeveria shqiptare po lejonte që zhvillimi i mësimin në shkollat vllehe të kryhej nga shtetas të huaj, gjë që nuk tolerohej nga asnjë shtet ballkanik dhe ishte në kundërshtim me Traktatet e LK. Ky fenomen do të ndalohej me ardhjen në pushtet të qeverisë së Nolit, e cila do të ndërmernte një sërë masash për këtë qëllim. Shkollat vllehe do të funksiononin rregullisht por, do të ndaloheshin të jepnin mësim ata mësues që nuk ishin nënshtetas shqiptarë. Gjatë vitit 1925 qeveria shqiptare jepte pëlqimin për hapjen e 2 konvikteve dhe 2 shkollave fillore në Tiranë si dhe nga një shkollë mikse në Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Përmet. Qeveria e bënte të ditur këtë vendim nënshtetasve nëpërmjet një komunikimi. Në këtë komunikim, theksohej se për të përmbushur kërkesën e paraqitur nga Rumania, do të krijoheshin të gjitha lehtësitat për hapjen e shkollave rumune në komunat me popullsi arumune. I vetmi kusht që kërkohej nga qeveria për çeljen e këtyre shkollave, ishte që ato të kërkoreshin nga bashkësitë përkatëse.

³⁷⁷ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f. 633.

³⁷⁸ Po aty, f. 633.

Kupohej se shkollat fillore do të frekuentoheshin nga nxënësit e të gjitha komunave arumune, ku mësimi do të zhvillohej paralelisht edhe në gjuhën zyrtare të shtetit. Përpjekjet e bëra gjatë këtij viti mundësonin që në ato fshatra me popullsi arumune, në një pjesë të shkollave të futej edhe gjuha arumune. Në vitin 1926 në Korçë do të hapej gjimnazi për nxënësit arumun që kishin mësuar në shkollat fillore të Korçës, Plasës dhe Shpëskës.³⁷⁹ Këto iniciativa do të ndëpriteshin në tetor 1927, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së re shqiptare, e cila sipas neneve 206 e 207 parashikonte që arsimi dhe edukimi i shtetasve i rezervohej shtetit. Kjo nënkuptonte, që të gjitha shkollat që u përkisnin pakicave kombëtare apo etno-kulturore, do të shndërroheshin në shtetërore dhe si pasojë programet mësimore do të aprovohej nga shteti. Në këto kushte, në Shqipëri do të ekzistonin vetëm dy shkolla private, një në Korçë dhe një në Shpëskë. Duke parë këtë situatë, Legata rumune në Tiranë i kërkonte MPJ të Shqipërisë të hapte pesë shkolla. Falë kësaj ndërhyrjeje, numri i shkollave arrinte në 7, me 9 kuadro didaktike dhe 485 nxënës. Shkollat ndodheshin në lokalitetet e paraqitura në tabelën e mëposhtëme:

Shkollat arumune në Shqipëri pas vitit 1927, të paraqitura në bazë të numrit të nxënësve dhe personelit për çdo lokalitet:

Lokalitetet	Nr. Mësuesve	Nr. Nxënësve
Korça	3	177
Dishnica	1	32
Voskopojë	1	69
Nica	1	32
Shpëskë	1	48
Llenga	1	62
Grabova	1	65

Tabela nr. 7³⁸⁰

³⁷⁹ Robert Çollaku, *Arumunët e Shqipërisë histori dhe dokumente-figura të shquara*, vep. e cit., f. 49.

³⁸⁰ Po aty, f. 49.

Programi mësimor që ndiqnin këto shkolla ishte në përputhje me direktivat e dhëna nga autoritetet shqiptare, por mësimi zhvillohej në gjuhën rumune. Pagesa e stafit mësimor sigurohej nga shteti shqiptar dhe nga kontributet e konsiderueshme të Rumanisë.³⁸¹ Shkollat që i përkisnin minoritetit etno-kulturor arumun do të mbylleshin përfundimisht me fillimin e Luftës së Dytë Botërore.

6.7. Besimet fetare në Shqipëri

Sipas statistikave në Shqipërinë e viteve 1920-1930 kishte tre fe kryesore dhe popullsia ishte e ndarë në myslimanë, ose siç quheshin ndryshe muhamedanë, katolikë dhe ortodoksë. Ky kriter ndarjeje i popullsisë nuk ishte e njëtrajtshëm në territorin e Shqipërisë, e cila për nga pikëpamja administrative përbëhej nga nëntë prefektuara kryesore. Në tabelën e mëposhtme paraqitet popullsia e prefekturave duke ndjekur përkatësinë fetare.

Popullsia e ndarë në prefektura sipas përkatësisë fetare në Shqipëri në vitin 1923:

Prefekturat	Muhamedanë	Ortodoks	Katolikë	Shuma
Berati	811.125	29.410	-	110.535
Dibra	83.759	1.497	8.740	93.986
Durrësi	71.998	5.231	3.837	81.666
Elbasani	77.444	6.183	-	83.627
Gjirokastra	58.963	60.023	Israel.33	119.019
Korça	65.083	49.176	-	114.259
Kosova	35.166	-	2.987	38.153
Shkodra	28.571	1.896	80.402	120.869
Vlora	27.595	14.799	51	42.445
Shuma	529.694	168.215	96.050	803959

Tabela nr .8³⁸²

³⁸¹ Robert Collaku, *Arumunët e Shqipërisë, histori dhe dokumente-figura të shquara*, vep. e cit., f. 49.

³⁸² Teki Selenica, *Shqipëria më 1923*, Shtypshkronja "Tirana", Tiranë, 1923, f. 7.

Për të patur një kuadër më të thjeshtëzuar të përbërjes së popullsisë sipas besimit fetar, në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna statistikore duke e ndarë Shqipërinë në tre krahina kryesore: Shqipëria e Veriut, Shqipëria e Mesme dhe ajo e Jugut.

Popullsia shqiptare e ndarë në tre krahina sipas përkatësisë fetare dhe përqindja që zë çdo besim fetar në secilën nga këto krahina:

	Shqipëria e Veriut	%	Shqipëria e Mesme	%	Shqipëria e Jugut	%	Shuma	%
Muhamedane	160573	19	254884	31	169218	21	584675	71
Katolike	85098	10	3857		32		88987	10
Ortodokse	2705		36316	5	119194	14	158215	19
	248376		295057		288444		831877	

Tabela nr.9³⁸³

Të dhënat statistikore të tabelës tregojnë qartë se në Shqipëri, 19 % e popullsisë i përkiste fesë ortodokse, 10% fesë katolike dhe 71% e popullsisë së vendit i përkiste fesë islame. Duket qartë që popullsia kristiane (ortodoks dhe katolik) numerikisht përbën një minorancë në krahasim me popullsinë myslimane. Por, siç do trajtohet edhe më poshtë, shteti shqiptar për t'u siguruar të gjitha besimeve të drejta të barabarta, do të deklaronte se Shqipëria nuk kishte fe zyrtare. Duke lexuar tabelën nr. 8, e cila pasqyron ndarjen e vendit në tre krahina kryesore, vihet në dukje fakti që në Shqipërinë e Veriut, ka një mbizotërim të popullsisë të besimit fetar islamik, kurse numri i ortodoksve është pothuajse inekzistent. Popullsia katolike është e përqëndruar në Shqipërinë e Veriut dhe është e papërfillshme në Shqipërinë e Jugut. Një e dhënë interesante që vihet re nga tabela është fakti që në Shqipërinë Jugut, në të cilën jetonte 35% e gjithë popullsisë së Shqipërisë, popullsia që i

³⁸³Justin Godart, *Shqipëria në 1921*, vep. e cit., f. 126.

përket fesë islame përbën 21% të popullsisë, kundrejt 14% të popullsisë ortodokse. Të dhënat statistikore, edhe pse nuk e vënë në dukje, në Shqipërinë e Mesme jetonte një komunitet i vogël izraelit, numri i tyre shkonte në 35 banorë. Numerikisht të krishterët katolikë përbënin minorancën dhe numri i tyre nuk shkonte më shumë se 88.987 banorë. Ata luanin një rol shumë të rëndësishëm pasi mbartnin me vete vulën e kulturës perëndimore që i diferenconte në mënyrë të prerë nga bashkësitë e tjera të vendit. Fakti që gjeografikisht vendi kishte prirje të shkonte drejt perëndimit të zhvilluar, si ekonomikisht ashtu dhe kulturalisht, u jepte katolikëve një vend të rëndësishëm në zhvillimin e shtetit modern. Katolikët vareshin nga pushteti i Romës dhe në Shkodër qëndronte një përfaqësues apostolik.³⁸⁴ Kleri katolik, nga pikëpamja fetare ishte i përbërë nga arqipeshkvi dhe ndahej në pesë peshkopata. Kleri katolik ishte shumë aktiv përsa i përkiste çështjes kombëtare dhe ishte pothuajse tërësisht shqiptar. Ai ishte anëtar i kongregacionit të Franceskanve që ishte rekrutuar, gjithashtu, i gjithi brenda vendit.³⁸⁵

Ndryshe ishte situata e jezuitëve, ata kishin gjetur një farë kundërshtie nga populli shqiptar për disiplinën e tyre. Komuniteti katolik në Shqipëri ishte i mbledhur në gjashtë dioqeza që shtriheshin në 115 vendbanime. Këto dioqeza ishin: Arkidioqeza e Durrësit, Arkidioqeza e Shkodrës, Dioqeza e Alessios, Dioqeza e Sapës (Zadrimë), Dioqeza e Pultit dhe Abacia e Oroshit.³⁸⁶ Ortodoksit vareshin nga Patriarka e Konstandinopojës dhe ishin përqëndruar kryesisht në Shqipërinë e Jugut dhe atë Qendrore. Kisha Ortodokse Shqiptare ishte e ndarë në katër metropole: në atë të Korçës, Beratit, Gjirokastrës dhe së fundmi në

³⁸⁴ Justin Godart, *Shqipëria në 1921*, vep. e cit., f. 126.

³⁸⁵ Po aty, f. 127.

³⁸⁶ Marenglen Verli, *Aspekte rreth krijimit dhe zgjidhjes së çështjes shqiptare, Vëllimi I, "KLEAN"*, Tiranë, 2014, f. 136.

mertopolin e Durrësit. Vetëm njëri nga metropolet kishte një qendër në territorin shqiptar, ky ishte ai i Durrësit, i cili më vonë do të zhvendosej në Korçë. Metropoli i Beratit ishte i zhvendosur në Korfuz, ndërsa ai i Gjirokastrës ishte në Janinë.³⁸⁷ Në Shqipërinë e Jugut dhe atë të Mesme kishte pothuajse 155.000 besimtarë që deklararin se i përkisnin fesë ortodokse. Fakti që shtetet fqinje e lidhnin identitetin e tyre kombëtar me fenë ortodokse, i jepte popullsisë ortodokse shqiptare një rol strategjik në formimin e shtetit të ri Shqiptar.

Ndërsa për popullsinë minoritare greke, e cila i përkiste besimit fetar ortodoks, flitej gjerësisht gjatë diskutimeve greko-shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve, në Shqipërinë e Veriut ekzistonte një komunitet i vogël në Shkodër, anëtarët e cilit i përkisnin minoritetit serb. Numri i tyre arrinte në 1.500 persona dhe predikonin fenë ortodokse. Ata ishin vendosur në rrethinat e Shkodrës prej shumë kohësh dhe posedonin një kishë ku mesha mbahej në gjuhën serbe. Kisha prej shumë kohësh ishte nën varësinë e Peshkopatës Ortodokse të Pejës. Para luftërave ballkanike, Peja ishte pjesë e Perandorisë Osmane, dhe Peshkopata e Pejës varej nga Patriarku Ekumenik i Kostandinopojës. Me mbarimin e luftës Peja bëhej pjesë e Malit të Zi dhe më pas do t'i bashkohej Mbretërisë serbo-kroate-slllovene. Kjo do të thoshte që Peshkopata e Pejës, bëhej pjesë e Kishës Autoqefale Serbe dhe si rrjedhojë famullia e Shkodrës do të lihej nën juridiksionit e kishës serbe. Kjo parashikohej të ndodhte para krijimit të shtetit të pavarur shqiptar. Kur Shqipëria do të bëhej një shtet i pavarur dhe sovran, patriarku serb e konsideronte të nevojshme që të përfaqësohej në Shkodër, për sa kohë që famullia të qëndronte nën juridiksionin eklesiastik të saj. Qëllimi i Kishës Autoqefale Serbe ishte që të krijonte peshkopatën e Shkodrës dhe të

³⁸⁷ Justin Godart, *Shqipëria në 1921*, vep. e cit., f. 127.

dërgonte një vartës të saj, i cili në të ardhmen duhej të bëhej peshkopi i kishës shqiptare kur kjo të formohej. Sigurisht, qeveria serbo-kroate-slllovene ishte në favor të krijimit të një kisha ortodokse të pavarur në Shqipëri dhe ofronte gjithë mbështetjen e saj. Qeveria shqiptare nuk e aprovonte emërimin e peshkopit pasi në vend po krijohet Kisha Autoqefale Shqiptare. Kisha e pavarur do t'i shtrinte shërbimet e saj në gjithë territorin shqiptar duke përfshirë edhe territorin e Shkodrës. Qeveria nuk e shikonte të arsyshme krijimin e një peshkopati në Shkodër, sidomos duke pasur parasysh faktin që numri i famullisë ishte shumë i vogël. Myslimanët numerikisht në raport me besimtarët katolikë dhe ortodoks përbënin mazhorancën në popullsinë e shtetit shqiptar. Nga të dhënat e paraqitura më lartë, Shqipëria kishte një popullsi prej 831.877 nga të cilët 584.675 deklararin që ishin besimtarë të fesë islame. Prezenca e një numri të lartë nënshtetasish shqiptarë që i përkisnin fesë islame, ishte përdorur shumë herë nga propaganda serbe dhe ajo greke për ta etiketuar Shqipërinë si një “Turqi e Vogël”. Kuptohet që kjo politikë denigruese e shteteve fqinj kishte si qëllim aneksimin e trojeve shqiptare. Ky raport superioriteti i besimtarëve myslimanë nga ana statistikore ishte më i theksuar në Shqipërinë e Veriut dhe atë Qendrore. Përkundrazi në Shqipërinë e Jugut, raporti ndërmjet popullsisë ortodokse dhe asaj myslimane ishte më i balancuar. Kjo vinte si pasojë e prezencës kostante në këto zona të kishës greke, e cila e ndihmuar edhe nga shkollat ku mësohej gjuha greke, predikonte ortodoksizmin si të vetmin besim autentik të bekuar nga zoti. Muhamedanët, siç quheshin nga shtetet evropiane, nuk kishin një udhëheqës të lartë në Shqipëri. Hierarkia e vjetër fetare dhe gjyqësore e tyre do të ruhej nga qeveritë që do të vijonin, në mënyrë që të shmangnin konflikte fetare të mundshme. Edhe pse shteti paguante kadië dhe myftitë, të cilët kryenin funksione të ngjashme me gjykatësit, kjo nuk do të thoshte se Shqipëria kishte

fe zyrtare.³⁸⁸ Kadiu ishte kompetent në fushën e divorcit, të martesës dhe me vdekjen e babait rregullonte të drejtat e fëmijëve. Myftiu ishte këshilltari kryesor i kadiut, ai ishte më shumë këshillues ndërgjegjje për çështjet rrëfyestore.³⁸⁹ Këto figura fetare, vepronin në përputhje me Art. 2 të “Deklaratës mbi Minoritetet”, e cila në paragrafin e tretë të këtij artikulli thoshte se: masa të përkatëshme do të merren për muhamedianët për rregullimin, të njësuara me zakonet muhamedane, të çështjeve të drejtave femënore edhe të statutit personal. Edhe pse ky paragraf është i pa qartë në specifikimin e këtyre masave, shteti shqiptar zgjidhte që të mos ndërhynte në çështjet e komunitetit islamik. Duke analizuar popullsinë, ajo që binte në sy në Shqipëri ishte fakti se, ndryshe nga çfarë do të ndodhte në rajon, besimtarët e ndanin besimin e tyre nga kombësia. Gjatë viteve 1920-1930, propaganda e huaj kishte përhapur idenë se, myslimanët identifikoheshin si turq dhe ortodoksët si grekë. Këto ide ishin të pabazuara pasi myslimanët, ortodoksët dhe katolikët kishin bashkëpunuar ndërmjet tyre për të konsoliduar gjithnjë e më shumë unitetin kombtar shqiptar.

6.8. Laiciteti i shtetit shqiptar si garanci e të drejtave të minoriteteve fetare

Shqipëria gjatë viteve 1920-1930 ishte një shtet me administratë qendore të fortë ku pushteti lokal luante një rol dytësor. Shteti shqiptar ishte unitar i ndarë në 9 prefektuara, 31 nënprefektuara, 80 krahina dhe 2538 katunde.³⁹⁰ Numri i popullsisë, sipas regjistrimeve të bëra në atë kohë, arrinte në 803.959 banorë. Kjo popullsi ndahej në tre besime fetare, të

³⁸⁸ Justin Godart, *Shqipëria në 1921*, vep. e cit., f. 128.

³⁸⁹ Po aty, f. 128.

³⁹⁰ Teki Selenica, *Shqipëria më 1923*, Shtypshkronja “Tirana”, Tiranë, 1923, f. 7.

cilat ishin: katolicizmi, ortodoksizmi dhe myslimanizmi.³⁹¹ Kjo karakteristikë unike e përbërjes së popullsisë shqiptare shpesh herë ishte një problem, si i jashtëm ashtu dhe i brendshëm. Shumë herë larmia fetare në Shqipëri përdorej si armë nga shtetet fqinje, të cilët kërkonin të zgjeroheshin në kurriz të shtetit të brishtë shqiptar. Atdhetarët dhe politikanët shqiptarë për t'i bërë ballë rreziqeve që i kanoseshin vendit gjatë Kongresit të Lushnjës votonin dhe shpallnin Statutin e Zgjeruar të Lushnjës. Statuti në kapitullin e dytë, të titulluar dispozita të ndryshme, neni 93, deklaronte se:

- Shteti shqiptar s'ka fe zyrtare. Të gjitha fetë e besimet fetare janë të nderuara dhe liria e ushtrimit dhe e praktikimit të tyre është e siguruar. Feja nuk mund të formojë pengime juridike me asnjë mënyrë. Fetë e besimet kurrsesi nuk mund të përdoren për qëllime politike.³⁹²

Neni 93 i Statutit, i cili ishte mjaft përparimtar për kohën, shprehte qartë laicitetin e shteti shqiptar. Sanksionimi i laicitetit të shtetit tregonte idetë konkrete të elitës politike shqiptare, e cila mundohet të garantonte një shtet me standarde evropiane, ku pushteti shpirtëror ishte i ndarë nga pushteti politik. Legjislatori duke kuptuar rëndësinë dhe vështirësinë në të cilën ndodhej shteti shqiptar i porsaformuar, lejonte dhe siguronte ushtrimin dhe praktikimin e fesë. Ky kalim tentonte të parandalonte përdorimin e fesë si faktor destabilizues, si nga faktorët e brendësh ashtu dhe nga ata të jashtëm të vendit. Neni 93 i Statutit e përcaktonte qartë, duke nënvizuar se besimet fetare kurrsesi nuk mund të përdoren për qëllime politike. Parimi i laicitetit konfirmohej përsëri si nga Statuti i

³⁹¹ Teki Selenica, *Shqipëria më 1923*, Shtypshkronja "Tirana", Tiranë, 1923, f. 7.

³⁹² Aleks Luarasi, *Akte Juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri*. Vep. e cit., f. 77.

Zgjeruar i Lushnjës edhe nga Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare. Ky parim nuk kishte si qëllim vetëm ndalimin e destabilizimit të vendit por, garantonte njëkohësisht minoritetet fetare të krishtera nga mazhoranca myslimane. Laiciteti ishte në përputhje të plotë me impenjimet e marra nga Shqipëria në momentin e aderimit në LK. Art. 2 i “Deklaratës mbi minoritetet”, nënvizonte faktin se: gjithë nënshtetasve të Shqipërisë do t’u jepej mbrojtje e plotë e jetës dhe e lirisë së tyre, pa ndryshim lindje, kombësie, gjuhe, race e feje. Paragrafi i dytë ishte më konciz pasi deklaronte se: të gjithë banuesit e Shqipërisë do të kenë të drejtë të përdorin lirisht fenë dhe besimin e tyre gjersa këto të mos jenë në kundërshtim me qetësinë publike dhe me zakonet. Secili do të ketë të drejtë të nderojë fenë. Zgjedhja që bënte shteti shqiptar që mos të kishte fe zyrtare, mbronte në mënyrë indirekte të drejtat e minoriteteve fetare duke u garantuar autonomi të plotë në predikimin e tyre.

Ndërkohë, të gjitha kuvendet shqiptare, para dhe pas pavarësisë së Shqipërisë e orientonin ndërtimin dhe funksionimin e shtetit shqiptar si një shtet në shkëputje të plotë nga pushteti shpirtëror. Të gjitha dokumentet themelore që do të aprovoreshin nga shteti shqiptar, do të sanksiononin ndarjen e fesë nga autoriteti shtetëror dhe do të saktësonin vetëm detyrat shpirtërore të drejtuesve fetarë në Shqipëri. Por edhe pse shteti shqiptar e kishte shpallur shumë herë laicitetin e tij, nuk ngurohej të bëhej regjistrimi i popullsisë sipas ndarjes fetetare. I tillë ishte regjistrimi i bërë në vitin 1930, me indeksin sipas përbërjes fetare të shqiptarve që jetonin në Mbretërinë Shqiptare. Në regjistrimet zyrtare rezultonin rreth 1 milion banorë, prej të cilëve, 696 mijë ishin shqiptarë të besimit islamik, (200 mijë i të cilëve i përkisnin sektit bektashi), 200 mijë ishin të besimit ortodoks, 105 mijë të besimit katolik, 204 izraelitë, 70 protestantë dhe 24 ateistë. Objektet e kultit të

regjistruara ishin si me poshtë: 1127 xhami, 260 teqe dhe xhami të bektashive, 844 kisha dhe 70 manastire të ortodoksëve si 147 kisha katolike. Këto raporte ishin trashëguar që pas krijimit të shtetit të pavarur shqiptar.³⁹³

6.9. Statuti legal i komuniteteve fetare

Statuti legal i komuniteteve fetare, ratifikohet nga parlamenti më 5 qeshor 1923 dhe aprovohej nga Këshilli i Lartë më 14 qeshor 1923.³⁹⁴ Statuti ishte një dokument, i cili përveçse nënvizonte të drejtat dhe detyrimet e komuniteteve fetare, shpallte pavarësinë e tyre nga shteti shqiptar. Ai ishte një dokument i thjeshtë dhe përbëhej nga disa nene, që po i rendisim si më poshtë:

1. *Liria dhe ndërgjegjja janë të siguruara sipas nenit 93 të Statutit dhe të neneve 1-2, të deklaruara në tetor 1921 dhe votuar nga Parlamenti.*
2. *Çdo degë e myslimanizmit, si Sunizmi, Bektashizmi, Rufaizmi, Halvetizmi, Kadrizmi etj, ashtu edhe ç'do degë e krishtërit, si Katolicizmi, Ortodoksizmi, Protestantizmi, si dhe të gjitha degët e ç'do feje tjetër, mund të organizohen në shoqata fetare të pavarura nga njëra-tjetra.*
3. *Secila shoqat fetare ose besimtare mund të ketë vetëm lidhje shpirtërore dogmatike me qendrat e mëdha fetare jasht Shqipërisë. Marrëdhëniet dhe letër-shkëmbimet midis tyre në këtë fushë, janë të lira pa ndërhyrje nga ana e qeverisë.*

Paria fetare e lartë duhet të ketë këto cilësi:

- a) *Të jetë nënshtetas shqiptar.*
- b) *Të dijë gjuhën shqipe.*
- c) *Të gëzojë të drejta civile dhe politike.*
- d) *Të jetë nga raca shqiptare ose nga familje që jeton prej tre brezash në Shqipëri.*

Nuk mund të zgjidhen në pari ata, të cilët zotëronin këto tituj fetarë në Shqipëri pas 28 nëntorit 1912 dhe që kishin luftuar kundër Pavarësisë së Shqipërisë.

³⁹³Enver Bytyci, *Shqiptarët, serbët dhe grekët*, vep. e cit., f. 195.

³⁹⁴Luan Omari, *Çështja e pakicave kombëtare*, vep. e cit., f. 50.

Me një ligj të posaçëm mund të jepej aprovimi edhe për persona që nuk i kishin cilësitë e lartpërmendura. Klerikët e shkallëve të tjera, duhet të kenë të gjitha cilësitë e përmendura në këtë nen.

Përfshihen nga paragrafi b. i këtij neni klerikët e viseve shqiptare ku nuk flitej gjuha shqipe.

Kryetarët e çdo feje dhe e çdo sekti do të zgjidhen sipas statuteve të tyre. Në ceremonitë zyrtare, pjesëmarrja i përket më të vjetërve në emërim.

4. *Secila shoqatë, komunitet dhe institucion fetar: si xhami, teqe, kisha, manastire etj, njohen si person moral dhe përfaqësohen sipas rregullave fetare të tyre.*

Këta kanë të drejtë të zotërojnë dhe të tjetërsojnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe të drejta të tjera civile në përputhje me natyrën e tyre; si dhe kanë të drejtë të administrojnë pasuritë e veta; shteti ruan të drejtën e kontrollit mbi administrimin e pasurisë dhe mbi llogaritë vjetore të tyre sipas ligjit të veçantë për shoqatat.

Secila shoqatë ose komunitet fetar a besimtar ka të drejtë, të zotërojë, të mbajë, të drejtojë dhe kontrollojë me shpenzimet e veta xhami, kisha, teqe, manastire dhe faltore të tjera, ashtu si dhe aksesoret e tyre, gjithashtu dhe shoqata bamirëse pa asnjë pengesë ose formalitet, duke u nënshtruar vetëm ligjeve të bashkisë për godinat.

5. *Shoqatat kanë të drejtë të vendosin dënime disiplinore mbi klerin dhe nënpunësit e vet.*
6. *Këto ligje hyjnë në fuqi që nga dita e shpalljes.*
7. *Ministria e Drejtësisë ngarkohet me zbatimin e këtij ligji.³⁹⁵*

Neni i parë i Statutit, nënvizonte edhe një herë me vendosmëri respektimin e parimit të laicitetit të shtetit shqiptar, i cili ishte shprehur në nenin 93 të Statutit të Lushnjës dhe më pas në Statutin e Zgjeruar të Lushnjës. Neni 2 i Statutit Legal, u njohte të drejtën të gjitha komuniteteve në Shqipëri, që të organizonin dhe formonin shoqata fetare të pavarura. Siç mund të kuptohet, pavarësisht, përhapjes dhe rëndësinë numerike që kishin në Shqipëri, besimet fetare kishin të drejta të barabarta. Ky nen ishte në përputhje të plotë me Art. 5 të “Deklaratës mbi minoritetet”. Por, njëkohësisht ishte edhe një përgjigje kundër atyre shteteve që e paraqisnin Shqipërinë si një shtet ku minoriteti fetar i krishterë ishte i diskriminuar. Neni 3 kishte një rëndësi të veçantë pasi shprehte qartë pavarësinë e

³⁹⁵MPJ, dosja 210, Tiranë, 1923, f. 5.

shoqatave fetare e besimtare nga qendrat e mëdha fetare jashtë Shqipërisë. Rëndësia a kësaj pavarësie bie në sy, pasi kisha ortodokse, një vit më para se të aprovohej Statuti, kishte shpallur pavarësinë nga Patriarka e Stambollit dhe po mundohej të përforconte riorganizimin e brendshëm të saj.

Parimi i pavarësisë, përforcohej edhe më shumë po të analizohen paragrafet e këtij neni. Ata shprehin qartë kriteret që duhet të gëzonte çdo nënshtetas për t'u bërë pjesë e klerit të lartë fetar. Ai duhet të ishte nënshtetas shqiptar, të dinte gjuhën shqipe, të gëzonte të drejta civile e politike dhe mbi të gjitha duhej të ishte prej racës shqiptare. Përsa i përkiste të drejtave të pakicave, ky nen parashikonte, në një nga pikat e tij, përjashtimin e paragrafit b, që kishte të bënte me gjuhën. Statuti në përputhje me “Deklaratën mbi mbrojtjen e minoriteteve”, parashikonte mundësinë, në ato zona ku flitej në gjuhë tjetër, të zgjidhej një kler që nuk zotëronte gjuhën shqipe. Si përfundim, Statuti legal i komuniteteve fetare u garantonte komuniteteve autonomi ndaj ndërhyrjes së shtetit. Kjo autonomi kishte të bënte jo vetëm me administrimin e pasurive, të luajtshme dhe të paluajtshme, por edhe në emërimin e personelit dhe masat disiplinore që do të merreshin ndaj tyre. Shteti nga ana e tij ruante të drejtën e kontrollit mbi administrimin e pasurisë dhe mbi llogaritë vjetore të tyre. Këto kontrolle, sigurisht, do të kryeshin sipas ligjeve në fuqi që ekzistonin në atë kohë. Statuti legal ishte një dokument i rëndësishëm, pasi respektonte parimin e laicitetit të shtetit dhe garantonte pavarësinë e Shqipërisë nga ndërhyrjet e jashtme destabilizuese me karakter fetar. Aspekti tjetër interesant i këtij dokumenti ishte mbrojtja dhe garantimi i çdo besimi fetar që të organizohej dhe të kishte shoqatat e veta. Këto të drejta të komuniteteve fetare ishin në përputhje me impenjimet që Shqipëria kishte marrë në planin ndërkombëtar.

6.10. Krijimi i Kishës Autoqefale Shqiptare nën frymën e respektimin të minoriteteve

Ndërkohë që atdhetarët përpiqeshin për njohjen e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare si shtet i pavarur dhe sovran, edhe klerikët ortodoks shqiptarë ishin duke punuar për krijim e një kishe të pavarur nga Patrikana e Stambollit.³⁹⁶ Pasi kjo e fundit kishte mbajtur gjithmonë një qëndrim antishqiptar, duke punuar në mbështetje të ideve ekspansioniste të shtetit grek. Patriotët shqiptarë ortodoks ishin të bindur se për të çliruar bashkë-besimtarët e tyre nga ndikimi grek dhe për t'u kthyer atyre ndërgjegjjen kombëtare nevojitej një kishë ortodokse shqiptare e pavarur.³⁹⁷ Qysh prej 1909 patriotët dhe nacionalistët ortodoks shqiptarë të Korçës kishin shpallur autoqefalinë e Kishës Ortodokse, për këtë arsye shumë prej tyre ishin persekutuar dhe sulmuar nga ana e kishës greke duke i martirizuar ata. Këtë fat do të kishin, në fund të shekullit të XIX dhe fillim të shekullit XX, Petro Nini Luarasi e Papa Kristo Negovani.³⁹⁸ Ishin pikërisht këto intimidime të kishës greke, që i detyruan shqiptarët të shpallnin pavarësinë e Kishës Ortodokse Shqiptare. Pas aktit të patriotëve korçarë, do të ishin shqiptarët e Amerikës të udhëhequr nga Fan Noli që më 1919, të vendosnin krijimin e Kishës Autoqefale Shqiptare. Ai bashkë me disa klerikë ortodoks shqiptarë transferoheshin nga Amerika në Korçë, ku do të përqëndronin forcat e tyre për krijimin e një kishe ortodokse kombëtare shqiptare. Ata mbështeteshin nga shumë patriotë, shumica e të cilëve ishin kthyer nga Amerika, dhe qeveria shqiptare.³⁹⁹ Patriotët

³⁹⁶ C 7811, *The enquiry in Southern Albania, Report by the Commission of Enquiry*, League of Nations, 2 May 1923, f. 44.

³⁹⁷ Roberto Moroco dela Roka, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, vep. e cit., f. 45.

³⁹⁸ Enver Bytyci, *Shqiptarët, serbët dhe grekët*, vep. e cit., f. 208.

³⁹⁹ MPJ, dosja 211, *Komisioni i hetimeve në Shqipëri, Raporti i veprimtarisë që nga dhjetori deri 19, 1922 deri më 1 shkurt 1923*, Lidhja e Kombeve, 1923, f. 6.

shqiptarë konfiskonin disa nga kishat e Korçës dhe fillonin mbajtjen e meshave në gjuhën amtare. Këto veprime irritonin një pjesë të popullsisë ortodokse, e cila protestonte duke mos shkuar në kishë, kur mbaheshin meshat në gjuhën shqipe. Në tentativë për të shmangur trazira, vendosej të mbahej në Berat një kongres ku do të merrnin pjesë delegatët e gjithë komuniteteve ortodokse shqiptare. Kongresi mbështetej në ligjet e shenjta dhe në rregulloren e Kishës Ortodokse Lindore, të cilat proklamnin ndarjen e pushtetit shpirtëror nga ai shtetëror.⁴⁰⁰

Në Kongresin e Parë të Pan-Ortodoksisë Shqiptare, mbajtur më datën 11 gusht 1922 në qytetin 2500 vjecar të Beratit, shpallej përfundimisht pavarësia e Kishës Ortodokse Shqiptare.⁴⁰¹ Kongresi vendoste t'i kërkonte Patriarkatës që të aprovonte dhe mbështeste këtë vendim. Patriarkata jepte një mendim të favorshëm dhe dërgonte në Korçë një përfaqësues me fuqi të plota. Përfaqësuesi deklaronte se Patriarka njohte legalitetin e kongresit të Beratit, ishte në favor të krijimit të kishës së pavarur shqiptare dhe do të merrte të gjitha masat e nevojshme për të konfirmuar ndarjen e kishave. Më vonë Patriarka e Stambollit do të ndryshonte qëndrimin e saj, duke deklaruar se përfaqësuesi që ajo kishte dërguar në Shqipëri, i ishte dhënë mandat vetëm që të hetonte mbi çështjen e pavarësisë së kishës. Gjithashtu, sipas kësaj deklarate, karakteri i kishës së pavarur shqiptare nuk do të lidhej me formimin e një kishe autoqefale, e kryesuar nga një Patriarkat, por do të ishte një kishë autonome, e cila do të qëndronte nën varësinë e Patriarkatës së Stambollit. Statusi i autonomisë nënkuptonte që ortodoksve shqiptarë u lejohej kremtimi i liturgjive në gjuhën

⁴⁰⁰MPJ, dosja 210, *Kisha Orthodhokse Autoqefale Kombëtare e Shqipërisë*. Tiranë, 1923, f. 53.

⁴⁰¹ Aben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, vep. e cit., f.337

shqipe dhe zgjedhja e priftërinjve nga ana e tyre.⁴⁰² Patriarka do të rezervonte të drejtën e emërimit të peshkopve. Por ky qëndrim binte në kundërshtim me Kongresin e Beratit, i cili gjatë punimeve të tij parashtronte këto kërkesa:

- I. Metropolit duhet të ishin shqiptare;
- II. Gjuha e përdorur gjatë shërbimeve të shenjta fetare, duke përmblajtur dhe atë të meshës, të ishte gjuha shqipe. Përgjatë duhet të bënin ato kisha që frekuentoheshin nga minoriteti grek në rrethin e Gjirokastrës;
- III. Për sa kohë që do të kishte një numër të pamjaftueshëm priftërinjesh që nuk e zotëronin mirë gjuhën shqipe, ata ishin të detyruar të lexonin lutjet në shqip dhe po të ishte e mundur të shkruanin nga ungjilli lutjet e zotit në shqip;
- IV. Kisha e parë shqiptare duhet të merrte bekimin nga Patriarka dhe të ishte në gjendje të kryente shenjtërimin e klerit të ulët.⁴⁰³

Kongresi i jepte mundësi si komunitetit grekofon dhe atij shqiptar, të vendosnin vet se në çfarë gjuhe duhet të kryheshin shërbimet dhe celebrimet kishtare. Komuniteti ortodoks i Gjirokastrës, nuk merrte pjesë në punimet e këtij kongresi, pasi kishte frikë se pjesëmarrja e tyre do të binte ndesh me dëshirën e Patriarkës së Stambollit.⁴⁰⁴ Edhe pse ky komunitet nuk dërgonte delegatet e tij në Kongresin e Beratit, ai mbante një qëndrim pozitiv kundrejt formimit të Kishës Autoqefale Shqiptare. Komuniteti protestonte vetëm për keqtrajtimin që i bëhej Shën Athanasios, i cili do të burgosej për disa javë sepse nuk

⁴⁰² C 7811, *The enquiry in Southern Albania, Report by the Commission of Enquiry*, League of Nations, 2 May 1923, f. 44.

⁴⁰³ C 7811, *Commission of Enquiry in Albania, Report of Activities from December 19th, 1922 to February 1st, 1923*, J.J. Sederholms, 2 May 1923, f. 44.

⁴⁰⁴ MPJ, dosja 211, Komisioni i hetimeve në Shqipëri, Raporti i veprimtarisë që nga 19 dhjetori 1922 deri më 1 shkurt 1923, Lidhja e Kombeve, 1923, f. 6.

kishte marrë pjesë në punimet e kongresit të Beratit.⁴⁰⁵ Për qëndrimin e tij, Shën Athanasios nuk do të emërohej zëvendës i Metropolit të Gjirokastrës, edhe pse ai arrinte të siguronte pjesën më të madhe të votave të popullsisë ortodokse. Në vendin e tij do të emërohej At Pano, i cili nuk gëzonte një simpati të madhe tek popullsia ortodokse.⁴⁰⁶ Emërimi i At Panos, gjithësesi, ishte i përkohëshëm dhe kështu dukej se dëshira e komunitetit do të plotësohej nga kisha e pavarur shqiptare.⁴⁰⁷

Ndryshe ishte gjendja në Korçë, ku mbizotëronte një klimë pozitiviteti dhe kënaqësie për krijimin e një kisha të pavarur shqiptare. Delegatët e pranishëm në Kongresin e Beratit, arrininin të formulonin dhe nënshkruanin një statut, i cili do të kishte një peshë të madhe në formimin e Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare Shqiptare. Statuti përbëhej nga 14 nene (ose nyje siç paraqitej në Statut) dhe dekretonte pavarësinë e Kishës Ortodokse Shqiptare. Art. 1 theksonte se: Kisha Ortodokse Autoqefale Kombëtare e Shqipërisë ishte pjesë e pandashme e Kishës së shenjtë të përgjithshme e Apostolike të të gjithë Ortodokseve. Ajo përbëhej nga të gjithë banorët e shtetit shqiptar që i besonin Krishtit.⁴⁰⁸ Art. 2, i referohej organizimit të kishës në territorin e shtetit shqiptar. Artikulli parashikonte se: paria më e lartë kishtare do të ishte Sinodi i përhershëm i përbërë prej peshkopësh kanonike nën kryesinë e një mitropoliti.⁴⁰⁹ Ky Sinod do të kishte titullin “Sinod i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë” dhe do të qëndronte në kryeqytet. Në pritje që të formohej “Sinodi i Shenjtë”, Statuti vendoste që Kisha Autoqefale Shqiptare

⁴⁰⁵ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi Kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, vep. e cit., f.353.

⁴⁰⁶ C 7811, *The enquiry in Southern Albania, Report by the Commission of Enquiry*, League of Nations, 2 May 1923, f. 44.

⁴⁰⁷ MPJ, dosja 211, Lidhja e Kombeve, 1923, f. 7.

⁴⁰⁸ *Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë*, Shtyp.& Libraria Dhorë Koti Korçë, Korçë, 1923, f. 3.

⁴⁰⁹ Po aty, f. 4.

të drejtohej përkohësisht nga një Këshill i Lartë i përbërë prej katër klerikësh dhe katër laikësh nën kryesinë e një kleri. Ky Këshill do ta kishte qendrën e tij në Korçë dhe anëtarët e tij do të zgjidheshin nga Kongresi. Art. 6 parashikonte që Këshilli i Lartë do të kishte si detyrë edhe të kontrollonte gjithë pasurisë të kishave, të manastirave dhe pasuritë e lëna për qëllime mirëbërëse.⁴¹⁰ Statusi paraqitej përpara Kongresit të Beratit dhe nëpërmjet nënshkrimit të anëtarve merrej aprovimi i tij.⁴¹¹ Pavarësisht vendimeve të marra gjatë Kongresit të Beratit, Patriarkana e Stambollit nuk do ta njohte pavarësinë e Kishes Autoqefale Shqiptare. Ky kundërshtim bazohej në rregulloren, sipas së cilës në shtetin e interesuar për autoqefalinë ortodoksë duhej të përbënin shumicën e popullsisë së tij.

Një kusht i tillë ishte e qartë se nuk plotësohej në rastin e Shqipërisë. Patriarkana Ekumenike do të dërgonte në vitin 1926, në Tiranë metropolin e Trebizontës, i cili ishte ngarkuar me detyrën që të caktonte përfundimisht statusin e Kishës Ortodokse Shqiptare. Në gusht të po atij viti arrihej një marrëveshje me delegacionin shqiptar, të zgjedhur nga qeveria e Tiranës. Marrëveshja parashikonte që, shërbesat fetare në kishat ortodokse të kremtoheshin në gjuhën shqipe, e cila në këtë mënyrë njihej si gjuhë liturgjike. Veç kësaj bashkësisë ortodokse shqiptare i jepej e drejta që të caktonte kandidatët peshkopë, të cilët do të përbënin Sinodin e Shenjtë.⁴¹² Marrëveshja arrihej falë forcimit të pushtetit të Ahmet Zogut, i cili ishte një mbështetës i vendosur i kombëtarizimit të bashkësive fetare në Shqipëri. Kjo marrëveshje do të kontestohet në fillim të vitit 1927, kur Patriarka Ekumenike e Stambollit do të kërkonte që të emëronte peshkopët e parë dhe të zgjidhte

⁴¹⁰ *Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë*, Shtyp. & Libraria Dori Koti Korçë, Korçë, 1923, f. 6.

⁴¹¹ Po aty, f. 6.

⁴¹² Albert Mousset, *Shqipëria përballë ...*, vep. e cit., f. 113.

kryetarin e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Shqiptare. Kjo kërkesë hidhej poshtë nga qeveria shqiptare dhe si pasojë Kisha Ortodokse Shqiptare ndahej në dy grupe: në “kombëtarë” dhe në “patriakanë”. Kjo situatë zgjidhej në shkurt të 1929 me krijimin e Sinodit të Shenjtë, i cili përbëhej nga pesë peshkopë dhe zgjidhte në krye imzot Visarionin. Selia peshkopale zgjidhte ta kishte qendrën e saj në qytetin e Korçës. Krijimi i Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Shqiptare kundërshtohej me vendosmëri nga Kisha Ortodokse Greke.⁴¹³ Ajo pretendonte se me këtë vendim shkeleshin dhe çënoheshin të drejtat e minoriteteve fetare të “Epirit të Veriut”, për të cilat Patriarka Eumenike simbolizonte vazhdimin e traditës helene. Këto akuza të ngritura nga Kisha Ortodokse Greke nuk merreshin në konsideratë, duke ditur që ortodoksët grekofonë në Shqipëri përbënin një pakicë të vogël të besimtarve ortodoksë. Më 1928, një kongres tjetër Pan Ortodoks Shqiptar do të miratonte statusin e Kishës Ortodokse Shqiptare, parimet e së cilës pasqyroheshin pothuajse në të gjitha ligjet themelore të shtetit shqiptar të asaj kohe. Monarkia shqiptare e Mbretit Zog, jo vetëm e respektonte Statusin Themeltar të Kishës Ortodokse, por e pasqyronte atë në kushtetutën e vendit dhe kontribuonte që pavarësia e Kishës të njihej e të pranohej nga Patriarku i Stambollit.

Në korrik të 1929, qeveria aprovonte Dekret-ligjin mbi formimin e Komuniteteve Fetare, i cili riafirmonte edhe një herë lirinë e fesë dhe pavarësinë e komuniteteve fetare nga shteti shqiptar. Sipas Art.1, çdo shtetas në Shqipëri gëzonte lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë që dëshironte; kjo liri ishte e garantuar me artikujt 5 e 203 të Statutit Themeltar të Mbretërisë. Rëndësi kishte Art.7, pasi sipas tij, kryetarët e feve, subalternet e tyre dhe

⁴¹³ MPJ, dosja 211, *Komisioni i Hetimeve në Shqipëri*, 1923, f. 6.

ndihmësit e zëvendësimit duhej të ishin shtetas shqiptare, të dinin shkrim e këndim lirisht në gjuhën zyrtare. Gjithashtu, këto figura fetare duhej të mos ishin të njohur në Shqipëri për vepra antikombëtare. Pra Qeveria nëpërmjet këtij dekret-ligji riafirmonte edhe një herë vullnetin e saj për forcimin e ndjenjës kombëtare, duke siguruar që kryetarët e feve të ishin shqiptarë dhe shërbesat e tyre të kryeshin në gjuhën zyrtare. Nëpërmjet këtyre masave kërkohesh të eliminohej me çdo forcë ndërhyrjet e shteteve fqinje. Këtë e theksonte Art. 20, i cili parashikonte që komunitetet u ndalohej të pranonin ndihma nga shtetet e huaja, me çdo formë me çdo mënyrë që të jetë. Dispozita e këtij paragrafi shtrihej edhe për ndihmat e ofruara prej shtetasve të huaj.⁴¹⁴ Mbretëria shqiptare ishte e vendosur të vazhdonte në rrugën e ndërmarrë, që kishte si qëllim kombëtarizimin e besimeve fetare, pa cënuar të drejtat e popullsisë minoritare të garantuara nga legjislacioni në fuqi.

Dispozitat e këtij Dekret-ligji përforcoheshin edhe nga Kodi Civil i vitit 1929, i cili parashikonte që shteti të kishte një kontroll sa më efikas mbi shoqatat e ndryshme që operonin në territorin shqiptar. Neni 424 theksonte se shoqatat politike, fetare, shkencore, artistike, mirëbërse, dëfrimi ose të tjera që nuk kanë një qëllim ekonomik, marrin personalitetin kur regjistrohen sipas procedurës të treguar në nenin 410. Ky regjistrim do të bëhej pasi shoqatat të shprehnin vullnetin e vet për t'u organizuar korporativisht dhe të aprovonin statutin.⁴¹⁵ Neni 410 kishte të bënte me dhënien e statusit të personit juridik, i cili aprovohej me dekret mbretëror mbas një mendimi pozitiv nga Këshilli i Ministrave. Por sipas këtij neni, për ato shoqata të cilat nuk kishin një qëllim ekonomik, parashikohej mundësia që ato të regjistroheshin pranë gjykatës së shkallës së parë të vendit ku do të

⁴¹⁴ Dekret-Ligje mbi formimin e Komuniteteve Fetare, Tiranë, 1929, f. 4.

⁴¹⁵ Kodi Civil 1929, Botimet Toena, Tiranë, f. 131.

ushtronin aktivitetin. Gjithashtu, Kodi Civil parashikonte sipas nenit 425, që shoqatat në statutet e veta të përmbanin dispozita të nevojshme mbi qëllimin, mbi të ardhurat dhe mbi organizimin e tyre. Rëndësi kishte edhe neni 427, i cili parashikonte mundësitë kur një shoqate mund t'i hiqej personaliteti juridik. Personaliteti mund të hiqej kur:

- Shoqata ndjek në realitet një qëllim krejt të ndryshëm nga ai që ishte caktuar në statutin e saj.
- Me një vendim të paligjshëm të drejtorisë kompromenton interesin publik.
- Sado sipas statutit të saj nuk ka një qëllim ekonomik por në realitet ndjek një qëllim të tillë.
- Ndonëse statuti i shoqatës nuk tregonte një qëllim politik ose social-fetar, por në realitet ajo ndiqte një qëllim të tillë.⁴¹⁶

Kodi Civil kishte rëndësi të madhe pasi rregullonte veprimtarinë e shumë shoqatave fetare të huaja që vepronin në territorin e Shqipërisë, shumica e të cilave nuk ishin të regjistruara. Këto shoqata shpesh her operonin në fshehtësi kundër interesave kombëtare të vendit. Gjithashtu, shumë shoqata që i përkisnin minoriteteve, veçanërisht atij grek, duke përfituar edhe nga statuti i regjimit të minoriteteve firmosur nga Shqipëria më 1921, siguronin financime nga jashtë vendit dhe i shërbenin propagandës së huaj anti kombëtare. Kodi Civil vepronte duke patur një karakter gjithëpërfshirës dhe nuk kishte karakter diskriminues ndaj minoriteteve siç pretendohet nga disa përfaqësues të këtyre komuniteteve. Gjatë viteve 1920-1930, popullsia minoritare gëzonte liri të plotë të kultit. Ritet në kisha kryeshin në gjuhën amtare, nxënësit merrnin edukim fetar në gjuhën amtare

⁴¹⁶Kodi Civil 1929, Botimet Toena, Tiranë, f. 131.

dhe priftërinjtë caktoheshin nga vetë minoritetet.⁴¹⁷ Por me shpalljen e Mbretërisë, krahas këtyre politikave liberale ndaj pakicave, shteti shqiptar vijonte konsolidimin e institucioneve kombëtare fetare, politike, arsimore dhe kulturore. Këto përpjekje nuk shiheshin me sy të mirë nga shtetet fqinje, të cilët do t'i shtonin përpjekjet e tyre për ndalimin e procesit të stabilizimit të shtetit shqiptar. Por pavarësisht ndërhyrjeve të jashtme, Shqipëria ishte e vendosur ta çonte deri në fund procesin e konsolidimit të shtetit dhe arritja e pavarësisë së Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare ishte kurorëzimi i kësaj politike. Pavarësia e saj do të njihej përfundimisht nga Kisha Ortodokse Greke në vitin 1937, falë përpjekjeve të shumta të atdhetarve shqiptarë.

⁴¹⁷Beqir Meta, *Monarkia. Zogu bëri me prona bujqit minoritarë*, <https://www.shqiperia.com/Monarkia-Zogu-beri-me-prona-bujqit-minoritare-.12186/>

PËRFUNDIME

Vitet 1920-1930 ishin shumë të rëndësishëm për formimin dhe konsolidimin e shtetit shqiptar. Në fakt gjatë kësaj periudhe vendi kalonte një fazë shumë delikate për të ardhmen e tij dhe gjithë sforcimet përqëndroheshin në këtë drejtim duke lënë në plan të dytë çështjen e minoriteteve. Pavarësisht tranzicionit politik që po kalonte vendi, shteti shqiptar nuk nguronte të njihte dhe të ofronte të gjitha garancitë e nevojshme të kohës, për respektimin e të drejtave të popullsisë minoritare. Problemi qëndronte së pari në përkufizimin juridik të termit “minoritet”, pasi gjatë këtyre viteve, jo vetëm legjislacioni i brendshëm shqiptar por, edhe ai ndërkombëtar nuk kishin arritur në një përkufizim të pranuar nga të gjithë. Përfundimisht do të ishte Gjykata e Përherëshme e Drejtësisë Ndërkombëtare të Lidhjes së Kombeve ajo që nëpërmjet një vendimi këshillues do të jepte një përkufizim të termit. Sipas vendimit me këtë term nënkuptohej: një kolektivitet personash që jetonte në një shtet ose lokalitet, të cilët kishin një racë, një fe, një gjuhë dhe tradita të veta, të bashkuar nga identifikimi i asaj race, feje, gjuhe dhe tradite nga një ndjenjë solidariteti, me qëllim që të ruajnë traditat e tyre, format e tyre të kultit, të garantonin shkollimin dhe edukimin e fëmijëve të tyre, sipas ndjenjave dhe traditave të racës së tyre, të cilat mbështeshin reciprokisht.

Shqipëria do të njihte dhe njëkohësisht do të garantonte të drejtat e minoriteteve për herë të parë, gjatë bisedimeve që do të zhvilloheshin në Konferencën e Paqes, për të ardhmen e saj si shtet i pavarur. Kjo Konferencë ndërkombëtare, e cila mbahej pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, do të organizohej për të vendosur fatin e shteteve humbëse që kishin marrë pjesë gjatë konfliktit. Pavarësisht faktit që Shqipëria kishte

shpallur shumë herë neutralitetin e saj, ajo ishte thirrur në këtë Konferencë që të mbronte territoret nga rivendikimet e Greqisë. Shteti helen do të përdorte prezencën e minoritetit grek në Shqipërinë e Jugut për të arritur qëllimin e saj, që ishte zgjerimi i territoreve të saj në dëm të shtetit fqinj. Delegatët grekë, për të bindur Fuqitë e Mëdha që të aprovonin kërkesat e tyre, përveçse paraqisnin të dhëna jo të sakta mbi numrin e popullsisë minoritare greke që jetonte në Shqipërinë e Jugut, mundoheshin ta etiketonin këtë të fundit si një vend me mazhorancë myslimane. Sipas tyre, ortodoksët që përbënin minorancën, rrezikonin t'u mohohet e drejta për të ushtruar besimin e tyre fetar. Greqia e shihte binomin fe-komb të pandarë nga njëri-tjetëri dhe njehësonin kombësinë greke me fenë. Këtë tezë pala greke e përforconte me lidhjen e fortë që kishte kisha ortodokse dhe gjuha greke në ato zona, në trashëgiminë e identitetit kombëtar grek. Kështu sipas saj, lënia e kësaj popullsie në territorin e shtetit të ri shqiptar me mazhorancë myslimane, rrezikonte humbjen e vlerave ortodokse dhe asimilimin e saj.

Delegatët shqiptarë, duke ndjerë rrezikun e copëtimit të vendit, nuk nguronin të theksonin se minoritetet që jetonin në trojet shqiptare do t'u jepeshin të gjitha garancitë që vendet e qytetruara u jepnin minoriteteve që ndodheshin në territoret e tyre. Kjo deklaratë do të ishte impenjimi i parë që Shqipëria edhe pse nëpërmjet delegatëve të saj, do të merrte për mbrojtjen dhe trajtimin e minoriteteve në planin ndërkombëtar. Deklarata bëhej në kohë kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikonte një regjim të posaçëm për këtë pjesë të popullsisë dhe aq më shumë kur në Shqipëri mungonin të dhënat statistikore për të verifikuar numrin real të minoriteteve. Megjithatë, ndryshe nga shtetet fqinje Shqipëria nuk e njehsonte përcaktimin e kombësisë me fenë. Identiteti kombëtar lidhej jo vetëm me

përkatësinë fetare por, dhe me gjuhën e folur, racën, doket, zakonet dhe vlerat e trashëguara ndër shekuj brez pas brezi. Sipas këtyre kriterëve popullsia e Shqipërisë ishte homogjene dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e saj mund të klasifikohej si minoritare.

Trajtimi i çështjes së minoriteve do të zinte një rol të rëndësishëm në legjislacionin e brendshëm me pranimin e Shqipërisë në organizatën ndërkombëtare të LK. Kjo ngjarje kaq e rëndësishme për historinë e shtetit shqiptar do të siguronte njohjen e pavarësisë së vendit nga Fuqitë e Mëdha dhe komuniteti ndërkombëtar. Por, anëtarësimi i Shqipërisë në këtë organizatë do të kushtëzohej me formosjen e një dokumenti, i cili do të përbënte bazën e regjimit të minoriteteve. Dokumenti që do të quhej “Deklarata mbi mbrojtjen e minoriteteve në Shqipëri”, kishte forcë mbi ligjet në vend dhe përbëhej nga 7 artikuj. Aty theksohej se të gjithë ndenjësve në Shqipëri do t’u garantohej një mbrojtje e plotë e jetës dhe lirisë së tyre, pa dallim lindje, kombësie, gjuhe, race dhe feje. Gjithashtu, me firmosjen e këtij dokumenti, shteti shqiptar angazhohej që nënshtetasve që bënin pjesë në minoritete të racës, fesë a të gjuhës, do t’u garantonte të gjitha ato të drejta dhe sigurime që kishin nënshtetasit shqiptarë. Këta do të kishin sidomos të drejtë që të mbanin, të drejtonin e të kontrollonin, me të ardhurat e tyre, apo të krijonin në kohën e ardhme, shkolla mirëbërëse, fetare a shoqërore, shkolla e të tjera ndërtesa mirërritjeje, duke patur të drejtën të përdornin lirisht gjuhën e vet e duke vepruar lirisht në fenë e tyre.

Por, firmosja e deklaratës për mbrojtjen e minoriteteve nuk ishte i vetmi vendim që merrej në lidhje me Shqipërinë. KKK vendoste të dërgonte në vend një komision ndërkombëtar, i cili kishte si detyrë të delineonte vijën kufitare të shtetit të ri shqiptar duke u bazuar në studimin e popullsisë që jetonte në të. Komisioni do të vizitonte gjithë territorin

e Shqipërisë, duke e përshkruar atë nga veriu deri në jug. Zona veriore e vendit nuk kishte probleme me popullsinë minoritare, pasi kjo popullsi ishte shumë e vogël në numër. Këtu problemet ishin më shumë të karakterit politik, ku shteti jugosllav duke përdorur komunitetin e vogël malazez, që jetonte në zonën e Shkodrës, kërkonte të zgjerohej në dëm të territoreve të shtetit shqiptar. Kjo politikë do të qëndronte edhe pas kryengritjes së Marka Gjonit, që më pas do të çonte në formimin e Republikës së Mirditës. Formimi i kësaj republike do të motivohej me nevojën e mbrojtjes së pakicave fetare katolike kundër qeverisë së Tiranës e mbështetur nga mazhoranca myslimane. Por, si përfundim kryengritja do të shuhej si pasojë e ndërhyrjes së LK tek qeveria jugosllave, e cila kishte luajtur një rol vendimtar në përhapjen e saj.

Me mbarimin e hetimeve në zonën veriore, Komisioni do të zhvendosej në drejtim të jugut të Shqipërisë ku do të hetonte mbi prezencën e popullsisë minoritare. Në krahinat jugore kishte një prezencë të theksuar të pakicave greke, të cilat kishin pasur një ndikim të konsiderueshëm në krijimin e kulturës së Shqipërisë së Jugut. Rreth kësaj pakice kishte një mospërputhje me të dhënat që paraqitnin si shteti grek dhe ai shqiptar. Greqia, duke njehsuar fenë me kombësinë, pretendonte se gjysma e popullsisë së kësaj krahine ishte me origjinë greke. Këto të dhëna shteti helen i shtonte me synimin që të aneksonte ato troje që shteti grek i quante “Epiri i Veriut”. Por, hetimet që do të bënte Komisioni Hetimor do të vërtetonin që popullsia minoritare greke që jetonte në Shqipëri nuk do të ishte më shumë se 36.000 banorë. Kjo popullsi ishte e përqëndruar e gjitha në prefekturën e Gjirokastrës, në atë të Korçës dhe në prefekturën e Himarës. Puna që do të zhvillonte Komisioni do të kishte një rëndësi të madhe për shtetin shqiptar, pasi do të vërtetonte se pakicave në vend u

garantoheshin të drejta të barabarta me popullsinë shqiptare. Kjo do të vërtetohet, si me prezencën e një numri të madh shkollash që i përkisanin pakicave, ashtu edhe me predikimin e besimit fetar në gjuhën e tyre amtare. Këto të drejta ishin në përputhje me impenjimet që Shqipëria kishte marrë përpara LK. Në disa zona ku banonin pakicat greke, siç ishte ajo e Dropullit, shkollat që përkisnin kësaj popullate, duke i llogaritur në bazë të përqindjes që ato zinin në këtë zonë, ishin më të shumta në numër se ato që i përkisnin popullsisë shqiptare. Hetimet e Komisionit përgënjeshtrojnë edhe akuzat e ngritura nga Greqia, e cila gjatë kësaj periudhe dhjetëvjeçare do të protestonte shumë herë përpara Asamblesë së LK. Këto protesta do të përforcoheshin edhe nga popullsia minoritare që jetonte brenda territorit të Shqipërisë. Të tilla ishin ato që do të regjistroheshin në krahinën e Himarës, të cilat edhe pse zhvilloheshin kundër reformave të ndërmarra nga qeveria në fushën e arsimit, në realitet kishin karakter ekonomik-politik. Në fillim të viteve '20-të, shteti shqiptar aprovonte disa reforma që kishin si qëllim unifikimin kombëtar të vendit, kurse Himara kishte trashëguar që nga pushtimi otoman një autonomi të veçantë krahinore. Kjo autonomi kishte të bënte më shumë me sistemin e taksave, ku krahinës në fjalë, ndryshe nga pjesa tjetër e vendit, i lejohej të pagonte një taksë vjetore të akorduar me pushtetin qendror. Protestat do të përfundonin me pranimin e popullsisë himariote të sistemit taksor, i cili do të zbatohet nga shteti në gjithë territorin e Shqipërisë.

Por, në Shqipërinë e Jugut faktorët politiko-ekonomikë ndërthureshin me ato fetaro-kulturorë. Kjo ndërthurje herë pas here ashëpërshej kur interesat e popullsisë që i përkisnin besimit mysliman përplaseshin me ato të popullsisë ortodokse. I tillë ishte edhe rasti i zgjedhjeve të përgjithshme, ku ortodoksit e Korçës dhe të Gjirokastrës kërkonin që të

kishin përfaqësuesit e vet politik në vend. Përfaqësuesit ortodoks të krahinave të jugut pretendonin që pushteti lokal të drejtohej nga përfaqësues të përzgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejt nga populli. Këtë propozim e mbështeste edhe Komisioni Ndërkombëtar, i cili mendonte që në këtë mënyrë si pakicat kombëtare dhe ato fetare do të kishin mundësinë të përfaqësoheshin nga kandidatët e tyre. Por ky lloj propozimi ishte i përealizueshëm për kohën, pasi në këtë periudhë edhe kushtetutat e vendeve më të zhvilluara evropiane, nuk i parshikonin të drejtat politike të minoriteteve. Këtë qëndrim e përforconte edhe Ligji i Administratës Civile, i cili parashikonte që drejtuesit dhe nëpunësit lokal të emëroheshin nga pushteti ekzekutiv. Këto kërkesa që vinin nga pushteti lokal dhe i drejtoheshin qeverisë, tregonin që shteti shqiptar ishte akoma i pakonsoliduar. Ky konsolidim, ose përforsim i pushtetit qendror, do të realizohej në respektimin e pakicave kombëtare dhe fetare. Qeveria shqiptare do të ndërmernte dhe aprovonte disa ligje, të cilat kishin si qëllim unifikimin e sitemit arsimor në respekt të diversitetit etnik, gjuhësor dhe fetar.

Niveli i arsimit në Shqipëri në fillim të viteve '20 -të ishte i prapambetur në krahasim me atë të rajonit të Ballkanit. Kjo situatë ishte krijuar si pasojë ndikimit të dy faktorëve që kishin patur një impakt negativ në vend. E para kishte të bënte me pushtimin shekullor të Perandorisë Osmane, i cili nga frika e krijimit të një identiteti kombëtar, ndalonte me të gjitha forcat çeljen e shkollave në gjuhën shqipe. E dyta kishte të bënte me ndikimin e madh që kishte kisha greke në jug të vendit në çeljen e shkollave ku mësimi zhvillohej në gjuhën greke. Gjatë kësaj periudhe, pjesa më e madhe e shkollave që funksiononin në vend ishin shkolla fillore, vetëm një numër i mjaft vogël i tyre mund të klasifikoheshin si shkolla të mesme. Për më shumë kushtet e tyre linin mjaft për të

dëshiruar, pasi strukturat ishin të amortizuara dhe klasat të mbipopulluara me nxënës. Gjatë mezit të viteve '20 - të dhe sidomos, me shpalljen e Shqipërisë Mbretëri, falë ligjeve që aprovonte shteti, situata e sistemit arsimor shkonte drejt përmirësimit. Aprovimi i Statutit Themeltar të Mbretërisë ishte një hap i rëndësishëm për zhvillimin e arsimit në Shqipëri, pasi parashikonte shtetëzimin dhe unifikimin e tij. Sistemi arsimor rregullohej nga Art. 206 dhe 207 të Statutit Themeltar, të cilët parashikonin që arsimi fillor për të gjithë shtetasit shqiptar është i detyrueshëm dhe gjithashtu mbylljen e shkollave private. Por, aprovimi i këtyre ligjeve, sidomos, pjesa që kishte të bënte me mbylljen e shkollave private, kundërshtohej nga komuniteti minoritar grek dhe Greqia. Ata këto kundërshtime i bazonin tek e drejta që u garantonte deklarata mbi mbrojtjen e minoriteteve, e cila u lejonte pakicave të mbanin dhe administronin shkollat e veta. Nga ky këndvështrim, Mbretëria Shqiptare, në një farë mënyre, shkonte kundër impenjimeve të marra në LK. Themi në një farë mënyre, pasi ligjet e aprovuar kishin karakter gjithpërfshirës dhe nuk ishin aspak diskriminues kundrejt pakicave që jetonin në vend. Synimi i qeverisë ishte, gjithashtu, të kontrollonte gjithë shkollat private pasi, një pjesë e konsiderueshme e tyre drejtoheshin nga kisha greke dhe subvencionoheshin nga shteti grek. Këto shkolla shumë herë ishin bërë vatër propagandës greke, e cila kishte si qëllim aneksimin e zonave të Shqipërisë së Jugut.

Për më shumë shkollat minoritare kishin luajtur një rol të rëndësishëm në përhapjen e kulturës greke dhe helenizimin e popullsisë ortodokse të Shqipërisë së Jugut. Kultura greke kishte pasur një ndikim negativ në përhapjen dhe forcimin e ndjenjës kombëtare shqiptare, e cila në vitet e para pas Luftës së Parë Botërore ishte akoma zbehtë. Qeveria shqiptare i konsideronte themeltare reformat që do të çonin në shtetëzimin dhe unifikimin e

sistemit arsimor, sepse, këto reforma kishin si qëllim rritjen e një ndjenje kombëtare të përbashkët. Dhe do të ishte gjuha shqiptare ajo që do të ndihmonte, jo vetëm në forcimin e kulturës shqiptare por edhe në zhvillimin e një shteti modern. Gjithsesi, reforma e rëndësishme arsimore e ndërmarrë nga qeveria shqiptare nuk parashikone ndalimin e mësimdhënies në gjuhën amtare në shkollat që i përkisnin popullsisë minoritare.

Shqipëria do të vazhdonte gjatë gjithë dhjetëvjeçarit të respektonte impenjimet e marra përpara LK, në momentin e firmosjes së Deklaratës mbi të Drejtat e Minoriteteve. Politika e tolerimit e shtetit shqiptar do të pasqyrohej edhe në raport me minoritetet fetare në vend. Historikisht, Shqipëria ka pasur një popullsi e cila i përkiste tre besimeve fetare kryesore: besimi fetar mysliman, ortodoks dhe ai katolik. Dy të fundit numerikisht ishin në një pozicion minoriteti kundrejt besimit fetar mysliman, edhe pse në Shqipëri këto komunitete nuk janë parë si të tilla. Por, shteti shqiptar në momentin e firmosjes së deklaratës së lartpërmendur do të merrte impenjime, jo vetëm për minoritetet e racës dhe të gjuhës, por edhe për atë të fesë. Ky vendim, marrë nga Shqipëria në një moment shumë delikat për të, ishte një pranim nga ana e qeverisë të ekzistencës së minoriteteve fetare. Shteti shqiptar për të garantuar të drejta të barabarta për besimtarët e tre besimeve fetare, nëpërmjet Statutit Themeltar shpallte laicitetin e tij, duke proklamuar që vendi nuk kishte fe zyrtare. Ky qëndrim prodhonte dy efekte mjaft pozitive për shoqërinë shqiptare. E para sanksiononte ndarjen e pushtetit shtetëror nga ai shpirtëror, duke i dhënë mundësinë secilit nga besimet fetare të organizonin strukturat e veta në mënyrë të pavarur. Efekti i dytë arrinte të ndikonte në krijimin e një klime paqësore në shoqërinë shqiptare të kohës. Kjo

refleктоhej në pranimin dhe respektimin e festave fetare të besimeve të ndryshme nga e gjithë popullsia.

Politika e ndjekur nga shteti shqiptar përforcohej akoma më shumë me aprovimin e Statutit Legal të Komuniteteve fetare, i cili nuk bënte gjë tjetër veçse sanksiononte edhe njëherë pavarësinë e komuniteteve fetare nga shteti. Gjithashtu, Statuti në përputhje me “Deklaratën mbi mrojtjen e minoriteteve”, parashikonte mundësinë, që në ato zona ku flitej në gjuhë tjetër, të zgjidhej një kler që të fliste gjuhën amtare të minoriteteve fetare. Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të minoriteteve fetare do të vazhdonte të ndiqej edhe pas formimit të Kishës Autoqefale shqiptare, e cila në statutin e saj do të parashikonte që: në ato kisha ku besimtarët që e frekuentonin i përkisnin minoriteteve, gjuha e përdorur gjatë shërbimeve fetare duhet të ishte gjuha amtare e tyre. Krijimi i kishës shqiptare do të kalonte shumë vështirësi përpara se të arrinte autoqefalinë e saj, por pavarësisht këtyre vështirësive ajo në parimet e saj do të kishte në qendër të vëmendjes edhe respektimin e të drejtave të minoriteteve.

Gjatë viteve 1920-1930, për nga përbërja e popullsisë Shqipëria ishte një shtet homogjen, ku popullsia me kombësi joshqiptare ishte shumë e vogël. Gjatë kësaj periudhe edhe pse nuk kishte të dhëna statistikore të sakta identifikoheshin disa grupe minoritare, të cilat ishin: minoriteti kombëtar grek, minoriteti kombëtar malazez dhe minoriteti kombëtar maqedonas, pavarësisht se shteti maqedonas do të formohej më vonë. Në vend ekzistonin edhe dy grupe popullate, të cilat gëzonin statusin e minoritetit etnokulturor. Ato ishin minoriteti etnokulturor arumun dhe minoriteti etnokulturor rom. Nga këto grupe popullatash, minoriteti grek ka qënë më i rëndësishmi, jo vetëm për nga ana numerike, por

prezenca e shtetit grek do t'i jepte pothuajse një rol parësor në ndikimin që do të kishte mbi formimin e kulturës së Shqipërisë së Jugut. Ndryshe ishte roli që do të kishin minoriteti maqedoans dhe ai malazez, të cilët formonin komunitete të vogla dhe ishin të përqëndruar kryesisht në zona rurale të vendosura në afërsi të zonave kufitare. Këto grupe popullate nuk do të kishin ndonjë rol specifik në shoqërinë shqiptare. Lidhur me dy komunitetet etnokulturore, ai arumun ishte më i madh në numër dhe shumë pjesëtarë të këtij komuniteti do të kontribuonin në fitoren e pavarësisë së shtetit shqiptar. Si përfundim, komuniteti rom ishte më i paragjykuari nga popullsia vendase, e cila shprehte haptasi një nënvlerësim të kulturës së tyre. Rreth këtij komuniteti, gjatë viteve që është fokusuar studimi, mungojnë shumë të dhëna jo vetëm mbi numrin e saktë të tyre por edhe mbi vendbanimet ku ata jetonin.

Studimi mund të shihet në dy këndvështrime, të cilat bëjnë të mundur që lexuesi të ketë një ide më të qartë mbi atë që lexon. Fillimisht, gjatë punimit është tentuar, me anë të dokumentave zyrtare të kohës dhe librat e shkruar nga studiuesit e huaj dhe vendas mbi këtë argument, të paraqitet pozita juridike e minoriteteve në Shqipëri gjatë viteve ku është përqëndruar studimi. Nga materiali i siguruar evidentohet që minoritetet që banonin në territorin e shtetit shqiptar, u ishin siguruar nga qeveria pothuajse të gjitha të drejtat që komuniteti ndërkombëtar kërkonte. Përfundim nga ky këndvështrim bënte minoriteti etnokulturor rom, i cili ishte i paragjykuar dhe nuk i njëhej pothuajse asnjë e drejtë. Përgjithësisht shoqëria shqiptare dhe shteti ishin mjaft tolerues kundrejt kësaj pjese të popullsisë. Kjo tregohet në mundësinë që u jepej pakicave, jo vetëm në shpалosjen e lirë të kulturës, doket, zakonet dhe traditat e tyre por, mbi të gjitha në mundësinë që u jepej të

çelnin shkolla ku mësimi të zhvillohej në gjuhën amtare. Mësimi i gjuhës amtare në shkollat minoritare është një nga të drejtat më të rëndësishme pasi i jepte të drejtën antarve të kësaj popullsie të trashgonin identitetin e tyre kombëtar. Kjo politikë do të vashdonte edhe pas aprovimit të ligjeve që parashikonin shtetëzimin e gjithë shkollave private. Legjislatori parashikonte gjithsesi, që në shkollat që i përkisnin minoriteteve, mësimi të zhvillohej në gjuhën e tyre amtare. Por, legjislacioni i brendshëm lejonte, gjithashtu, që minoritetet të shprehnin lirisht bindjet e tyre fetare dhe shërbimet fetare të kryheshin në gjuhën e tyre amtare. Në këtë drejtim, Shqipëria ishte një nga shtetet më të përparuar dhe kulturuar të Gadishullit të Ballkanit.

Nga këndvështrimi i dytë mund të analizohet fakti se, regjimi i minoriteteve që garantonte e drejta ndërkombëtare u njihte të drejtat atyre zonave, ku pjesëtarët që i përkisnin pakicave përbënin shumicën e popullsisë, të kishin një autonomi lokale, pra të vetadministroheshin. Legjislacioni shqiptar parashikonte që Shqipëria ishte një shtet unitar me administratë të fortë qendrore dhe nuk linte vend për autonominë e qeverisjes lokale në zonat ku jetonin minoritetet. Kjo ndoshta, pasi duke parë dobësinë e insitucioneve shqiptare dhe rrezikun që i kanosej vendit nga shtetet fqinje, legjislatori e vlerësonte si të parakohëshme dhënien e të drejtës për t'u vetëqeverisur zonave ku minoritetet përbënin shumicën e popullsisë. Ky përfundim mund të shihet si pikënisje për zhvillimin e studimeve në fushën e të drejtave të minoriteteve.

BIBLOGRAFIA

Arkivat

C 93, M 48, 1922 VII, f. 4, Report of the Commission of Enquiry.

C 512, M 387, 1922, De la Commission D'enquete sur ses travaux, Societe des Nations, 20 Decembre 1921.

C 542. M 387. 1921. VII, League of Nations, Report of the Commission of Enquiry on its work from November 19th to December 20th, 1921.

C 547, M 150, 1921. VII, Extracts from and summaries of documents concerning the commission of enquiry in Albania, Lague of Nations.

C 781, Commission of Enquiry in Albania, Report of Activities from December 19th, 1922, to February 1st, 1923, J.J. Sederholm, 2 May 1923.

C 975/211/90, Memorandum submitted by his Majestys Government to Conference of Ambassadors, British Embassy, Paris, July 20, 1921.

C 1195, M 145, 18.01.1922.

C16554/580/90, The Marquess Curzon of Kedleston to Lord Harding, Foreing Office, August 17, 1921.

C. 5236, M. 155, 1922, korrispondencë e Xhafer Ypit drejtuar Sekretarit të Përgjithëshëm të Lidhjes së Kombeve.

C 6071/735/90, General report on Albania presented by the Commission of Enquiry to the Council of the League of Nation, April 24, 1922.

C 7570/735/90, Supplementary Report of the Commission of Enquiry In Albania submitted to the Council, May 12, 1922.

C 7810, Report of the Commission of Enquiry on its work from February 1st to the beginning of April 1923, League of Nations, 2 may 1923.

C 7811, Report of the Commission of Enquiry in Albania from Decembre 19th, 1922 to February 1st, 1923, J.J. Sederholms, 2 May 1923.

C7812, 2 May 1923, Final report of the Commission of Enquiry, League of Nations

MPJ, Bisedim në Këshillin e Shoqnisë se Kombevet mbi çështjen e minoritetit shqiptar dhe të pasunieve shqiptare në Greqi, qeshor, 1928.

MPJ, dosja, 86, fleta 24, Echange des populations Grecques et Turques musulmans d'origine albanaise en Grece, Athenes, 1924.

MPJ, dosja 86, fleta 95, Anex2. General report of the Delegation of the Mixed Commission entrusted with the investigation of the Albanianquestion, Athens, 1924.

MPJ, dosja 86, fleta 215, Moslems of Albanian origin in Greece, 1923

MPJ, dosja 96, fleta 71, Athinë, 1924.

MPj, dosja 101, fleta 34, korrispondencë e Prefekturës së Vlorës drejtuar Ministrisë së Punve të Brendëshme, Tiranë, 1921.

MJP, Dosja 101, Fleta 35, korrespondencë e Prefekturës së Elbasanit drejtuar Ministrisë së Punve të Brëndëshme, Elbasan, 1922.

MJP, Dosja 102, fleta 30, korrispondencë e Ministris së Arsimit, Tiranë, 1922.

MPJ, dosja 102, fleta 128, Tirane, 1922.

MPJ, dosja 102, fleta 141, Minorities in Albania, League of Nations, Geneva, 1922.

MPJ, dosja 102, fleta 302, Letter to associated press, 1922.

MPJ, dosja 131, fleta 514, Korrispondencë e Legatës shqipëtare në Parisë drejtuar Ministrisë së Punve të Jashtëme, Paris, 2 janar 1925.

MPJ, dosja 141, fleta 2, Lozana, 15 qeshor 1923.

MJP, dosja 163, fleta 14, korrispondencë e Ministris së Punve të Brëndeshme, Tiranë, 1922.

MPJ, dosja 164, fleta 7, Tiranë, 1922.

MPJ, dosja 164, fleta 8, correspondencë e Ministrisë se Arsimit drejtuar MPJ, Tiranë, 1922.

MPJ, dosja 164, fleta 10, Mbi shkollat sllavishte, Tiranë, 1922.

MJP, dosja 164, fleta,13, Mbi shkollat slavishte të Shkodrës e të katundit Vrakë, Tiranë, 1922.

MPJ, dosja 209, fleta 10, Tiranë, 1923.

MPJ, dosja 209, fleta 11, Mbi çështjen e Himarës, Tiranë, 1923.

MPJ, dosja 209, fleta 29, Mbi ankimet e disa himarjotëve, Vlorë 1923.

MPJ, dosja 210, fleta 53, Kisha Orthodhokse Autoqefale Kombëtare e Shqipërisë. Tiranë, 1923.

MPJ, dosja 211, fleta 6, Komisioni i hetimeve në Shqipri, Raporti i veprimtarisë që nga dhjetori deri 19, 1922 deri më 1 shkurt 1923, Lidhja e Kombeve, 1923.

MPJ, dosja 211, fleta 7, Lidhja e Kombeve, 1923.

MPJ, dosja 211, f.122, Rezervat me rëndësi, Tiranë, 1923.

MPJ, dosja 211, fleta 226, korrispondencë e Ministrisë së Punve të Brendëshme, Tiranë, 1923.

MPJ, dosja 211, fleta 235, Mbi shkollat grekophone, 1923.

MPJ, dosja 211, fleta 241, Marrë prej raportit të Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve, Du Journal Officiel, Mai 1923.

MPJ, dosja 221, fleta 9, Lidhja e Kombeve, 1923.

MPJ, dosja 303, fleta 6, Mbi shkollat e Himarës, Tiranë, 1923.

Statutet dhe Ligjet

Kodi Civil 1929, Botimet Toena, Tiranë.

Ligjet e Asimit, Mbretinija Shqiptare, Ministria e Arsimit, “Telegraf”, Tiranë, 1928.

Ligje mbi Reformen Agrare, Mbretinija Shqiptare, Kryesia e Keshillit Ministrues, Tiranë, 1930.

Statuti i Kishës Orthodhokse Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë, Shtyp.& Libraria Dhorë Koti Korçë, Korçë, 1923.

Dekret-ligje mbi formimin e Komuniteteve Fetare, Tiranë, 1929.

Libra

Agalliu Mimoza, *Mbrojtja ndërkombëtare e minoriteteve*, “Marin Barleti”, Tiranë, 2013.

Anastasi Aurela, *Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)*, Shtëpia botuese “PEGI”, Tiranë, 2007

Berati Dhimitër, *Shënime historike mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Lidhjen e Kombeve*, “HUSI BOROSHI”, Tiranë 2007.

- Bërxfholi Arqile, *Minoritetet në Shqipëri* (Studim Demografik), Tiranë, 2005.
- Bytyci Enver, *Shqiptarët, serbët dhe grekët*, “KOHA”, Tiranë, 2005.
- Castellan Georges, *Historia e Ballkanit (shekulli XIV-XX)*, “Çabej”, Tiranë, 1996.
- Collaku Robert, *Arumunët e Shqipërisë histori dhe dokumente-figura të shquara*, EMAL, Tiranë, 2001.
- Çabej Eqrem, *Shqiptarët midis perëndimit dhe lindjes*, “MçM”, Tiranë, 1994
- Danaj Koço, *Shqipëria natyrale*, “ERIK”, Tiranë, 2006.
- Dela Roka Roberto Moroco, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, “ELENA GJIKÀ”, Tiranë.
- Duka Valentina, *Historia e Shqipërisë 1912-2000*, “Kristalina-KH”, Tiranë, 2007.
- Durham Edith, Brenga e Ballkanit, “Argeta LMG”, Tiranë, 2009.
- Frashëri Kristo, *Himara dhe përkatësia etnike e himarjotëve*, Botimet Toena, Tiranë, 2005.
- Godart Justin, *Shqipëria në 1921, Urtësia Bektashiene*, Tiranë, 2015.
- Gusho Jani, *Arumunët e Shqipërisë, histori dhe dokumente-figura të shquara*, “EMAL”, Tiranë, 2001.
- Guy Nicola C, *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*, Botime Pegi, Tiranë, 2012
- Konica Faik, *Shqipëria Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore*, Shtëpia botuese “55”, Tiranë, 2010.

- Kristo P. Luarasi, *Ligji i administratës civile të Shtetit Shqiptar*, Shtypshkronja “Mbrothësija”, Tiranë, 1922.
- Liço Filip, *Probleme të marrëdhënieve greko-shqiptare*, Neraida, Tiranë, 2009.
- Llanaj Asqeri, *Kur historia flet vet, (Vështrim krahasues i disa periudhave historike)*, “Triptik”, Tiranë, 2003.
- Luarasi Aleks, *Akte juridike për historinë e shtetit dhe të së drejtës në Shqipëri*, “Luarasi”, Tiranë, 1999.
- Meta Beqir, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtare në Shqipëri (1912-1924)*, Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Historisë, Tiranë, 2013.
- Mousset Albert, *Shqipëria përballë Evropës (1912-1929)*, “DITURIA”, Tiranë, 2004.
- Omari Luan, *Sistemi parlamentar, Lindja dhe evolucioni i parlamentarizmit*, Bot. 4, “Elena Gjika”.
- Omari Luan, *Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri*, “Luarasi”, Tiranë, 2005.
- Omari Luan, *E Drejta Kushtetuese*, “ABC”, Tiranë, 2010
- Ortakovski Vladimir, *Minorities in the Balkans*, “Transnational Publishers”, Ardsley, 2000.
- Papajani Adrian, *Të drejtat e pakicave*, “Sejko” Elbasan, 2005.
- Poulton Hugh, *The Balkans Minorities and States in Conflict*, Minority Rights Group, London, 1991.
- Puto Arben, *Historia diplomatike e çështjes Shqiptare 1878-1926*, Akademia e Shkencave, Tiranë 2003,

Puto Aben, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Botime Toena, Tiranë, 2009.

Schevill Ferdinand, *Ballkani Historia dhe Qytetërimi*, Shtëpia Botuese “UEGEN”, Tiranë, 2002.

Selenica Teki, *Shqipëria më 1923*, Shtypshkronja “Tirana”, Tiranë, 1923.

Shundit Vangjel, *Arumunët e Shqipërisë histori dhe dokumente*, “Globus”, Tiranë, 2001.

Spahiu Dritan, *Monarkia Shqiptare (1928 – 1939), Reforma arsimore e realizuar në periudhën e Mbretërisë Shqiptare*, Botimet Toena, Tiranë, 2011.

Swire Joseph, *Shqipëria: Ngritja e një Mbretërie*, Williams&Norgate Ltd, Londër, 1929.

Të drejtat e Shqipnisë Ethnike, “Zoja e Paperlyeme”, Shkodër, 1944.

Verli Marenglen, *Aspekte rreth krijimit dhe zgjidhjes së çështjes shqiptare*, Vëllimi I, “KLEAN”, Tiranë, 2014.

Verli Marenglen, *Monarkia Shqiptare (1928 - 1939)*, Botimet Toena, Tiranë, 2011.

Vllamasi Sejfi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942*, “Marin Barleta”, Tiranë, 1995.

Zavalani Tajar, *Historia e Shqipnis*, “PHOENIX”, Londër, 1996.

Publikime Shkencore

Rizo Elona, *Vështrim historic mbi Përpyjekjet për përcaktimin e përkufizimit të minoriteteve*, f. 112, Jus &Justicia 1, Nr.1, Tiranë, 2008.

Web

Avenia Catello, Tutela internazionale delle minoranze, f.12,

<http://www.altalex.com/documents/neës/2012/07/12/tutela-internazionale-delle-minoranze>

Cerreti Claudio, Minoranze etnico-linguistiche, f.2, Enciclopedia dei ragazzi 2006,
[http://www.treccani.it/enciclopedia/minoranze-etnico-linguistiche_\(Enciclopedia_dei_ragazzi\)/](http://www.treccani.it/enciclopedia/minoranze-etnico-linguistiche_(Enciclopedia_dei_ragazzi)/)

Chanoux Emile, Memorie de licence delle minoranze etniche nel diritto internazionale,
l'Universita di Torino.

Kristafi Ksenofon, 95 vjet më parë, Shqipëria në Lidhjen e Kombeve,
<http://balkanweb.com/gazetashqiptare/95-vjet-me-pare-shqiperia-ne-lidhjen-e-kombev>

Meta Beqir, Lidhja e Kombeve dhe minoritetet në Shqipëri,
<http://www.forumishqiptar.com/threads/58759-Lidhja-e-Kombeve-dhe-minoritetet-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri>

Meta Beqir, Monarkia zogu bëri me prona bujqit minoritar,
<https://www.shqiperia.com/Monarkia-Zogu-beri-me-prona-bujqit-minoritare-.12186/>

Suran Fulvio, Somma Fabrizio, Ricerche sociali, Centro di Ricerche Storiche di Rovigo, f.
12, http://www.crsrv.org/pdf/ricerche_sociali/Ricerche_sociali_17.pdf